



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2020**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. JUNA 2020. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2020**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media,
5. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë (7) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
6. Propozimi i GP Nisma Socialdemokrate për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare,
7. Interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti,
8. Raportim i kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za tri (3) člana Nezavisne komisije,
5. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za sedam (7.) članova Borda Radiotelevizije Kosova.
6. Predlog PG Socialdemokratske Inicijative za izmenu poslanika u Parlamentarnim komisijama,
7. Interpelacija premijera Republike Kosovo, g-dina Avdullah Hoti,
8. Izveštavanje premijera Republike Kosovo i parlamentarna debata o dijalogu Kosovo - Srbija.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA : Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të bërë të ditur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Pika e parë, siç e dini, i kemi 30 minuta për deklarimet jashtë rendit të ditës. Diskutimi në emër të grupit zgjat pesë minuta, kurse diskutimi i deputetit tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fillimisht në emër të Grupit Parlamentar, po supozoj në emër të Grupit Parlamentar, e ka kërkuar fjalën deputeti Shpejtim Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetare!

Të respektuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Të dielën që lamë pas ishim dëshmitarë të hapjes së Kosovës ndaj Serbisë. Si rënia e tretë brenda pak ditësh. Ditën kur kjo Qeveri u votua nga gjithë deputetët e Listës serbe dhe kur hoqi reciprocitetin, nuk kishte mbetur tjetër veç pritjes për ndërhyrjen e radhës, secila më e rëndë se tjetra.

Të dielën që lamë pas, shteti i Kosovës pushoi së ekzistuari, sepse atë ditë territori i Kosovës shtrohej e poshtërohej nga mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë. Nga reklamat e posterët me logon e Kosovës pjesë të Serbisë e deri te votimi i anëtarëve të Kabinetit të Avdullah Hotit, përfshirë zëvendësin e tij.

Hapja e vendotimeve nëpër komunat e Kosovës, nga veriu deri në jug, nga Leposaviqi deri në Sharr, ishte cenim i rëndë i integritetit shtetëror.

Pretendimet e Serbisë i dimë të gjithë, por obligimi ynë është respektimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit. Kushtetutën e shkelët, lejuat mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, kështu legjitimuat e përligjët cenimin e integritetit shtetëror, sepse serbët e Kosovës nuk votuan si votues jashtë vendit përmes postës apo në zyrat ndërlidhëse, por votuan si shtetas të Serbisë brenda saj.

Po si mund të ishte ndryshe, e çfarë mund të pritej tjetër nga një Qeveri e paligjshme dhe pa legjitimitet, pothuajse me vetëm 40 vota të deputetëve shqiptarë.

Avdullah Hoti, i cili më 2017 kishte thënë se është për keqardhje dhe e turpshme që qeveria do të varet nga Lista serbe, sot lëvizet nga dy duar, nga Hashim Thaçi në njërin, e në tjetrin nga Lista serbe.

Kjo Qeveri e varur nga Lista serbe, ende pa bërë tri javë të plota, bëri tri veprime të dëmshme për sovranitetin e vendit. Vetëm tri ditë pas votimit hoqi masat e reciprocitetit ndajë Serbisë, vetëm 13 ditë pas votimit hoqi dorë edhe nga njohjet dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, kurse brenda tri javësh lejoi zgjedhjet e Serbisë në Kosovë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e saj.

Në këto tri javë kjo Qeveri po kompensonte ditët e humbura në Qeverinë Kurti për Serbinë dhe Listën serbe.

Më 21 qershor serbët e Kosovës nuk votuan siç votojnë serbët e Kroacisë, Sllovenisë e të vendeve të tjera, ku ka banorë serbë. Askund tjetër nuk u hapën vendvotimet me stemën e Serbisë. Ju që lejuat këtë, mohuat shtetin e Kosovës.

Deri sa po lejoheshin zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, në anën tjetër, në Podujevë ka mbi 3 muaj që janë pezulluar zgjedhjet për kryetar të Komunës. Privimi i qytetarëve të Podujevës nga e drejta kushtetuese për të zgjedhur kryetarin e Komunës po bëhet me vendime antikushtetuese të Presidentit, e me motiv politik, justifikimi për shkak të pandemisë tashmë është i pakuptimtë.

Nga 6 shkurti i këtij i viti, qytetarët e komunës së Podujevës janë pa kryetar komune, kjo për shkak të bllokimit të zgjedhjeve nga presidenti Thaçi. Atyre po u mohohet të kenë qeverisje lokale që del nga vullneti i qytetarëve me justifikimin se rrezikojnë shëndetin publik. Por, të dielën u organizuan zgjedhjet e Serbisë në Kosovë dhe me këtë rast ky justifikim ka rënë poshtë plotësisht. Sepse si mund të shpjegohet që zgjedhjet e Serbisë mund të organizohen, kurse ato të vetë komunave të Kosovës jo. Cila është porosia? Që ne kemi më pak të drejta, që minoriteti serb nuk është përgjegjësi e qeverisë sonë sa i takon shëndetit publik, se dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë, ku u votua të dielën, nuk janë komuna të Kosovës. Cila qoftë arsyeja, është antikushtetuese dhe e papranueshme.

Qytetarëve të Podujevës u garantohej e drejta për të zgjedhur, këtë të drejtë nuk mund ta mohojë presidenti me vendime antikushtetuese. Komuna si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale duhet të reflektojë pritjet e qytetarëve të saj. Kjo bëhet e mundur përmes organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të drejtpërdrejta.

Pengimi i zgjedhjeve është i qëllimshëm dhe po aq antikushtetues nga ana e presidentit. Askush nuk ka të drejtë e autorizime, e aq më pak presidenti që arbitrarisht të pamundësojë ushtrimin dhe përmbushjen e këtyre të drejtave, duke shtyrë pa afat mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të komunës.

Zgjedhjet në Podujevë duhet të mbahet ashtu siç parashihet me ligj, kurse Komisioni i Qendror i Zgjedhjeve të organizojë ato ashtu siç e ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Zoti deputet, në qoftë se ju jap juve kohë shtesë, duhet secilit deputet tjetër. Kështu që 30 sekonda për deputetin Bulliqi dhe pastaj për secilin tjetër do t'i kemi nga 30 sekonda.

SHPËTIM BULLIQI: Bllokimi i mbajtjes së zgjedhjeve në Podujevë nuk po bëhet për arsye të shëndetit publik. Për këtë president që bënte thirrje për mosbindje civile ndaj vendimeve të Qeverisë, nuk bëhet vonë as për shëndetin e as për shtetin. Ai po bllokoi këto zgjedhje si kthim favori ndaj LDK-së. Kjo e fundit i hapi rrugë planeve të tij, kurse Thaçi po i mundëson mbajtjen e komunës pa zgjedhje.

Sidoqoftë, shtyrja e zgjedhjeve nuk mund t'i pamundësojë ato, e as nuk e shmang dot fundin e keqkeqeverisjes në Podujevë dhe nuk mund.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Ekrem Hyseni e ka kërkuar fjalën, pesë minuta për deputetin.

EKREM HYSENI: E nderuar kryetare e Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,
Se pandemia COVID-19 na dha një mësim të shtrenjtë ne dhe botës, ne ishim vetë dëshmitarë.

U pa se krijimi i resurseve humane kur neve na duhen, është i pamundur siç ishte puna me specialistë të lëmenjve përkatës dhe po ashtu na doli që të jetë problem serioz. Nuk krijohet specialisti brenda ditës, po duhet të kemi një plan për resurse humane me afatgjatë që të jemi të përgatitur ndoshta jo për situatën siç ishte COVID-19, po për situata të ngjashme e të tjera.

Me këtë befasi të keqe globale, e cila u quajti COVID, u pa se ne mund të jemi të pafuqishëm dhe të papërgatitur, ashtu siç është edhe bota, po ashtu edhe ne si pjesë e saj.

Edhe sot që ne po flasim akoma jemi në pandemi dhe ka shumë pikëpyetje, siç janë: Kur do të përfundojë, si do të jetë imuniteti i njerëzve pas kalimit të pandemisë, a ka mundësi që pandemia të kthehet prapë edhe pyetje të tjera, të cilat mund të na lindin gjatë rrugës dhe gjatë menaxhimit të saj.

Duke e parë edhe shpërthimin e rasteve të reja pas lirimit të masave kufizuese tek ne edhe në botë ka mundësi që shumë projekte të supresohen dhe kjo mund të ketë një ndikim negativ dhe sëmundje të tjera që janë jo COVID, pra pas pandemisë, prapë ne kemi të njëjtat probleme në shëndetësinë kosovare, siç kanë qenë kanceri, sëmundjet e zemrës, mushkërive dhe sëmundjet e tjera jo COVID, nuk kanë pauzë pra, këto nuk mund të presin derisa të kalojë pandemia dhe mendoj se këtyre grupeve të sëmundjeve gjatë kohës së pandemisë u kemi hyrë në hak me qasje të kufizuara në institucione dhe shërbime shëndetësore.

Proceset e avancimit të shërbimeve shëndetësore nuk duhet të lidhen vetëm me pandeminë, duhet dhënë prioritet me masa të shpejta dhe të prekshme nga qytetari, edhe të problemeve të tjera të mëhershme, me bindje të plotë se Qeveria Hoti dhe ministri i Shëndetësisë, zoti Zemaj, do t'i kenë prioritet të gjitha këto. Ne jemi të bindur se duhet të marrin një ndryshim në dinamikën e këtyre punëve dhe ky ndryshim duhet të jetë në nivel të përsheptimit të tyre.

Spitali Regjional i Podujevës, spitali i Prishtinës, specializimet, punësimi i stafit shëndetësor, siç janë specialistët, infermierë edhe profesionistë të tjerë, duhet pra të jetë një prej atyre parimeve dhe do të jetë një prej pikave të këtij programi qeverisës gjatë këtij mandati.

Probleme si kujdesi paliativ po ashtu paraqet një prej shërbimeve të munguara në Kosovë, ky si shërbim realisht paraqitet si hall i madh për qytetarët, po edhe për familjen.

Pacienti që ka nevojë për trajtim të dinjtetshëm... dhe deri më sot kjo barrë bie vetëm mbi familjen me shërbime të kufizuara, ndoshta jo në kohën e duhur dhe prapë me një cilësi të dyshimtë. Është me imponim që ky shërbim të ofrohet duke kujtuar se edhe gjatë proceseve integruuese të Kroacisë në një moment BE-ja ka pasur si kriter edhe shërbimin paliativ ndryshimin e tij në Kroaci.

Investime të tjera në drejtim të shërbimeve të tjera po ashtu janë imediate për të përmirësuar shërbimet ekzistuese dhe njëkohësisht të ofrohen shërbime të tjera, të cilat i kemi mungesë pra shërbime deficitare.

Dhe, në fund, duke e parë punën e madhe të institucioneve shëndetësore dhe stafit të tij, kolegëve tanë të cilët punojnë në këto institucione, shfrytëzoj rastin që nga ky institucion të falënderoj punëtorët shëndetësorë, pra me apelin tash të njohur, ta ruajmë distancën, të përdorim maskat

mbrojtëse dhe higjienën personale për t'i ndihmuar veten dhe institucionet, stafin shëndetësor drejt kalimit sa më të shpejtë ndaj pandemisë COVID.

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Ka kohë që në këtë Kuvend përplasemi për tema të ashtuquajtura të mëdha dhe rrallë herë po mund të trajtojmë tema, të cila drejtpërdrejt e prekin dhe rëndojnë jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Njëra ndër masat e shumta kufizuese që u bënë nga Qeveria në kohën e pandemisë ishte edhe mbyllja e kopshteve private, mbyllje kjo që sikurse shumë sektorë, pati pasoja të mëdha për faktin e problemeve, të cilat e shoqëruan këtë veprimtari.

Të gjithë e dimë që bizneset private kanë humbur shumë financiarisht, por kanë humbur shumë edhe personat fizikë.

Po flas në këtë rast për një problem shumë specifik për kopshtet apo çerdhet private në Kosovë.

Ne të gjithë këtu e dimë se çmimet astronomike të këtyre kopshteve të cilat nuk janë aspak të standardizuara me kushtet që i ofrojnë ato, po flas për një pjesë të tyre. Ne si shtet dhe shoqëri jetojmë në një sistem kushtetues, ku koncepti i zhvillimit ekonomik bazohet në parimin e ekonomisë së tregut të lirë dhe promovimit të konkurrencës së lirë.

Megjithatë, nuk mund të qëndrojmë indiferent përballë abuzimeve që kanë ndodhur me ngritjen e çmimeve të këtyre çerdheve në raport me shërbimet që ato ofrojnë.

Gjatë periudhës së pandemisë kemi pranuar shqetësime dhe brenga të shumta nga prindër, të cilët kanë telefonuar nga këto kopshte, duke kërkuar shuma parash për shërbime që nuk i kanë marrë, domethënë kanë kërkuar pagesë mujore për fëmijët që nuk i kanë dërguar në kopsht në mënyrë që t'i paguajnë punëtorët, përderisa e dimë se edhe Ministria e Arsimit ka afruar një shumë të njëjtë për të njëjtit punëtorë.

Po ashtu, këto kopshte në një farë mënyre po i kushtëzojnë prindërit për t'i dërguar fëmijët e tyre, qoftë edhe të sëmurë, përndryshe duhet të paguajnë shumën e plotë edhe nëse nuk e dërgojnë fëmijët për t'i siguruar vendin për muajin tjetër të ardhshëm.

I nderuar ministër i Arsimit dhe ju ministre e Financave, disa nga kopshtet private po i ngritin çmimet pa asnjë standard për ta kompensuar humbjen e tyre gjatë periudhës së izolimit dhe kjo dukuri duhet të ndalet menjëherë.

A e dini çka do të thotë për një prind të ri, me së paku dy fëmijë, të punojë vetëm për të paguar kopshtin e fëmijëve. A e dini që një prind me pagë mesatare në Kosovë ka edhe obligime të tjera financiare, përveç pagesës së kopshtit të fëmijëve.

Me burokracinë dhe masat e pakapërcyeshme për regjistrim nëpër kopshte publike po mundësohet një prind me pagesë mesatare që ta dërgojë fëmijën e tij në kopshte publike.

Në anën tjetër, kopshtet private po e shfrytëzojnë mirë këtë hapësirë dhe shkojnë e rrisin çmimet çdo ditë, pa asnjë kontroll, disa nga ata i ikin edhe tatimit, sepse kërkojnë pagesa kesh dhe nuk lejojnë të lëshohen kuponë fiskalë. Shumë prindër po i nënshtrohen një rritjeje çmimi prej 30 ose 50 euro në momentin e fundit dhe pa paralajmërim, duke pasur parasysh që nuk ka zgjidhje tjetër.

Nëse institucionet kompetente heshtin dhe mbyllin sytë para kësaj dukurie, le ta dinë se po e rrënojnë ekonominë familjare dhe po e pamundësojnë natalitetin, duke mos i standardizuar çmimet nëpër kopshte private dhe duke u pamundësuar prindërve që të regjistrojnë fëmijët nëpër kopshte publike me procedura burokratike që i keni për regjistrim.

Ministria e Arsimit, meqenëse i licencon këto institucione, do të duhej urgjentisht të urdhëronte Inspektoratin e Arsimit që të inspektojë parregullsitë në çerdhe dhe të vijë në një raport para këtij Kuvendi me të gjeturat dhe problemet e identifikuara.

Kolegë të nderuar,

Veçmas ju anëtarë të Komisionit Parlamentar për Arsim, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ju lutem shumë tash ka nevojë më shumë se kurrë për një inspektim të detajuar financiar nëpër kopshte private dhe nxjerrjen e një rregulloreje, e cila do t'i përcaktonte standardizimin e çmimeve në proporcion me kushtet që i ofron kopshti.

Po ashtu kërkoj që t'i ulni kriteret për regjistrimin nëpër kopshte publike, sepse kjo gjendje është e papërbalueshme dhe po bëhet edhe e padurueshme për prindërit e rinj sidomos në Kosovë.

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Albena Reshitaj.

ALBENA RESHITAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Fatkeqësisht u desh që të paraqitet një gjendje, e cila ndodh një herë në rreth 100 vjet, si pandemia COVID-19, në mënyrë që mangësitë në sistemin tonë shëndetësor të dalin në pah, e më pas të bëhen temë diskutimi.

A duhet të ballafaqohemi ne si popull me pasojat për të kuptuar rëndësinë që duhet të punohet në eliminim të shkakut.

Në këtë periudhë të ketë mungesa të mëdha në personelin shëndetësor në tërë Kosovën, aq sa u desh që pothuajse të gjitha institucionet shëndetësore të angazhojnë mjekë e infermierë vullnetarë për t'i mbuluar këto nevoja.

Gjendja e sistemit shëndetësor do të vazhdojë të rëndohet edhe më tutje nëse ne nuk vetëdijesohemi, nuk reflektojmë fatkeqësisht duke pasur parasysh këtë situatë qysh tani edhe në rishikim të buxhetit.

Unë vazhdimisht kam pasur takime me përfaqësues të sindikatave mjekësore, grupeve të interesit dhe njohës të mirë të fushës së mjekësisë e që lidhen me çështje buxhetore.

Meqë jemi te rishikimi buxhetor, unë dua të adresoj disa mangësi që tani me qëllim që nesër të mos bëhet vonë.

Ashtu që gradualisht të përmirësojmë gjendjen e sistemit shëndetësor e të mos lejojmë që brenda 5 deri në 10 vjet të shkojmë drejt një katastrofe shëndetësore.

Një shqetësim imi konkret është edhe pse çdo vit është parashikuar buxhet për hapjen e konkursit për specializime, ky buxhet gjithmonë ka shkuar në linja të tjera buxhetore dhe problemi i resurseve humane në shëndetësi nuk u adresua asnjëherë në katër vjetët e fundit.

Më poshtë më lejoni të flas për fakte, të cilat aktualisht flasin për gjendjen e shëndetësisë kosovare dhe janë çështje që kërkojnë zgjidhje urgjente.

Kosova nuk qëndron aspak mirë për sa i përket numrit të mjekëve në krahasim me vendet e rajonit, në total ka 2,3 mjekë për 1 000 banorë, e këtu përfshihen mbi 600 mjekë të përgjithshëm, e që thotë se numri i specializimeve për 1 000 banorë është edhe më i vogël se kaq.

Deri më 31 dhjetor 2019, në Gjermani janë të regjistruar 331 mjekë me pasaporta kosovare. Sipas një ankete që kanë bërë mjekët e rinj që po i presin specializimet, nëse nuk hapen specializimet brenda vitit 2020, rreth 70 prej tyre do ta lëshojnë Kosovën.

Duke llogaritur që Kosova apo Kosovës i kushton 100 mijë euro një mjek i diplomuar, kurse Gjermanisë i kushton 400 mijë euro, i bie që deri më 31 dhjetor 2019 ne kemi humbur mbi 30 milionë euro investime në mjekët tanë, kurse Gjermania ka përfituar donacion të trurit kosovar në vlerë prej 132 milionë euro, po flasim për mjekë të përgjithshëm pa llogaritur këtu një numër të jashtëzakonshëm të infermierëve.

Deri në fund të vitit 2022 mbi 250 mjekë do të dalin në pension dhe jemi dëshmitarë që brenda pesë vjetëve një pjesë e reparteve apo klinikave në spitalet rajonale kanë tendencë rrezik të mbylljen, pikërisht për shkak të këtij keqmenaxhimi që ka ndodhur viteve të fundit.

Tashmë jemi prapa dy vjet për të mbuluar nevoja që krijohen me vende vakante nga dalja në pension e mjekëve tanë.

Gjithashtu është pikërisht kjo edhe mungesa e profilizimit të spitaleve rajonale që çon drejt mbylljes së këtyre spitaleve. Numër jashtëzakonisht i madh i mjekëve në këto spitale do të dalin në pension paramendojeni, për t'i zëvendësuar këta mjek me specialist të rinj duhet që mjekët të fillojnë qysh këtë vit në mënyrë urgjente specializimet.

Po ashtu është shumë e rëndësishme që të bëhet profilizimi i spitaleve rajonale, ashtu që të shtohet numri i reparteve, të cilat nuk ekzistojnë fare, disa prej tyre janë shuar apo nuk janë funksionalizuar fare.

Mbi 4000 mjekë sa janë në total në Kosovë, rreth 1 300 prej tyre i takojnë grupmoshës 50 deri 59 vjet, që do të thotë se një periudhë 10-vjeçare të gjithë do të dalin në pension, afër 30% e mjekëve kosovarë, domethënë humbim 30% të mjekëve dhe ne nuk kemi përgatitur kuadro të reja, të cilët do t'i zënë këto vende.

Sipas SHSKUK-së, 22% janë mjekë specialistë, kurse 19% janë staf jomjekësor. Gjithashtu duhet të kërkojmë që të rritet numri i vendeve të punës për mjekë, për specialistë dhe të ulet numri i vendeve të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Deputeti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Nëse është datë 24 qershor, një datë e cila identifikon komunitetin egjiptian me ditën e tyre, me komunitetin i cili jeton dhe vepron në Ballkan, andaj në situatën të cilën gjendemi në situatë pandemie, ku ne jemi të kufizuar për veprime dhe manifestime, të cilat janë tradita të ne, shfrytëzoj rastin në këtë pikë të rendit të ditës të uroj komunitetin tim egjiptian, duke u dëshiruar dhe duke uruar që ky komunitet në vitet e ardhshme të numërojë raste pozitive të ngritjes, qoftë në fushën e arsimit, punësimit në çështje të tjera në jetë cilësore, ku qasja në institucionet lokale dhe qendrore të jetë më e mundshme.

Pse po e ngre këtë pikë, për shkak se ne sigurisht që po ballafaqohemi edhe sfidohemi çdo herë dhe përpiqemi bashkë me institucionet, e në këtë rast edhe me Qeverinë që ne të kemi një pozitë më të mirë edhe të punojmë në këtë drejtim.

Andaj, pa dashur ta zgjas shumë, edhe një herë uroj dhe ftoj Qeverinë që vërtet vitin e ardhshëm të numërojë të arriturat e përbashkëta, ku ne të kemi mundësi për rezultate, ku është i nevojshëm dhe besoj që do t'i kemi parasysh çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin egjiptian.

Andaj, edhe një herë uroj komunitetin për këtë ditë dhe ju them që jam shumë krenar me identitetin tim. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Labinotë Demi-Murtezi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, kryetare!

Java që lamë pas ka qenë më e rënda sa u përket rasteve me COVID-19 në Kosovë, për shtatë ditë janë regjistruar përafërsisht 700 raste, duke bërë kështu që të rritet edhe fluksi i atyre që kërkojnë trajtim e në këto momente e kemi të stërmbytur Klinikën Infektive.

Në anën tjetër, Ministria e Shëndetësisë nuk ka as strategji e as plan të përballjes me numrin e shtuar të të infektuarve.

Derisa numri i të prekurve shtohet, qytetarët janë në terr informativ me vendimin që të mos testohen kontaktet e kontakteve, por vetëm ata me simptoma të rënda, të cilët paraqiten në klinika si dhe mbi 150 ekstrakte që janë marrë dhe që nuk kanë hyrë ende në laborator. Qeveria ua ka kthyer shpinën qytetarëve jo vetëm për ata që nuk janë prekur, por po braktis edhe të prekurit potencialë, madje edhe të infektuarit.

Sot kur po shohim rritjen e vazhdueshme të rasteve, Ministria e Shëndetësisë pasi ka humbur kontrollin mbi situatën, mungesën e profesionalizmit dhe përkushtimit po synon ta mbulojë me mbylljen nga transparenca institucionale.

Ju në programin tuaj qeverisës ndër të tjera keni thënë se duhet të vlerësohet shtrirja e imunitetit natyror ndaj COVID-19 në një pjesë të rëndësishme të popullatës, nëse keni vendosur për imunitet kolektiv, duke toleruar shtrirjen e infeksionit ju jeni të detyruar që t'i njoftoni qytetarët, e këtë nuk e keni bërë.

Hapja graduale e planifikuar më herët nuk ka qenë vetëm një frazë, por një vlerësim i kujdesshëm dhe i planifikuar, ajo duhet të ishte zbatuar pikë për pikë nga ana e juaj, përndryshe ajo do të quhej “vrasje në masë”.

Gjithë sakrificat e bërë nga të gjithë prej muajit mars e deri më 1 qershor është shpërdoruar në këto dhjetë ditë e fundit nga ana e juaj, avancimi në menaxhim dhe vënia nën kontroll të plotë të përhapjes së pandemisë nga ana e Qeverisë Kurti, ju e përmbysët dhe e nxorët tërësisht jashtë kontrollit vetëm brenda pakë ditësh.

Ndryshimi i përnjëhershëm i strategjisë, nëse veç është strategji, kjo ju që po bëni dhe heqja me shpejtësi e masave nuk është shoqëruar me asnjë plan veprimi konkret. Tani që po flasim, instituti ka dalë jashtë kapaciteteve të veta, kushdo që ka vendosur që ta dorëzojë Kosovën te tezat e imunitetit kolektiv, pa kurrfarë vlerësimi paraprak, ose është dashakeqës ose është plotësisht i paditur.

Kjo po dëshmon se situata e tanishme me COVID-19 po del nga kontrolli, shtretërit po mbushen e potenciali shëndetësor po tregohet i pafuqishëm nga rritja e numrit të të infektuarve edhe në mesin e personelit shëndetësor, paaftësia dhe papërgjegjësia profesionale tashmë po përkethehet në shifra rekorde të të infektuarve dhe humbje e besimi qytetar në institucione.

Andaj, të dashur qytetarë,

Ju vazhdoni të kujdeseni për shëndetin tuaj duke e ruajtur distancën sociale dhe duke përdorur maskat aty ku nuk mund ta mbani distancën, mbani higjienën personale dhe evitoni në maksimum kontaktet me familjarë e shoqëri. Dikur ishim storje suksesi në botë për luftimin e pandemisë, e sot jemi në mëshirën e fatit.

KRYETARJA: Deputetja Evgjëni Thaçi-Drăgusha e ka fjalën.

EVGJËNI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit!

Përsëndetje për të gjithë,

Në fakt, edhe unë do të flas për një temë që u fol nga kolegu Bulliqi, po hallin unë nuk e kam te qytetarët e Podujevës në këtë rast, por te qytetarët e Luginës së Preshevës.

Nuk e kam hallin e qytetarëve të Podujevës, sepse ata veçse e kanë një qeverisje lokale të zgjedhur në mënyrë demokratike që vepron në bazë të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe e cila kujdeset për ta, zgjedhjet do të mbahen shumë shpejt dhe ju mund të shkoni të bëni garë, të bëni fushatë dhe fitoftë më i mirë, unë uroj këtë.

Pra, të dielën, më 21 qershor, u mbajtën zgjedhjet parlamentare në Serbi, ku për herë të parë të gjitha partitë që përfaqësojnë shqiptarët atje u bashkuan në një listë zgjedhore, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm për përfaqësim të dinjitetshëm dhe avancim të kërkesave të qytetarëve nga tri komunat me shumicë shqiptare në Serbi, edhe pse me një rezultat jo të kënaqshëm, unë inkurajoj të gjithë përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit e të Medvegjës që të vazhdojnë bashkëpunimin për avancimin e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve atje, të cilët konsiderohen si populli më i diskriminuar në Evropë.

Nga ana tjetër, është për keqardhje dhe e pakuptueshme që Qeveria e Kosovës nuk bëri as hapin më të vogël për të ndihmuar në këtë çështje shumë të rëndësishme.

Ne e dimë se mijëra qytetarë të Luginës së Preshevës jetojnë në Kosovë. Përderisa votimi për zgjedhjet në Serbi u lejua dhe u organizua për qytetarët serbë nëpër komunat me shumicë serbe një gjë e tillë nuk u bë edhe për shqiptarët me të drejtë vote në këtë zgjedhje.

Disa prej tyre në mënyrë të paorganizuar shkuan dhe votuan në komunat prej nga vijnë, por shumica prej tyre nuk patën mundësi të shkojnë të votojnë, sepse Qeveria jonë mbajti një rol komplet pasiv, duke ulur kështu mundësinë e përfaqësimit me më shumë deputetë në Parlamentin e Serbisë.

Ministrat e Qeverisë së Kosovës u mjaftuan me postime në rrjete sociale, ashtu siç do të mund të deklaroheshin për zgjedhjet në secilin vend të botës. Me këto veprime ose mosveprime, Qeveria bëri diskriminim në baza etnike dhe përjashtoi veten nga përgjegjësia që ka për kujdes ndaj këtyre qytetarëve që vijnë nga Lugina e Preshevës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga kjo përgjegjësi nuk amnistohen as udhëheqësit e komunave tona, e sidomos tri komunave, ku përqendrimi i qytetarëve nga lugina është më i madh, Gjilani, Fushë-Kosova dhe Prishtina, kryetarët e të cilave komuna në kohë fushate nuk hezitojnë që çështjen e luginës ta përdorin për agjenda politike elektorale.

Qeveria qendrore dhe ajo lokale në Kosovë duhet t'i ndihmojnë shqiptarët e luginës me gjëra të prekshme, të cilat ndikojnë direkt në përmirësimin e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Me kaq ka përfunduar koha e paraparë për Deklarime jashtë rendit të ditës.

Në emër të Qeverisë, fjalën e ka kërkuar kryeministri.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë dëshiroj dy çështje të adresoj dhe të përgjigjem në interesimet tuaja.

E para lidhur me zgjedhjet që ndodhën në Serbi në vikendin që shkoi, të cilat për hir të së vërtetës organizohen në Kosovë nga OSBE-ja, ata kanë kërkuar të kenë kësaj radhe 140 pika grumbulluese, nuk janë lejuar. Unë kam lejuar të njëjtat aranzhime që i kanë hasur institucionet e Kosovës nga viti 2012 e këndeje nën menaxhimin e OSBE-së. Tash më lejoni prapë të jem shumë i drejtpërdrejtë, kjo kërkesë, sepse OSBE-ja nuk e merr përsipër organizimin e këtyre pikave grumbulluese pa një miratim të institucioneve të Kosovës, kërkesa ka qenë në qeverinë paraprake nja dy tri javë dhe ka pritur aty në zyrë, as nuk është miratuar as nuk është refuzuar kjo është e vërteta.

Për zgjedhjen në Luginën e Preshevës për vendet që kanë fituar përfaqësuesit shqiptarë në Kuvend atje, është mirë që kësaj radhe kanë garuar me listë të përbashkët dhe unë i kam takuar përfaqësuesit e tyre në zyrën time, po unë nuk bëj as postime në Facebook e as nuk i nxjerr para kamerave, atë që e kam thënë, është që e kanë mbështetjen e plotë edhe tani më jemi angazhuar përmes zëvendëskryeminstres që të organizojmë mbledhje të përbashkët mes Kosovës edhe Shqipërisë për një pako mbështetëse gjithëpërfshirëse edhe në arsim, edhe në shëndetësi, edhe në qeverisje lokale, edhe në ekonomi, që do të jetë pjesë e marrëveshjeve mes dy qeverive për të ndihmua shqiptarët në Luginën e Preshevës.

Sa i përket menaxhimit me situatën në shëndetësi me COVID-19, më lejoni t'ju them që jemi duke ndjekur strikt protokollet që lëshon Organizata Botërore e Shëndetësisë edhe Komisioni Evropian në të gjitha masat që po ndërmarrim për lehtësim të funksionimit të ekonomisë dhe të shoqërisë, jemi duke ndjekur këto protokolle edhe këto vendime për lehtësim të masave janë të ekspertëve shëndetësorë. Unë nuk do të lejoj asnjëherë që vendime të tilla të bëhen politike, po ju ftoj edhe juve që të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim që të mos shfrytëzohet asnjëherë në deklaratimet tona publike situata e pandemisë për të akuzuar këtë qeveri ose këdo tjetër. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Evgjëni Thaçi-Dragusha, replikë dy minuta, dhe pastaj deputeti Bulliqi.

EVGJËNI THAÇI-DRAGUSHA. Faleminderit!

I nderuar kryeministër, faleminderit për përgjigjen tuaj,

Në fakt, veç desha që këtë adresim ta bëni si kryeministër, ju e drejtoni Qeverinë e Republikës së Kosovës, jo një organizatë joqeveritare. Nuk mund të thoni që kam takuar njerëz nga Lugina, po s'i kam bërë postime se nuk më duhen postimet, përkundrazi unë mendoj që është dashur të bëni postime, të bëni thirrje për dalje në votime atje, ka qenë interesi i të gjithëve, ka qenë në interesin e të gjithëve që qytetarët e Luginës së Preshevës të dalin masivisht dhe të votojnë për atë listë, të cilën ata kanë punuar shumë që të jenë të bashkuar dhe të dalin sa më mirë atje.

Prapë po e potencoj, keni bërë gabim që nuk keni bërë asnjë hap në lidhje me inkurajimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të cilët jetojnë në Kosovë që të shkojnë dhe të votojnë ose të organizohen zgjedhjet në Kosovë, ashtu siç janë organizuar zgjedhjet nëpër komunat me shumicë serbe. Nuk mund të thoni se kështu është bërë edhe më herët, kështu veç kemi vazhduar, kështu e ka lënë Qeveria e kaluar, jo, nuk mund të thoni. Duhet të bëni ndryshimin për të cilin jeni zgjedhur, për të cilën deklaroheni që i keni marrë votat. Faleminderit!

KRYETARJA: Edhe deputeti Bulliqi e ka kërkuar fjalën. E quajta gabim replikë, në fakt sipas nenit 48 të Rregullores që e kam sqaruar herën e kaluar ndaj deklarimeve të Qeverisë kanë të drejtë deputetët të bëjnë komente të shkurtra apo pyetje shtesë për sqarim. Urdhëro, deputeti Bulliqi, në përputhje me nenin 48.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zonja kryetare!

Sa për njohurin e zotit Hoti, po ia përkujtoj që në Kosovë nuk ka pasur grumbullim të votave të serbëve, por janë realizuar votime të rregullta të popullatës serbe në tërë territorin e Kosovës në ato komuna ku janë shumicë.

Prandaj, zoti Hoti ka pasur për obligim që së paku këtyre partive politike, të cilat e kanë kokën në Serbi, t'ua ndaloj këto lloga, në të cilën lloga kanë bërë fushatë zgjedhore dhe në cilën Kosova ndodhet si pjesë integrale e Serbisë. Këtë punë ka qenë detyrë e Qeverisë ta bëjë, po meqë nuk e ka bërë dhe po e pranon që është bashkëpjesëmarrës i organizimit të këtyre zgjedhjeve, atëherë le ta dinë edhe qytetarët e Kosovës cili ka qenë kontributi i tij në këtë proces.

KRYETARJA: Për çështjen e njëjtë, deklarin e kryeministrit, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Sa i përket çështjes së zgjedhjeve në Luginën e Preshevës, fillimisht u tha katër, pastaj tri, tash dy dhe kjo tendencë sjell në mendimin që ne tash duhet t'i fajësojmë qytetarët e Luginës së Preshevës, Bujanocit e Medvegjës që ata nuk paskan qenë mjaftueshëm unikë që të

fitojnë më shumë vende. Nuk është problemi te ta, problemi është te Prishtina dhe te Tirana, problemi është te negociatat, problemi është te kushtëzimet, ata duhet të kenë ulëse të rezervuara dhe pastaj nuk kanë pse të bëhen unikë të luftojnë në garë me njëri-tjetrin, të luftojnë për vendet që i kanë. Pra, njëjtë të sikurse serbët në Kosovë që i kanë ulëset e rezervuara, duhet t'i kenë edhe qytetarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

Pra, edhe për kryeministrin nga Tirana, zotin Edi Rama, po edhe këtu në Prishtinë kërkesa duhet të drejtohet karshi Serbisë për ulëset e rezervuara, e jo karshi shqiptarëve të kërkohet nga ata të bëjnë diçka të pamundur, e nëse nuk arrijnë ta bëjnë, pastaj edhe t'ua lëmë fajin.

KRYETARJA: Deputetja Blerta Deliu, a e dëshironi për këtë temë fjalën, sepse vetëm për këtë lejohet, atëherë deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit! Meqë jemi në temën e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Dua ta di që edhe një herë mbi çfarë baze janë lejuar këto zgjedhje të mbahen në territorin e Republikës së Kosovës. A ka qenë kryeministri i vetëdijshëm që ato zgjedhje janë mbajtur edhe në komuna joserbe, për shembull, në komunën e Dragashit, e cila ndodhet në jug të Kosovës dhe kufizohet me Republikën e Shqipërisë, pra nuk ka pakicë serbe aty që të lejohet mbajtja, kanë fituar komunitetet joshumicë, joserbe, pra. A kanë qenë në dijeni institucionet e Republikës së Kosovës për këtë gjë, e para.

E dyta, cili është komenti juaj rreth pjesëmarrjes së zyrtarëve të lartë publikë që kanë pozitë në Republikën e Kosovës në organizimin e mbajtjes së zgjedhjeve paralele antikushtetuese në territorin e Republikës së Kosovës, pra nga zyrtarë dhe vartës personalisht të zotit Hoti. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Labinotë Demi-Murtezi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Pandemia mbetet shqetësimi që, siç duket do të na përcjellë edhe për një kohë të gjatë. Andaj, për momentin problemi kryesor është mendoj se është humbja e besimit qytetarë te Qeveria, te mosmarrja e përgjegjësisë bazuar në bazën profesionale.

Një tjetër problem është e kundërta e atyre që janë replikuar e që janë publikuar se ne do të bëjmë numër të madh të testeve, madje kemi pasur gëzim të deputetëve se nga një ministër që bënte izolim dhe numër të paktë të testeve, po vijmë te një ministër, i cili hap bizneset dhe bën numër të madh të testeve, ndërkohë që ndodh e kundërta, testet e marra nuk marrin rezultatet në kohën e duhur aspak në kohën reale dhe bëhet shmangie nga numri i tyre, edhe pse kjo nuk është alternativa e vetme përfundimtare.

Një tjetër problem që është shfaqur këto ditë sa i përket menaxhimit, është mosfunksionimi i numrave kontaktues, përmes të cilëve qytetarët në vazhdimësi kanë kontaktuar stafin shëndetësor ose kanë marrë edhe informatat lidhur me pandeminë.

Ne nuk kemi fajë kur ministri nuk e di se sa vatra infeksioni ka në vendin tonë, cilat janë termat kyçe që e përcjellin pandeminë, sepse nuk është i fushës së tij dhe kështu rrjedhimisht kjo reflekton në gjithë punën e menaxhimit sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë.

Ne jemi paragjykuar duke thënë se edhe i gëzohemi rritjes së numrit të të infektuarve, çka nuk është aspak e vërtetë, ne kemi bërë të pamundurën që ky numër të jetë sa më i vogël, që infeksioni të shpërndahet sa më pak. Ka humbur rrjedha e ciklit të të infektuarve në vendin tonë.

OBSH-ja jep standardet e përgjithshme. Ne duhet të reflektojmë karshi mundësive që i kemi. Deri tani është mbushur Klinika Infektive, e Pulmologjisë, e Dermatologjisë, pritet një tjetër në radhë që është e sëmundjeve sportive. E çka do të bëjmë tash kur parashihen si mundësi edhe spitalet regjionale që aspak nuk i plotësojnë kushtet për trajtimin e këtyre personave të infektuar me COVID-19...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kryetarja, e cila e adreson edhe një çështje në lidhje me atë që tha zoti Hoti dhe pas kësaj mund të drejtoheni.

VJOSA OSMANI: Lidhur me deklaratën e kryeministrit, një koment të shkurtër sa i përket çështjes së zgjedhjeve të Serbisë të mbajtura në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Në vitin 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar rezolutë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, duke vlerësuar që është shkelje e Kushtetutës, është shkelje e ligjeve në Kosovë dhe është shkelje e praktikave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në atë kohë ajo rezolutë i pati marrë 76 vota, në vitin 2012, pra, ka marrë vota edhe nga pushteti i atëhershëm, edhe nga opozita.

Për fat të keq që nga atëherë janë mbajtur zgjedhjet e Serbisë, por fakti që janë mbajtur nuk i bënë as të ligjshme e as në përputhje me Kushtetutën dhe me praktikat ndërkombëtare.

Në fakt, në qoftë se përmendet OSBE-ja si organizatë ndërkombëtare që e merr përsipër një detyrë të tillë, ju e dini që me Kushtetutën tonë delegimi i detyrave sovrane të institucioneve tona në raport me një organizatë ndërkombëtare mund të bëhet vetëm me ratifikim nga ky Kuvend.

Ka pasur raste kur në të kaluarën është deleguar ndonjë kompetencë e institucioneve të Kosovës tek organizma ndërkombëtarë, por kur pa i marrë 80 vota në këtë Kuvend, sepse Kushtetuta e qartë e parasheh procedurën. Pra, të delegohet sovraniteti tek OSBE-ja me gjithë dashamirësinë të kjo organizatë pa ratifikim në Kuvend, nuk është në përputhje me Kushtetutën. Prandaj, pyetja ime e thjeshtë sot për Qeverinë është kjo.

Cila është baza ligjore, nën një.

Cila është baza kushtetuese, nën dy, dhe

Cila konventë ndërkombëtare e lejojnë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve?

Do të mund të flisnim ndoshta për praktika ndërkombëtare sikur të kishim marrëdhënie diplomatike me Serbinë dhe sikur ata të kishin qoftë ambasadë, qoftë konsullatë të hapur në Kosovë, ku qytetarët me dy shtetësi do mund të votonin.

Meqenëse një gjë e tillë nuk ekziston është mirë të sqarohet në këtë Kuvend. Pse është shkelur vullneti i këtij Kuvendi, i bërë i qartë qysh në vitin 2012 për mosmbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës?

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Osmani! Zoti Hoti, a e dëshironi fjalën?

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Unë kisha në plan të përgjigjem, po besoj që në fjalën që kisha më herët i thashë të gjitha sqarimet e nevojshme edhe ju të gjitha i dini, po aq sa unë. Unë e shfrytëzoj rastin që t'i uroj deputetit Berisha nesër ditën e komunitetit egjiptian. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Natyrisht që i bashkohemi urimit edhe për deputetin Berisha, edhe për deputetin Elbert Krasniqi, por kjo nuk e arsyeton mospërgjigjen për një çështje kaq të rëndësishme, siç është mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të nenit 45 të Rregullores, koha për pyetje parlamentare është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një seancë plenare mund të parashtrojë më së shumti dy pyetje dhe parashtrimi i pyetjes nuk mund të zgjasë më shumë se dy minuta. Përgjigjja e anëtarit të Qeverisë

nuk mund të jetë më e gjatë se sa tre minuta. Deputeti ka të drejtë t'ia bëjë edhe një pyetje plotësuese anëtarit të Qeverisë, e cila nuk mund të zgjasë më tepër se një minutë. Përgjigjja plotësuese e anëtarit të Qeverisë nuk mund të zgjasë më tepër se dy minuta. Ju lus që të gjithë t'i përmbaheni kohës së kufizuar.

Në këtë seancë janë parashtruar 11 pyetje parlamentare.

Po filloj me deputetin Rasim Selmanaj, pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti. A është deputeti këtu? Fjalën e ka deputeti Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetare!

Pyetja ime për kryeministrin, zotin Hoti, është pse po ndodhin vonesat në kompensimin e mjeteve materiale ndaj ish të burgosurve politikë, të cilët kishin vuajtur vite të tëra nëpër burgjet e Serbisë?

Disa të burgosur pas çlirimit nga burgjet serbe kanë vdekur si pasojë e torturave, disa të tjerë janë invalidë dhe në moshë të shtyre. Me dhjetëra e qindra bashkëvuajtës jo rastësisht më kanë gjetur si adresë mua që si deputet për ta ngritur këtë çështje këtu në Parlament.

Për mua është e pakuptueshme kjo vonesë e kompensimit të mjeteve që u takojnë.

Kërkoj nga Qeveria menjëherë të fillojë me kompensimin e mjeteve ndaj ish të burgosurve politikë. Nuk është e ndershme t'i detyrojmë këta që janë meritore për lirinë e Kosovës që të dalin në protesta për një të drejtë të tyre që u takon e që është vendim i institucioneve të Kosovës.

Është hera e dytë që jam i detyruar të flas në Parlament për këtë çështje.

KRYETARJA: Fjala për kryeministrin.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar deputet Selmanaj,

Po e jep përgjigjen zyrtare që e kam nga Ministria e Financave. Ku me Ligjin numër 03/L-95 përcaktohen të drejtat, përgjegjësitë edhe çështje të tjera sa u përket ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

E Kreu IV i këtij ligji paraqet të themelohet komisioni qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë. Edhe në pikën katër specifikohet komisioni qeveritar, mënyra e funksionimit, e tjera, e tjera.

Në nenin 22, aty përcaktohen mjetet financiar për përmbushjen e këtyre obligimeve në kuadër të Ministrisë së Financave është i ndarë fondi prej 5.5 milionë euro që është i pashpenzuar për sivjet për këtë kategori, i paraparë si subvencione dhe ne do të procedojmë së shpejti në bazë të ligjit me këto pagesa.

KRYETARJA: A dëshironi pyetje plotësuese? Urdhëro, deputeti Selmanaj, e ka fjalën një minutë.

RASIM SELMANAJ: I nderuar kryeministër, Kjo fjalë se do të procedojmë së shpejti, a ka mundësi të dihet kur do të kompensohen këto mjete ndaj këtyre ish të burgosurve politikë. Meqenëse ekziston ai fond, atëherë pse po ndodhin këto vonesa që të implementohet kjo pagesë ndaj tyre.

KRYETARJA: Urdhëroni, dy minuta!

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: T'ju them të drejtën, nuk e di saktë pse ka ndodhur deri në këtë moment vonesa, po situata për ministrinë dhe për mua është e qartë, mjetet janë të ndara në bazë të ligjit, komisioni duhet të sjellë listat që i verifikon dhe ne do të procedojmë me pagesën e atyre listave deri në shumën prej 5,5 milionë euro për sivjet dhe shpresoj që do të përmbillet shpejt ky proces.

KRYETARJA: Deputeti Rasim Selmanaj, përsëri pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti.

RASIM SELMANAJ: Pyetja e dytë imja për kryeministrin Hoti është: Kur Qeveria e Kosovës do të marrë vendim që pushimorja e fëmijëve në Deçan t'i kthehet në pronësi Komunës së Deçanit?

Për juve, të nderuar deputetë dhe për opinionin dëshiroj t'i them disa fjalë lidhur me këtë çështje.

Pushimorja e fëmijëve në Deçan ishte dikur një vend turistik që ishte destinacion i fëmijëve nga mbarë hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe më gjerë. Aty që nga paslufta janë vendosur ushtarët e KFOR-it. Ne e vlerësojmë rolin e pazëvendësueshëm të KFOR-it në sigurinë e vendit tonë, por që prezenca e KFOR-it me qëllim të ruajtjes së manastirit tanimë nuk është e nevojshme, sepse sigurinë e këtij manastiri mund ta bëjë Policia e Kosovës.

Prandaj, një vendim i Qeverisë për kthimin e kësaj prone Komunës së Deçanit do të ishte i mirëseardhur jo vetëm për qytetarët e kësaj komune.

Qeveria Haradinaj e kishte sjellë në Parlament Ligjin numër 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe i njëjti ka kaluar në dy lexime.

Si dhe Gjykata Kushtetuese pas kërkesës së presidentit e kishte vlerësuar ligjin në përputhshmëri me Kushtetutën.

Tani Qeveria e Kosovës, bazuar në këtë ligj, mund të marrë këtë vendim për bartjen e kësaj prone Komunës së Deçanit që aty t’i rikthehet zhvillimi i turizmit dhe punësimit. Është në kompetencën dhe vullnetin e Qeverisë në marrjen e këtij vendimi.

Prandaj, pyetja dhe kërkesa ime e thjeshtë është: Që Qeveria me vendim të veçantë t’ia kthejë në pronësi apo në menaxhim pushimorin e fëmijëve, siç njihet sot si “Kampi Sparta”, Komunës së Deçanit, e jo të nxirret eventualisht në privatizim.

KRYETARJA: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar deputet, është me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, aty përcaktohet që AKP-ja është sigurisht organ i pavarur publik, i cili ushtron funksionet e veta në mënyrë autonome e tjera, e tjera. Edhe Agjencia si e tillë ka zotësi juridike për të menaxhuar me pronën që e ka në menaxhim dhe Agjencia i jep përgjegjësi këtij Kuvendi.

Qasja jonë si qeveri është kjo, që ne të ndalim procesin e privatizimit, që ne të analizojmë të gjitha pronat që ende nuk janë privatizuar dhe në konsultim me komunat të listojmë ato prona që mund t’i shfrytëzojmë për interes publik, përfshirë edhe këtë pronë, toka bujqësore dhe pronat e tjera që janë nëpër qendra të ndryshme, nëpër komuna të ndryshme dhe pastaj ato që duhet të dalin në privatizim, të privatizohen me një rund të vetëm të privatizimit. Unë besoj që brenda një periudhe të arsyeshme, të mos jap afat kohor, ne do të sjellim për plotësim-ndryshim Ligjin për AKP-në, ku do të parashihet kjo politikë e qeverisë. Faleminderit!

KRYETARJA: A dëshironi pyetje plotësuese? Urdhëro, deputeti Selmanaj!

RASIM SELMANAJ: Kryeministër, nuk jam i kënaqur me përgjigjen për faktin se tash në këtë Parlament e kemi votuar në një ligj për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe unë mendoj që duke u thirrur në këtë ligj, Qeveria mund të marrë vendim që këtë pushimorë t’ia kthejë Komunës së Deçanit, dhe unë jam i bindur që kjo varet prej vullnetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pajtohem edhe është lajm i mirë që ju do ta ndaloni privatizimin dhe të shihen ato prona që janë me interes publik që të mos privatizohen dhe t’u kthehen komunave, por meqenëse kjo është pak edhe si rast i veçantë, kisha kërkuar që ta trajtoni si vendim të mundshëm këtë çështje.

KRYETARJA: Edhe dy minuta sqarim.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Një vendim tanimë është në fuqi i Qeverisë paraprake, i cili i ndalon krejt procesin e privatizimit. Ne do të analizojmë krejt listën e aseteve që janë në menaxhim të AKP-së për të parë se cilat prej aseteve mund t'i shfrytëzojmë për qëllime publike të komunave ose të institucioneve të tjera dhe mandej të vazhdojmë me një valë të vetme të privatizimit. Tash nuk mund të jap përgjigje konkrete, por unë besoj, jam i bindur që pushimorja e fëmijëve atje është në interes publik dhe nuk shoh ndonjë rrezik që ajo të privatizohet përpara se ne të sjellim në Kuvend Ligjin për AKP-në.

KRYETARJA: Deputeti Shpejtim Bulliqi, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Ministri nuk është këtu, a dëshironi ta parashtroini pyetjen apo ta lëni për seancën e radhës? Deputeti Bulliqi e ka fjalën!

SHPEJTIM BULLIQI: Kryetare, faleminderit! Meqë ministri nuk qenka këtu, unë mendoj që ta lëmë, ta presim ministrin kur t'i bëhen rendet, ne e pyesim.

KRYETARJA: Në rregull! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër, zoti Selmanaj,

Në çdo fushatë elektorale ju personalisht, por edhe Lidhja Demokratike e Kosovës keni proklamuar se me ardhjen në pushtet të Lidhjes Demokratike do të bëni zbardhjen e të gjitha rasteve të ashtuquajtura “vrasje politike”.

Tani meqë jeni në pushtet dhe e keni kryeministrin, ju jeni zëvendëskryeministër dhe i keni dikasteret e tjera që qeverisni, kisha dashur të di cili është plani konkret i kësaj qeverie në zbardhjen e këtyre rasteve? Kur do ta shohim një plan konkret? Dhe, kur do të shihen rezultatet e para, sepse unë do të vazhdoj të kërkoj në çdo seancë pothuajse këtë çështje dhe kisha dashur të kërkoj edhe prej deputetëve të LDK-së që të më bashkohen në këtë iniciativë.

KRYETARJA: Zëvendëskryeministri e ka fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DRITON SELMANAJ: Faleminderit për pyetjen, e nderuar deputete!

Vërtet kisha një herë telashe të kuptoj pse bash mua më drejtohet kjo pyetje, por gjithsesi kam përgjigje. Tash nuk është e vërtetë që unë e kam përmendur, ndoshta pikërisht në kohën e fushatës nuk i kam përmendur këto raste, por i kam përmendur para se të hyj në politikë dhe

madje shumë. Edhe unë mendoj që nuk është vetëm imja apo e LDK-së, unë mendoj duhet të jetë kërkesë e të gjithë neve si popull që të gjitha vrasjet e pasluftës në Kosovë dhe gjatë luftës të zbardhen.

Unë mendoj që është obligim moral dhe kombëtar i secilit nga ne që drejtësia të vihet në vend. Është obligimi më i vogël që ne mund të bëjmë për familjet e tyre që ata të dinë pse dhe nga kush janë vrarë? Çështje tjetër në kontekstin tjetër unë besoj ju jeni të vetëdijshëm që politika nuk u jep zgjidhje këtyre temave, kjo është çështje e drejtësisë dhe nëse mendoni që politika duhet t'u japë zgjidhje këtyre gjërave, jeni shumë gabim, sepse ne e dimë që këto procese janë të ndara. Ato krejt çka duhet të bëjmë ne si politikanë është që të ndërtojmë, them legjislacion, të ndërtojmë ambient të përshtatshëm, ku drejtësia e thotë fjalën e vet. Unë po them, jo vetëm për veprimtarët e LDK-së, kushdo që është vrarë gjatë dhe pas luftës meriton drejtësi. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Musliu, pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit!

Zëvendëskryeministër, më vjen mirë që pas shumë vjetësh, gati 20 vjet u bënë, për herë të parë e thoni me fjalën plot që kjo është çështje e drejtësisë në rend të parë dhe e dyta, unë jam shumë e vetëdijshme që politika nuk i zgjidh këto probleme dhe jo rastësisht ta kam bërë pyetjen parlamentare, e thatë edhe vetë, keni qenë një ndër proklamuesit më të mëdhenj që me ardhjen në pushtet të Lidhjes Demokratike këto raste do të zgjidhen. Jam ballafaquar direkt nëpër studiot televizive me kandidatët e LDK-së pikërisht për këtë çështje dhe u kam apelua që të mos abuzojnë me ato familje, të cilave u kanë ndodhur këto raste.

Prandaj, edhe një herë po e përsëris, meqë ju gjatë gjithë fushatave edhe jo vetëm në fushatën e fundit, por edhe në çdo fushatë elektorale keni bërë pikërisht politikë me këto raste, unë po ju pyes çka keni rast konkret dhe edhe një herë po e them, i ftoj të gjithë deputetët e Lidhjes Demokratike që të më bashkohen dhe bashkërisht të bëjmë presion në aspektin pozitiv që ju të bëni diçka konkrete për zbardhjen e këtyre rasteve, sepse në fushatat e tjera kemi për t'u ballafaquar prapë dhe pastaj besoj që e keni një kartë të djegur.

KRYETARJA: Urdhëro, dy minuta!

ZËVENDESKRYEMINISTRI DRITON SELMANAJ: Po e përsëris prapë, nuk është çështje fushate kjo, nuk është çështje e thjeshtë, është shumë komplekse dhe mos provoni askush ta reduktoni në çështje të përfitimeve eventuale, asnjëherë në jetën time në fushatë s'kam folur për këtë temë, por unë personalisht s'do të ndalem kurrë, ama kurrë derisa secila vrasje të zbardhet.

Edhe unë si politikan rolin tim do ta luaj, edhe si qeveri do të krijojmë ambient të përshtatshëm që prokurorët dhe gjykatësit ta bëjnë punën e tyre. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministren Vlora Dumoshi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Kabinet qeveritar,

E nderuar ministre,

Tani më shumë se 18 muaj janë bërë që kur me propozim amendamentin tim Kuvendi i Kosovës ka ndarë 200 mijë euro për shtatoren në parkun “Fadil Vokrri”. Edhe pse mjetet buxhetore kanë qenë të siguruara, projekti ka pasur ngecjet e tij dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vetëm para ca ditësh ka bërë prezantimin e projektit së shtatores së Fadil Vokrrit, ndërsa ende nuk është projekti i parkut ku do të vendoset shtatorja.

Duke ju falënderuar, e nderuar ministre për prezantimin e këtyre të dhënave dhe fillimin e punës për shtatoren, kam pyetje për këtë çështje: ku ka ngecur procesi i realizimit të projektit të parkut dhe ku planifikohet të vendoset shtatorja e legjendës së futbollit Fadil Vokrri?

KRYETARJA: Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: E nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni fillimisht sot, më 23 qershor është Dita Botërore Olimpike, në këtë ditë më lejoni t’i uroj të gjithë sportistët që na bëjnë krenarë me paraqitjet e tyre nëpër garat ndërkombëtare, ku Kosovës gjithmonë i sjellin medaljet e arta.

Me këtë rast e uroj presidentin e Komunitetit Olimpik, Besim Hasani dhe gjithë kryetarët e federatave, trajnerët, e posaçërisht heroinën tonë të gjallë, Majlinda Kelmendi.

I nderuar deputet Bekim Haxhiu, të falënderoj për pyetjen e parashtruar. Më datën 1 qershor 2020 është nënshkruar kontrata në vlerë prej 49 mijë e 500 euro për realizimin e shtatores së Fadil Vokrrit dhe hartimit të projektit kryesor të parkut, ku dhe do të vendoset shtatorja e Fadil Vokrrit. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka parashtruar kërkesën që parku dhe shtatorja të vendosen te stadiumi i kryeqytetit. Më 9 qershor 2020, në dyvjetorin e vdekjes së legjendës tonë të sportit Fadil Vokrri, kemi prezantuar bocetën fituese të skulptorit Agron Blakçorit, e përzgjedhur nga juria profesionale pas një procesi shumë transparent. Prezantimi është mbajtur në stadiumin e kryeqytetit, ku të pranishëm ishin shumë fytyra politike, po ashtu edhe ju zoti deputet. Finalizimi i projektit të shtatores dhe parkut do të bëhet deri në fund të muajit tetor. Faleminderit!

KRYETARJA: Pyetje shitesë, deputeti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar ministre për përgjigjen!

A mund të presim që inaugurimin e parkut dhe shtatores ta kemi përpara ndeshjes së parë kualifikuese të kombëtares së Kosovës në muajin shtator? A mund të procedojmë dhe a mund të shpresojmë që një motivim shitesë për sportistët tanë ta kemi shtatoren e legjendës përpara Stadiumit “Fadil Vokrri”, përpara ndeshjes së parë të Kombëtares së Kosovës.

KRYETARJA: Urdhëro, ministre!

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Unë shumë kisha pasur dëshirë për t’u realizuar kjo para lojës, por janë afatet e përcaktuara me ligj, ku edhe e kemi nënshkruar kontratën. Por, ne do ta përcjellim punën e skulptorit dhe në qoftë se është ndonjë mundësi që të bëhet më herët, do të ishte e mirëseardhur. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Lika.

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër Ramë Lika,

Komuna e Dardanës, ish-Kamenicës, në emër të reformave në arsim ka mbyllur disa shkolla në këtë komunë. Deri më tani janë mbyllur shkollat: “Nuhi Berisha” në fshatin Tugjec, që kishte 30 nxënës, shkolla “7 Shtatori” në Krilevë me 35 nxënës, Shkolla “Idriz Seferi” në fshatin Strezoc me 42 nxënës dhe Shkolla “Hasan Prishtina” në fshatin Busavatë me 104 nxënës. Këto shkolla janë në fshatrat e brezit kufitar me Serbinë dhe mbyllja e këtyre shkollave në emër të reformave dhe transformimit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kamenicës paraqet problem serioz për shpërngulje të popullatës nga brezi kufitar me Serbinë.

Për shkak të kësaj, nxënësit e fshatrave të Gollakut po detyrohen të udhëtojnë deri në 25 km një drejtim dhe ky është problem serioz për nxënësit dhe familjet e tyre, prandaj dhe po detyrohen që të vendosen në Kamenicë dhe të shpërngulen nga brezi kufitar. Konsideroj që vendimi i Komunës së Dardanës nuk është i peshuar mirë, në vend se fshatrat e brezit kufitar të mbështeten, ato për shkak të vështirësive që po paraqiten tani për udhëtimin e nxënësve rrezikohen që të ketë zhvendosje të popullatës. Sot brezi kufitar, fshati Krilevë ka 100 shtëpi, Busavata 100 shtëpi, Tugjec, Sfirçë e Gmicë, Feriqevë deri në Kapi janë përafërsisht edhe 100 shtëpi të tjera që kanë dërguar fëmijët në shkollat: “Nuhi Berisha” Tugjec, në shkollën “Hasan Prishtina” në Busavatë, e cila është ndërtuar vitin e kaluar, ndërsa këtë vit është mbyllur. Kjo dëshmon se veprimi është bërë me nguti dhe jo i peshuar mirë. Nxënësit, prindërit dhe banorët e fshatrave të brezit kufitar po kërkojnë që të mos lejohet të ndodhë kjo shpërngulje nga brezi kufitar me Serbinë në emër të reformave, sepse banorët e komunës së Kamenicës janë paralajmëruar nga komuna që planifikohet në fazën e dytë të zhvendosjen edhe nxënësit nga

shkollat në Koretin që ka 330 nxënës, në Topanicë me 104 nxënës, e në Petrovë që ka 106 nxënës.

Prandaj, i nderuar ministër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI RAMË LIKAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar Kryeministër Hoti,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E falënderoj shumë për pyetjen deputetin e Kuvendit, zotin Bekim Haxhiu, siç e dini kryetari i Komunës së Kamenicës, përkatësisht Dardanës, zoti Qëndron Kastrati, bazuar në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, por edhe mbi Ligjin për arsimin në komuna ka marrë një vendim për riorganizimin e shkollave në Komunën e Dardanës dhe të cilën e ka ndarë në tri faza.

Fazën e parë, për zhvendosjen e nxënësve nga viset rurale në Dardanë dhe tri shkolla, me ç'rast janë zhvendosur, ndërsa njëra prej tyre nuk është zhvendosur për shkak se ka reaguar komuniteti dhe mësimdhënësit. Kjo shkollë është në Busavatë dhe ka gjithsej 107 nxënës, siç ju e potencuat.

Në fazën e dytë kanë pasur të zhvendosen edhe katër shkolla të tjera, mirëpo ka hasur përsëri në rezistencë të komunitetit dhe të personelit mësimdhënës, ku janë zhvilluar një varg bisedimesh me këtë komunitet, por gjithashtu edhe ministria e Arsimit, zonja Bajrami, ka komunikuar me kryetarin e Komunës së Dardanës dhe kanë arritur një memorandum mirëkuptimi për pezullimin e përkohshëm të këtij vendimi. Në këtë rast, në këtë memorandum mirëkuptimi është paraparë që Ministria e Arsimit dhe Shkencës, së bashku me Komunën e Dardanës të punojnë në përmirësimin e infrastrukturës së shkollave në Dardanë, në njërën anë dhe, në anën tjetër, t' i adaptojnë dy shkolla për t' i shndërruar në çerdhe, pastaj të investohet në laboratorë, në kabinete e dollapë për nxënës, ndërsa ajo që ka qenë më e rëndësishmja në këtë fazë, është që së bashku me donatorët dhe partnerët fillimorë të ndërmerret një hulumtim të rrjetit të shkollave, por me theks të posaçëm në komunën e Dardanës, zakonisht për ato shkolla që kanë numër të vogël të nxënësve, hulumtim, të cilin ne do ta procedojmë në mënyrë që të kemi një vendimmarrje të bazuar në fakte për optimizimin e rrjetit të shkollave, përkatësisht për organizimin e këtij rrjeti.

Mirëpo, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të jetë shumë e kujdesshme që të bashkërendojë aktivitetet me DKA-në, me prindërit, me menaxhmentin e shkollave, duke pasur parasysh edhe gjendjen ekonomike, sociale të këtyre familjeve, por duke pasur parasysh edhe aspektin e cilësisë në këto shkolla, për arsye se vetë kryetari Kastrati ka arsyetuar që në

Komunën e Dardanës prej 38 shkolla, vetëm 5 prej tyre i plotësojnë kriteret sipas formulës së financimit dhe kjo është një ngarkesë, prandaj janë edhe një varg faktorësh demografikë, të cilët e detyrojnë të ndërmarre një rol...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Faleminderit! A keni pyetje plotësuese?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër për sqarimin!

Dua vetëm t'ju plotësoj që shkollat në brezin kufitar me Serbinë që janë me komunën e Prishtinës, Hajkobilla është hapur me 8 nxënës, Gllgovica me 10 nxënës, Mareci me 4, Prapashtica me 4 nxënës dhe Dabisheci me 15 nxënës. Dhe, mbështetja e cila duhet t'u jepet dhe këtyre shkollave që janë të hapura dhe atyre që janë planifikuar në komunën e Dardanes të mbyllen, duhet të jetë e bashkërenduar me Ministrinë e Arsimit dhe DKA, me qëllim të mbështetjes të funksionimit të këtyre shkollave, në brezin kufitar me qëllim të parandalimit të shpërnguljes nga brezi kufitar i popullatës, sepse në çdo rast që nga komuna e Dardanes, nga brezi kufitar është shpërngulur në qytet, është shndërruar edhe në rast social, për shkak se edhe toka dhe pasuria, të cilën e kanë lënë në fshatrat e tyre, pra kanë mbetur të papunuara dhe mbesin raste sociale, ku kemi një dëm edhe në aspektin strategjik, edhe të zhvillimit të arsimit edhe parandalimit të shpërnguljes.

Prandaj, ju uroj që bashkërisht me Komunën e Dardanes, por edhe me komunat e tjera të brezit kufitar të bashkërendoheni që të parandalohet shpërngulja, por edhe të investohet në edukimin e fëmijëve në brezin kufitar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti Likaj, nëse keni përgjigje shtesë, keni 2 minuta në dispozicion.

MINISTRI RAMË LIKAJ: Ky nuk është një rast i vetëm, siç e thatë, janë rreth 311 shkolla të tilla, për të cilat duhe pasur kujdes dhe ne kërkojmë edhe prej juve si deputetë të Republikës së Kosovës, por edhe nga qeveria që të mbështeten edhe komunat, edhe DKA-të, për arsye se sipas formulës së financimit, shumica e këtyre komunave kanë një mbingarkesë në personel arsimor dhe në vend që të investohet në cilësi, investohet domethënë në paga. E dini që buxheti i Kosovës mbi 86% i shpenzon kryesisht për paga, mirëpo duhet pasur parasysh këtë kategori, duhet pasur parasysh rrethanat, të cilat i përmende, por duhet pasur parasysh edhe socializimin e fëmijëve, zhvillimin e tyre në një ambient konkurrues dhe të shëndoshë dhe, natyrisht se nevojitet përkrahja e të gjithëve që këtë reformë ta bëjmë së bashku në komunikim me komunitetet dhe me aprovim prej tyre, por në mënyrë shumë të kujdesshme. Po them duke pasur

parasysh edhe vështirësitë për shkak të udhëtimit, por neve Ligji i arsimit parauniversitar na obligon, sidomos për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, që të kemi kujdes edhe distancën e udhëtimit të nxënësve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në vijim fjala është për deputeten Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Pyetja ime shkon për ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zonjën Vlora Dumoshi, bazuar në vendimin 02/03 të Qeverisë së Kosovës, po flas për Qeverinë Kurti, për pakon emergjente fiskale, për evitimin e situatës së krijuar nga COVID-19, është paraparë rritja e buxhetit për grante dhe subvencione në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për aktivitetet kulturore dhe sportive në vlerë prej 5 milionë eurosh.

Pyetja për ministren është: a mund të na njoftoni më tepër dhe më detajisht se a janë ndarë këto mjete? Dhe nëse po, në çfarë baze dhe në çfarë kriteresh? Faleminderit!

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Faleminderit deputetes, zonjës Eliza Hoxha, për pyetjen e drejtuar, më lejoni t'ju njoftoj juve dhe gjithë qytetarët, sidomos komunitetin kulturor, të rinjtë dhe sportistët që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka dërguar komentet për rishikimin e Projektligjit të buxhetit.

Vendimi i Kryeministrit Hoti në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ka ndarë 5 milionë euro. Pra, kjo është paketa ku do të përfshihet përkrahja për kulturën, rininë dhe sportin.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit tashmë i ka marrë hapat e parë duke i krijuar grupet brenda ministrisë dhe në ato grupe janë edhe përfaqësues të komunitetit kulturor, rinor dhe sportistë. Po presim që projektligjin, rishikimin e buxhetit të gjithë deputetët ta votojnë që kjo paketë të shkojë sa më shpejt te kultura, rinia dhe sporti, i cili është shumë i domosdoshëm, sidomos në këtë kohë pandemie. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Dumoshi! A keni pyetje shtesë, zonja Hoxha?

ELIZA HOXHA: Po, kisha dashur ndoshta vetëm një sqarim, nëse flasim vetëm për sektorin e kulturës, zonja ministre, keni pasur një takim virtual nëse e kujtoj, më 31 mars të këtij viti, me disa nga aktorët e institucioneve kulturore dhe më pas kujtoj që ka qenë një projekt propozim i dorëzuar, më 3 prill, si draft dhe më 10 prill si strategji se si të veprohet.

Përgjigjja në atë kohë besoj se ka qenë për shkak të kodit buxhetor, por ajo që më intereson mua është që kanë kaluar 3 muaj dhe ende nuk ka një vendim për grupin emergjent që do të punojë në këtë çështje dhe do të ndihmojë procesin. Dhe, e dyta brenga tjetër është për artistët që janë të pavarur. Domethënë, sepse në këtë proces janë përfshirë institucionet kulturore, por jo edhe artistët e pavarur dhe si do të bëhet evidentimi i tyre dhe çka do të ndodhë me ta?

KRYESUESJA: Ministrja, përgjigje shtesë!

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: Faleminderit, për këtë nënpyetje! Sigurisht që vendimi ka qenë i marrë nga qeveria e kaluar, për shkak të situatës së krijuar dhe mocionit edhe ju si deputete dhe të gjithë ne, ne e dimë që dokumenti i buxhetit është dokumenti më i rëndësishëm i shtetit të Kosovës dhe çdo rishikim ose prekje në strukturën e saj duhet të kalojë në Kuvendin e Kosovës.

Unë për informatën tuaj kam kontaktuar me të gjitha grupet e pavarura, të cilat janë organizata kryesore, kulturore që kanë festivale, si Doku Festi, Anibari dhe shumë të tjerë, të cilët janë të përfshirë në këto grupe punuese, por gjithashtu edhe për artistët e pavarur kam marrë letër prej tyre, kam bërë dy takime diku është numri 160 dhe ne secilin prej tyre do ta trajtojmë me prioritet për këtë mbështetje, të cilën e ofron shteti i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministre! Deputetja Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: E nderuar kryesuese!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi dëshmitarë se bashkatdhetarët tanë në diasporë janë ndër më meritoret për luftën, pavarësinë dhe shtet ndërtimin tonë. Bashkatdhetarët tanë janë ata, të cilët e ndajnë kafshatën e gojës me familjet e tyre në Kosovë. Tani në kohën kur të gjithë jemi duke luftuar me armikun e përbashkët COVID-19, bashkatdhetarët tanë nuk u kursyen dhe me një video u kërkua që të kontribuojnë për Kosovën duke dërguar të holla. Marrë parasysh se ky fond menaxhohet nga Ministria e Financave, zonja ministre, ju lutem që të na tregoni sa është totali i parave të dërguara nga bashkatdhetarët tanë deri më tani?

A është bërë funksional ky fond? Dhe, nëse po, për çfarë aktivitete po shfrytëzohen këto mjete?

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Unë ju njoftoj se thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave ka hapur një llogari zyrtare bankare të dedikuar për pranimin dhe evidentimin e fondeve që dedikohen në luftën kundër pandemisë COVID-19, kryesisht në formë të grave dhe donacioneve.

Me qëllim të rritjes së transparencës, si dhe llogaridhënies sa më të lartë ndaj publikut, si dhe partnerëve tanë nënlllogaria e hapur është pjesë e sistemit të llogarisë së vetme të thesarit dhe mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe është funksionale nga data 1 prill e këtij viti. Janë gjithsej 722 mijë e 164 euro të mbledhura deri më tani. Prej të cilave 671 mijë e 497 euro kanë ardhur nga jashtë Kosove, ndërsa nga brenda kanë ardhur 50 mijë e 667 euro. Në bazë të vendit të origjinës të transferit të mjeteve, mjetet nga vijnë nga Zvicra, Gjermania, Shqipëria, Suedia, Austria, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Belgjika dhe Finlanda. Sipas legjislacionit në fuqi për financat publike vetëm shuma prej 150 mijë euro është alokuar tek Ministria e Shëndetësisë më herët, meqenëse donatori në bazë të marrëveshjes ka kërkuar që fonde të dedikohen te Ministria e Shëndetësisë. Si dhe, shuma tjetër prej 1 511 eurove është alokuar në fondin komunal të Skenderajt, meqenëse njëjtë sikurse në rastin tjetër, edhe këtu donatori ka kërkuar që këto mjete të dedikohen në Komunën e Skenderajt. Sidoqoftë, mjetet e tjera domethënë nuk ka shpenzime dhe këto janë fondet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ju lutem ia vazhdoni edhe një minutë fjalën për ministren!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Mjetet e tjera domethënë gjenden në llogari. Ne kemi edhe evidenca se prej cilave shtete vijnë këto mjete. Natyrisht se këto mjete do të përdoren për menaxhimin e pandemisë dhe do t'u dedikohen Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive të tjera, të cilat mbulojnë nevojat e qytetarëve për të menaxhuar pandeminë COVID-19.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Musliu ka pyetje shtesë?

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, ministre!

Do të kërkoja nëse është e mundur që të jenë transparente kurdo që këto mjete të dërgohen për shfrytëzim te ministritë e tjera.

KRYESUESJA: Ministria e ka fjalën për përgjigje!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, deputete!

Edhe ne do të kujdesemi maksimalisht që të ketë transparencë të plotë për shpenzimin e këtyre parave dhe njëkohësisht në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës falënderoj të gjithë bashkatdhetarët dhe donatorët e brendshëm, të cilët kanë kontribuar në këtë kohë, kur edhe ata kanë qenë të goditur nga pandemia.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Ariana Musliu-Shoshi e ka edhe një pyetje për ministrin Ramë Likaj.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër, është e dijshe që pesha e rëndë e çantave, të cilët fëmijët tanë i bartin librat dhe pajisjet e tjera shkollore, është duke rrezikuar shëndetin e tyre. Njëkohësisht, duke shkaktuar dhimbje të boshtit kurrizor dhe lodhje të madhe e kjo duke ndikuar në procesin mësimor. Sipas një hulumtimi që është bërë nga Instituti Pedagogjik del se pesha e çantave të fëmijët e ciklit të ulët tejkalon kufizimin e këshillueshëm prej 10% të peshës së trupit. Fëmijët tanë bartin pesha më të mëdha se ajo që është e lejuar, sipas po të njëjtit institut del se të gjeturat tregojnë se nxënësit e klasës së parë, të cilët kanë peshën trupore mesatarisht 23 kilogramë e bartin çantën mesatarisht 4 kg e 170 gramë, dhe nxënësit e klasave të gjashta e arrijnë peshën deri në 10 kg, pra çanta e tyre.

Duke marrë parasysh se si zgjedhje mund të kemi digjitalizimin e librave, fondet të cilat mund të sigurohen nga organizatat ndërkombëtare dhe nga Bashkimi Evropian, si dhe sirtarë personalë, të cilët nuk kanë ndonjë kosto të madhe për nxënësit tanë, a mund të na tregoni ju si qeveri e re, cila është zgjidhja juaj për këtë problem?

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjala është për ministrin!

MINISTRI RAMË LIKAJ: E falënderoj deputeten e Kuvendit, zonjën Ariana Musliu Shoshi, për pyetjen që ka bërë lidhur me peshën e çantave. Natyrisht se pesha e tepruar e çantave për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm i prindërve, i shoqërisë dhe i qeverisë, por edhe i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa ne si Ministri e Arsimit, Shkencës e trajtojmë shëndetin e fëmijëve me prioritet, prandaj reagimi ynë do të jetë i menjëhershëm, kuptohet në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, në radhë të parë duke instaluar edhe rafte nëpër shkolla.

Vitin e kaluar ka qenë një buxhet dhe këtë vit 9 shkolla të reja domethënë janë pajisur me rafte, pasi që është e njohur që ato shkolla që kanë pasur rafte, kjo çështje është zgjidhur pak a shumë. Në të njëjtën kohë MASHT-i do të përkujdeset që në kuadër të rishikimit të Ligjit mbi tekstet mësimore të kufizohet edhe pesha e teksteve mësimore, por gjithashtu të vendosen kritere për letrën që do të përdoret. Ju e theksuat shumë mirë se shumë hulumtime, në mesin e tyre edhe

Instituti Pedagogjik kanë konstatuar se peshat e çantave kanë tejkaluar prej 12 deri 18% peshën trupore që është shqetësuese, kjo ndikon në lodhjen dhe dëmtimet në kurriz dhe në shëndetin e nxënësve.

Në anën tjetër, ne në program qeverisës e kemi edhe rishikimin e kurrikulave, por njëkohësisht krahas rishikimit të kurrikulave edhe të përmbajtjes së teksteve mësimore për ta larguar përmbajtjen e tepërt mësimore. E përmende digjitalizimin dhe jemi duke punuar shumë që të shtojmë përmbajtjen digjitale në tekstet mësimore dhe duke larguar pra përmbajtjen e tepërt, por edhe në furnizim me pajisje të teknologjisë informative, jo vetëm shkollat, por edhe nxënësit edhe kategoritë e marginalizuara, të cilat kanë qenë të privuar edhe nga mësimi në distancë. Natyrisht se është tentuar edhe me forma të tjera, për shembull, për mësimin në një ndërrim, mirëpo e dini situatën dhe dini kufizimet për shkak të COVID-it dhe një gjë e tillë është shumë e vështirë të zgjidhet shpejt.

Ne jemi duke jetuar në një rrethinë digjitale, prandaj duhet t'i përshtatemi kësaj rrethine digjitale. Ndërsa, vetë situata me COVID dhe mësimi në distancë na ka treguar se është një mundësi, të cilën ne duhet ta shfrytëzojmë dhe të përparojmë në këtë drejtim. Buxheti është shumë i kufizuar, kërkoj përkrahjen tuaj dhe të Qeverisë që të shtohet buxheti për këto shkolla. Në vitin 2020 kemi vetëm 50 mijë euro për raftë, vitin 2021 kemi 100 mijë, vitin 2022 vetëm 200 mijë, që është një buxhet jashtëzakonisht i kufizuar, prandaj kërkohen fonde shtesë. Ne do të kërkojmë edhe nga donatorët që t'i shtojmë këto burime për ta përmirësuar këtë gjendje. Faleminderit për pyetjen!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Valon Ramadani, pyetje për ministren Vlora Dumoshi.

VALON RAMADANI: Faleminderit, nënkryetare!

Pyetja ime ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, më konkretisht marrja e masave mbrojtëse për objektin e shkollës “Ismail Qemali” në Ferizaj. E nderuara zonja Vlora Dumoshi, të gjithë e dimë vlerën dhe rëndësinë e veçantë për objektet e trashëgimisë kulturore, të cilat fatkeqësisht tek ne nuk janë të shumta, por ato që janë çfarë po ndërmerren që ato të mbrohen. Pra, konkretisht, a keni marrë ndonjë masë mbrojtëse për mbrojtjen e objektit të shkollës “Ismail Qemali” në Ferizaj, objekt ky i cili prej vitit 2015 është shpallur objekt i mbrojtur i trashëgimisë kulturore.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjala është për ministren Dumoshi.

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E falënderoj deputetin për pyetjen, më lejoni t'ju njoftoj që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Qendra rajonale për trashëgiminë kulturore në Gjilan, institucion kompetent edhe për Komunën e Ferizajt në fund të vitit të kaluar ka hartuar projektin e gjendjes ekzistuese dhe të konservimit, restaurimit për shkollën “Ismail Qemali” respektivisht “Jeronim de Rada”. Lidhur me këtë ndërtesë nga Komuna e Ferizajt është kërkuar konfirmimi për destinimin e shkollës, duke e ruajtur dhe funksionin primar me qëllim edukativ dhe arsimor dhe t'i jepet në shfrytëzim shkollës së artit.

Projekti sipas para masës dhe para llogarisë deri në funksionalizimin e plotë, e kap vlerën 620 mijë euro. Prandaj, në këtë kuadër do të bisedojmë me Komunën e Ferizajt që investimi të jetë i përbashkët. Do t'ju jap edhe disa informacione të tjera, në Komunën e Ferizajt për këtë vit në pjesën e kulturës investimet tona janë: nën ndërtesën e Teatrit 50 mijë euro, Kisha Katolike 70 mijë euro. Kurse, në kuadër të programit masa preventive, intervenime, emergjente, do të zbatohen në këto projekte: në Mullirin e Madh të Ferizajt 12 mijë euro, shkolla e Nerodimes 15 mijë euro, Mulliri i Babushit në Nerodime me 7 mijë euro. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Ramadani ka pyetje shtesë, regjia!

VALON RAMADANI: Faleminderit, nënkryetare!

Faleminderit edhe zonjës Dumoshi për këto informata, mirëpo ne do ta mbajmë përgjegjëse se për si formë qysh na u tha sot gati se çdoherë po kësso lloj premtime dhe ata që kanë qenë në Ferizaj te kjo shkollë e kanë vizituar, e kanë parë se në çfarë gjendje ka qenë kjo jo më larg se 5 ose 6 muaj dhe para disa dite kur ne e kemi vizituar është e njëjta gjendje qysh aktivistë vullnetarë, sidomos aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje që e kanë pastruar këtë objekt shkollor dhe ne sigurisht që do ta mbajmë përgjegjëse ministren në ditët në vijim nëse do të bëhen ato që i tha pak më herët. Faleminderit!

KRYESUESJA: Po, përgjigje shtesë, zonja Dumoshi?

MINISTRJA VLORA DUMOSHI: Faleminderit, i nderuar deputet Valon! Përgjegjës jemi ne secili, edhe ti që je deputet, edhe unë si ministre. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka marrëveshje memorandume me komunat. Ne si Ministri e Kulturës kemi hartuar projektin siç ju thashë për konservimin dhe kjo shkollë të fillojë si shkollë e artit, tash Komuna e Ferizajt është përgjegjëse për pjesën tjetër. Ne do t'i sigurojmë një pjesë të buxhetit, kurse pjesën tjetër duhet Komuna e Ferizajt. Ne e dimë që shumë objekte të kësaj rëndësie të trashëgimisë i kemi në gjendje shumë të rëndë edhe jemi koshientë për këtë punë, por me mundësitë dhe buxhetet që i kemi edhe me marrëveshjet me komuna besoj që do t'ia dalim.

KRYESUESJA: Deputeti Valon Ramadani, pyetje për zotin Veliu.

VALON RAMADANI: Faleminderit, nënkryetare!

Çështjen, të cilën do ta nge tash drejtuar zotit Agim Veliu që ka të bëjë me gjendjen dhe kushtet e rënda të punës për zjarrfikësit në përgjithësi, e sidomos ata në Ferizaj.

Prej vizitës që e kam pasur në Brigadën e Zjarrfikësve në Ferizaj, kam kuptuar mungesën e kushteve elementare për ta, nuk kanë veshje zjarrduruese, madje as kapela e këpucë. Për numrin e banorëve të Ferizajt do të duhej të ishin 167 zjarrfikës, por janë vetëm 58, kurse 32 prej tyre janë me kontratë mbi vepër. Nuk kanë shujta ditore, nuk kanë sigurim shëndetësor, punojnë përtej orarit dhe madje as nuk paguhen me rregull. Kam pyetje konkrete, cilat janë veprimet që do t'i ndërmerrni për t'ua përmirësuar kushtet e dobëta aktuale të punës që ata i kanë.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputeti Ramadani! Fjala është për zotin Agim Veliu.

MINISTRI AGIM VELIU: Faleminderit, zonja Nagavci!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra,

Duke iu referuar pyetjes së Valon Ramadani lidhur me gjendjen e Brigadës së Zjarrfikësve në Komunën e Ferizajt, më lejoni të sqaroj se bazuar në Ligjin 04L/049 për zjarrfikje dhe shpëtim, neni 7, statuti i zjarrfikësve përcaktohet se njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit janë staf i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe menaxhohen nga Agjencia në bashkëpunim dhe koordinim me komunat.

Sa për informimin tuaj, mjetet buxhetore, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, kapitalet dhe subvencionet për këto njësi vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të menaxhohen nga vetë komunat. Kjo gjendje aktuale ka paraqitur vështirësi të theksuar në menaxhimin efikas dhe gjithëpërfshirës për përmbushjen e plotë të mandatit të këtyre njësive. Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme me qëllim të ngritjes së nivelit të gatishmërisë dhe mbështetje për njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit ka investuar në shumë projekte nëpër të gjitha komunat, siç janë: me automjete, pajisje të përbashkëta, intervenuese, furnizime me uniforma, ndërtime të objekteve, renovime të objekteve e tjerë. Gjatë vitit 2019, Agjencia e Menaxhimit Emergjent ka furnizuar këto njësi dhe të gjitha njësitë e tjera në nivel vendi me pajisje mbrojtëse, si vijon: uniforma mbrojtëse, helmeta mbrojtëse, çizme mbrojtëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Edhe një minutë, regjia!

MINISTRI AGIM VELIU: Të gjithë pjesëtarët e njësive profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit në nivel vendi, përveç pagës të cilët e marrin rregullisht, marrin edhe shumën për

rrezikshmëri në vlerë prej 107 eurosh. Gjatë vitit 2018-2019, njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit në nivel vendi janë kompensuar me shtesat për ndërrime të natës, festa zyrtare, si dhe për orët shtesë.

Rregullorja numër 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit përcakton numrin prej një zjarrfikësi profesional në 1 mijë e 500 banorë. Njësia profesionale e zjarrfikësve dhe shpëtimit në Ferizaj ka gjithsej 29 pjesëtarë profesionalë dhe 34 punëtorë sezonalë të shoqatës vullnetare zjarrfikëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zoti Ramadani? Po edhe një minutë, regjia!

VALON RAMADANI: Faleminderit, nënkryetare!

Po, e tha edhe zoti Veliu që stafi i zjarrfikësve është në Ministrinë e Punëve të Brendshme, mirëpo kur vjen pyetje te përgjegjësia ose te ato që duhet të merren përsipër, i hedhet faji komunës, kur shkon te ata në komunë dhe i pyet, ata ia lënë fajin ministrisë, mirëpo gjendjen të cilën unë e ngrita si shqetësim, zjarrfikësit lëre që nuk kanë shujta, por nuk kanë as qumësht 1 litër në ditë, që duhet gjithqysh ata ta përdorin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! A keni përgjigje shtesë lidhur me pyetjen e deputetit, zoti Veliu? Jo, s'keni përgjigje!

Atëherë, ju njoftoj se të pranishëm në sallë aktualisht janë 70 deputetë.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Mirëpo, duke qenë se seanca e mëparshme nuk është përfunduar, nuk kemi procesverbal për ta miratuar dhe e votojmë në njërën nga seancat e radhës, pasi të përfundojë ajo seancë.

Për rend dite, fjalën e ka kërkuar deputeti Shkëlzen Hajdini.

SHKËLZEN HAJDINI: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Ju deputetë të nderuar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozoj të plotësohet rendi i ditës me një pikë shtesë. Propozoj të futet në rend të ditës aprovimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit me numër 07L/001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Duke marrë parasysh afektimin e ekonomisë së vendit dhe të gjitha fushave, sferave nga virusi COVID, është shumë e rëndësishme të procedojmë më tutje me aprovimin e këtij ligji dhe lus deputetët ta votojnë këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hajdini! Sigurisht e dini se ky ligj nuk është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL, kështu që kur keni menduar ta fusni si pikë të rendit të ditës, domethënë në cilën pjesë të seancës, sepse akoma nuk është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Regjia, ju lutem fjalën deputetit!

SHKËLZEN HAJDINI: Faleminderit, nënkryetare!

Propozoj të futet si pikë e parë e rendit të ditës.

KRYESUESJA: Atëherë, i ftoj shefat e grupeve parlamentare të deklarohen, por ju njoftoj paraprakisht se kjo nuk është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL dhe duhet të kemi parasysh se duhet t'i jepet kohë edhe Komisionit FunkSIONAL për ta shqyrtuar. E ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Hekuran Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, kryesuese!

Meqenëse nuk e kemi shqyrtuar ende në Komisionin për Buxhet dhe Transfere, sepse ka ardhur dje, pra ka qenë afat tepër i shkurtë për të bërë ndonjë shqyrtim, është e papranueshme të shkohet me shmangie të procedurës për diçka ku kemi devijim me qindra milionë euro. Pra, duhet ta shohim, duhet të ketë llogaridhënie se ku kanë shkuar ato para. Është e papranueshme të shkohet me procedurë të tillë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Deputeti Arben Gashi, në emër të LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Duke marrë parasysh rëndësinë e kalimit të Buxhetit dhe duke marrë parasysh që një pjesë e konsiderueshme e Qeverisë, përfshi edhe kryeministrin, javën e ardhshme nuk do të jenë në Kosovë, konsideruam se është me rëndësi që ta trajtojmë në prezencë të kryeministrit edhe çështjen e Buxhetit dhe sa më shpejt t'i trajtojmë këto çështje.

Pra, ne po flasim për shqyrtim në parim vetëm në leximin e parë, jo në leximin e dytë. Leximi i dytë do të vijë kur të përfundojnë procedurat Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet tjera, kushdo që ka vërejtje. Ajo që ne po kërkojmë është që sot të shqyrtohet në leximin e parë si pikë e parë e rendit të ditës, duke tejkaluar Rregulloren e punës dhe t'i japim një mundësi që të kemi një buxhet të rishikuar dhe të përfshijmë edhe çështjet ekonomike dhe financiare që janë me karakter

urgjent, në mënyrë që të hapim rrugën që edhe ligjet tjera që duhet të ndryshohen si derivat i ndryshimit të projekt-buxhetit të shkojnë sa më shpejt në Kuvend.

Është çështje e një qasjeje më pragmatike e afirmative në aspektin ekonomik dhe buxhetor të vendit. Faleminderit!

KRYETARJA: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

E di që në aspektin procedural është e drejtë të kërkohet një gjë e tillë, por sinqerisht nuk po besoj se po kërkon një gjë të tillë. Është befasuese një kërkesë e tillë, kur dihet që edhe herën e kaluar Qeveria e kaluar është vonuar më përgatitjen dhe procedimin e Buxhetit. E ka bërë një buxhet që nuk ka qenë adekuat për situatën, edhe pse Pandemia ka qenë e shpallur, edhe pse rastet e para i kemi pasur në Kosovë, prapëseprapë është sjellë një Buxhet këtu në procedurë të përshpejtuar pa iu dhënë mundësi deputetëve që të diskutojnë, ta japin kontributin e tyre, t'i japin kritikën po edhe propozimet e tyre, dhe është diskutuar në mënyrën çfarë është diskutuar dhe është aprovuar.

Ne kemi menduar që është hera e fundit që ky Kuvend do të ballafaqohet me situatë të tilla. E kemi përmendur se ka qenë një procedurë e trafikuar dhe klandestine. Tash, është prej dokumenteve më të rëndësishme. Njëri nga ministrat e tha që Buxheti është prej dokumenteve më të rëndësishme që diskuton dhe aprovon Kuvendit. Pajtohem besoj në këtë pikë. Nëse është dokumenti më i rëndësishëm për të cilin diskuton, debaton, e kritikojnë, e përkrahin, japin alternativa, Buxheti, atëherë si po kërkohet një dokument i rëndësishëm së tillë me një vëllim prej afërsisht 600 faqesh, që shumica e deputetëve, flas me përgjegjësi, nuk besoj se e kanë marrë prej kutive të tyre, se ai sigurisht mbrëmë është vendosur në kutitë e deputetëve apo një ditë ose dy më herët. Si ka mundësi 600 faqe material me gjithë atë numër të projekteve të përpunohet prej deputetëve që realisht unë pajtohem që nuk jam i fushave të caktuara dhe për t'i kuptuar dokumente dhe projektligje të fushave tjera mua më duhet një kohë më shumë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkon që rishikimi i Buxhetit, Ligji për rishikimin e Buxhetit t'i plotësojë të gjitha afatet ligjore, që nënkupton që 14 ditë pune pasi të sillet në Kryesinë të Kuvendit të ketë mundësi që të trajtohet në leximin e parë. Diskutimet janë në lexim të parë, diskutimet bëhen në lexim të parë, kritikën japin në lexim të parë. Ndërsa, pas leximit të parë në komisionet funksionale diskutohet për amendamentet që kanë të drejtë t'i propozojnë ata që kanë të drejtë dhe vjen në lexim të dytë, diskutohen amendamentet, votohen amendamentet dhe votohet në tërësi.

Nuk është shenjë e mirë kjo. Nuk u ndiem mirë parëz, sinqerisht po them, por për shkak të situatave të krijuara nga e kaluara ne nuk mundëm t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Nëse

vazhdohet në këtë mënyrë, që ne të vendosemi në qoshe si opozitë dhe të sfidohemi vazhdimisht, edhe me nguti, edhe me procedura, edhe me... kjo është edhe mungesë e transparencës, atëherë ne normalisht që nuk mund ta japim votën për. Nuk duhet ad hoc, nuk duhet gjithmonë të jemi në nxituar që ne të diskutojmë çështje të caktuara.

Prandaj, besoj se këtij rishikimi të Buxhetit është dashur t'i paraprijë edhe diskutimi për programin e Qeverisë aktuale. Fillimisht, të diskutohet për programin, pastaj të shikohet a janë reflektuar prioritetet, programi i kësaj Qeverie në rishikim. Cila është urgjenca e kësaj. Nëse e kanë bërë mirë atëherë Buxhetin, që e kanë lavdëruar si Buxhet i mirë, pse pati nevojë pas tre muajve, as tre muaj s'i ka, për ta rishikuar? Hajde, paska nevojë të rishikohet, pse paska nevojë të rishikohet me procedurë të përshpejtuar?

Për të mos e zgjatur më tutje, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk mund e përkrah mocionin procedural për diskutimin dhe futjen e Buxhetit në rend dite, sepse është dokument i rëndësisë së veçantë dhe është dokument voluminoz, të cilin secili prej ne deputetëve kemi nevojë të shohim çfarë ka ndodhur brenda Buxhetit origjinal dhe Buxhetit të rishikuar. Ku janë këto ndryshime? Kah do të shkojnë këto ndryshime? Dhe normalisht, mbi bazën e kësaj edhe do t'i kemi diskutimet, po pastaj edhe qëndrimin tonë politik. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, deputeti Daut Haradinaj. A e keni kartelën e zonjës Haxhiu, apo...? Po, me kartelë të zonjës Haxhiu.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Kryeministër,

Deputetë,

Fillimisht, do të kërkoja prej kryetares që të na krijohen kushte për të ju adresuar deputetëve, sepse shumë keq kemi mbetur atje prapa. Këtë duhet ta keni parasysh.

Kjo sot që po kërkojmë ne është mocion procedural për ta futur Projektligjin. Është e vërtetë që opozita ka të drejtë të kritikojë. Por, meqenëse kryeministri largohet prej Kosovës dhe natyrisht, disa ditë nuk do të jetë këtu, ne kemi kërkuar që të hyjë në procedurë të përshpejtuar. Gjithsesi, sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare, që u fol më herët, një pjesë e madhe e atyre marrëveshjeve janë të nënshkruara pikërisht nga ministri, ose ish-ministri Hamza, që tash e pati fjalën.

Kemi edhe këtu po ashtu në komision, po ashtu nga opozita, të cilat janë konfirmuar dhe janë përkrahur në komisionet përkatëse ato marrëveshje ndërkombëtare dhe sot janë në Kuvend. Është e vërtetë që opozita nuk është e obliguar t'i votojë, por asnjëherë në Parlamentin e Kosovës asnjë qeveri nuk i ka pasur 81 vota. I ka pasur një koalicion, por një qeveri nuk i ka pasur, sepse deputetë të caktuar nuk e kanë votuar as atë qeveri. Ne po kërkojmë mocion

procedural, që të futet në procedurë të përshpejtuar në lexim të parë, pastaj do të ketë kohë të mjaftueshme për amendamente rreth këtij projekt-buxheti. Faleminderit! Pra, si Aleancë jemi pro.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista Serbe nuk e ka kërkuar fjalën. Grupi Parlamentar Nisma është Endrit Shala.

ENDRIT SHALA: Faleminderit, kryetare!

I nderua Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Grup Parlamentar Nisma-AKR jemi dakord që të fillojmë qysh sot me këtë mocion dhe të procedojmë me rishikimin e Buxhetit, duke pasur parasysh edhe situatën e krijuar dhe nevojën që institucionet e vendit e kanë për një rishikim sa më të shpejtë të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nuk kemi të tjerë të lajmëruar.

Atëherë, e vendos mocionin në votim. Siç e dini, duhet të jenë pro mocionit 2/3-at e deputetëve që marrin pjesë në votim.

Lus deputetët që të përgatiten për votim! Në sallë janë 103 deputetë.

Kush është për? Faleminderit!

Kush është kundër? Faleminderit!

A ka abstenime? Nuk po shoh abstenime. E lus administratën t'i sjellin rezultatet e votimit!

Kemi pasur 56 vota për, 48 vota kundër, që do të thotë se propozimi apo mocioni procedural nuk kalon, sepse nuk i ka marrë 2/3-at e nevojshme për ndryshim të rendit të ditës.

4. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 3 (tre) anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, nënkryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc. Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që t'i propozojnë këta emra. Grupi i VV-së tashmë i ka propozuar. A dëshironi t'i lexoni ju? Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Po, zonja kryetare!

Të propozuarit tanë për këtë komision janë: Valon Ramadani, kryetar, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, anëtare, dhe Agon Batusha, anëtar.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së e ka nënkryetarin e parë dhe një anëtar.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetare!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e propozon zonjën Rrezarta Krasniqi nënkryetare e parë dhe Besa Gaxherri anëtare të komisionit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetare!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e propozon Ganimete Musliun dhe Floreta Zejnullahun.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi parlamentar i AAK-së, zoti Haradinaj e ka fjalën, përsëri me kartelë të zonjës Haxhiu.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Aleanca e propozon zotin Rasim Selmani, anëtar.

KRYETARJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Listës serbe na është dërguar emri, zoti Slavko Simiq. Ftoj Nismën ta japë propozimin e vet. Deputeti Endrit shala.

ENDRIT SHALA: Faleminderit, kryetare!

Nga ana e Grupit Parlamentar Nisma socialdemokrate dhe AKR propozojmë deputeten Mirlinda Sopi-Krasniqi.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi 6+ e ka propozuar deputetin Fikrim Damka për anëtar të komisionit. Procedojmë në votim. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtarëve të Komisionit ad hoc.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Nga 103 të pranishëm të gjithë kanë votuar për. Konstatohet se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ngarkohet ky komision për përzgjedhjen e kandidatëve dhe të veprojë në përputhje me nenin 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë anëtarë të Bordit të RTK-së

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë emrat për kryetar, nënkryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë anëtarë të Bordit të RTK-së, 5 anëtarë nga komuniteti shqiptar, 1 nga komuniteti serb dhe 1 anëtar nga komunitetet tjera joshumicë.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i prezantojnë emrat. Grupi Parlamentar i VV-së, Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetare!

Për këtë Komision ad hoc i kemi propozuar deputetët, si në vijim: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, nënkryetare, sepse këtu e kemi pozicionin e nënkryetarit. Valon Ramadani, anëtar dhe Agon Batusha, anëtar.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së propozon zonjën Doruntina Maloku-Kastrati për kryetare të komisionit, zotin Ardian Shala për anëtar. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetare!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozon deputeten Blerta Deliu dhe Mërgim Lushtaku.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Kryetare, lypna kah jemi nëpër Kuvend, se po duhet të lëvizim. Kërkona, kërko ku jemi të ulur edhe na gjen.

KRYETARJA: Unë të gjeta, zonja deputete, por s'bënte mikrofonin.

TEUTA HAXHIU: Herën tjetër, në seancën tjetër unë i thërras kolegët e mi deputetë të ulen nëpër vendet e veta. Edhe ju atëherë mbajeni distancën, sepse shih, asnjë nuk ta ka mbajtur distancën sot, asnjë deputet. Dhe, ne nuk mund të ulemi atje në tarracë.

Në emër të grupit tonë parlamentar është Rasim Selmanaj.

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i Listës serbe ka propozuar deputetin Igor Simiq. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar Nisma - AKR, zotin Endrit Shala ta japë propozimin!

ENDRIT SHALA: Faleminderit, kryetare!

Në emër të Grupit Parlamentar Nisma-AKR për këtë komision ad hoc e propozojmë deputeten Mirlinda Sopi-Krasniqi.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi 6+ e ka propozuar deputetin Albert Kinolli për nënkryetar të dytë të komisionit.

Procedojmë me votim. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtarëve të Komisionit ad hoc.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

102 kanë marrë pjesë në votim, do të thotë 101 vota për dhe 1 abstenim. Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 7 anëtarë të Bordit të RTK-së, 5 anëtarë nga komuniteti shqiptar, 1 anëtar nga komuniteti serb dhe 1 anëtar nga komunitetet tjera joshumicë.

Ngarkohet ky Komision për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, që të veprojë në përputhje me nenin 26 të Ligjit për RTK-në dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime. Faleminderit!

6. Propozimi i Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare

Zëvendësimet janë si vijon:

1. Deputetja Arbëreshë Krasniqi është propozuar për anëtare në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis në vend të ish-deputetes Albulena Balaj-Halimaj.

2. Deputeti Endrit Shala është propozuar për anëtar në Komisionin për Legjislacion në vend të ish-deputetes Albulena Balaj-Halimaj.

3. Deputetja Arbëreshë Krasniqi është propozuar për anëtare në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Pra, këto janë zëvendësimet. Kërkoj nga ju që me ngritje dore të deklaroheni, në qoftë se pajtoheni me propozimet e këtij grupi parlamentar.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konstatoj se këto zëvendësime u miratuan nga ana e Kuvendit të Kosovës me shumicë votash.

7. Interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Avdullah Hoti

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se deputeti Liburn Aliu i mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës në lidhje me heqjen e masave të reciprocitetit të Republikës së Kosovës ndaj Serbisë.

Në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Propozuesi i interpelancës mbanë të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në fund të debatit i ka deri në 5 minuta.

Në bazë të nenit 48.4 të Rregullores së Kuvendit kryeministri paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjet e ngritura në interpelancë në kohëzgjatje prej maksimum 15 minuta.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është, si në vijim:

- Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka 45 minuta,
- Grupi Parlamentar i LDK-së i ka 44 minuta, por minus 8 minuta që ndahen për kryeministrin, i bie t'i ketë 34 minuta,
- Grupi Parlamentar i PDK-së i ka 36 minuta,
- Grupi Parlamentar i AAK-së i ka 19,5 minuta,
- Grupi Parlamentar Lista Serbe, 13 minuta,
- Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, 8 minuta,
- Grupi Parlamentar 6+, po ashtu 8 minuta.

Deputetët pa grup parlamentar, që në këtë rast janë deputetët Etem Arifi dhe Veton Berisha, i kanë 4 minuta në total të dy bashkë, në qoftë se dëshirojnë të flasin.

Ftoj fillimisht deputetin Liburn Aliu, që si propozues i interpelancës ta marrë fjalën. I keni dhjetë minuta, zoti deputet.

LIBURN ALIU: E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Nga përvojat tona të deritanishme në negociatat me Serbinë, ajo që qartë mund të identifikojmë është se epilogu i negociatave është përcaktuar që para se të fillojnë ato. Marrëveshjet e dëmshme për Kosovën shihen ende pa filluar negociatat.

Na kujtohet të gjithëve, që në vitin 2011, pra para se të fillonin negociatat në Bruksel, u pat hequr reciprociteti me Serbinë i vendosur në korrik të këtij viti dhe i cili zgjati 50 ditë. Priteshin negociatat me Serbinë, të cilat nuk patën filluar pa u hequr reciprociteti ndaj saj. Edhe atëherë na u desh që negociatorët të dëshmohen karshi Serbisë, duke hequr dorë nga sovraniteti, thuajse ne ishim agresori e ata viktima.

Negociatat u filluan, rrodhën dhe u përmbyllën me marrëveshje të dëmshme dhe gjatë tërë kohës duke na thënë Serbia se nuk do ta njohë kurrë Kosovën. Dhe pra, nuk kishte si të mos dihej epilogu i atyre negociatave.

Heqja e reciprocitetit si pikënisje e dialogut me Serbinë i dha asokohe kuptim fundit të saj. Mësimi nga ato negociata është se inferioriteti që në fillim të negociatave pashmangshëm do t'i përcjell deri në fund. Aso kohe, madje para se të flitej për negociata, nga shpifjet e makinerisë së shtetit serb doli raporti i Dick Martit, i cili godiste luftën çlirimtare të popullit tonë dhe drejtpërdrejt edhe figurën e ardhshme të atyre negociatave, Hashim Thaçi. Thaçi asokohe pati deklaruar se do të padisë Martin për shpifje dhe diçka e tillë ishte shumë e pritshme.

Shpifjet ishin të rënda dhe sherri ishte shumë i madh, por kjo padi kurrë nuk u bë. Kësaj tërheqjeje para akuzave ndaj Martit dhe duke ia shtuar edhe reciprocitetin, pozicioni i Thaçit u thellua në inferioritet dhe kështu u bë negociatori i dëshiruar përballë Serbisë. I dëshiruar vazhdon të mbetet edhe sot kështu në pako, bashkë me këto lëshimet që u bënë kohëve të fundit.

Në atë kohë për të gjithë ata që donin të shihnin ishte gjithçka e qartë. Nënshkrimi i “Zajednicës” në fund dhe pa njohje, dhe ashtu u bë. Dhe tani, Serbia e mësuar me Kosovën në negociata kërkon të njëjtën, e do Kosovën në tryezë të bisedimeve ashtu si e pati edhe në Bruksel, të thyer ende pa filluar. Së pari, u desh të hiqet pengesa e parë, të rrëzohet Qeveria e dalë nga vota e qytetarëve, e cila nuk varet nga Lista serbe, në mes të Pandemisë për të ardhur një Qeveri tjetër me 59 vota e që varet nga Lista serbe dhe madje nga cilido deputet i saj.

Serbia nuk do që të negociojë me Kosovën pa e pasur “Kalin e Trojës” brenda. Ajo e bën presionin nga jashtë, por edhe e do kushtëzimin nga brenda. E kur kjo të arrihet të tjerat pastaj vijnë me radhë. Kur kjo u arrit, u vazhdua pastaj me heqjen e reciprocitetit dhe heqjen dorë nga anëtarësimet në organizata ndërkombëtare. Kur për herë të parë në historinë e Kosovës u futën kamionë në dokumentet e të cilëve shkruante Republika e Kosovës, kur filloi një raport kushtëzimi me Serbinë dhe kur shteti filloi të pozicionohej si i barabartë karshi Serbisë dhe kur u arrit të dërgohet ndihmë për qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, dhe atë drejtpërdrejtë nga Banka e Republikës së Kosovës në llogaritë bankare të komunave, gjë që nuk kishte ndodhur më parë, pra edhe pse ishim në rrugë të mbarë për njohjen, edhe të diplomave, edhe të teksteve shkollore, ndodhi ajo pra që nuk ishte e papritur, u hoq reciprociteti.

E prisnim, sepse kështu ka ndodhur edhe më herët dhe çka i bie kjo? Reciprociteti derivon nga barazia dhe barazia është ajo e cila normalizon marrëdhëniet. Pabarazia, pra favorët dhe privilegjet për dikë e diskriminojnë dikë tjetër. Më duhet të citoj Sami Frashërin, i cili thotë “Privilegjet janë shokë të tiranisë, pa barazi nuk ka as liri.”

Nëse dëshirojmë fqinjësi të mirë e raporte normale me Serbinë ne duhet ta vëmë reciprocitetin. Serbia nuk ka obligim të sillet mirë me neve, kur ne se vëmë reciprocitetin me të. Kosova duhet të vendosë reciprocitet me Serbinë dhe të kërkojë borxhin e saj nga Serbia për krimet dhe dëmet e okupimit të luftës. Në vend të kësaj Kosova ka marrë pjesë në borxhin e jashtëm të Serbisë, ndërkohë që jemi përjashtuar nga sukcesioni i pasurisë së Jugosllavisë. Reciprocitetin që e mendojmë ne nuk është reciprocitet banal, as gjeometrik e as vegël për hakmarrje ndaj Serbisë. Nuk është reciprociteti i pasqyrës, por është reciprocitet strategjik. Serbia nuk na njeh për të mos na njohur dhe kjo është strategji e saj, ndërsa ne s’duhet ta njohim në mënyrë që ajo pastaj të na njohë.

Pra, reciprociteti që patëm kërkuar prej vitit 2011 ka qenë strategjik. Barrierave të Serbisë iu përgjigjemi me barrierat tona pikërisht që të mos ketë barrierë. Obligimet reciproke e mirëmbajnë bashkëpunimin ndërkombëtar, prandaj reciprociteti ynë ndaj Serbisë nuk është agresiv. Mungesa e tij është shtypëse dhe eksploatuese ndaj nesh. Praktikisht, Serbisë po i lejohej proteksionizëm agresiv, kurse neve as reciprocitet mbrojtës. Madje, si masë e mirëbesimit dhe e kooperimit ne filluam me Qeverinë Kurti reciprocitetin gradual, në vend të një reciprociteti të menjëhershëm, por kot. Ju e hoqët edhe këtë. Dhe çka tjetër? Zoti Hoti po pranon çdo kusht të dhënë nga Vuçiqi. Një nga këto kushte e që është rrënim i pozicionit tonë negociator është heqja dorë me vullnet të plotë subjektiv nga anëtarësimi i Kosovës nëpër organizatat ndërkombëtare. Ai e deklaroi vet këtë gjë, këtë heqje dorë. Ndërsa, Serbia nuk pati deklaram në lidhje me heqjen dorë nga lobimi për tërheqjen e njohjeve nga shtetet që tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës. Ajo madje, përsëriti tërheqjet e njohjeve që vazhduan në ndërkohë.

Dhe, çka tjetër? Rikthimi i Thaçit si faktor kryesor i dialogimit me Serbinë është dobësim serioz i pozitës politike të Kosovës në dialogë. Zoti Hoti e riktheu Thaçin e njëjtë, të dëshiruarin e negociatave në të shkuarën, që edhe hoqi dorë nga padia ndaj Dick Marthy-t edhe na e solli Gjykatën Speciale që gjykon sot luftën tonë çlirimtare. Rikthimi përballë Vuçiqit i figurës që është në rënie rapide të kredibilitetit, si jashtë ashtu edhe brenda, do të thotë trimërim i Serbisë.

A nuk ju kujtohet marrëdhënia qesharake me Vuçiqin në konferencën në Vjenë? A nuk ju kujtohet loja e Vuçiqit me të? Po nuk ka si të mos fitojë Vuçiqi me 75% të ulëseve në Parlamentin e Serbisë pas kësaj. Ai nuk mundet të jetë deri më tani faktori kryesor në këto negociata. Atë e bëri zoti Hoti.

Dhe tani, të nderuar deputetë, si i thoni ju tërë kësaj loje e që nga përvoja e së shkuarës dhe ajo që po shohim sot, po ia dimë qysh tash fundin e hidhur. E dimë si, shumica apo një pjesë e madhe e deputetëve kësaj krejt i përgjigjen me një fjalë, kjo është për të mirën e vendit. Epo, për të mirën e vendit do të duhej shkuar ndryshe në negociata me Serbinë, me reciprocitet pa heqjen dorë nga përpjekjet për anëtarësim nëpër organizata ndërkombëtare si palë e barabartë, me një proces transparent dhe të koordinuar mirë, me agjendë dhe platformë të qartë, e cila do të ishte diskutuar gjerë dhe me një unitet të vendosur mbi parimet e shtetësisë dhe mbi kërkesa konkrete karshi Serbisë, me një prerje të qartë me të shkuarën me marrëveshjet në Bruksel dhe nivelin e zbatimit të tyre, me temë konkrete për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, gjë që nuk ka ndodhur në të shkuarën, pos kur është manipuluar me to.

Ta zëmë, pikërisht kjo tema që u hap sot, çështja e ulëseve të rezervuara në Parlamentin e Serbisë do të mund të ishte njëra nga temat e negociatave me Serbinë dhe në definim të çështjes së njohjes që në fillim të bisedimeve. Kjo do të ishte rruga e drejtë, e jo kjo që keni zgjedhur ju, jo kështu të thyer paraprakisht. Prandaj, nuk ka se si të jetë ndryshe, pos kështu në mënyrë jotransparente. Takimi do të ndodhë pas katër ditësh. Në ndërkohë që ne deputetët dhe pothuaj askush nuk e di se çfarë do të flitet. Ju po thoni që heqjen e reciprocitetit dhe heqjen dorë nga anëtarësimi ua kanë kërkuar apo u është thënë nga administrata në Uashington. Po mirë, a na thoni se çfarë u thatë ju atëherë? Çka keni kërkuar? Për çfarë do të flisni? A e dini ju vetë, zoti Hoti, se për çfarë do të flisni? Cila është agjenda e takimit në Uashington? Cila është agjenda e takimit në Bruksel? Kush i ka përcaktuar temat?

Thuhet se do të ketë marrëveshje historike. Cila është pjesa historike e bisedave, së paku? Po harroni që jeni Qeveri me 59 vota dhe se njerëzit më të votuar i keni jashtë Qeverisë! Po harroni që jeni jo legjitimë dhe të paligjshëm, por mbase mu për këtë edhe ne nuk po dimë gjë. Po të ishte ndonjë marrëveshje e dobishme luftë do të bënit se cili do të fliste i pari dhe ju zoti Hoti nuk do të kishit ardhur në rend prej Thaçit, por meqenëse nuk po pritet marrëveshje e mirë, nuk kemi edhe si ta dimë se për çfarë do të flitet.

Ne nuk po dimë se për çka do të flisni, por një gjë po e dimë sigurt, që mbase po doni ta merrni më qafë një popull, i cili nuk do ju lejojë.

KRYETARJA: Faleminderit! Ftoj kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. I keni 15 minuta.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Republika e Kosovës më 17 shkurt 2008 është projekti më kulmor dhe i patjetërsueshëm i kombit shqiptar në Kosovë dhe etnive tjera që jetojnë në të, i jetësuar në Kuvendin e Kosovës dhe i mbrojtur nga Kushtetuta e vendit.

Mbi këtë projekt nuk mund të negociojë askush. Këtu përfundon çdo përpjekje për të rrënuar subjektivitetin e republikës sonë, por edhe për ta zhvlerësuar të drejtën tonë historike për shtet të pavarur. Por në anën tjetër, këtu hapet një perspektivë që është krejtësisht legjitime për të normalizuar marrëdhëniet tona shtetërore me vendet fqinje dhe për të përparuar drejt integriteteve euro-atlantike, që paraqet qëllimin tonë më natyror për t'u kthyer aty ku e kemi vendin, në familjen e madhe evropiane.

Nisur nga kjo premisë e përparimit të subjektivitetit tonë shtetëror Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2011 kishte votuar një rezolutë, me të cilën autorizonte Qeverinë e Republikës së Kosovës për fillimin e një dialogu që do të trajtonte çështje teknike të mbetura pezull në mes Kosovës dhe Serbisë. Nënshpresa e atij dialogu ishte gjetja për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Edhe pse, ai proces kulmoi me marrëveshjen e parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Baroneshës Ashton, më 19 prill 2013, e cila parashihte një varg masash përmes së cilave ndikohej drejtpërdrejtë jeta e qytetarëve, Serbia e devalvoi duke mos e kaluar këtë marrëveshje në Kuvendin e Serbisë dhe kështu duke bërë nulë krejt përpjekjen për normalizim të marrëdhënieve.

Krejt kjo kishte ndodhur, sepse Serbia nuk kishte për qëllim normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, por intimidimin e subjektivitetit dhe integritetit të Kosovës. E në anën tjetër, mekanizmat politikë në Bruksel nuk e kishin fuqinë për të garantuar marrëveshjen e arritur. Ajo që kishte humbur më së shumti klasa politike në Kosovë gjatë këtij procesi të tej zgjatur dialogues ishte besueshmëria popullore në njërën anë, si dhe ishte dëmtuar konsensusi i brendshëm politik për tema të tilla të rëndësishme nacionale që gjithmonë kishte ekzistuar.

E në anën tjetër, Serbia në asnjë moment nuk e ndali fushatën e saj denigruese e bllokuese ndaj shtetit të Kosovës. Madje, ajo kishte shfrytëzuar procesin e tejzgjatur të dialogut për të

riorganizuar kapacitetet e saja në dëm të shtetësisë së Kosovës, kapacitete këto që ishin devalvuar më parë me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, që ishte në favor të Kosovës.

Krejt kjo rezultoi me një proces dialogues me shumë frustrime e mosbesim brenda tij, derisa ai përfundimisht u shua me vendosjen e tarifës 100% nga ana e Kosovës ndaj mallrave serbe. Për fat të keq, kjo vetëm sa e kurthoi Kosovën në rrugëtimin e saj drejt proceseve integruese dhe ktheu reflektorët e presionit mbi ne.

Të gjetur në këtë situatë, pa vullnet politik për të dyja palët për të hapur alternativa të reja dialoguese, si dhe me një vullnet anemik nga Brukseli për të adresuar mënyrat e zgjidhjes së ngërçit dialogues, faktori amerikan pranoi të jetë jo më arbitër jashtë palëve, por ndihmues kreativ i një procesi tashmë të ri, i cili nuk rrjedhë vetëm për të konsumuar vetveten, por për të prodhuar një marrëveshje përfundimtare paqeje në mes Kosovës dhe Serbisë, e cila duhet të kulmojë me njohje reciproke.

Prandaj, të nderuar deputetë, sot jemi në rrethana të reja ku për herë të parë ne jemi jo vetëm aktorë, por edhe protagonistë në kuadrin që po ndërtohet për të arritur te një marrëveshje, që në thelb ka njohjen reciproke në mes të dy vendeve. Kosova ka interes jetik të përmbyll konsolidimin e shtetësisë së saj në arenën ndërkombëtare përmes çarjes së rrethimit që ka sjellë konflikti i ngrirë me Serbinë. Kosova më nuk mund të jetë vetëm palë që ftohet në tavolinën e bisedimeve, por do të jetë insistuese e krijimit të konsensusit ndërkombëtar për të përmbyllur konfliktin me Serbinë dhe për të siguruar njohjen reciproke, njohjen nga pesë vende të BE-së dhe ulësen në OKB. Ky është interesi ynë strategjik. Për realizimin e këtij ne duhet të jemi bashkë, të vendosur dhe të koordinuar me miqtë tanë.

Ky momentum i ri ndërkombëtar BE - SHBA, i cili ka për qëllim të prodhojë një projekt përfundimtar normalizimi dhe paqeje përmes njohjes reciproke në mes Kosovës dhe Serbisë, duhet ta pranojmë, vjen për Kosovën në një kohë kur grupime politike populliste, jo vetëm nuk patën guximin të marrin përgjegjësinë politike e kombëtare për t'i dalë në mbrojtje subjektivitetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës, por i rrezikuan ato përmes barrikadimit dhe humbjes së miqve.

Asnjë sfidë politike nuk duhet të na frikësojë e as ta stopojë për ta mbrojtur sovranitetin tonë. Për më shumë, këtë proces të ri dialogues duhet shikuar si një mundësi, që së bashku me miqtë tanë që janë sponsorizuesit dhe garantuesit e projektit tonë për shtet të pavarur, ta përparojmë dhe konsolidojmë shtetësinë e Kosovës dhe subjektivitetin e saj ndërkombëtar.

Largimi i barrierave tarifore nga ana e Qeverisë sonë ishte një veprim i vullnetit të mirë për t'i dhënë shtysë procesit politik për betonimin e subjektivitetit të Republikës së Kosovës, por edhe për të bërë vend në krahët e miqve tanë ndërkombëtarë.

Ne si Qeveri nuk besojmë që masat e përkohshme politike që krijojnë barrierë ekonomike ndërmjet vendeve mund të zgjidhin problemin politik me Serbinë. Unë ju siguroj se barrierat ekonomike dhe tregtare do t'i adresojmë përmes mekanizmave rajonalë dhe evropianë. Problemet politike që kemi me shtetin tonë fqinj mund t'i adresojmë vetëm duke aplikuar politika të qëndrueshme dhe efikase që koordinohen ngushtë me miqtë tanë ndërkombëtar.

Unë jam i bindur, se vetëm në këtë mënyrë pra, përmes masave që tani kemi ndërmarrë në koordinim me të gjitha qendrat e vendosjes ndërkombëtare do të mund të kthejmë besimin e SHBA-ve ndaj Qeverisë së Kosovës, sikurse edhe eliminimin e keqkuptimeve të shkaktuara në mes nesh dhe Berlinit, Parisit, Brukselit dhe Londrës.

E gjithë kjo ndërmarrje e Qeverisë sonë si dhe vendimi që e kemi marrë në ditë të para, kanë pasur për qëllim që qytetarët e Kosovës dhe shteti i Kosovës në asnjë formë apo rrethanë të mos paguajnë faturën e politikave të gabuara, që izoluan vendin nga miqtë tanë. Pasojat e atyre vendimeve morën formën, siç e dini, të masave ndëshkuese me izolim diplomatik, politik e financiar, të shqiptuara publikisht nga SHBA-të dhe nga Shtëpia e Bardhë. Ne kemi nevojë, sidomos tani në vigjilje të përballjes përfundimtare me Serbinë, qoftë në Uashington apo Bruksel, Paris dhe Berlin, të jemi bashkë dhe përkrah njëri-tjetrit. Miqtë tanë na duan të jemi bashkë. Është e domosdoshme të jemi bashkë, kur përballemi me pengesat që Kosova ka në rrugëtimin e vet drejt anëtarësimit në NATO, në OKB dhe në BE.

Ju siguroj se vendimin që kemi marrë ka qenë në koordinim me miqtë tanë ndërkombëtarë. Ne ruajmë të drejtën tonë, që nëse procesi i dialogut nuk jep rezultatet e pritura brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në koordinim me miqtë tanë ndërkombëtarë të ndërmarrim të gjitha masat ligjore për të ruajtur ekonominë dhe sovranitetin tonë shtetëror. Besoj që të gjithë pajtohemi, se asnjë masë e reciprocitetit nuk mund të jetë e suksesshme, nëse ne nuk koordinohemi me miqtë tanë ndërkombëtarë. Faleminderit!

KRYETARJA: Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetare!

Ka rreth një dekadë që në këtë Kuvend po përballemi me çështjen që ka të bëjë me reciprocitetin me Serbinë.

Për ju që nuk e dini e që doni ta dini, reciprocitet do të thotë barazi, reciprocitet do të thotë, edhe dinjitet, edhe shtetësi, por edhe mbrojtje. Të jesh kundër reciprocitetit do të thotë të kesh hequr

dorë nga barazia, nga shtetësia, nga dinjiteti dhe nga mbrojtja përballë Serbisë në bisedime, do të thotë të jesh i pabarabartë qysh në nisje. Do të thotë, se ju nuk guxoni as të mbroheni edhe kur mundeni. Është i tmerrshëm mosguximi që të mbroheni edhe kur mund të fitoni.

Reciprociteti që vendosi Qeveria Kurti ju dha mundësi që ta mbronit Republikën, ju hoqët dorë nga kjo mundësi. Ndër vendimet më me unitet të Qeverisë suaj ilegale ishte pikërisht heqja e masave të reciprocitetit me Serbinë. U bëtë bashkë të gjithë për ta marrë këtë vendim shumë të rëndësishëm, por e morët këtë vendim duke qenë edhe vendim i turpshëm e, për fat të keq, ky vendim ju bëri të gjithëve bashkë.

Për shembull, LDK-ja duke hequr dorë nga premtimi i saj për zëvendësimin e taksës me reciprocitet, AAK-ja duke harruar tashmë taksën 100% ndaj mallrave serbe e boshnjake, Nisma duke mos folur asgjë, kurse Lista Serbe duke kushtëzuar mirëmbajtjen e koalicionit me heqjen e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë. Kështu erdhi deri te vendimi më i rëndësishëm i Qeverisë suaj “Koti”. Ju treguat që jeni të gatshëm të hiqni dorë nga gjithçka, përveç nga të qenit në pushtet. E keni provuar shumë herë këtë, po e provoni edhe tash. Ju nuk hoqët dorë vetëm nga reciprociteti ndaj Serbisë, ju hoqët dorë edhe nga aplikimi për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, sepse edhe kjo ishte kërkesë e Serbisë. Ju hoqët dorë edhe nga lobimi për njohje të reja.

Tërheqja nga reciprociteti, nga aplikimi për anëtarësim në organizata ndërkombëtare e në veçanti edhe nga lobimi për njohje të reja ju bën juve të shkoni përballë Serbisë të çarmatosur, të zhveshur politikisht dhe të pambrojtur qysh në start. E dimë tashmë që juve të gjithë bashkë ju bëri presidenti. Në ndërtimin e një Qeverie, ndonëse ilegale, por të gjithë ju bashkuat atij edhe kundër reciprocitetit edhe kundër Qeverisë Kurti, iu bashkuat atij edhe për pushtetin, edhe për marrëveshjet me Serbinë, prandaj ne e kemi shumë të vështirë sot ta gjejmë dallimin në mes jush, sepse ju vërtet jeni të njëjtë në të gjitha këto tema.

Dua t’ua ilustroj. Për shembull, nuk mund të gjej dallim në qëndrime për këto çështje në mes jush dhe Thaçit, përveçse ai është bosi juaj, ky është dallimi i vetëm. E ai bos prodhoi, përveçse një qeveri ilegale, edhe një kryeministër shëgert. Mustafa u pajtua me Thaçin kundër Qeverisë Kurti. Nëse nuk është kështu, ma thoni. A është kështu? Veselin nuk e kemi dëgjuar asnjëherë të kundërshtojë ish-shefin e tij të partisë, madje as për dekretin e nominimit të Hotit, apo nuk është kështu? Ka diçka të vërtetë, thotë kolegu im. Mustafën nuk e dallojmë nga Veseli për sa u përket bisedimeve me Serbinë, të gjithë janë për bisedime me Serbinë. Haradinaj iu bashkua Thaçit, po ashtu. Apo nuk është kështu?

Madje, iu bashkua Thaçit edhe për t’ia bërë votat LDK-së, apo nuk është kështu? E Limaj nuk ka dallim nga asnjëri prej këtyre, nga të cilët asnjëherë nuk sheh, as kundërshtim, as ndryshim. Madje, pajtohet edhe kur secili prej tyre nuk pajtohen me njëri-tjetrin. Pra, të gjithë jeni bërë

bashkë dhe nuk po e gjej dallimin. Ju sfidoj ta thoni të kundërtën, referuar kësaj që thash unë këtu. Por, pasi interpelanca e sotme është thirrur për heqjen e masave të reciprocitetit i ngre disa pyetje për ju që jeni kundër reciprocitetit, në veçanti për zotin Avdullah Hoti, i cili e mori këtë vendim. Çka përfiton Kosova duke mos qenë e barabartë me Serbinë? Çka përfiton Kosova nga heqja e reciprocitetit? Përse është pengesë reciprociteti? Mbaj shënim, sepse pres përgjigje.

Për kë është pengesë pra reciprociteti. Dhe në fund të fundit, në çfarë dialogu jeni nisur? A e kuptoni se nuk ka dialog pa reciprocitet? Nuk ka dialog në mes të pabarabartëve, sepse ai nuk quhet më dialog.

Ju kështu keni hequr dorë edhe nga vet dialogu, prandaj para se të mendoni se ku po shkoni, mendoni se ku do të ktheheni.

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i LDK-së, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

E nderuar kryetare,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç duket, pa dëshirën tonë si shumicë parlamentare ne sot do të ndahemi në ata që kanë dëshirën e deklaruar dhe zgjedhin privilegjin e të ndenjurit në rrugën populiste, si në retorikë ashtu edhe në veprim.

Përballë atyre që kanë deklaruar përkushtimin dhe angazhimin në këtë kohë dhe rrugë, që duket jo popullore, por që ndjek rrugën e asaj që duhet të bëhet. Sepse, ajo që duhet të bëhet është jetike për vendin. Pra, ne nuk e kemi komoditetin e refuzimit të pjesëmarrjes në bisedimet e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e aq më pak nuk mund të kemi rehatinë që të bëhemi palë duke hyrë në luftën me Evropën apo Amerikën dhe duke nxitur tendenca kundër njëra-tjetrës. Ne jemi Kosova dhe kështu duhet të përfaqësohemi në secilin forum, në secilën iniciativë. Kur ne ndahemi në ata që e ndjekin dëshirën dhe në ata që veprojnë për të bërë atë që duhet, ironia është se ata që e ndjekin dëshirën populiste, tentojnë ta imponojnë dëshirën e tyre si vullnet të popullit, të cilin e përkthejnë pastaj si detyrim për ne. Deri dje partnerët tanë të qeverisjes e kishin mundësinë ta përfaqësojnë vendin, ta ndërtojnë konsensusin. Nuk e bënë as njërën as tjetrën. Sot, e kemi ne mundësinë që të përfaqësojmë vendin, por edhe e kemi detyrën që ta ndërtojmë konsensusin dhe ta ruajmë shtetin.

Miqtë tanë të qeverisjes së djeshme e kanë vetëm perspektivën e tyre, perspektivë të cilën mundohen ta paraqesin si të vërtetën absolute. Duke u bazuar në opinionin e tyre, të cilin mundohen ta paraqesin si fakt.

Pra, shokë dhe shoqe nga Vetëvendosje, hajde ta ndërtojmë perspektivën e Kosovës, jo nga llogoret partiake, por nga institucionet përfaqësuese, pra nga Kuvendi i Kosovës. Duke ndërtuar konsensusin qoftë edhe pas ditë të tëra debate e përplasje të ideve, por jo të interesave.

Ne mund t'i shohim çështjet nga një perspektivë tjetër. Pra, mund të shohim edhe pak mbrapa se si u ngritën shtete e perandori, po nuk duhet të harrojmë të shohim se si ranë ato. E të mos harrojmë sidomos sa është e rëndësishme për një shtet të ri dhe vend të vogël të kenë drejtimin e duhur, veprimin e duhur, deklarinin e menduar. Pra, të jemi realë për atë që na pret dhe për atë që na ofrojnë dhe duhet të jemi të vetëdijshëm për atë që ofrojmë ne në këtë procesi politik dhe jo duke u bazuar në interesin tonë partiak.

Sot, pra të shohim interesin e vendit tonë nesër. Të mos e paraqesim interesin partiak si fakt, e të mos e besojmë si një të vërtetë superiore.

Në anën tjetër, nuk duhet të humbim kohë duke argumentuar se si duhet të jetë një qeverisje e mirë, se si duhet të jetë një lidhësi i duhur. Hajde ta dëshmojmë përkushtimin tonë, hajde ta dëshmojmë lidhësin sot ne këtu, nga ky Kuvend, jo duke u fshehur pas fjalimeve partiake përçarëse, por duke i dalë përballë situatës me veprime konkrete, duke bashkëpunuar ne si pushtet dhe ju si opozitë, në interesin jetik të vendit. Ne sot ju zgjatim dorën e bashkëpunimit për të treguar lidhësin e duhur për këtë proces për të mirën e vendit. Ne sot duhet të pajtohemi që gjërat të cilat nuk janë të duhurat, të mos bëhen. Po në të njëjtën kohë duhet të pajtohemi që gjërat që nuk janë të vërteta, të mos thuhën. Sepse, po u bënë veprime të gabuara dhe po u thanë gjëra të pavërteta, dëmi është i madh dhe i pariparueshëm si dhe raportet tona do të dëmtohen, ashtu edhe interesi i vendit.

Ne e dimë që hakmarrja më e mirë është që të mos bëhesh si armiku yt. Ne e dimë, ose të paktën mund të pajtohemi që ne arritëm ta kemi vëmendjen e botës, sepse ishim ndryshe, jo si armiku ynë. Ishim bashkëpunues, nuk ishim refuzues. Ishim të vendosur për vendin tonë, nuk ishim të përçarë. Kishim një plan se ku do të shkojmë, nuk udhëhiqeshim nga stihia. Pra, e dinim se çka duam të arrijmë. Këtë vëmendje ndërkombëtare e kishim kur ishim bashkë. Arritëm ta shndërrojmë në simpati nga bota demokratike dhe me përkushtimin tonë, simpatia botërore u përkthye në përkrahje politike për kauzën e lirisë dhe shtetit të Kosovës. E kur përkrahja politike u bë fakt, armiku bëri veprimet të cilat bota i dënoi si të papranueshme dhe kur ato nuk u ndaluan, i ndëshkoi me forcën e armës, e cila bashkuar me armët e UÇK-së e solli lirinë e Kosovës.

Pra, ne sot dhe asnjëherë nuk duhet të bëjmë gabimin e armikut tonë. Nuk duhet të bëjmë botën kundër vetes, nuk duhet të kthehemi kundër njëri-tjetrit, sidomos në këtë proces. Por, edhe në asnjë proces tjetër, sepse duhet të jemi bashkë për të vendosur. Është në fuqinë tonë që të tërhiqemi në një cep të Ballkani dhe të botës nëse këtë do ta quaja fuqi. Kjo është e kollajshme,

por nuk është e duhur. Kjo mund të jetë e dëshirueshme, por kjo nuk është e duhura. Kjo tërheqja, ky izolim, mund të jetë populist sot, por është antipopullor nesër dhe përgjithmonë.

Izolimi nuk është zgjidhja, atë nuk e përqafojmë ne. E kundërta është zgjidhja, është përfaqësimi, bashkëpunimi, rrjetëzimi. Janë mundësitë tona, sepse edhe e kaluara e ka dëshmuar se kur kemi bërë këto veprime, kemi dalë fitues. Kujtojeni Rambujenë, kujtojeni Parisin, kujtoheni Vjenën, kujtojeni Brukselin dhe tash do të bindeni edhe me Uashingtonin! Ne duhet dhe do të jemi fitues, por fitues të mëdhenj dhe të sigurt jemi vetëm kur shkojmë bashkë dhe të vendosur.

Të nderuar kolegë,

Si përfundim, më duhet të konfirmoj se ne e kemi zgjedhur rrugën e vështirë të marrjes përsipër të nxjerrjes së vendit nga stuhia në det të hapur drejt brigjeve të sigurta, të ekzistencës së përherëshme në kufijtë e tij dhe me organizimin e vet kushtetues.

Pra, thirrja ime për ju sot, lutja jonë për ju është, hajde ta përfaqësojmë Kosovën me dinjitet, hajdeni t'i drejtojmë bisedimet me integritet, hajde ta ruajmë unitetin e Kosovës sonë të dashur. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e kërkon fjalën? Deputeti Enver Hoxhaj!

ENVER HOXHAI: E nderuar, zonja kryetare!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

E dëgjova goxha me vëmendje iniciuesin e interpelancës dhe e pata përshtypjen që iniciuesi i interpelancës nuk po flet me një audiencë që janë Kuvendi i Kosovës, por po flet sikur të ishte jashtë. Do të duhej t'i thoshit disa gjëra të cilat ne i dimë dhe qytetarët e dinë.

Së pari, reciprocitetin e ke vendosur më 1 prill. Së dyti, nuk ka qenë i plotë reciprociteti i plotë reciprocitet politik, ekonomik, tregtar se si e keni promovuar. Së treti, nuk e keni vendosur në mbledhjen e parë të Qeverisë. Nuk e keni vendosur kur Sierra Leone e ka tërhequr njohjen e Kosovës. E keni vendosur kur keni qenë Qeveri e shkarkuar. Prandaj, ju kisha lutur mos flisni sikur të ishit në audiencë ndërkombëtare, se ne kemi qenë këtu, e dimë çka ndodhur.

Po më habiti që edhe kryeministri foli sikur të ishte farë akademie diplomatike në Holandë a Finlandë. Foli për historikun e dialogut, qysh ia ka nisur, cilat marrëveshje i kemi arritur. Unë mendoj që temën që ne e kemi, është më serioze, më shqetësuese. Nuk ka të bëjë me atë a jemi ne në opozitë dhe a janë kolegët e nderuar në Qeveri. Ka të bëjë me diçka çka është më serioze. Po ju jap shembullin e parë. Tarifa 100 për qind është vendosur si masë dhe kundërmasë ndaj

Serbisë për shkak të tërheqjes së njohjes së pavarësisë së Kosovës. Ju kolegë të nderuar, edhe VV-ja, edhe LDK-ja e keni hequr tarifën, e keni hequr reciprocitetin dhe keni hequr dorë nga kandidatura, nga aplikimi në organizata ndërkombëtare. D.m.th. i keni bërë tri lëshime për një lloj gjysmë zotimi fals, të rrejshëm të Serbisë.

Po ma merr mendja që Kryeministri si ekonomist, të paktën në kontabilitet duhet t'i llogarit këto gjëra. Veç ta kryej! Cili është dëmi më i madh i këtij zotimi? Dhe po dua të jem shumë i sigurtë. Këta kolegët e VV-së vërtet kanë vendosur një standard të ri se për 50 ditë e kanë shkelur dy herë Kushtetutën. Por kjo Qeveri ka vendosur një standard të ri, se për dy javë e shkeli Deklaratën e Pavarësisë dhe unë e kam ndërmend t'ju citoj Deklaratën e Pavarësisë, pikën e tetë se çka thotë. Mbajeni mend! Mbajeni mend, mbajeni mend! Deklarata e Pavarësisë i ka diku 12 nene, paragrafë, pika. Uran veç pak dhe pika e tetë thotë kështu po citoj: me pavarësinë vjen detyra e anëtarësimit të përgjithshëm në bashkësinë ndërkombëtare. Ne pranojmë plotësisht këtë detyrë. Me fjalë të tjera, me zotimin që ka bërë Qeveria, ju keni hequr dorë prej kësaj, prej këtij paragrafi të Deklaratës së Pavarësisë. Kjo është!

Kryetarja e Kuvendit po thotë edhe pikën nëntë. Pajtohem edhe pikën nëntë. S'po dua që të jem shumë i gjatë, se po dua që kolegëve t'ju jap hapësirë. Kjo është një temë më serioze përtej debatit kush është opozitë, përtej debatit kush është Qeveri. Dhe a e dini pse po e përmendi Deklaratën e Pavarësisë, jo vetëm si argument retorik, po nëse ju do t'ju thoni partnerëve amerikanë e kemi të shkruar në Deklaratën e Pavarësisë, ma merr mendja që nuk do të kërkonin prej juve të keni një zotim të tillë.

Nëse ju do t'u thoshit partnerëve amerikanë që është edhe Pakon e Ahtisarit një gjë e tillë, ma merr mendja që ata do të thoshin: kemi konsideratë. Nëse e kishit tërhequr, e kishit larguar reciprocitetin vetëm për shkak të tërheqjes së njohjes, kishte qenë njëfarë balance, por i keni bërë tri lëshime. Shqetësimet të cilat ne i kemi për atë, unë e pata përshtypjen që dhe kolegët e VV-së, edhe Qeveria po flet sikur të jetë jashtë kontekstit. Shqetësimet që unë i kam janë këto: çka nënkupton ky zotim? A vlen ky zotim që ne nuk kërkojmë njohje dhe nuk kërkojmë anëtarësim në organizata ndërkombëtare deri të dielën që shkon Kryeministri në Uashington, a vlen për komplet 2020-ën, apo vlen për këtë mandat të kësaj Qeverie? Dhe a e dini se çka i bie? Se po e shoh ministren e jashtme e kam në krahun e majtë. Kjo i bie, që Qeveria e Republikës së Kosovës, në fakt e ka pezulluar politikën e saj të jashtme. E ka suspenduar politikën e saj të jashtme. Kjo i bie se Ministria e Punëve të Jashtme është Ministri e Punëve të Jashtme në pauzë. Këto janë tema serioze. Kjo është arsyeja pse ne i kemi dhënë gravitet këtij debati. Sepse ne mendojmë që duhet ta diskutojmë këtë temë.

Po kaloj te një çështje e dytë. Se realisht kur e shndërron politikën e jashtme në protokoll, se tash ka mbetur veç protokoll, të paktën në protokoll nuk bën gabime. Po pastaj kur protokollin e shndërron në temë gjeopolitike, është çështje edhe më e ndjeshme. Ja po jap një shembull. Unë e

kam parë me simpati shkuarjen e Kryeministrit në Uashington dhe kam dalë në deklarata publikisht. Po dje unë mbeta i habitur kur e pash që ka vendosur të shkojë në Bruksel para se të shkojë në Uashington. A krejt vëmendja ndërkombëtare, ngjarja kryesore e Ballkanit është çka ndodh mes Kosovës e Serbisë në Uashington. Kur të shkojë në Uashington, ata mund ta pyesin çka ju thanë në Bruksel. Po a e dini që kur e keni vizitë të deklaruar publikisht te partneri kryesor, nuk e bën gabimin të thotë po shkoj në Bruksel, pastaj prej Brukselit po shkoj në Uashington. Vuçiqi po shkon në Moskë dhe prej Moskës po shkon në Uashington, është goxha gabim i madh. Mendoj se është goxha gabim i madh. D.t.th. është goxha zhvarësi të bëhet një gabim protokollar me pasoja gjeopolitike. Të paktën, me sens mund ta thonë si kalove në Bruksel, çka thanë në Bruksel, se ata janë qendra e botës dhe partneri ynë kryesor.

Te taksa. Taksa vërtet është vendosur në nëntor të 2018-ës me pritjen tonë që ne do ta krijojmë njëfarë situate të ndërvërsisë, të ‘link-ich’ të ndërlidhjes, që Serbia e ndal fushatën kundër njohjes dhe partnerët tanë e marrin seriozisht. Dhe për një kohë e kanë marrë seriozisht. Po, në Qeverinë ku kam qenë unë me kolegët që kam pasur bashkëpunim shumë të mirë e patën shndërruar taksën në parullë, slogan zgjedhor, Kosova 100 për qind, 10 për qind vota. Rezultati! Mandej çka kam mbetur i habitur edhe më shumë, që ju po ashtu e keni bërë një gabim të madh strategjik, LDK-ja dhe VV-ja. Kur thatë që taksën do ta zëvendësojmë me reciprocitet dhe kur e keni përmendur në program të Qeverisë, realisht janë ditur pasojat të cilat do të jenë.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që nuk kemi nevojë që për tema të politikës së jashtme ta godasim shumë njëri-tjetrin, meqë janë fakte të matshme. Por, kam nevojë t’i them dy-tri gjëra, se nuk dua që në fund të vitit të vijmë pastaj në konkluzë krejt të tjera. Po shkoni në Uashington, që duhet të shkoni në Uashington pa platformë, po shkoni në Uashington pa parime. Unë s’e dëgjova Kryeministrin që përmendi parime mbi të cilat do të negociojë. Po shkoni në Uashington pa tema, mandej po dhe qartë dhe janë tri-katër gjëra që po përflitet që mund të diskutohen. Mund të diskutohet unioni doganor të cilin edhe LDK-ja, edhe PDK-ja e kanë kundërshtuar. Edhe Avdullah Hoti si ministër i financave dhe unë si ministër i jashtëm. Mund të diskutohet çështja e tregut të përbashkët, të cilin edhe LDK-ja, edhe PDK-ja e kanë kundërshtuar. Mundet unioni doganor të cilin ne po ashtu e kemi kundërshtuar. Mundet minishengeni, të cilin të gjithë ne e kemi kundërshtuar. Unë e kam përshtypjen që kur ju të mbërrini në Uashington, mund të jeni politikisht të papërgatitur, mund të jeni përmbajtësisht të papërgatitur dhe mund të jeni psikikisht të papërgatitur për barrën e cila ju pret.

Ne jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë për dialog me juve. Po, një send po ju them, zgjerojeni pak kontekstin. Ju s’mund të kërkonit mbështetje prej PDK-së për dialog, mënyrën si donit të katapultoni buxhetin. Atëherë, nëse doni bashkëpunim, zgjerojeni kontekstin! Bëjeni një listë të temave, ulemi dhe e bisedojmë me njëri-tjetrin. Po i them të gjitha këto se nuk kisha pasur qejf

mbi të gjitha në 2020-ën të gabojmë, se çmimi i gabimeve mund të jetë më i madh sesa çmimi i gabimeve që kemi bërë deri më tash.

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Gazmend Abrashi.

GAZMEND ABRASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Ministra,

Deputetë,

Media dhe ju këshilltarë të Kosovës,

Është tragjike që parimi i reciprocitetit është përfolur, është shtrembëruar dhe është raportuar në forma të ndryshme, duke tentuar të mblidhen poenë politike, të cilët në esencë nuk kanë kurrfarë konotacioni dhe si i tillë është shumë i thjeshtë dhe shumë praktik.

Kosova prej vitit 2007 është anëtare e barabartë e CEFTA-s, marrëveshje kjo që anëtarëson të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor, me qëllim të lëvizjes së lirë të mallrave, njerëzve dhe kapitalit. Përkundër asaj se në atë kohë Kosova nuk ka pasur interes praktik të kyçet në këtë organizatë, interesi politik që Kosova të kyçet në organizatat rajonale, në atë kohë ka qenë jetik për Kosovën.

Në këtë marrëveshje janë të rregulluara saktësisht parimi i reciprocitetit, që nënkupton njohjen e vulave të ndërsjella doganore të shteteve të Ballkanit Perëndimor, certifikatave të mallrave, transitin e lirshëm të maunave nëpër shtetet e Ballkanit Perëndimor, eliminimin e pritjeve të mëdha në vendkalimet kufitare dhe menaxhimin e ashtuquajtur të implementimit të menaxhimit të integruar në kufijve dhe shumë e shumë marrëdhënieve të ndërsjella tregtare që kanë të bëjnë me thjeshtësimin e procedurave administrative në vendkalime kufitare.

Me kalimin e kohës, Serbia përkundër që i ka nënshkruar këto marrëveshje reciproke, shumicën e tyre nuk i ka respektuar përkundër raportimit të pareshtur të Republikës së Kosovës në Sekretariatit e CEFTA-s në Bruksel për bllokadat që ajo i ka bërë në kontinuitet. Si rezultat i mosrespektimit të këtyre marrëveshjeve reciproke, të nënshkruara në kuadër të Marrëveshjes së CEFTA-s, Qeveria Haradinaj fut në fillim taksën 10 për qind, e më vonë 100 për qind, me kushtëzim që e njëjta mund të hiqet vetëm kur parimi i reciprocitetit respektohet në tërësi. Përkundër presionit të madh të Serbisë dhe presionit ndërkombëtar që kjo taksë të hiqet, Qeveria Haradinaj vazhdon me taksën deri në implementimin e sakët të Marrëveshjes së reciprocitetit.

Parimi i rivendosjes së parimit të reciprocitetit është vendim i Qeverisë Haradinaj që daton në nëntorin e v. 2018 në të cilin janë të përshkruara saktë deklaratimet që duhet të bëhen nga prodhuesit serbë, duke përdorur vetëm emrin kushtetues të Kosovës. Me involvimin e diplomacisë amerikane, gjegjësisht ambasadorit Grenell, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me

këmbëngulësinë më të madhe e kërkon që ky parim të respektohet dhe si rezultat konkret kemi marrëveshjen e nënshkruar në Berlin, ndërmjetësuar nga ambasadori Grenell për hapjen e rrjetit hekurudhor Prishtinë - Beograd dhe linjës ajror Prishtinë - Beograd.

Andaj parimi i reciprocitetit, i proklamuar nga Qeveria paraprake ishte vetëm një fikSION, i cili në të vërtetë ka qenë në kontinuitet i zbatuar. Duke përdorë gjithnjë emrin kushtetues të Kosovës në importin kontinuel të mallrave. Tashmë, insistimi i Aleancës për involvimin e diplomacisë amerikane po jep rezultatet e para dhe element për stabilizimin e raporteve të lëkundura me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Andaj, deputetë të nderur, ju ftoj që këtë marrëveshje të pastër mos ta politizojmë dhe t'i japim rast diplomacisë që qysh në udhëtimin e parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 27 qershor t'i presim rezultatet konkrete. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista Serbe, nuk janë këtu. Grupi Parlamentar NISMA-AKR, a e ka kërkuar dikush fjalën? Jo! Grupi Parlamentar 6+? Nuk e ka kërkuar askush fjalën. Deputetët pa grup? Nuk ka!

Kryeministri e ka kërkuar fjalën sërish. D.m.th. këto minuta do të merren nga minutat e Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Unë në paraqitjen time besoj që isha gjithëpërfshirës në qasjen që kemi si Qeveri karshi këtij procesi dhe besoj që në pikën tjetër të rendit të ditës do të diskutojmë më konkretisht për procesin e dialogut. Jam koncentruar vetëm në çështjet për të cilën është thirrur kjo interpelancë, po më lejoni të them shumë qartë edhe thjeshtë. Ne i kemi hequr masat e reciprocitetit për t'i dhënë mundësi dialogut. Kaq e thjeshtë është. çdo teori tjetër që ndërtohet është e paqëndrueshme.

Pse na duhet dialogu? Pse po hyjmë në proces të dialogut? Nuk po hyjmë për të normalizuar linjat e autobusëve, as për zgjidhur çështje teknike, sepse kemi dialoguar që nëntë vjet për atë çështje. Po hyjmë për njohje reciproke. Për këtë po hyjmë, jo për gjë tjetër. Kjo është!

Ne e ruajmë të drejtën tonë. Nëse dialogu nuk është i suksesshëm dhe do ta marrim vesh shpejt nëse nuk është i suksesshëm. Është çështje javësh kur dimë a po ecim përpara në këtë proces, a mund ta përmbyllim marrëveshjen apo jo, ne e ruajmë të drejtën si shtet sovran për të vendosur të gjitha masat e reciprocitetit. S'kemi hequr dorë prej sovranitetit qysh po ndërtoni teori të tilla, ju kisha lutur!

Këtu ka njerëz me përvojë në këtë Kuvend në politikë të jashtme më shumë edhe se deklaratimet që u bënë janë pak të paqëndrueshme. Kur e kemi marrë në ditën e tretë të qeverisjes tonë vendimin e guximshëm që të heqim këto masa, në koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë,

t'i hapim mundësi dialogut, ky vendim është përshëndetur nga PDK si parti opozitare. Me deklaram publik keni thënë se është marrë një vendim i guximshëm në koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë për t'i hapur mundësi procesit të dialogut.

Vizita jonë në Bruksel të enjten nuk e zëvendëson takimin në Uashington. Vizita jonë ka për qëllim që ne në nivelet më të larta të Komisionit Evropian, të institucioneve të BE-së të kërkojmë liberalizimin e vizave dhe të koordinojmë për atë që është e mundur mbështetjen që ne presim si Kosovë në kuadër të mbështetjes për Ballkanin Perëndimor, për pakon e rimëkëmbjes ekonomike. Kjo është e vërteta!

Ndërkohë që përfaqësuesit e Serbisë shkojnë në Moskë dhe mandej fluturojnë në Uashington, ne shkojmë në Brusel, aty ku e kemi vendin, dhe mandej vazhdojmë më tutje në bisedat në Uashington.

Platformën për dialog e kemi të qartë. Besoj në pikën e dytë do ta diskutojmë më në detaje. Edhe unë tani më kam zhvilluar diskutime të gjera edhe publike, edhe me miqtë tanë, për t'u bërë të qartë këtë platformë. Dhe cila është ajo? Atë që e thash: për njohje reciproke. Dialog për njohje reciproke dhe çdo gjë tjetër i subordinohet këtij qëllimi. Çdo gjë tjetër që thuhet, unë besoj që është vetëm politikë ditore. E ka ftuar forumin e liderëve të partive politike, në dy takime.

Opozita nuk ka marrë pjesë. E ftoj edhe sot që të marrë pjesë, që të na dëgjojë se si Qeveri si do të paraqitemi në këtë proces. E kemi prezantuar këtë platformë para institucionit më të lartë akademik në vend, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Kemi biseduar me shoqërinë civile, me njerëzit që dhjetë vjet, njëzet vjet, e përcjellin këtë proces. Kemi biseduar për këtë qëllim me ambasadorët e Quintit, të cilët e kanë bartur këtë platformë, këtë mesazh të Qeverisë sonë te qeveritë e tyre. Kemi biseduar me të gjithë ambasadorët e BE-së për ta bartur këtë mesazh te qeveritë e tyre. Kemi biseduar me ambasadorët tanë në qendrat kryesore në Evropë dhe në Amerikë për të treguar pozicionin e Qeverisë së Kosovës karshi procesit të dialogut, për t'u treguar këtë që po ju them këtë në këtë foltore.

Nuk ka asgjë prapa kësaj edhe kam për të qenë plotësisht transparent deri në fund, edhe në forumin e liderëve të partive politike, edhe këtu në raportim në Kuvend, edhe në kërkesën që do ta kem në pikën tjetër të rendit të ditës që të formohet një komision parlamentar për procesin e dialogut. Kjo është e vërtetë!

Mund të bëjmë sado politikë ditore, po vetëm përmes procesit të dialogut kemi ardhur këtu ku jemi. E më thonë tani nëse ne aplikojmë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, edhe parterët tanë kryesorë ndërkombëtarë thonë nuk e keni përkrahjen tonë, ku shkojmë? Qëndrimi i kësaj Qeverie ka qenë ky, ne pauzojmë aplikimin tonë. Pra, nuk e dorëzojmë aplikimin tonë në organizata ndërkombëtare deri më 27 qershor, për të parë nëse mund të bëjmë progres në proces

të dialogut. Kjo është e vërteta! Mund të thoni sa të doni teori, vetëm kjo është e vërtetë. Gjithmonë kam për t'ju thënë drejtpërdrejt të vërtetën. Këto punë kryhen bashkë në këtë Kuvend, pozitë dhe opozitë, ose nuk kryhen fare. Prandaj do të jem plotësisht transparent, të kërkoj gjithëpërfshirje. Nëse s'mund ta arrijmë atë, nuk shkon përpara procesi i dialogut. Ose ka për t'u arritur një marrëveshje e mirë që është në përputhje me Kushtetutën, ose nuk ka për të pasur marrëveshje. Këtë mund t'ju them, edhe mund të vazhdojmë pastaj me vendosje të masave, me mbajtje të status-quo-s edhe me të gjitha problemet që i kemi pasur deri më tash.

Është jetike të ruhen partneritetet, miqësitë ndërkombëtare. Nëse nuk i kemi mbrapa ata partnerë, mbesim në vend i vogël i izoluar që kurdo mund të marrim njoftime për tërheqje të njohjeve, ose mbetemi vend ku shtetësinë tonë e kemi të pakonsoliduar në arenën ndërkombëtare. Ne nuk kemi rrugë tjetër. Ne nuk mund të shkojmë përmes Moskës për t'u anëtarësuar në OKB. Mund të shkojmë vetëm përmes Brukselit edhe Uashingtonit për anëtarësim në OKB. S'ka rrugë tjetër! Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Mimoza Kusari-Lila nga Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit e nderuara Kryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zoti Hoti pak më parë e përmendi, në fakt në ekspozenë e tij hyrëse tha nëse nuk kemi sukses në dialog do të koordinohemi me miqtë ndërkombëtarë pikë, pikë, pikë. Nuk e dimë çka. Për çka do të koordinohemi me miqtë ndërkombëtarë? Për ta shpallur edhe një herë pavarësinë? Cila është strategjia nëse nuk ka sukses dialogu? Çfarë koordinimi ne na duhet, kur ne nuk kemi ide për vete se çka presim prej dialogu? E para!

E dyta! Tha platforma për dialog me njohje reciproke. Platforma për dialog me njohje reciproke bën për të ardhur te ajo platformë, ne e heqim reciprocitetin. D.t.th. masat ekonomike tregtare të cilat u ndihmojnë bizneseve kosovare të jenë të barabarta me ato serbe hiqen, për të rënë në një pozitë disavantazh dhe presim një njohje politike nga Serbia.

Ftesë për takim tha që u ka bërë partive politike. Jo! Deputetët i kanë bërë ftesë përfaqësuesit të Qeverisë që të tregoj se çka do të bisedojë në dialog, për arsye se z. Hoti tha këtu: ne shkojmë për njohje reciproke. Z. Grenell, aty ku do të ndodhë takimi, ka thënë që do të bisedojnë për çështje ekonomike. Për çështje ekonomike e keni hequr reciprocitetin, i cili është në funksion të zhvillimit ekonomik. Dhe si mund të jetë një veprim i cili është në kundërshti komplet me interesat e biznesit dhe ekonomisë së vendit, në funksion të një marrëveshje e cila ka karakter ekonomik, për arsye se karakter ekonomik, për arsye se karakterin politik ia keni lënë Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, nga përfaqësuesi i ish-Qeverisë PAN, këtu më herët, që ka qenë edhe bartës i dikasterit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, tha u shkel Kushtetuta në Qeverinë e kaluar. Me të vërtetë, po ka më zi sesa të bëhet tradhti kombëtare me para të buxhetit të Kosovës, të paguhen kompani lobuese në kohë të qeverisjes PAN, për të lobuar nëpër Evropë për ndarje të Kosovës. Mesa e di unë PDK-AAK-Nisma kanë qenë bashkë në Qeveri. Raporti që ka dalë është që janë paguar kompani konsulente, të cilat janë munduar që politikëbërësit në Francë dhe në Evropë t'i bindin që zgjidhja korrigjimit të kufirit është zgjidhje e cila është më stabilja për rajonin. Ajo nuk është vetëm shkelje e Kushtetutës, ajo është tradhti kombëtare. E dikush të dalë e të moralizojë që ka qenë përgjegjës për sa e sa vite për politikën e jashtme, është me të vërtetë e tepërt. Për shkak se ajo çka kemi parë ne për qeverisje të PAN-it, në fakt, i kemi pasur jo njohjet, po minus 19 njohje, për arsye se 20 tërhiqen, një njohje gjatë krejt dy vjetëve sa kanë qenë në pushtet.

Kur flasim, flasim me argumente edhe fakte të cilat janë të mbështetura, në veçanti për politikën e jashtme dhe raportet me Serbinë. Më 20 korrik të këtij viti bëhen rrafsh nëntë vjet kur për herë të parë janë aplikuar masat e reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Kjo ka qenë që të bëhet Serbia t'i njohë vulat e Doganave të Kosovës, se nuk e njihte as Bosnja e Hercegovina pas shpalljes së pavarësisë dhe pas heqjes së UNMIK-ut nga logot e vulave të Doganave të Kosovës. Çfarë ndodhi për 50 ditë? Që të dyja i pranuan ato dhe u hoqën, në fakt u lëshuan kamionët për shkak se paralel edhe atë anë edhe këtë anë paramendohej se do të shkonte një qarkullim i lirë i mallrave.

Pas nëntë vjetësh dhe 33 marrëveshjeve në Bruksel ja ku jemi. Ende më keq. Në aspektin institucional, edhe unë, edhe ju besoj të gjithë, që ia duan të mirën këtij vendi, do të donim të kishim një memorie institucionale. Të mësonim nga gabimet tona. A kemi gabuar? Kemi gabuar në mënyrën sesi e kemi trajtuar ose si e kemi lënë të na trajtojë Serbia. Gjatë gjithë kohë i kemi dhënë hapësirë. Bile, pas marrëveshjeve të vitit 2014 dhe më vonë të vitit 2015 është vetë deklarata e z. Vuçiq që ka thënë shumë lehtë e pata me shqiptarë. Kam menduar në fakt që ata do të barrikadohen pas qëndrimit të GJND-së dhe nuk do të pranojnë të hyjnë në negociata për çka kanë hyrë. 33 marrëveshje të nënshkruara, të gjithë kemi pasur besim, përfshirë edhe mua, edhe si ish-ministre e pastaj edhe si politikëbërëse se do të ketë mundësi me ndërmjetësim ndërkombëtar që të kemi sukses në këto marrëveshje.

Por ja ku jemi sot! Cili është suktesi? Suktesi apo mossuktesi, në fakt ne jemi duke u kthyer ende më keq sesa që kemi qenë, për arsye se pas heqjes së kësaj mase nga përfaqësuesit e Qeverisë aktuale jolegjitime, në Doganat e Kosovës në fakt zhdoganohet mall i cili adresa ka vetëm qytetet e Kosovës, përderisa për disa ditë të paktën bizneset nga Serbia kishin vendosur emrin Republika e Kosovës, për arsye natyrisht ekonomike.

U tha këtu nga z. Abrashi, tha fikSION ka qenë reciprociteti. Nëse për z. Gashi është fikSION Republika e Kosovës, është problem i tij, por Republika e Kosovës është fakt dhe si i tillë duhet

të mbrohet. Dhe nuk ka thuhet fikSION, a është në fakt, kur në dokumente të cilat janë dokument në Doganat e Kosovës është shkruar Republika e Kosovës. Është po i njëjti z. Abrashi që në kohën kur isha ministër, mu pat adresuar tha nëse arrin të vendosësh masën e reciprocitetit, një përmendore midis Prishtinës kemi për ta ngritur. Masa që vendosur për pesëdhjetë ditë, e përmendorja s'është aty, po s'ka lidhje, se ato janë veç fjalë e fraza të zbrazëta.

Tash, në aspektin e barazisë që e kemi me Serbinë, ne njëmend jemi të barabartë, të paktën për takimin në Uashington. Është deklaruar se prezent do të jenë Presidenti i Kosovës me z. Hoti dhe Presidenti i Serbisë me znj. Bërnabiq. Aty i kemi mundësua të njëjtën. Në fakt, e kemi një uniformitet, për arsye se në sistemin politik institucional në Serbi, presidenti ia propozon parlamentit kryeministrin, znj. Bërnabiq. Edhe në sistemin e Kosovës, me shkelje të rendit kushtetues, Presidenti ia ka propozuar këtij Kuvendi z. Hoti për Kryeministër. Kështu që këta dy janë të barabartë. Krejt në pozicione të barabarta janë. Veç këtë qartësi e keni, cili do të jetë përfaqësimi politik i Kosovës në Shtëpinë e Bardhë. Ky do të jetë. Atje do jenë në karrigen kryesore z. Vuçiq dhe Thaçi, që do ta vazhdojnë dialogun e dy vjetëve që ka shkuar në terr informativ të plotë, me marrëveshje dhe diskutime të cilat më shumë z. Vuçiq i është shërbyer në fakt si këshilltar i z. Thaçi sesa që ka pasur ndonjë negociim për Kosovën.

Tash disa pyetje shumë konkrete. Në fakt, janë nënshkruar disa marrëveshje të cilat nuk e kanë stemën e as nënshkrimin e zyrtarëve në kapacitetin shtetëror të Kosovës. Tri marrëveshjet: për hekurudha, për autostradë dhe për vijë ajrore janë të nënshkruara nga ana e Republikës së Serbisë, përfaqësuesit e Serbisë, nga ana e Kosovës, drejtori i Infrastrukturës. Në fakt, nuk është emri i tij, po është edhe titulli i tij si drejtorat. Ne prej dy ministrive që ishte dashur, ose dy kryeministrave, ose dy përfaqësuesve zyrtarë, njëri është shtet, tjetri është drejtori. Ky është statusi aktual i marrëveshjeve ekonomike, tri prej tyre që janë nënshkruar. Pa asnjë stemë.

E dëgjova z. Thaçi dje, tha do të jemi me logo, do të jemi me stemë, në bazë të Kushtetutës së Kosovës. Jo ajo nuk është në bazë të Kushtetutës. Marrëveshja për rrugë, gjithashtu për hekurudhat në fakt e parasheh ndërtimin e hekurudhës e cila shkon drejtpërdrejt në Merdar, d.m.th. e eviton veriun e Kosovës. z. Hoti e di shumë mirë se me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim fizibiliteti ekziston për hekurudhën Prishtinë - Leshan. Me IBRD-në, në vitin 2015-2016. Pse është evituar? Pse po i ikin veriut? Pse hekurudha e cila nuk ka fizibilitet, as te Infrakosi nuk fizibilitet dhe asnjë analizë, është një hekurudhë shumë e dëmtuar gjatë luftës, të parashihet që të ndërtohet me atë fond.

Cila është marrëveshja e cila pritet të diskutohet atje? Marrëveshje për zonë ekonomike? Çfarë zone ekonomike kur je në disavantazh ekonomik? Ne në v. 2007, së paku kemi hyrë të barabartë në CEFTA, kemi hyrë me shumë disavantazh në CEFTA. Kemi hyrë me UNMIK dhe kemi pasur dëmet e luftës. A do të diskutojë pala e Kosovës për 22 miliardë, po e citoj z. Muhamet Musatafa? Në vitin 2019, në intervistën për Fondin për të Drejtën Humanitare, 22

miliardë janë dëme të cilat Serbia ia ka shkaktuar Kosovës gjatë luftës së fundit. Dy miliardë janë fond i vjedhur pensional. A do të diskutohet për këto çështje apo do të mbeten këto si pjesë ndoshta pranojmë një pako ekonomike që na jep dikush?

As në v. 2011 reciprociteti nuk ka qenë i pranuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose Bashkimi Evropian. Në bisedën time me përfaqësues të Shteteve të Bashkuara, i kam thënë unë atëherë se jap dorëheqje si ministre e Tregtisë. Fatkeqësia e kësaj situatë është që jo vetëm që këta nuk e kanë negociuar ose s'e kanë diskutuar më tutje, po në fakt kanë pranuar të rrëzojnë një Qeveri, për të hequr reciprocitetin edhe për të zënë këto karrige, për mos të pasur ide se çfarë do të ndodhë kur të shkojnë atje. Si dhe çfarë arsyetimi ka të ktheheni pa marrëveshje? Çfarë marrëveshje? Ku është platforma për marrëveshje? Ne, lëre që shkojmë totalisht të papërgatitur, pa unitet të brendshëm, me një sistem dhe me një kastë politike tërësisht të fragmentuar, por gjithashtu ne e kemi bërë një konfuzion total të proceseve.

Dhe krejt në fund, marrëveshjet politike dhe ekonomike. Ne e dimë që për vendet e Ballkanit Perëndimor ekziston procesi i Berlinit. Prosesi i Berlinit ka paraparë edhe projektet e infrastrukturës të cilat tashmë janë duplikuar. Ku mbetet procesi i Berlinit? Cili është statusi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të nënshkruar në v. 2016? Ku është roli i Kosovës në raport me vendet e rajonit? Çfarë marrëveshje tregtare mund të kemi me Serbinë, kur e kemi një në CEFTA, kur e keni një të Stabilizim-Asociimit me mbikëqyrje të Bashkimit Evropian? Krejt këto pyetje duan përgjigje dhe ne nuk mund t'i marrim me këtë kompetencë e cila u tregua deri më tash. Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Zonja Kusari,

Iu referove diskutimit të deputetit të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Hoxhaj. Është fakt që dy herë është shkelur Kushtetuta dhe këtë nuk po e themi ne, po e ka thënë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Shumë lehtësisht po e përdor termin tradhti, pa ofruar fakte. Po mburresh me faktin që kur ke qenë ministre edhe pjesë e Qeverisë, ke vendos reciprocitet. Po thuaje, bëju korrekte, kam vendosur reciprocitet, kur kam qenë ministre, ku ti edhe unë bashkë shef apo Kryeministër e kemi pasur z. Thaçi.

Nëse e ke lexuar me vëmendje punën e reciprocitetit, e ka hequr edhe Qeveria aktuale, pa hyrë në atë a është dashur të hiqet apo jo, po e ka hequr edhe Qeveria aktuale edhe Qeveria e kaluar. Ne për vendimin e kaluar, më shumë kemi folur për taksën 100 për qind sesa për pikën e dytë të vendimit. Pika e dytë e vendimit ka qenë më e rëndë sesa pika e parë e vendimit.

Prandaj, edhe për CEFTA-n, znj. Kusari, ke mund sa ke qenë ministre e Financave, në fakt ministre e Tregtisë e Industrisë. Po kërkoj falje, po korrigjohem unë, s'ka problem kur e kam gabim. Veç korrigjohu edhe ti! Veç ti korrigjohu shumë se ti ke shumë gabim! E ke shumë gabim se ata që ti po thua ndarje të kufijve, korrigjim të kufijve, ta kanë thënë edhe shtetet më të fuqishme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, të gjithë ata që na kanë ndihmuar edhe deri këtu kemi ardhur bashkë, që nuk kanë parë ata marrëveshje. Ata s'kanë! Nëse keni, qiteni more atë marrëveshje! Mos flisni për marrëveshje inekzistente se seriozisht nuk është diçka që mund të shitet as në publik, as askund. Është më tepër paranojë, edhe është në stilin e tyre.

Zonja Kusari,

T'u kisha lutur! Unë e kuptoj, që duke përmendur emra të caktuar, gjithmonë do të rritesh vetë. Por kur të përmendësh emra të caktuar, është mirë të kesh fakte, të kesh argumente, se njerëz të caktuar të këtij vendi, personalitete, kanë dhënë shumë për këtë vend. Nuk ia amnistoj askujt asnjë gabim se s'jam avokat i askujt, po kanë dhënë kontribute, edhe kur të maten kontributet e tua personale me disa të tjerë, nuk dukesh fare. Hiç nuk dukesh, bash hiç. Kështu që t'u kisha lutur të kesh konsideratë për të gjithë njerëzit, punën e tyre, angazhimin e tyre dhe atyre që kanë dhënë deri ditën e sotme. Faleminderit!

KRYETARJA: Kundër-replikë, zonja Kusari!

MIMOZA KUSARI-LILA: Duhet t'i adresoj tri çështje që i tha zoti Hamza.

E para, zoti Hamza, për asnjë pjesë të karrierës sime nuk e fsheh, edhe asnjë gjë s'ka qenë sekrete, kanë qenë poste publike. Prandaj, edhe referenca në kohën e marrjes së masave të reciprocitetit, të gjithë e dinë se kam qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë Thaçi 2, e para.

E dyta, janë dokumente publike reagimet, kundërshtitë dhe gjithashtu të gjitha masat politike, tregtare të cilat janë ndërmarrë gjatë asaj periudhe, në fakt kundër shkeljeve të CEFTA-s që i kanë bërë vendet e rajonit. Ka qenë një politikë aktive tregtare e cila sot është e dokumentuar. Hiç më larg se me një kërkim të thjeshtë në internet mund të gjesh të gjitha reagimet për CEFTA. Edhe sot e kësaj dite mendoj që Kosova ka hyrë e pabarabartë dhe mbetet e pabarabartë në Marrëveshjen e CEFTA-s.

Dhe, si e treta, z. Hamza, nuk e kemi shpikur marrëveshjen për ndryshim të kufijve. Kur rrihni gjoks, e thoshit po ia ktheni fjalën Grenell-it, ai është përfaqësues i 13 agjencive sekrete, e konfirmoi ai që brenda Shtëpisë së Bardhë, këshilltari i Presidentit për siguri nacionale, z. Bolton, ka diskutuar dhe ka pasur plan shkëmbim të territoreve. Ai është takuar edhe me Presidentin Thaçi, edhe me Vuçiq. Tash, a t'u besojmë, a mos t'u besojmë atyre. Se këtu një seancë na keni pas mbajtur, duke na thënë qysh duhet t'u besojmë amerikanëve, se me të vërtetë

ata kanë thënë që s'ka ndryshim të kufijve, përderisa tash u tha, kur ka dalë z. Bolton. Po presim kur të dalë edhe z. Grenell dikur më vonë, edhe e marrim vesh a është ende duke vazhduar diskutimi për ndarje të Kosovës ose ndryshim të kufijve.

Mandej, sa i përket a jam e vogël a e madhe, secili na tregon puna, e këtu vijmë me vota. Shumë mirë që askush nuk na e ndërron, as nuk bëjmë pazare për të na zgjedhur këtu dikush prej deputetëve, por është sovrani atje jashtë që na mban. Sa herë që të jetë nevoja, matemi, nuk është problem, po të gjuhen ofendime sa herë që juve s'ju përshtaten faktet, je e vogël, je kështu, je ashtu, po lëreni de më, se u bë bajat kjo punë. Të kthehemi në temë. Nëse ke për të argumentuar, mirë, nëse s'ke për të argumentuar, çështje që kanë të bëjnë me ndarje të kufijve, nuk i kam shpikur unë, po neve kanë ardhur dhe na kanë thënë, se ne askush me mendje të shëndoshë si përfaqësues të popullit këtu, nuk e nisim atë temë pa qenë diçka e vërtetë.

KRYETARJA: Deputeti Hamza sërish, nga minutat e Grupit Parlamentar të PDK-së.

BEDRI HAMZA: Jo, veç një pikë shumë shkurt. Sa është e madhe, sa është e vogël si parti e dimë të gjithë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Fjalën e ka Kryetarja e Kuvendit, zonja Osmani!

VJOSA OSMANI: Të nderuar deputetë,

Besoj përgjatë viteve në këtë institucion kemi dëgjuar sesi reciprociteti duhet të jetë parim themelor i marrëdhënieve ndërshtetërore, meqenëse është i bazuar në barazinë mes shteteve. Është një koncept praktik dhe është veprim ekuivalent dhe i cili varet nga një veprim ose reagim i një shteti tjetër. Pra, është masë reaktive e kurrë masë nxitëse. Është automatike dhe gjithmonë e parashikueshme nga një shtet i cili ballafaqohet me një politikë të padrejtë të një shteti tjetër. Pra, në rastin tonë, në qoftë se Serbia nuk është e kënaqur me një masë reciproke të Kosovës, atëherë ajo do të duhej në radhë të parë që të tërhiqej nga masa e saj e cila ka bërë që të ngrihet masa reciproke.

Vendosja e masës së reciprocitetit në raport me Serbinë nuk ka qenë asnjëherë instrument për bllokimin e dialogut, por përkundrazi, mjet për ta afirmuar sovranitetin e Republikës së Kosovës, sepse Kosova që nga fillimi i këtij procesi e ka dëshmuar historikisht, pavarësisht kush ka qenë në pushtet, se është e hapur për dialog dhe prandaj e ka dëshmuar këtë me veprime konkrete. Vendosja e reciprocitetit në fakt vetëm i ka kontribuar përmirësimit të marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, kushdo që e kupton drejt këtë parim, sepse duke mos vendosur reciprocitet Kosova, vetëm do ta trimërojë Serbinë më shumë që të angazhohet në politikat destruktive, të cilat pengojnë rregullimin apo normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Përkundrazi,

në qoftë se e bëjmë Serbinë që të vuajë pasojat e politikës së saj destruktive, ajo eventualisht do të ndryshonte kurs dhe do të shihte se është edhe në interesin e saj në fakt që të kishte raporte normale me Kosovën, por edhe me fqinjët e tjerë të cilët përgjatë këtyre viteve vazhdon t'i destabilizojë, përfshirë Bosnjën edhe Maqedoninë, Malin e Zi e të tjera.

Për shumë vite me radhë, qytetarët tanë kanë qenë viktimë të politikave destruktive të Serbisë, deri edhe te mosrealizimi apo zbatimi i marrëveshjeve të cilat janë arritur në Bruksel, ta zëmë mospranimi i diplomave, targave të automjeteve, dokumenteve e shumë të tjera. Ka qenë pikërisht mosreagimi ynë i cili ka mundësuar Serbisë që të vazhdojë t'i dëmtojë qytetarët e Kosovës pa asnjë kosto.

Reciprociteti pra nuk do të duhej parë si dëshirë e jona për ta ndëshkuar një shtet tjetër, por vetëm si obligim i yni kushtetues për ta mbrojtur Republikën tonë. Prandaj, për mua mbetet krejtësisht e pakuptimtë, e papranueshme dhe mbi të gjitha e dëmshme për pozicionin e Kosovës në dialog në qoftë se reciprociteti quhet pengesë.

E aq më tepër nga një kryeministër i vendit që duhet ta përfaqësojë Kosovën në atë tavolinë, sepse parimi i barazisë, pra i reciprocitetit është parim që i ka paraprirë shtetkrijimit të Republikës së Kosovës. Në qoftë se ju kujtohet dita kur është shpallur pavarësia e vendit tonë, letrat që i kemi dërguar për njohje, letrat e njohjeve që na kanë ardhur, në të gjitha thuhet që Kosova synon të jetë e barabartë me kombet e shtetet e tjera, në cilësimin e attributeve të shtetësisë.

Prandaj, praktika e reciprocitetit, të nderuar deputetë, njihet e pranohet e përqafohet si e tillë nga të gjithë liderët e vendeve demokratike.

Këtu, tani na u fol shumë për atë se, çka thonë miqtë tanë, por është mirë ta krahasojmë se çka thonë miqtë tanë e çka thonë edhe armiqtë tanë. Miqtë tanë, ta zëmë presidenti amerikan z. Trump, thotë që, fjala e tij e preferuar është reciprociteti dhe nëse dikush ta rritë 50% ndaj nesh, atëherë edhe ne duhet të vendosim tarifë 50% ndaj tyre, si masë reciproke.

Ish-presidenti Sarkozy i Francës, ta zëmë, thotë që, në një Evropë e cila është e hapur ndaj globalizmit dhe tregut të lirë, aty do duhej të ekzistonte edhe reciprociteti. Në një rast tjetër ai thoshte, dua reciprocitet, sepse dua ta hapi tregun, dhe në qoftë se unë e hapi tregun edhe ju duhet ta bëni të njëjtën gjë, sepse kërkoj barazi.

Andaj, kërkesa për reciprocitet është kërkesë që ne e kemi dëgjuar, është parim që ne e kemi mësuar nga miqtë tanë. Kthehemi tash te armiqtë. Çfarë thonë Serbia dhe Rusia për neve? Si na quajnë neve?

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Serbia dhe Rusia, sidomos për juve që e përcillni politikën e jashtme një kohë të gjatë, na quajnë, konflikt i ngrirë. Po ju pyes, kush e quajti sot në këtë Kuvend Kosovën, konflikt i ngrirë? Kryeministri i vendit tonë.

Duhet ta kemi mesë të qartë, Kosova nga 17 Shkurti 2018, nuk është konflikt i ngrirë. Kosova është çështje e zgjidhur njëherë e përgjithmonë. Konflikte të ngrira si Abkhazia e vende nëpër Rusi e në ish-BRSS e vende të tjera, të cilat nuk e kanë statusin e zgjidhur, është për keqardhje që të krahasohen me Republikën e pavarur e sovranë të Kosovës. Dhe, një gjë e tillë nuk do duhej kurrë të tolerohej si gjuhë e përdorur nga institucionet tona e aq më pak në këtë Kuvend.

Në fakt, duke hequr dorë nga parimi i reciprocitetit, përveç pamundësisë së trajtimit të barabartë karshi Serbisë, vendit tonë i është mohuar edhe e drejta që të kërkoj trajtim të barabartë për qytetarët shqiptarë të Luginës së Preshevës, të cilët në mënyrë sistematike vazhdojnë të diskriminohen e të rrezikohen nga pushteti serb.

Kjo situatë bëhet edhe më e rëndë në qoftë se i shohim i platformat tona politike me të cilat kemi garuar para qytetarëve të Kosovës. Kemi thënë në të tjera, reciprociteti i plotë i të drejtave dhe lirive themelore të shqiptarëve, s'po flas për territor, po flas për reciprocitet të drejtash, shqiptarëve që jetojnë në Serbi dhe serbëve që jetojnë në Kosovë, është një nga kushtet thelbësore për zgjidhje të qëndrueshme të çështjeve të interesit të ndërsjellë, nga platforma për dialog e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Reciprociteti, natyrisht ishte pika kyçe mbi të cilën ne kërkuam besimin qytetar. Secili prej nesh, zonja dhe zotërinj, kur kemi dalë para qytetarëve e kemi quajtura reciprocitetin minimumi i dinjitetit shtetëror.

Çka ndryshoi nga shtatori deri sot që minimumi i dinjitetit shtetëror, sot nga vet Kosova të quhet pengesë? Unë e kuptoj plotësisht nevojën për koordinim me SHBA-të, por koordinimi është i suksesshëm kur ne të gjithë flasim njëzëri, duke kërkuar barazi. Kur deri sot, Shtetet e Bashkuar nuk e kanë refuzuar Kosovën kur ajo ka kërkuar mbrojtjen e interesit të saj njëzëri? Kurrë!

E sa herë që dikush i ka punuar tjetërkujt prapa shpinës, natyrisht që kur ne se mbrojmë interesin tonë siç duhet, nuk mund të presim nga askush tjetër.

Më lejoni që t'ju pyes, cilat interesa nacionale të Kosovës kanë ndryshuar sot nga shtatori i vitit të kaluar? A ka ndryshuar Serbia qasjen ndaj Kosovës? A na duhet dëshmi më e madhe se sa ajo që e pamë nga Daçiçi këto ditë?

Do të thotë, ju premton Shteteve të Bashkuara se do ta bllokojë kampanjën e ç 'njohjeve, kurse qysh të nesërmen, ende pa u përmbushu 24 orë e bën një gjë të tillë. Pra, e falënderon Algjerinë, Meksikën e shtet e tjera për mosnjohje të Kosovës.

A na duhen akoma prova për ta parë fytyrën e vërtetë të Serbisë? Tash, Vuçiqi me Daçiqin e luajnë politikën e policit të mirë dhe policit të keq. Madje, edhe arsyetohen se kinse Daçiqi po bën këtë, po e shkel premtimin e dhënë ndaj Amerikës, sepse na qenka i partisë tjetër nga Vuçiqi.

Mirë, edhe ne e kemi ministren e Jashtme nga një parti tjetër nga kryeministri. Le të shkojë pra, ministra e Jashtme, le të arsyetohet që është e partisë tjetër dhe le të thotë, unë po kërkoj njohje. Unë po aplikoj për anëtarësime në organizata ndërkombëtare, meqenëse me këtë argument po arsyetohen Daçiqi dhe Vuçiqi.

Prandaj, unë nuk kam nevojë që të ofrojë më shumë dëshmi sesi sillet Serbia karshi Kosovës, edhe karshi miqve tanë ndërkombëtarë, sepse këtë e di çdokush që jeton në këtë vend. Prandaj, në qoftë se vërtetë duam fuqizim e betonim të subjektivitetit tonë ndërkombëtar, atëherë duhet të nisemi nga ajo që secili prej nesh e kemi premtuar para qytetarëve tanë. Minimumi i dinjitetit shtetëror.

Po ju citoj të gjithëve; minimumi i dinjitetit shtetëror është barazia. Kosova nuk është konflikt i ngrirë, edhe sot e asnjëherë nuk është politikë ditore që ne të kërkojmë ët trajtohem i të barabartë. Nuk është politikë populliste që ne të kërkojmë që të trajtohem i të barabartë.

Është obligim i yni si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, të kërkojmë të trajtohem i si dy shtete të barabarta në tavolinë të dialogut dhe çdo kund. Lexojeni, Qeveria s'qenka këtu, lexojeni letrat e njohjeve, lexon mbi çfarë baze na kanë njohur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, lexojeni mbi çfarë baze na kanë njohur shtetet tjera mike, por kur ju hiqni dorë nga atributet e shtetësisë, pse prisni që t'ju mbrojnë të tjerët.

Hajde të flasim të gjithë njëzëri në këtë Kuvend, që duam barazi. Do ta shihni se çfarë përkrahjeje do të kemi nga Shtetet e Bashkuara dhe të tjerët. Hajde sot, unanimisht ta miratojmë këtë kërkesë për barazi dhe asgjë tjetër, e do ta shihni sesi do të trajtohem i nga miqtë tanë.

Hajde sot, të flasim njëzëri për reciprocitet, së paku në njohjen e diplomave, së paku në njohjen e dokumenteve tona. Të kërkojmë barazi në njohjen në emrit tonë kushtetues, Republika e Kosovës. T'i kërkojmë këto unanimisht si Kuvend i Republikës së Kosovës.

Por, të nderuar deputetë, unë këtu nuk po shoh shumë shpresë. A e dini pse? Sepse ende pa u nisur, Qeveria ka rënë në kundërshtim me rezolutën e miratuar në po këtë Kuvend, në mars të vitit 2020, që ndër të tjera thotë që nuk negociohet rendi kushtetues i Republikës sonë.

Cilat janë kriteret e shtetësisë? Cilat janë kriteret e sovranitetit? Të gjithë e dimë, përveç territorit dhe popullsisë, është edhe e drejta për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare. E drejta për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, nuk është e drejtë nga e cila pauzon. Përndryshe, kjo shndërrohet në shtetësi në pauzë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ju faleminderit, znj. Osmani. Nga PDK, për fjalë është lajmëruar deputeti Sejdi Hoxha.

SEJDI HOXHA: Faleminderit, kryesuese, po unë do ta tërheq fjalën. Do të flas në temën e radhës që vjen pastaj. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse po flasim për reciprocitetin, ka shumë dilema dhe pikëpyetje. A ishte reciprocitetin, ka shumë dilema dhe pikëpyetje. A ishte reciprociteti si kamuflazh për të shpëtuar nga presioni i miqve tanë ndërkombëtarë apo ishte mashtrim i opinionit?

Koha po tregon se ishte edhe kamuflazh e rrjedhimisht edhe njëloj mashtrimi për t'u arsyetuar për heqjen e taksës. Në momentin kur Qeveria Kurti e hoqi taksën, mbase ishte e tejdukshme se reciprociteti dukej një lojë me publikun.

Albin Kurti kishte dy mundësi; e para, të mos e hiqte taksën dhe të shkonte në shtëpi me kredit moral e politik dhe e dyta, ta heqë taksën me kundërvlerë, duke u koordinuar me Amerikën, por që nuk e bëri asnjërën.

Sipas mendimit tim, e bëri veprimin më të keq, e heq taksën duke besuar se me reciprocitetin do ta kompensojë kreditin moral në popull dhe do ta përkrahë Amerika. Por, nuk ndodhi as e para dhe as e dyta.

Populli e pa se, Albini e eliminoi taksën, pra ktheu tregun e Serbisë në Kosovë. Kjo nuk mund të thuhet ndryshe, kur tregu në Kosovë u vërshua me mallra serbe. Nga, duaj tënden dhe rrotullimi i kamionëve, ndodhi vendimi i Qeverisë Kurti për ta hequr taksën dhe për ta kthyer tregun e Serbisë në Kosovë.

Dialogu për Albinin, siç duket ishte mision i pamundur dhe kështu Qeveria Kurti hyri në konflikt të hapur me ambasadorin Grenell e rrjedhimisht edhe me Amerikën. Por, në gjithë këtë odiseadë

lajmi i mirë për Kosovën është se, Amerika është udhëheqëse e dialogut. Po ajo Amerikë e cila e bombardoi Serbinë. Po ajo Amerikë që na përkrahi në shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe së fundmi në formimin e ushtrisë së Kosovës.

Kolegia ime e nderuar, Mimoza Kusari-Lila, e përmendi fjalën tradhti kombëtare, duke aluduar te partitë e PAN-it, pra te Qeveria Haradinaj. Pra, Mimosës i them, po e vërtetë, Ramush Haradinaj i ka bërë tri tradhti kombëtare. E para, nuk e ka heq taksën. Pra, nëse kjo është tradhti kombëtare, po, Ramush Haradinaj e ka bërë këtë tradhti.

E dyta, e ka eliminuar mundësinë e ndryshimit të kufijve. Po, është e vërtetë, nëse dhe kjo është tradhti, atëherë këtë e ka bërë Ramush Haradinaj.

Dhe e treta, nëse vlerësohet se është tradhti kombëtare, atëherë Ramush Haradinaj, edhe dialogun nga Brukseli e ka dërguar në Uashington.

Andaj, me bindje të plotë e them se lajmi i mirë për Kosovën është se Amerika është udhëheqëse e dialogut Kosovë - Serbi.

Krejt në fund, e kisha ftuar publikisht Albin Kurtin që t'i bashkohet dialogut, sepse dialogu nuk i përket asnjë qeverie dhe asnjë partie politike. Asnjë marrëveshje e dëmshme për Kosovën, ku preken kufijtë edhe që vlerësohet që është e dëmshme nuk do të votohet në këtë Kuvend.

Prandaj, është mirë që në dialog të shkohet me platformë, me parime, por edhe të shkohet të bashkuar nga të gjitha partitë politike, sepse edhe një herë po e përsëris, dialogu Kosovë-Serbi, nuk është çështje e një qeverie e as një partie politike. Faleminderit!

KRYETARJA: Nënkryetarja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Është tepër e qartë, reciprocitet, taksa është vetëm një masë. Qëndrimi ynë dhe i LDK-së, është i qartë, siç e tha edhe Kujtimi, nesër ky do të jetë pozicioni i Republikës së Kosovës, që të shkojmë drejt reciprociteti të plotë. Taksa do të kthehet në reciprocitet, domethënë, nuk hiqet.

Këto janë fjalët e z. Avdullah Hoti. Kështu kishte deklaruar jo shumë moti, më saktësisht më 20 shtator të vitit të kaluar në një emision televiziv që për ironi si kryetitull kishte togfjalëshin: Besëlidhja e Kosovës.

Kështu foli LDK-ja para zgjedhjeve, gjatë zgjedhjeve dhe madje edhe kur u votua Qeveria Kurti, më 3 shkurt.

Tarifa, tha, do të zëvendësohet me masa të reciprocitetit të plotë me Serbinë. Kështu shkruhej edhe në marrëveshjen për bashkëqeverisje e në programin qeverisës të Qeverisë Kurti.

Më 6 tetor, qytetarët votuan për një kryeministër dhe një Qeveri që do t'i përfaqësonte ata me dinjitet dhe që do t'ju qëndronte prapa zotimeve të dhëna. Çdo prioritet e masë mbi të cilën qytetarët u shprehën më vonë, është mesë e pritshme që Qeveria e tyre do duhej ta përmbushte.

Andaj, edhe Qeveria Kurti si Qeveri legjitime e mori vendimin për zëvendësimin e tarifës me reciprocitet ndaj Serbisë, të bindur, pra me bindje të plotë se kjo është në interes të shtetit të Kosovës. Është në interes të prodhuesve vendor dhe duke e vendosur për herë të parë Kosovën në nivel të raporteve plotësisht të barabarta me Serbinë.

Ndërkaq, edhe ju, ndonëse i keni kërkuar votat e qytetarëve me qëndrimin për reciprocitet, brenda vetëm 52 ditëve kapërcyhet në skajin tjetër, e skaji tjetër ishte nënshtrimi para Thaçit, dhe nëpërmjet tij edhe para Serbisë.

Kështu, ju u bëtë edhe një herë patericë. Patericë e vegël në duart e një presidenti që nuk i gëzon as 1/4 e mbështetjes popullore.

Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, tha këtu se nevojitet një konsensus. Për çfarë konsensusi e ke fjalën z. Gashi, edhe pse tani nuk jeni këtu? Për t'u gjunjëzuar edhe një herë para Serbisë? Për t'u gjunjëzuar para Thaçit e për të vazhduar vallen me të? Jo, faleminderit!

Ajo që do duhej që ta bënim bashkërisht, ishte të qëndronim, por si gjithnjë, LDK-ja nuk qëndroi. Nuk qëndroi. Kot po flasim këtu për konsensus, sepse sado që edhe ju keni folur për reciprocitetin, pra ashtu siç ju u shprehet, keni qenë populistë, kur vjen koha e rëndësishme për Kosovën, ju gjunjëzoheni sikurse edhe më parë.

Kurrë më të qartë, qytetarët nuk e kanë pasur situatën. I hoqët maskat. Si një kryeministre pa mbështetje qytetare, si një Qeveri jolegjitime, ju zgjodhët t'i bashkoheni Thaçit, duke i kthyer edhe njëherë në skenë planet e tij për shkëmbin territorial. E këtë e bëtë, në një kohë kur mbi 2/3 e popullsisë është bashkuar kundër tij. Kundër planeve tij, e kësaj edhe kundër Qeverisë së tij të paligjshme, në të cilën ju jeni vetëm një kryeministër formal.

Pra, si Qeveri e Thaçit, ju u bëtë edhe njëherë të gjithë bashkë. E penguat vazhdimin e qeverisjes së mirë, e cila e gëzonte besimin dhe përkrahjen e publikut, në rrugën e saj për një shtet ligjor. Për luftim të korrupsionit, për çkapje të shtetit, për barazi përballë Serbisë.

Ju personalisht, faktikisht nuk përfaqësoni asgjë. Në krye të kësaj Qeverie, jeni për ta realizuar agjendën e një personi të cilit populli i tregoi se nuk i nënshtrohet.

Në fjalën tuaj, ju thatë se nuk jemi vetëm aktorë, por edhe protagonistë dhe thatë se do duhej të koordinohemi me miqtë tanë. Për çfarë duhet të koordinohemi? Për çfarë mendoni se ju mund të qëndroni deri në fund, kur ju dorëzuat, madje edhe përpara heqjes së reciprocitetit në këtë moment të rëndësishëm.

Si në Qeveri e krijuar nga aranzhimet antikushtetuese të presidentit, me një votë të kontrabanduar pas mesit të natës, të votuar nga një deputet me mandat të humbur e dënuar për vepër penale, të varur votë për votë nga 10 deputetë e Listës serbe, nuk kishit sesi të nisnit ndryshe dhe sigurisht se nuk do të vazhdoni gjatë.

Të shantazhuar dhe të përkulur së brendshmi, s'mund të përballoni në mënyrë dinjitoze reciprocitetin së jashtmi. Andaj, edhe e larguat atë, menjëherë sapo erdhët në pushtet.

Pikërisht, kur masat e reciprocitetit kishin filluar që të jepnin rezultatet konkrete, kur për herë të parë filluan t'i referohen shtetit të Kosovës si, Republika e Kosovës, në vend të emërtimeve antikushtetuese, Kosova edhe Metohia, vendimi i juaj për heqjen e reciprocitetit, erdhi si kundërvënie ndaj shtetësisë, të cilin Serbia natyrshëm e mirëpriti dhe e përshëndeti. Dhe, sikur të mos ju mjaftonte kjo, brenda vetëm pak ditësh, ju faktikisht hoqët dorë edhe nga njohjet, duke hequr dorë nga e drejta për të aplikuar në anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe këtë për hatër të Serbisë e për fatkeqësinë e Kosovës.

Andaj, na thoni, për ku jeni nisur kështu? Si mund të pretendoni se qëllimi i juaj është njohja finale, përderisa ju hiqni dorë akoma pa filluar bisedimet?

Zmbrapsja që i keni bërë Republikës së Kosovës përballë Serbisë, me heqjen e reciprocitetit, me heqjen dorë nga anëtarësimet dhe lejimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë së fundmi, është një zmbrapsje e cila veçse e ka gjuhëzuar Kosovën përballë Serbisë.

Andaj, që të ndalet zvetënimi, duhet të ndalet vazhdimi i kësaj Qeverie një orë e më parë, ku ju jeni vetëm formalisht kryeministër.

KRYETARJA: E ftoj administratën që t'i evidentojë deputetët që po e shkelin Ligjin për Duhanin, atje prapa dhe pastaj t'ia dërgojmë Inspektoratit të Ministrisë së Shëndetësisë, ashtu siç jemi marrë vesh me ministrin e Shëndetësisë.

Fjalën e ka deputeti Haxhi Avdyli. Zoti deputet i keni 3 minuta e 15 sekondat e fundit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Procesi i dialogut i deritanishëm me 34 marrëveshje nga të cilat vetëm 4 kanë gjetur aplikim në terren, mendoj që ka qenë një proces i dështuar dhe i pasuksesshëm. Tani po hyjmë në një fazë të re, ku kjo fazë është një fazë e cila po duket sikur po bëhet me një nguti dhe pa ndonjë parapërgatitje të mirë, dhe duket si një rifillim jo i mirë.

Një nga pengesat e bërjes së suksesshëm të këtij dialogu, është edhe pasoja e Qeverisë së kaluar, ku kryeministri i atëhershëm ka deleguar përgjegjësitë e dialogut te presidenti Thaçi, dhe ky president e ka dëmtuar me deklaratat e tij të papërgjegjshme për korrigjim të kufijve, duke shkaktua një pozitë jo të mirë të Kosovës në këtë dialog.

Lajm i mirë është që kjo kërkesë e presidentit nuk u përkrah nga shtetet si Gjermania e Franca, e tash së fundmi edhe Shtetet e Bashkuara u distancuan nga kjo ide, sepse u la si një ide e një këshilltari kontrovers, i cili edhe u shkarkua, ai Bolton.

Prandaj, ne duhet që tani të shikojmë se si do të vazhdojë ky dialog. Për juve si kryeministër, kisha pasur si kërkesë që bashkënegociatorit Thaçi, ta inkurajoni apo ta pyesni se a do të mundet që në këtë fazë të dialogut ta bëjë bashkimin e Luginës së Preshevës, dhe nëse nuk arrin ta bëjë bashkimin e Luginës së Preshevës, së paku në këtë dialog të angazhoheni bashkërisht që të ngritët çështja e shqiptarëve të Preshevës, sepse ata po privohen nga të drejtat bazike dhe janë pakica më e diskriminuar në Evropë.

Kërkoj që, së paku të kërkohet edhe reciprocitet politik ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës, sepse vetëm të dielën e kaluar e kemi rastin e fundit, rastin më të freskët, ku serbët votuan në Veri për zgjedhjet në Serbi, ndërsa shqiptarët të cilët janë nga Lugina e Preshevës e që jetojnë në Kosovë, u privuan nga kjo e drejtë siç po privohen edhe nga shumë të drejta të tjera.

Në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, Qeveria është ai bartësi apo udhëheqësi i negociatave. Në bazë të deklaratave, keni thënë që s'ka garë mes nesh, dhe kjo në shikim të parë duket si një deklaratë korrekte, por mendoj që duhet të bartjen dhe udhëheqjen e negociatave ta bëjë Qeveria, sepse kemi një president jokredibil, kur njihen deklaratat që i ka bërë në të kaluarën.

Meqenëse koha po më mbaron, mendoj se duhet të bëhet rishikimi i marrëveshjeve të deritashme dhe marrëveshjet e reja, duhet të bëhen duke u bazuar në unitet të partive, sepse tani ju jeni duke shkuar jo vetëm të papërgatitur, por me një skenë të përçarë politik si asnjëherë më parë.

KRYETARJA: Faleminderit! Nuk kanë mbetur më minuta për Grupin Parlamentar të LDK-së. Fjalën e ka Grupi i Parlamentar i PDK-së, z. Kadri Veseli. I kanë mbetur 20 minuta Grupit Parlamentar të PDK-së.

KADRI VESELI: Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Është mirë që sot në Kuvendin e Kosovës po flasim për reciprocitetin dhe dialogun me Serbinë. Është gjest për t'u përshëndetur, prania e kryeministrit Hoti dhe raportimi i tij para takimit në Uashington. Por, ka një problem.

Qytetarët e dinë dhe unë po përsërisë këtu. Fatkeqësisht, kur bëhet fjalë për dialogun, qëndrimet e kësaj Qeverie, të këtij kryeministri dhe ish-kryeministrit të kaluar, ndërrojnë sipas interesave.

Këta dhe partitë e tyre, kur janë në opozitë, i quajnë tradhtarë kundërshtarët politikë që shkojnë për dialog, ndërsa kur vet vijnë në pushtet, dorëzohen e nënshtrohen para Serbisë.

Të nderuar qytetarë,

Një pjesë e partive politike, duke u nisur prej Lidhjes Demokratike të Kosovës e deri te Vetëvendosje, procesin e dialogut e kanë keqpërdorur si një mjet për pushtet dhe kundër oponentëve politikë, në këtë rast, Partisë Demokratike të Kosovës.

Asnjëherë, nuk e kanë parë si ballafaqim me Serbinë, për ta përfunduar njëherë e mirë këtë histori të gjatë konflikti dhe për të mos ua lënë barrë gjeneratave që vijnë. Në vend se të shfrytëzohet kjo mundësi për t'u bërë bashkë dhe për të krijuar unitet përballë Serbisë, sikurse është angazhuar Partia Demokratike e Kosovës, këto parti politike kanë zgjedhur të kundërtën; të mashtrojnë, të akuzojnë, të mbjellin përçarje e frikë brenda, të ikin nga përgjegjësia, madje të hyjnë në konflikt edhe me partnerët ndërkombëtarë.

Dhe, a e dini për çfarë? Jo për gjë tjetër, pos për një grusht votash.

Për dijeninë e secilit dhe në respekt të qytetarëve që po na ndjekin, ne e kemi ditur që nga fillimi se dialogu me Serbinë, nuk është një temë e këndshme dhe popullore që sjell vota. Madje, Partia Demokratike e Kosovës, e ka paguar çmimin për këtë, por ne e kemi marrë përgjegjësinë që na takon duke qenë në Qeveri, sepse i kemi besuar Kosovës, luftës sonë dhe u kemi besuar miqve ndërkombëtarë.

Mbi të gjitha, ashtu siç e kemi ditur se nga ballafaqimi me Serbinë nuk duhet të frikësohemi dhe as të fshihemi pas të tjerëve, por të përballemi dhe të fitojmë sikurse kemi fituar në qershorin e vitit 1999.

Ky është dallimi i Partisë Demokratike të Kosovës me disa parti të tjera, të cilat në opozitë u dalin në krahë e në pushtet bëhen të dëgjueshëm, të urtë dhe i ikin përgjegjësi.

Më lejoni t'ju rikujtoj vetëm një deklaratë të kryeministrit Hoti, nga dhjetëra të tilla sa i ka dhënë sa ka qenë në opozitë.

Kryeministër, më 30 korrik 2018, si shef i Grupit Parlamentar, deklaroni që, pika 7 ose 8: Që shteti i Serbisë duhet të ofrojë menjëherë të dhënat për të pagjeturit, të shprehë vullnet për kërkim-falje dhe për kompensim të dëmeve të luftës si platformë e juaja për dialogun, do të thotë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Tani, shtrohet pyetja sot, a bëri Serbia ndonjërin prej këtyre veprimeve, para se kryeministri Hoti të takohet me udhëheqësit e Serbisë, këtë javë në Uashington? Natyrisht, që jo.

U zotua Qeveria e Avdullah Hotit, shkoi edhe më tej. U zotua se nuk do të aplikojë në asnjë organizatë ndërkombëtare, duke vendosur shtetin e Kosovës në pauzë. Nuk e di apo s'kam mbamendje, por nuk e di që për këto 21 vjet ka pasur një qëndrim të tillë, skandaloz që e ka bërë të ndonjë qeveri tjetër sikurse kjo. Kjo flet shumë për pozicionin e ardhshëm negociues me Serbinë që është i dobët.

Kur flasim mashtrimin dhe ndryshimin e qëndrimeve për dialogun, hiç më i mirë s'ka qenë as ish-kryeministri Albin Kurti. Njëjtë premtonte në opozitë se nuk do të ulej në tavolinë pa i kthyer të pagjetur, pa u paguar dëmet e luftës nga ana e Serbisë, dhe i kishte 100 parakushte që i recitonte si poezi, pikërisht këtu ku jam, por sapo erdhi në pushtet i harroi ato. Vrapoi për t'u takuar me Bernabiqin e i mbeti merak që s'e takoi edhe Vuçiqin.

Nxori rezolutë për vetën në gjysmë të natës në kohën e pandemisë për t'u takuar pa kushte me Vuçiqin. Vet i keni nxjerrë ju së bashku kryeministër, si Lidhje Demokratike e Kosovës dhe Lëvizje Vetëvendosje, rezolutën. Asnjë kusht nuk ka për takimet me Serbinë. Kjo është forma sesi i trajtoni qytetarët tanë.

Për 100 ditët e qeverisjes së Albin Kurtit, nuk ka mbetur mall e konvoj serb pa hyrë në Kosovë. Për tërë këto vite LDK-në, për tërë këtë kohë në fakt, juve ju ka pasur në krah si Lidhje Demokratike e Kosovës dhe ju e keni votuar dhe e keni mbështetur.

Këto kaste politike me lojëra e mashtrime kanë krijuar neveri te qytetarët. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës edhe Vetëvendosje, siç duket, kurrë nuk e di për çka qëndrojnë kur bëhet fjalë për interesat nacionale.

Ata e dinë për çfarë qëndrojnë vetëm kur bëhet fjalë për interesat e tyre personale dhe partiake. Njëjtë vepruan edhe për demarkacionin, duke e kundërshtuar me gjithçka që mundën dhe pastaj e votuan. Njëjtë edhe me taksën dhe reciprocitetin, i folën, kërcënuan me to, shanë për to dhe në

fund të gjithë e dimë se cili ka qenë përfundimi i tyre. E Kosova dhe qytetarët e vendit u dëmtuan rëndë nga këto papërgjegjësi.

Vetëm ta kujtojmë izolimin e qytetarëve tanë, ende duke mos u liberalizuar vizat.

6 tetori që u reklamua si shpresë për vendin prodhoi kryeministra e Qeveri mashtrimi. Njësoj do të përfundojë edhe kjo Qeveri, sepse as mendjen dhe as qëllimin nuk e ka të mbarë.

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Vetëvendosja po prodhojnë probleme dhe konflikte për gjithçka brenda kombit tonë, brenda shqiptarëve, më shumë sesa po zgjidhin diçka.

E kanë vendosur qytetarin si target përfitimi, në vend se ta konsideronin si besim dhe partner.

Si mund të flasësh për bashkim kombëtar, kur ndanë dhe hasmëron aq keq shqiptarët mes veti. Si mund ta mbrosh Kosovën jashtë, kur e përçanë aq shumë brenda. Si mund ta mbrosh Kosovën brenda, kur jashtë i sulmon partnerët e lirisë dhe shtetit siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sa të vazhdojë kjo qasje, për fatin tonë të keq, do të forcohet edhe më shumë Vuçiqi dhe do të na rrezikojë Serbia.

Me të tillë, nuk ka nevojë Kosova të ketë kundërshtarë jashtë, sepse këta brenda po e kryejnë punën për ta, po e fyejnë çdokënd dhe po rrënojnë gjithçka.

Të dashur qytetarë,

Me dittë të tëra mund të flitet dhe të vazhdohet, por shpeshherë edhe ia vlen të flitet. Por, para nesh kemi një proces që nuk mund të nënvlerësohet, por as të anashkalohet, nevojiten vendime.

Dialogu me Serbinë është kërkesë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Duhet të ndalet mashtrimi dhe këto parti të flasin qartë, e kam fjalën për Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Vetëvendosjen, qoftë në opozitë, qoftë pozitë, cili është qëndrimi i tyre?

Dhe, të mos manipulojnë me parulla për qëllim të përfitimit elektoral. Le t'i sjellin qëndrimet e tyre, po edhe le t'ju qëndrojnë atyre ose me fjalë ose me shkrim, njëherë e përgjithmonë, sepse tashmë të gjithë e dimë se ata po i ndërrojnë fjalët.

Sa për PDK-në, ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë, kryeministër, qysh në maj 2018 kur e kemi ofruar platformën për dialogun. Nuk jemi për luftë me Serbinë, derisa Serbia nuk cenon ndonjë pjesë të Kosovës ose të qytetarëve tanë.

Jemi për dialog që Kosovës i siguron ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si shtet sovran dhe të pacenuar. Ku janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë edhe Kosova. Bashkimi Evropian duhet ta njohë shtetin e Kosovës, po flas për 27 shtetet, dhe t'i hapë rrugë integritit dhe liberalizimit të vizave.

Jemi dhe do të mbetemi përherë evropianë krenarë. Faleminderit!

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i AAK-së, Teuta Haxhiu. Më fal, znj. Haxhiu, kemi replikë një sekondë nga...Faktikisht nuk ka kohë më LDK-ja. Vetëm në qoftë se pajtohet Nisma. Nisma nuk po pajtohet.

Grupi 6+ i ka 7 minuta e 35 sekonda. Urdhëro z. Gashi, e keni kërkuar fjalën për replikë.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Koalicioni ka kohë të cilën mund ta përdorë dhe unë si kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe koordinator i këtij koalicioni në Kuvend, po e shfrytëzoj kohë e partnerëve tanë të koalicionit, Grupit 6+.

Pra, zoti Veseli, ne po pajtohemi me ju në atë që e thatë duke nxjerr një konkluzion, se ka shumë mënyra qysh ne mund të dështojmë, plotë mënyra, po është e vetmja mënyrë sesi mund të kemi ne sukses, është dialogu, dhe kjo ka qenë e padiskutueshme dhe pakontestueshme për LDK-në.

Pra, dialogu për Lidhjen Demokratike të Kosovës, është esenca e mënyrës së menduarit dhe të vepruarit politik. Dialogu ndërmjet vete dhe dialogu me të tjerët.

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, shtyllë e dytë e jashtëzakonshme dhe e rëndësishme është bashkëpunimi me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe ruajtja e këtij partneriteti të jashtëzakonshëm, të cilin ne nuk e kemi cenuar dhe nuk e cenojmë në asnjë formë.

Po t'i kemi parasysh disa elemente. Gjuha të cilën ne e kemi përdorur dhe përdorim, nuk është gjuhë e cila i ndanë qytetarët e Kosovës dhe as politikanët, në tradhtarë dhe patriotë. Pra, refuzoj ta përdori këtë gjuhë të cilën ju e cituat ose pretenduat që është përdorur nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Nuk është një gjuhë që ne e përdorim. Nuk e kemi përdorur asnjëherë dhe s'do ta përdorim sa sot.

Andaj, ju them me bindje të plotë, dhe e përsërisë, që ka plotë mënyra sesi mund të dështojmë si shtet dhe si shoqëri, por ka vetëm një mënyrë sesi mund të kemi sukses është dialogu i brendshëm, bashkëbisedimi, është mirëkuptimi. Nuk është gjuha e urrejtjes, nuk është gjuha, tradhtarë dhe patriotë, nuk është gjuha e cila na prishë me partnerët tanë ndërkombëtarë, por

është një gjuhë e butë e shoqëruar me veprime të forta. Veprime të forta të cilat Qeveria po i merr në interes të Kosovës.

Asnjëherë, në asnjë rrethanë dhe asnjë formë nuk vendoset në pauzë shteti i Kosovës. Shteti i Kosovës është një dhe i pacenueshëm. Territori i saj është një dhe i pacenueshëm. Organizimi institucional është i pacenueshëm. Pra, këto janë postulate të vendosura në statutin e LDK-së dhe po ashtu të vendosura në platformën politike për dialogun.

Unë mund t'ju them dhe garantoj, se ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, si koalicion qeveritar, jemi të hapur për bashkëpunim. Jemi të hapur që së bashku t'i eliminojmë të gjitha mundësitë dhe rreziqet e dështimit. Që së bashku ta ndërtojmë vetëm një mundësi suksesi. Nuk kemi shumë mundësi të suksessit, është vetëm një.

Mundësia e vetme e suksessit është dialogu, bashkëbisedimi dhe mirëkuptimi. Pra, ju lutem dhe ju kërkoj që të jeni të vëmendshëm në ato që i thoni. Të jemi të singertë në ato që veprojmë dhe të jemi të përkushtuar në mënyrën sesi ne e shohim shtetin tonë.

Pra, ta kemi parasysh këtë qëndrim, këtë veprim dhe t'i eliminojmë këto rreziqe. Faleminderit!

KRYETARJA: Keni kërkuar replikë? Po! I keni 10 minuta e 22 sekonda.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Kryetar i Grupit Parlamentar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk do të kisha dëshiruar që të kisha sa replika as kundër-replikë, po kjo është jeta parlamentare.

Unë e tash edhe një herë për të mos ju rikthyer të njëjtave çështje. Arben, mjafton t'i shikoni deklaratat të cilat i kam edhe këtu para vetës, të datës, nuk e paska vitin, 3 janar, pastaj më duket edhe 14 korrikut 2018, ku ju e akuzoni koalicionin PAN dhe PSD-në, 3 janar qenka kjo.

Do të thotë vetëm po flas dhe unë nuk fola diçka që nuk ka qenë. Jemi para publikut, mund të shikohen të gjitha.

Ne e kemi pasur një debat me kryeministrin aktual, në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka qenë edhe i nderuari nënkryetar atëherë, Kujtimi. Për besë, unë atëherë i kam thënë, kujdes për fjalorin, se ka njerëz që edhe kanë dhënë diçka për vendin.

I kam thënë, mos se nuk është mirë se riciklohet pushteti, në kuptimin riciklohet edhe opozita, ta kemi një qëndrim, në mënyrë të veçantë në ballafaqim me Serbinë. Më ka ardhur rëndë atëherë.

Për këtë arsye, unë isha shumë i rezervuar dhe as nuk u futa fare në atë pjesën e deklaratave të cilat Avdullah Hoti, i ka thënë kur kemi shkuar.

Po ua përkujtoj. Kemi pasur takim, Presidenti i Republikës, kryeministri dhe unë si kryetar i Kuvendit, në cilësinë e pozicioneve formale që i kemi pasur në institucionet e Republikës së Kosovës.

Kemi takuar z. Palmer, i cili ka qenë ndihmëssekretar i Shtetit dhe pastaj e kemi takuar dhe znj. Mogerini. Ka qenë një akuzë tepër e rëndë e cila nuk do duhej të ndodhte për arsye se ja tani kemi këtë pozicion. Është kryeministër.

Imagjinoni, si do të ishte nëse unë do të përdorja një fjalor të tillë ndaj z. Hoti, atëherë kam qenë i indinjuar dhe kam dalë nga vetvetja. Janë stenogramet me aq sa e di unë edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Si do të jetë, unë po e shoh se ka njëlloj bajraktarizmi në çështjen se kush e përfaqëson Kosovën. E kam thënë edhe kur kemi qenë në pozitë, si kryetar i Kuvendit edhe udhëheqës i koalicionit PAN e po e them edhe tani, kushdo le të jetë, kush do le të shkojë, vetëm ta mbrojë interesin e shqiptarëve, ta mbrojë shtetin e pavarur e sovran, Republikën e Kosovës dhe të mos krijojë kësi situata.

Vërtet 21 vjet i kemi momente lirie dhe 10 vjet, përkatësisht 12 vjet shtet, por nganjëherë disa ua kanë mbushur mendjen njerëzve, thuajse armiku i Kosovës janë vet shqiptarët. Thua se këtu nuk u luftua për shtet, s'është luftuar për sovranitet. Këtu ardhur disi në mënyrë shumë spontane, tradhtarët janë në mesin e shqiptarëve.

Kjo nuk ka ndodhur dhe as nuk do të ndodhë sa të jem unë kryetar i PDK-së. Kurrë s'do të flas për askënd. As zyrtarët e PDK-së me lejen time nuk mund ta quajnë dikë, tradhtar, se është fjalë e rëndë.

Veç për besë, na keni quajtur na keni fyer, dhe për këtë arsye edhe sot ta lëmë një hapësirë ballafaqimit me Serbinë bashkërisht, të mos ndahemi mes vete, por edhe tjetra, të mos turpërohemi.

Se pastaj e kam hallin edhe për këtë tjetrin, mund të jetë shumë cinike, s'po e them për cinizëm këtë pjesë. Vendosni qëndrimet të cilat i ka edhe Lëvizja Vetëvendosje edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ne i kemi të shkruara, të mos i ndërrojmë, të qëndrojmë burrërisht pas tyre.

Po merremi vesh të gjithë bashkërisht, a dëshironi të mos shkojmë në dialog me Serbinë pa i kthyer trupat e të pagjeturve edhe pa i paguar dëmet, reparacionet Serbia? Po shkojmë të gjithë së bashku.

Askujt s'i dhemb shpirti më shumë ose më pak, të bile disa e kanë njëfarë përvojë edhe kanë një humbje të cilën e kanë pasur.

Në qoftë se vërtetë po themi se jemi të gjithë patriotë, jemi për një shtet multietnik, por shumica këtu është shqiptare dhe s'kemi pse të fshihemi prej këtij fakti. Të bëhemi bashkë, atëherë na krijoni mundësinë që edhe ne kur jemi opozitë të mund t'ju përkrahim juve tani z. kryeministër.

Por edhe kur kemi qenë në pozitë, themi se ju do të jeni edhe katër vite, po të mos ndodhë prapë e njëjta si të mbetesh në opozitë ta digjni Kosovën edhe të mos ekzistojë Kosova më, dhe tradhtar menjëherë. Ky nuk është moral, kjo nuk është sjellje e mirë.

Kjo është ajo që desha ta them. Edhe njëherë, sa herë që them Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po jo të nënvlerësojmë dhe të fusim përçarje edhe me Bashkimin Evropian, gjithmonë Kosova. E qëndrimin e mbajmë ne, qëndrimin e mbajmë të përbashkët, ai i cili është i sakrificës kombëtare të gjeneratave të tëra deri në vitin 1999 dhe atë që e thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Nuk keni pse të shqetësoheni, o kryeministër, e ke Kushtetutën. Veç respektoje Kushtetutën dhe mbaj qëndrimin dhe sigurisht se më 27 qershor do të kalosh tepër mirë.

Na raporton neve në Kuvend, ky është institucioni më i lartë. Ne do ta kemi qëndrimin i cili është konform Kushtetutës edhe përballë dinjitetit të cilin e kemi të gjithë bashkërisht, si ju edhe unë si opozitë, po edhe ju si kryeministër. Faleminderit!

KRYETARJA: Tash, radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së. Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Argatin më të madh Vuçiqit ia ka bërë ish-kryeministri Kurti. Nuk la vend Vuçiqi pa kërkuar heqjen e taksës kudo nëpër botë, vend nuk la. Dhe, kryeministri i atëhershëm, Kurti pa asnjë hezitim e hoqi taksën dhe ia plotësoi kërkesën pa asnjë kundërvlerë. Taksa e dridhi Serbinë për herë të parë.

Ndërsa me këtë reciprocitetin imagjinar të Qeverisë Kurti, maunat prej Serbisë vërshuan kudo në Kosovë. Për herë të parë prodhuesit vendor frymuan lirshëm në qeverisjen Haradinaj.

Në atë kohë, për ato ditë, kryeministri Kurti, nuk hezitoi fare për ta bërë faktor Serbinë kudo nëpër botë. To të mbahet në mendje kjo. Ju kujtohen 1000 teste, ju kujtohen mjekët që erdhën

nga Serbia, ju kujtohet edhe mjekëve tonë shqiptarë 200 që ishin vullnetarë për të shkuar në Preshevë, në Luginë të Preshevës, nuk ju ktheu asnjë përgjigje.

Kërkesa e tyre të shkruara, mbeten në arkiva. Ndoshta i kanë marrë me vete natën e fundit.

Mbi të gjitha, ishte i gatshëm për t'u ulur në tavolinë me Vuçiqin, as pa kërkuar falje e as pa diskutuar asnjë gjë. Vullnetmirë që tua japë menjëherë 10 milionë euro serbëve në pjesën veriore për rrymën e papaguar, duke diskriminuar edhe serbët në pjesët tjera që paguajnë nga 2008-ta, po edhe komunitetet tjera.

Pra, 10 milionë. I vetmi kryeministër që do të mbahet në mendje, 10 milionë euro në kohë të pandemisë.

Po i kthehem një përmendoreje që u përmend se isha në zyrë. Mimosë, keni kërkuar një përmendore, sa do të doja që përgjegjësia publike vërtetë të jetë e lartë e secilit dhe e secilës që merr një detyrë. Por, nëse kërkon përmendore, Mimosë, po ua rikujtoj vetëm disa gjëra e që janë fakte.

Qytetarët e vendit e kanë të freskët aktakuzën për keqpërdorim detyre në kohën tënde si ministre në vlerën 12,5 milionë euro. Pra, abuzim me kompetencat tuaja. Por, ajo që nuk është përmendur, për ata që, nuk e di sa deputetë janë në legjislaturën e katërt, për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, një deputet i partisë tënde atëherë, Emin Gërbeshi, ka kërkuar shkarkimin tënd.

Pra, a e dini se çfarë do të thotë që një deputet i partisë së njëjtë të kërkojë shkarkim të ministri apo një ministereje, askush nuk i njeh më mirë ministrat apo ministret sesa vet deputetët e partisë suaj. Nuk e di, nuk besoj që e ke harruar, por nëse e ka harruar po ta rikujtoj.

Pra, të kërkojë shkarkim është shumë e rëndë dhe për çka janë edhe transkriptet, nëse do edhe t'i lexoj. Pra, nëse pas keqpërdorimeve tuaja zyrtare tenton që të mbash moral këtu, Mimosë, sa keq e ku ka mbetur ky vend.

KRYETARJA: Zëvendëskryeministrja Balaj e ka kërkuar fjalën. Do t'i shfrytëzojë minutat e Grupit Parlamentar Nisma - AKR. Janë, faktikisht 6,5 minuta.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA ALBULENA BALAJ - HALIMAJ: Faleminderit, kryetare!

Në fakt, unë më shumë e mora fjalën për replikë për dy deputetë, por kam 5 minuta dhe po flas edhe diçka tjetër.

Në fakt, po më duket paksa e çuditshme sesi po sillet opozita, thuajse opozita është injoruar nga Qeveria e në fakt nuk është injoruar nga Qeveria opozita. Përkundrazi, Qeveria i ka bërë ftesë opozitës që të jetë pjesë e dialogut, por deri më tani opozita e ka kundërshtuar.

Dhe, nëse dje kur ishte Vetëvendosje në Qeveri kërkonte që kur të fillojë dialogu të jetë edhe opozita pjesë e saj, atëherë pse të mos jetë sot opozita pjesë e dialogut. Pra, për disa problemi është te i pari dhe jo te dialogu, te disa është problemi te i pari dhe jo se duhet të jemi bashkë.

Prandaj, kjo pak sa po më habit dhe normalisht që nuk po dua të jetë kështu.

E dyta për të cilën desha të flas është zonja Nagavci dhe shumë deputetë të Vetëvendosjes po e përmendin reciprocitetin dhe po e përmendin vendimin që asnjë produkt nuk mund të hyjë në Kosovë nëse nuk i referohet Kosovës me Republika e Kosovës. Pra, këtë vendim zonja Nagavci e ka marrë zoti Shala kur ka qenë ministër, pra këtë vendim e ka marrë Nisma. Unë e kam thënë dhe po e përsëris se ky është vendim i zotit Shala që asnjë produkt nga atëherë nuk ka hyrë nëse i është referuar Kosovës me emërtime të tjera, vetëm Republika e Kosovës. Pra, ju e keni marrë një vendim mbi një vendim që ka ekzistuar në kohën e zotit Endrit Shala.

Dhe ajo që desha të replikoj me zotin Selimi, jo nuk është pajtuar gjithmonë zoti Limaj për gjithçka, zoti Selimi. Zoti Limaj pajtohet që të jetë një politikë unike përballë Serbisë, por jo me të gjithë, e sidomos me ju zoti Selimi nuk është pajtuar.

Dhe, jam e lumtur që me ju dhe Vetëvendosjen nuk është pajtuar, prandaj jo me të gjithë është pajtuar.

KRYETARJA: Deputeti Hekuran Murati e ka fjalën.

HEKURAN MURATI: Meqenëse koha është e shkurtër, duhet të përqendrohem vetëm në disa replika për sa u përket parafolësve dhe në disa pyetje për zotin Hoti, i cili për momentin nuk qenka këtu.

Në fjalimin e tij fillimisht zoti Hoti tha që ne nuk do të jemi vetëm aktorë, por madje edhe protagonistë. Tash me marrë me analizua se çka ndodhi ende pa filluar bisedimet, e shoh që Serbia e ka kërkuar heqjen e reciprocitetit, e këta “tap” ia kanë dhënë heqjen e reciprocitetit, por s’ka mjaftuar - i kanë dhënë edhe bonus, kanë thanë as në organizata ndërkombëtare nuk kemi për t’u anëtarësuar për aq sa bisedojmë. Pra, që në start pozita është në minus. Nëse nisemi prej thënies që dita e mirë shihet në mëngjes, vaj halli për neve kur të na kthehen prej bisedimeve çka kanë për të na sjellë.

Për më tepër, u tha që do të jetë protagonist, por nuk na tregoi se cila do të jetë agjenda e takimit. Pra, zoti Hoti, a e di agjendën se çka ka do të bisedohet edhe në Bruksel, edhe në Uashington, çka do të bisedohet atje? U pyet që në fillim prej Liburnit, por nuk na tregoi, tash a po e mban të fshehur këtë informatë prej Kuvendit, apo nuk e di as vetë?

Tjetër, zoti Gashi, që po ashtu iku tani, jo qenka atje në fund, e përmendi në fjalimin e tij që puna e reciprocitetit na qenka një farë popullizmi. Jo zoti Gashi, nuk popullizëm, është platformë me të cilën kemi garuar ne, edhe ju, në fushatën zgjedhore dhe ju kemi treguar votuesve tanë që reciprociteti do të jetë qasja jonë e përbashkët.

Pra, ju e keni pasur një marrëveshje me ne, e keni pasur edhe një marrëveshje me votuesin, njësoj qysh edhe ne kemi pasur marrëveshje me votuesin tonë, dhe ju keni vendosur që t'i shkëlqoni që të dyja për shkak se e kishit një marrëveshje që më herët me AAK-në e Nismën, e besa edhe me PDK-në, që të mos e lejoni Qeverinë Kurti të ketë jetë të gjatë për shkak se kishit frikë këputjen e damarëve të hajnisë dhe të korrupsionit.

Si rrjedhojë e kësaj, ju ishit në gjendje që të bëheni bashkë dhe të ofroni në emër të përfitimit partiak, pra vetëm që të zëvendësoheshit në pozitë të kryeministrit, ishit në gjendje të sakrifikoni interesin shtetërorë, pra ofruat pazar më të ulët për Kosovën, duke premtuar se ju do ta hiqni edhe reciprocitetin.

Sa i përket zoti Veselit, u tha cili është qëndrimi i qartë. Pyetjen e njëjtë e kisha bërë edhe për PDK-në, edhe për zotin Veselin: A keni qëndrim të qartë për sa i përket cenimit të integritetit territorial të vendit? A pajtoheni me Thaçin, i cili ka thënë se komunat në pjesën veriore të vendit janë dhuratë e Rankoviqit? A pajtoheni me këtë deklaratë dhe nëse nuk pajtoheni, si e shpjegoni që ministrja e partisë suaj ka nënshkruar kontratë lobimi për të lobuar për ndryshim të kufijve të vendit me kompaninë “Mazorel” në Francë. Pra, kjo duhet të qartësohet. A mund ta qartësoni pozicionin që e keni karshi pozicioneve të Thaçit?

Tjetra? U tha edhe prej AAK-së tash, puna e patriotizmit, u përmend taksa e këto. Unë besoj që për AAK-në mjafton vetëm të jua ripërkujtoj se çka ka thënë Albini, e ka formuluar mjaft mirë, sa herë që vjen puna te pushteti, “tap” e lëshojnë bajrakun. Pra, edhe kësaj radhe janë pushtet, janë në Qeveri, kanë mundësi ta kthejnë edhe taksën edhe reciprocitetin, por kanë vendosur të qëndrojnë aty për shkak të përfitimeve që sjell pushteti. Pra nuk i dëgjon duke kërkuar as taks, e as reciprocitet tash, por merren me të kaluarën.

Në mungesë të reciprocitetit, se u tha që reciprociteti nuk na qenka sovranitet, është edhe mirë bile. Madje sovraniteti është njëri prej elementeve të shtetësisë dhe me heqjen e sovranitetit shtetit i thyhet njëra këmbë. Pra, me këtë vendim, shtetit i është thyer njëra këmbë, e rrezikon t'i thyhet edhe ndonjë këmbë tjetër e shtetit, që mund të jetë, qoftë qeverisja efektive në gjithë

territorin, pra nëpërmjet ndonjë “zajednice”, qoftë ndryshimi i kufijve, pra duke e cenuar territorin e vendit, këmbën tjetër.

Me heqjen e reciprocitetit hiqet edhe parimi i barazisë dhe shteti i Kosovës nga palë në tavolinë kthehet në copë mishi mbi të cilën negociohet. Pra, këtë e keni siguruar me këtë vendim, që në start keni hequr dorë prej parimit të barazisë. Krejt çka kemi kërkuar ne ka qenë barazi që palët të jenë të barabarta dhe siç u tha edhe prej disa parafolësve, askush nuk mund të ketë asnjë argument kundër, nëse palët kërkojnë të jenë të barabarta në bisedime.

Se heqja e reciprocitetit ishte kërkesë e Serbisë, këtu s’ka dilemë. Por, pyetjen që e kam për zoti Hotin është se me leje të kujt vendosi ta heqë reciprocitetin, leje prej këtij Kuvendi s’ka pasur, legjitimitet popullor nuk ka se ka garuar me premtimin për reciprocitet. Legalitet në këtë Kuvend nuk ka se po e shohim që sa e sa herë nuk e tejkalojnë shifrën prej 58 votave. Pra, me leje të kujt vendosën ta heqin reciprocitetin, me leje të kujt vendosën të heqin dorë prej sovranitetit dhe ta ndalojnë aktivitetin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare?

Po ashtu si pyetje, cila është agjenda e tatimit në Uashington, çka do të diskutohet atje dhe cila është agjenda e takimit në Bruksel dhe a është e vërtetë që atje do të takoheni me presidentin Vuçiq? Faleminderit!

KRYETARJA: Sejdi Hoxha, nga PDK-ja, e ka fjalën. I keni katër minuta e gjysmë, zoti deputet!

SEJDI HOXHA: Kryetare, me leje, edhe tre minuta i kam nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, mund ta konfirmoni te deputetja Teuta Haxhiu.

KRYETARJA: A pajtoheni, zonja deputete? Po, në rregull, shtatë minuta e gjysmë, faktikisht tetë komplet.

SEJDI HOXHA: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot po flasim për tarifën dhe për reciprocitetin. Për këtë temë, dy partitë që ishin në pushtet në koalicion, edhe Vetëvendosja, por edhe LDK-ja, realisht u treguan mashtruese ndaj qytetarëve në zgjedhjet e 6 tetorit. E këtij mashtrimi iu hoq maska sot, sepse asnjë njëra e as tjetra nuk e mbajtën premtimin për tarifën dhe për reciprocitetin.

Këtë pohim timin do ta faktoj nëpërmjet prezantimit të fakteve, të cilat do t’i shpalos në mënyrë kronologjike.

Këto dy parti, nëpërmjet koalicionit i quajtur si koalicion i shpresës, ishin pajtuar paraprakisht në marrëveshjen e tyre të koalicionit që taksa ndaj mallrave serbe të hiqet vetëm me vendosjen e plotë të parimit të reciprocitetit. Këtë e kanë pohuar edhe zyrtarët më të lartë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Më intereson të di pse Lidhja Demokratike e Kosovës u pajtua për vendosjen e reciprocitetit në marrëveshjen e koalicionit që e bëri me Lëvizjen Vetëvendosje, a u frikësua që Vetëvendosja nuk po e merr në koalicion, apo pati ndonjë arsye tjetër?

Pse Lidhja Demokratike e Kosovës e ndryshoi qëndrimin e saj për reciprocitetin, pasi e mori udhëheqjen e Qeverisë.

Në anën tjetër, Albin Kurti në ditën e parë të punës si kryeministër në një konferencë për media deklaroi që taksa prej 100% do të hiqet vetëm nëse në vend të saj do të vendoset parimi i plotë i reciprocitetit, por realisht doli krejt e kundërta.

Pushteti e tjetërsoi dhe e ndryshoi Albinin. Ai më 27 shkurt 2020 vendosi ta heqë taksën për një periudhë prej 90 ditësh, por nuk e vendosi reciprocitetin të cilën e kishte premtuar në fushatën zgjedhore, pra krahas shumë mashtrimeve që u bëri qytetarëve me shumë premtime tjera, njëri nga mashtrimet ishte edhe reciprociteti me Serbinë.

Ju praktikisht me taksën dhe reciprocitetin erdhët komplet në versionin që e kishte propozuar kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Kadri Veseli, ideja e të cilit ishte që taksa të pezullohej përkohësisht, e në qoftë se Serbia nuk reflekton, atëherë të vendoset reciprociteti i plotë.

Pra, kisha pasur dëshirë, nuk është për të ju ardhur keq, që ta pranoni faktin që për të gjitha temat e mëdha vetëm po blini kohë dhe po i mashtroni qytetarët, e në fund për të gjitha temat nacionale po ktheheni në idenë e Partisë Demokratike të Kosovës, sikur kjo tani që po ndodh me reciprocitetin.

Çfarë ndodhi pastaj me këtë temë? Qeveria Kurti menjëherë pasi e mori lajmin për vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe e kuptoi që më nuk mund të jetë në pushtet, në ditët e fundit të saj mori vendim popullist që ta vendosë reciprocitetin. Pra, këtë veprim nuk e bëri për parime, por e bëri në ditët e fundit kur e kuptoi që më nuk mund të jetë në Qeveri.

Sa ishin në opozitë, me shumë patriotizëm flisnin për mosnjohjen e diplomave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës nga Serbia, për hyrjen e makinave me targa serbe në Kosovë, për çështjen e të pagjeturve dhe kthimin e trupave të tyre në Kosovë, për burgosjen e qytetarëve shqiptarë në

Serbi, por kur erdhën në Qeveri nuk bënë asnjë veprim konkret, vetëm fjalë dhe premtime të kota, dhe mashtrime para qytetarëve.

Asnjëherë që nga paslufta ndikimi i Serbisë në Kosovë nuk ishte më i madh se në Qeverinë Kurti dhe në Qeverinë Hoti.

Gjatë kohës së pandemisë në Kosovë arrinin qindra mjekë dhe zyrtarë shëndetësorë serbë, ndërsa mjekët tanë nuk lejoheshin të shkojnë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc për t'u afruar qytetarëve shqiptarë shërbime atje. A ishte ky reciprocitet?

Në kohën e qeverisjes tuaj, lëre që nuk pati reciprocitet, por me shumë dashamirësi iu hapën dyert Serbisë, në Pejë hynin maunat, të cilat përveç targave serbe bartnin edhe fotografitë e presidentit të Rusisë, Vladimir Putin. Ky ishte një provokim i radhës qytetarëve të Kosovës nën qeverisjen tuaj.

Ju në fakt e mbajtët një premtim për reciprocitetin, por atë nuk e vendosët me Serbinë, çuditërisht reciprocitet të plotë vendosët me Shqipërinë. Serbisë i hapët dyert për bashkëpunim si asnjëherë më parë për të sjellë mjekë në Kosovë, bile të tregohet shumë humane duke i sjellë edhe 1000 teste për COVID-19.

Madje, e lejuat që Qeveria e Serbisë t'i zbatojë vendimet e saj për menaxhimin e pandemisë edhe në komunat e veriut të Kosovës. Me këtë rast e cenuat edhe sovranitetin e Republikës së Kosovës.

Imagjinoni, qytetarë të dashur, po të ndodhnin të gjitha këto veprime skandaloze nga ndonjë Qeveri tjetër çfarë kishin qenë në gjendje të bëjnë edhe Lëvizja Vetëvendosjes, por edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Në opozitë plot gojën bashkim kombëtar, flamujt në sako, ndërsa në pushtet e bllokuat Shqipërinë dhe nuk lejuat asnjë bashkëpunim në fushën e shëndetësisë, të arsimit apo të ekonomisë. Shumë më burrërore do të kishte qenë që këtë temë ta zgjidhnit në ditët e para qeverisëse, ta pezulloni taksën dhe së bashku me miqtë tanë ndërkombëtarë t'i hapni rrugë vazhdimit të bisedimeve, e jo t'i maltretoni qytetarët ende me këtë temë boshe.

Të nderuar qytetarë,

Edhe pse PDK-ja është në opozitë, ajo asnjëherë nuk do t'i ndryshojë qëndrimet e saj për tema të rëndësishme për vendin. Ne gjithmonë do ta ndihmojmë shtetin tonë në tema të mëdha, por do të jemi shumë korrigjues dhe të pakompromis ndaj veprimeve të papërgjegjshme dhe abuzive, të cilat u bëhen qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Nisma - AKR, deputetja Arbëreshë Kryeziu, katër minuta e tre sekonda, me kartelë të deputetit Endrit Shala.

ARBËRESHË KRYEZIU: Faleminderit, kryetare!

Në fakt, mbiemrin Krasniqi se po më ngatërron..

KRYETARJA: Kërkoj shumë falje, problem meqenëse këtu s'po ju del këtu emri.

ARBËRESHË KRASNIQI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ka orë të tëra që diskutohet çështja e dialogut, çështje kjo që me të vërtetë është me rëndësi shumë për vendin. Dhe, në anën tjetër, krahas këtij dialogu, diskutohet shumë dhe përmendet termi reciprocitet dhe jam shumë e sigurt që shumë deputetë të këtij parlamenti nuk e kuptojnë saktë se çka do të thotë reciprocitet dhe unë kam një pyetje, e veçanërisht për deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje: A është reciprociteti që ne t'ia japim shtetit serb 1 000 teste për COVID që, në anën tjetër, për 50 ditë sa këta ishin në qeverisje ata na i dhuruan për bamirësi 1 000 teste neve, dhe a është reciprocitet që maunat, kur ishit ju në pushtet, erdhën në Kosovë pa asnjë pengesë dhe a do të kemi mundësi edhe ne që po me mauna të sillemi në shtetin serb?

Unë kam edhe pyetje tjetër: Pse në qeverisjen Kurti, për ato pak ditë sa ishte, u përmendën aq shumë thikat dhe u shndërrua Shtëpia e Bardhë në shtëpi të kuqe dhe u përmendën shumë këmbisha dhe çka në fakt patët të na thoni dhe të bëni ju nëse do t'ju jepej mundësia dhe rasti që të shkoni atje?

Dhe pyetja tjetër është, pse nuk shkua kur e kishit mundësinë? Pse nuk shkua të na tregoni saktë kur të ktheheni se çka po diskutohet atje dhe çka në fakt do të bëhet atje?

Kështu që, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jo vetëm për 50 ditë të qeverisjes Kurti, por edhe për këto diskutime që sot dhe në seanca tjera i kemi dëgjuar, janë me të vërtetë jopërmbytësore në realitet me atë që e thonë. Në fakt, kur u jepet mundësia dhe iu dha mundësi, nuk e treguan veten.

Dhe, do të ndërlidhesha pak me deputetin Selimi, me diskutimin e tij të mëhershëm kur përmendet emri i zotit Limaj. Ne dhe gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës e dimë se e gjithë veprimtaria dhe puna e zotit Limaj i ka bërë nder Kosovës, edhe para luftës, edhe gjatë luftës, edhe gjatë ndërtimit të shtetit të Republikës së Kosovës. Kështu që ne nuk kemi asnjë dilemë dhe jam e sigurt që edhe qytetarët e Republikës së Kosovës i besojnë shumë dhe gjatë këtij procesi të dialogut, ku ne si Nismë do ta mbështetim, sepse ne jemi për dialog, ama dialog me njohje, dialog me njohje reciproke, dialog me të cilin do t'i sillen të mira vendit dhe jo dëme në asnjë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi e ka fjalën, në total 13 minuta e 7 sekonda kanë mbetur për Vetëvendosjen.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Qeveria Kurti ishte qeveria e vetme që prioritet e pati mbrojtjen e Republikës dhe të sovranitetit. Vendosja e reciprocitetit të plotë politik dhe tregtar ndaj Serbisë ishte vendimi më i rëndësishëm, ngase Qeveria e Republikës është vënë në funksion të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm shtetëror.

Por, ja që tani e kemi një qeveri ilegale, e cila nuk e ka prioritet mbrojtjen e shtetësisë të territorit dhe avancimin e interesave të qytetarëve të saj.

Zoti Hoti, kryeministri i Qeverisë ilegale, tha se reciprociteti është barrierë. Nuk është barrierë, reciprociteti është barazi është parim me të cilin udhëhiqen marrëdhëniet ndërmjet shteteve sovrane, shtetet e organizatat mbrojnë dhe avancojnë interesat e tyre duke siguruar trajtim korrekt e respekt të ndërsjellë.

Shtete demokratike e përdorin mekanizmin e reciprocitetit për t'i mbrojtur e avancuar interesat e shtetit dhe të qytetarëve të tyre.

Po i marr vetëm tre shembuj. Në mars 2019, Parlamenti Evropian e miratoi rezolutën, me të cilën i kërkoi Komisionit Evropian që ta vendosë mekanizmin e reciprocitetit ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kjo nga se Shtetet e Bashkuara të Amerikës aplikonin viza për shtetasit e Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Polonisë dhe Rumanisë.

Në shtator 2019, Spanja paralajmëroi se do të vendosë masa reciproke ndaj Britanisë, Britania nëse nuk garanton të drejtat e 180 mijë qytetarëve spanjollë, që jetojnë dhe punojnë në këtë shtet, Spanja do t'i përgjigjet me reciprocitet, do t'i revokojë të drejtat e mbi 360 mijë britanikëve që jetojnë dhe punojnë në Spanjë.

Njëjtë, në mars të vitit 2019, të shqetësuar për rritjen e shpejtë të Kinës dhe ndikimin e madh të saj në ekonominë botërore, liderët e Gjermanisë dhe Francës kërkuan më shumë reciprocitet.

Gjermania, e cila për pak ditë do ta marrë kryesimin e Bashkimit Evropian, në draft-dokumentin 24 faqesh thekson se do të ketë më shumë reciprocitet në raport me Kinën. Kjo vjen pas ankesës së kompanive gjermane, të cilat nuk kanë qasje në tregun kinez, aq sa kanë tregtarët kinezë në tregun gjerman.

Gjithë këta shembuj tregojnë se si veprojnë shtetet normale e demokratike.

Kryeministri qenka këtu, unë po e shfrytëzoj rastin që kryeministrit t'ia drejtoj disa pyetje dhe kërkoj vëmendjen e tij.

Çka është reciprociteti, kryeministër, sepse përgjigjja jote më herët ishte se është barrierë. Ju thatë se ne jemi tani jo vetëm aktorë, por edhe protagonistë, aktorë dhe protagonistë të kujt, zoti Hoti?

Çfarë veprimi po paralajmëroni se do të merrni, ndarje apo “zajednicë”, apo edhe ndarje, edhe “zajednicë”.

Ju po ashtu thatë se do të kthehemi në familjen evropiane. Në cilën familje dhe si do të ktheheni, të nënshtruar në këtë familje evropiane ku shtetet kanë dinjitet, ato mbrojnë dhe avancojnë interesat e tyre, dhe traktatet e marrëveshjet e tyre bazohen mbi reciprocitetin, mbi parimin e barazisë dhe me këtë mendësi nuk mendoj se një kryeministër ilegal si ju mund ta dërgoni shtetin drejt një familjeje evropiane siç është Bashkimi Evropian.

U tha se po e arrijmë një marrëveshje në mënyrë që qytetarët të mos e paguajnë faturën e izolimit. Cilët qytetarë, kë përfaqëson zoti Hoti? I ka vetëm 26 mijë vota, nuk ka legjitimitet të flasë në emër të qytetarëve të këtij vendi. Çfarë izolimi, po flet për izolimin, cilin izolim? Izolimin që e sollën këta për 20 vjet. Ne sot s’kemi viza për shkak se qeveritë e kaluara dhe njerëz aktorë, të cilët janë në këtë Qeveri tani, janë të korruptuar dhe për këtë arsye s’kemi viza.

U falën 8 200 hektarë tokë, thanë po e lirojmë popullatën e Kosovës që të mos jetë e izoluar, që të udhëtojnë lirshëm nëpër Bashkimin Evropian, por ja që ne vazhdojmë të jemi të izoluar, por nuk i kemi më 8 200 hektarë tokë, nuk kemi burime ujore, pozita strategjike e pika turistike, të cilat i falët.

U tha se kemi biseduar me ambasadorët tanë. Me cilët ambasadorë? Ambasadorët të cilët janë të inkuadruar në kontratat e lobimit dhe kanë lobuar për ndarjen e Kosovës, ambasadorët të cilët janë të emëruar nga koalicioni PDK-LDK?

U tha se kemi folur me miqtë tanë ndërkombëtarë. Me cilët miq? Gjermaninë, e cila shqetësohet çdo ditë se çfarë marrëveshje mund të sjellë kjo vizitë në Uashington e këtij kryeministri ilegal me presidentin, i cili, jo veç që është udhëheqësi i bisedimeve, por ai do të jetë kryesori dhe do të flasë, kryeministri shkon vetëm në përcjellje të tij.

U tha se kemi fol me miqtë ndërkombëtarë. Me cilët miq? Me Britaninë? Deputetët britanikë me shqetësim të madh në vitin 2018 kanë paralajmëruar që presidenti i Kosovës me paratë e buxhetit të shtetit të Kosovës po lobon për ndarjen e Kosovës.

Këtu në këtë foltore zoti Veseli tha se rezoluta u votua dhe këtu nuk pati përmbajtje as parime dhe se nuk pati platformë të bisedimeve me Serbinë. Ajo rezolutë, e cila u votua, nuk kishte synim që

të sjellë këtu, kishte synim më së pari që të determinojë dhe të vendosë ta autorizojë kryeministrin Kurti, i cili do t'i përfaqësojë bisedimet Kosovë - Serbi.

Është pikërisht LDK-ja e cila e ka shkelur këtë rezolutë, ka votua vetë, duke e autorizuar Thaçin udhëheqës të bisedimeve.

U fol për kontrata lobimi, mirëpo është shumë me rëndësi që zoti Veseli, i cili vjen këtu në këtë foltore dhe na tregon për çështje të caktuara, duhet të tregojë së pari pse figuron emri i tij në kontratën me “Medicine IN global Strategies LCE”, ku emri i tij figuron si person kontaktues, përderisa ai ishte kryetar i Kuvendit. Ndërsa ministrja Dhurata Hoxha e kishte lidhur këtë kontratë. Pse është emri i tij këtu për çka ka lobuar, për ndarjen e Kosovës? Faleminderit!

KRYETARJA: Zoti Endrit Shala nuk është këtu edhe ashtu, veç një minutë ka mbetur për Nismën.

I fundit që flet është deputeti Elbert Krasniqi, pastaj propozuesi do t'i ketë pesë minuta për ta përmbyllur komplet debatin para votimit. Zoti Krasniqi, i keni 6 minuta e 17 sekondat e fundit të grupit të juaj parlamentar.

ELBERT KRASNIQI: E nderuara kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më 6 tetor qytetarët votuan për Republikën, votuan për barazi dhe për reciprocitet me Serbinë. Ata që e mohojnë vullnetin e qytetarëve e mohojnë barazinë, e mohojnë vetë shtetin.

Pikërisht kjo e bëri një pjesë të këtij Kuvendi kur më 3 qershor e votoi këtë qeveri jolegjitime. Dhe pikërisht kjo Qeveri e morri vendimin kundër qytetarëve dhe kundër shtetit për t'i shfuqizuar vendimet e Qeverisë Kurti për reciprocitet si parim me marrëdhëniet me Serbinë, duke e hequr reciprocitetin ju hoqët dorë nga sovraniteti ynë dhe pranuat nënshtrimin, e kjo erdhi mu në kohën kur presidenti i Serbisë deklaroi se Kosova nuk mund të aplikojë masa reciprociteti ndaj Serbisë për shkak se kjo e fundit nuk e njeh Kosovën si shtet.

Zoti Hoti, nuk e keni asnjë të drejtë ta ekspozoni shtetin e Republikës së Kosovës, autoritetet tona shtetërore, ndërmarrësit e prodhuesit tanë ndaj diskriminimit. Ju s'keni të drejtë t'i vendosni kosovarët në pozitë të pabarabartë kur ata kanë nevojë të ndërveprojnë me autoritetet e Serbisë.

Juve nuk do të duhej të ju pengojë kur të tjerët e thërrasin Kosovën Republika e Kosovës. Kur masa reciprocitetit ua ndaloj të tjerëve t'i referohen Kosovës me terma jo kushtetues, që e mohojnë shtetin tonë dhe qenien tonë.

Pse po ju pengon Republika e Kosovës, zoti Hoti? Nuk do të besoja që Kosova do të ketë një udhëheqës që e favorizon Serbinë kundrejt Kosovës.

Zoti Hoti, duke e hequr reciprocitetin, Kosovën po e vendosni në disfavor në bisedimet me Serbinë. Po i mohoni madje edhe marrëveshjet e deritashme të arritura në dialogun teknik në shumë dimensione, e ndër to edhe lëvizjen e lirë.

Andaj, rrjedhimisht, më vijnë këto pyetje: Kur do t'i ndalë Serbia barrierat tregtare në transit? Kur do të mund që bizneset nga Evropa t'i sjellin mallrat e tyre në Kosovë pa i penguar Serbia? Kur do të mund prodhuesit kosovarë të barnave dhe ushqimeve të eksportojnë në Evropë pa u penguar nga autoritetet e Serbisë? Pse nuk mjaftojnë licencat, certifikatat e testimet e Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në tregun evropian? Pse duhet që prodhuesit që e zhvillojnë veprimtarinë në Kosovë dhe të pajisen me dokumentacione të Serbisë, sikur të ishin biznese në Serbi?

Deri kur do t'i pranojë Kabineti juaj qeveritar dokumentet e mallra që na quajnë me emra jo kushtetues, me emra që na mohojnë shtetësinë? Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nuk e ka kërkuar askush tjetër fjalën. E ftoj propozuesin, deputetin Liburn Aliu, i ka fillimisht tre minuta e 51 sekonda, në qoftë se dëshiron t'i shfrytëzojë të Grupit Parlamentar VV dhe pastaj pesë minutat e fundit për konkluzion, totali është 8 minuta e 51 sekonda. Deputeti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Atëherë këta tre minuta po i shfrytëzoj prej vendit.

Në fjalën e kryeministrit Hoti u përmend që në Uashington do të mbrohet sovraniteti. Pyetja ime është kjo: A do të jetë temë sovraniteti, pse duhet mbrojtur sovranitetin, nëse atje do të bisedohet për çështje vetëm ekonomike?

Tjetra? Në thelb u tha që platformë e bisedimeve është njohja reciproke. Njohja reciproke mund të jetë qëllimi. Ndërsa platforma do të kishte treguar se si mbërrimë te kjo. Unë nuk po e di se çka konkretisht do të flitet dhe si do të arrihet te kjo njohje reciproke. A ka ndonjë dokument, a ka ndonjë letër, a ka ndonjë premtim nga dikush nga Serbia që të na thuhet që do të kemi njohje reciproke në fund? Në negociatat e mëhershme, kur ka qenë zoti Thaçi, gjithmonë para se të shkojë në negociata, ai ka thënë se negociatat duhet të përfundojnë me njohje reciproke. Gjithmonë ato negociata ne kemi bërë kompromise, e në fund, Serbia, jo që nuk na ka njohur, por gjatë gjithë kohës na ka thënë që ne nuk do të ju njohim kurrë. Serbia po thotë sot të njëjtën. Pra, ajo po vazhdon të thotë që ne nuk do të ju njohim asnjëherë.

Për sa u përket deklarimeve në lidhje me reciprocitetin dhe vendimin që e ka marrë kryeministri Kurti, ju po përpiqeni të mos e përmendni dhe ta fshihni një fakt që gjatë kohës së vendosjes së masave të reciprocitetit, maunet që kanë hyrë në Kosovë e kanë pasur në letër të shkruar Republika e Kosovës. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë më herët, në asnjërën prej qeverive.

Për sa i përket Qeverisë së kaluar, para asaj kur ka qenë taksa e vendosur, si pikë e dytë ka qenë çështja që të gjitha ato mallra që hynë t'i referohen Kosovës me emrin kushtetues. Realisht, në fakte që ne i kemi pa mallrat që kanë hyrë kanë paguar taksë, ato që kanë hyrë e kanë pagua taksën, por Kosovës nuk i janë referuar me emrin kushtetues dhe për këtë kemi fakte. I janë referua vetëm me qytete të veçanta, për ç'gjë që ka pasur edhe vendim të veçantë asisoj të mos i referohen.

Një pyetje konkrete e kam për zotin Veseli, se nga deklarinimet që i dëgjova nga deputetët e Partisë Demokratike këtu mbase po më duket se në fund mbase do ta votojnë rezolutën për reciprocitetin, sepse u tha që ka qenë ide e PDK-së më herët, krejt në rregull është, pavarësisht që ka pasur rezolutë të Kuvendit të Republikës së Kosovës qysh më herët dhe çështja e reciprocitetit është shtruar që nga viti 2011, por pyetja është kjo: U përmend njohja me anëtarësimin në OKB, marrëveshja me Serbinë e cila përfundon me anëtarësim në OKB, e kjo po ma kujton përnjëherë periudhën e Boltonit, në të cilën tash së fundit u diskutua që çështja e korrigjimit të kufijve dhe shkëmbimit territorial dhe ndarjes së Kosovës ka qenë temë diskutimi nga ai. Asokohe kur ka qenë kjo temë ka qenë njëkohësisht çështja edhe e anëtarësimit në OKB, ku Kina dhe Rusia do ta pranojnë atë zgjidhje. A mund të na japë ose a mund të na distancohet nga ndonjë ide e tillë dhe të na japë mendim për reciprocitetin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Meqenëse koha është shteruar, tash i keni edhe pesë minuta për konkluzion. Urdhëro!

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Pas këtij debati të kësaj interpelance jam pak sa më i ngrohur për kah bindja dhe besimi që këtu do ta votojmë një rezolutë, e cila edhe do të votohet, pasi edhe qëndrimi në lidhje me reciprocitetin nga Partia Demokratike e Kosovës, por qëndrimi po ashtu nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ku përmendet vazhdimisht taksa, unë pres që ne ta votojmë këtë rezolutë.

Unë do ta lexoj në vijim rezolutën dhe më pastaj edhe arsyetimin, të cilën e keni po ashtu edhe para jush.

REZOLUTË

1. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i zbatojë parimet e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha fushat.
2. Masa e reciprocitetit në fushën e marrëdhënieve tregtare të rivendoset brenda pesë ditësh nga miratimi i kësaj rezolute.

Arsyetim

Republika e Kosovës e gëzon të drejtën që qytetarët e saj, ndërmarrësit, profesionistët, punëtorët të trajtohen barabarësisht, pa paragjykime, pa pengesa, pra me dinjitetin e domosdoshëm ku zhvillojnë aktivitete jetësore profesionale.

Republika e Kosovës me shpalljen e pavarësisë ka subjektivitet ndërkombëtar dhe dokumentacioni apo çfarëdo forme tjetër ndërveprimi në marrëdhënie ndërkombëtare nuk mund të jetë ndryshe, përpos reciproke.

Nuk ka arsye legjitime, ligjore në nivel shteti apo ndërkombëtarisht që të pranohet nga Qeveria se shtetasit e Republikës së Kosovës dhe autoritetet tona mund të diskriminohen, pengohen, të cenohen dokumentet dhe identiteti i tyre kombëtar e shtetëror, kur ata eventualisht kanë nevojë të ndërveprojnë me autoritetet e Serbisë në kuptimin tregtar, civil, apo të ndonjë sferë tjetër shtetërore.

Qytetarët e Republikës së Kosovës çdo herë e kanë shprehur vullnetin që trajtohen e të trajtojnë barabarësisht nga e me qytetarët e shteteve në rajon.

Reciprociteti si parim e veprim zgjeron mundësitë e respektimit të ndërsjellë shtetëror të të drejtave. Nuk ka asnjë zhvillim të qenësishëm të rajonit tonë nëse lejohen përpjekjet që e pozicionojnë si të pabarabartë Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Andaj, vendimi ynë afirmon raportet e barabarta ndërshtetërore, respektimin e të drejtave universale dhe krijon klimën e drejtësisë ndërmjet shoqërive.

Marrëveshja e përgjithshme për tarifatat dhe tregtinë GATT, e vitit 1947 dhe e ndryshuar më 1994, që është edhe instrumenti themelues i Organizatës Botërore të Tregtisë, njeh parimet themelore të reciprocitetit, mosdiskriminimit e shtetit më të favorizuar.

Këto parime vlejnë për të siguruar trajtim të barabartë të palëve në politikat tregtare, duke eliminuar barrierat.

Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore CEFTA, e vitit 2007, ndër të tjera, ka për qëllim eliminimin e barrierave tregtare dhe lehtësimin e lëvizjes së mallrave në transit, lëvizjen ndërkufitare të mallrave e të shërbimeve në territoret e vendeve midis tyre.

Që nga hyrja në fuqi e CEFTA-s, Serbia ka aplikuar një sërë barrierash tregtare jotarifore ndaj Republikës së Kosovës, duke përfshirë të tilla në transit, ato teknike dhe barrierat politike.

Kështu, Serbia i ka dëmtuar eksportuesit dhe importuesit nga Republika e Kosovës, duke rezultuar me një deficit të lartë tregtar për vendin tonë.

Në këto kushte, të gjitha raportet njoftojnë që vetëm duke aplikuar masat e reciprocitetit mund të mbërrihet në barazi, ashtu që të drejtat legjitime të Republikës së Kosovës në tërësi dhe të çdo qytetari të mbrohen e promovohen.

Mbi këtë arsyetim dhe rezolutën që sapo e lexova, unë kërkoj nga ju, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta votojmë këtë rezolutë me idenë që kjo pastaj ta ndërtojë një bazë të barazisë karshi Serbisë, sidomos në fazën në të cilën gjendemi para shkuarjes në Uashington dhe para marrëveshjes eventuale me Serbinë, për të cilën ne nuk po e dimë as për çka do të bisedohet as nuk po e dimë përmbajtjen e saj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Deputeti Liburn Aliu, në bazë të nenit 44, pika 4 d të Rregullores së Kuvendit dhe nënshkruesit e tjerë i kanë propozuar Kuvendit për miratim propozim-rezolutën që sapo u lexua. Kërkohet deklarimi me votim për këtë propozim-rezolutë.

I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen. Në sallë janë 83 deputetë.

Kush është për? Faleminderit!

Kush është kundër? A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

E lus Administratën ta sjellë rezultatin.

Me 31 vota për, 34 vota kundër dhe 1 abstenim nuk kalon rezoluta e propozuar nga deputeti Liburn Aliu, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë.

8. Raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi

Me ftesë së Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2020, kryeministri i Kosovës është ftuar që të raportojë në Kuvend lidhur me dialogun Kosovë - Serbi dhe takimin që do të mbahet më 27 qershor, në Uashington DC.

Fjalën fillimisht e ka kryeministri i Kosovës për të raportuar para Kuvendit.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, zonja kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Unë ju falënderoj për kërkesën që sot të raportojmë para Kuvendit për qasjen tonë për dialog dhe për vizitën e pritur në Uashington.

Ne edhe ashtu kemi pas në plan që ta kërkojmë këtë raportim.

Unë fillimisht dëshiroj që ta prezantoj qasjen tonë karshi procesit të dialogut dhe më lejoni të them që nuk do të dëgjoni asgjë të re, përveç se një qasje të strukturuar, të planifikuar të asaj që gjithmonë e kemi thënë me plot rezoluta të Kuvendit, edhe si qasje që kemi tash si koalicion qeverisës.

Pra, e para për ne dialogu bazohet në Kushtetutën e Kosovës. Kjo është platforma e dialogut, nuk ka platformë tjetër, nuk ka dokumente tjera që mund të negociohen ndërmjet partive politike për t'u dakorduar për procesin e dialogut. Është vetëm Kushtetuta.

E dyta, dialogu udhëhiqet nga kryeministri i vendit, sepse kështu thotë Kushtetuta e vendit, sepse kështu thotë edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të vitit të kaluar.

Tani sa u përket parimeve për procesin e dialogut, janë tri parime që janë të artikuluar në Kushtetutë.

E para që integriteti territorial i Kosovës është i panegociueshëm.

E dyta që organizimi kushtetues i vendit është i panegociueshëm, dhe

E treta që marrëveshja që mund të arrihet duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën.

Sa u përket objektivave janë këto. Ne bëjmë dialog për njohje reciproke, jo për ndonjë gjë tjetër. Normalisht, normalizimi duhet të jetë derivat i njohjes reciproke ndërmjet dy vendeve.

Ne bëjmë dialog për të siguruar njohje nga pesë vendet e BE-së. Ne bëjmë dialog për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe ne bëjmë dialog për t'i hapur rrugë Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, në përputhje me procedurat për në ato organizata. Ne bëjmë dialog për ta shfuqizuar përfundimisht Rezolutën 1244. Dhe, sigurisht, ne bëjmë dialog për t'i përmbyllur të gjitha çështjet e hapura që i kemi me Serbinë, duke filluar nga të pagjeturit, nga dëmet e luftës, nga kthimi i dokumentacionit e plot çështje të tjera që duhet të negociohen në përputhje me konventat ndërkombëtare për arritjen e atyre dakordimeve.

Tani sa i përket organizimit të procesit të dialogut, kjo Qeveri kështu e sheh mënyrën e organizimit të procesit të dialogut dhe përfaqësimit të shtetit të Kosovës në këtë proces, jo duke krijuar trupa mbiinstitucionalë, por duke e shfrytëzuar kushtetutën dhe kompetencat që ka secila prej institucioneve.

Mekanizmi i parë do të jetë forumi i liderëve të partive politike parlamentare, të cilët unë tentoj t'i mbaj plotësisht të informuar gjatë gjithë kohës.

Deri më tash unë e kam takuar shumicën prej tyre në takime individuale dhe në një takim të përbashkët, ku e kam prezantuar këtë qasje tonën për dialog dhe kam marrë komentet dhe sugjerimet e tyre.

Unë i ftoj edhe nga kjo foltore përfaqësuesit e opozitës që të bëhen pjesë e këtij forumi, që nuk është vendimmarrës, por është trup konsultativ për ta krijuar konsensusin e nevojshëm për marrëveshjen që duhet të vijë në Kuvendin e Kosovës.

E dyta është Këshilli i Ekspertëve për Dialog, që do të themelohet brenda Zyrës së Kryeministrit, ku marrin pjesë persona me përvojë në procesin e dialogut nga fusha akademike, nga shoqëria civile dhe në veçanti persona që kanë qenë të përfshirë në procesin e dialogut tash e sa vite.

Kemi pasur deri më tani disa konsultime me njerëz kyç që kanë përvojë në këtë proces dhe unë pres që shumë shpejtë të formalizohet ky këshill.

Kem marrë mbështetje për këtë këshill nga Ambasada Britanike dhe nga Ambasada Norvegjeze për të ofruar mbështetje profesionale për punën e këtij këshilli.

Edhe e treta, tek organizimi i procesit, unë i propozoj këtij Kuvendi që të themelohet Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje të Procesit të Dialogut, të cilin duhet ta udhëheqë opozita. Unë besoj që nëpërmjet këtij komisioni parlamentar dhe rolit që ka opozita duke e

udhëhequr këtë komision, t'i përdorë mekanizmat parlamentar për të siguruar që është e përfshirë në këtë proces.

Siç ju informova edhe në pikën paraprake të rendit të ditës, deri më tash ne kemi mbajtur disa takime për t'i informua edhe qytetarët për qasjen tonë për dialog, duke filluar nga tryeza në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me shoqërinë civile, pastaj në diskutime formale, në takime formale me ambasadorë të QUINT-it dhe me ambasadorët e BE-së, edhe me të emëruarin e BE-së për procesin e dialogut, zotin Lajçak.

Dhe, gjithashtu konsultimet ndërinstitucionale që i kemi bërë për këtë proces.

Unë ju garantoj një gjë, këtu do të jemi plotësisht transparentë gjatë gjithë këtij procesi, ose do të ketë marrëveshje të mirë për Kosovën në përputhje me Kushtetutën, ose nuk do të ketë marrëveshje.

Mua më vjen keq nëse nuk arrijmë që për disa muaj të kemi një marrëveshje në mënyrë që të mos vazhdojë kjo situatë e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, por përtej kësaj nuk kemi realisht ku të shkojmë.

Unë besoj që ju pajtoheni të gjithë me mua se ne duhet t'i dëgjojmë partnerë tanë ndërkombëtarë sa i përket qasjes që e kanë në këtë proces dhe kjo qasje është bërë e ditur formalisht e zyrtarisht nga letra uruese e sekretarit Pompeo, ku ai e sheh dialogun si qëllim që çon në njohje reciproke.

Për mua nuk ka garanci më të mëdha pse po hyjmë në këtë proces dhe në linjë me këtë janë edhe qëndrimet e ambasadorit Grenell, që i ka dhënë një shtytje këtij procesi.

Edhe ftesën që e kemi tanimë nga presidenti Macron për Samitin e Parisit nga mesi i muajit korrik. Unë besoj që kjo është qasja që duhet ta kemi në këtë proces, pra mos pritni që do të kemi platformë formale që do ta diskutojmë dhe do ta miratojmë. Platforma për dialog është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kompetencat kushtetuese i kemi të qarta edhe unë si kryeministër, edhe Presidenca, edhe ju si Kuvend për ta mbikëqyrur këtë proces. Atë që unë ju garantoj është transparenca e plotë gjatë gjithë këtij procesi.

Edhe po ju them një gjë, kjo marrëveshje arrihet nëse ne sigurojmë përfshirjen e opozitës në të gjitha fazat e arritjes së marrëveshjes. Nëse opozita nuk bëhet pjesë e kësaj, nuk ka marrëveshje. Nuk janë çështje që mund të kryhen nga një shumicë parlamentare, as nga e kaluara, ju kujtohet ish-kolegëve të mi në Kuvend, u kam thënë atëherë, nuk mund të hyjmë në proces të dialogut nëse opozita nuk bëhet pjesë. Keni kërkuar atëherë të krijohen mekanizma jashtëinstitucionalë, të cilët i ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese, ato ekipet e dialogut. Edhe sot po ju them, ky dialog nuk

do të jetë i suksesshëm, nuk mund të mbërrijmë marrëveshje nëse opozita nuk bëhet pjesë. Unë e ftoj Opozitën që të bëhet pjesë vetëm duke shfrytëzuar mekanizmat kushtetues, jo mekanizma jashtë institucioneve. Unë edhe sot u kam bërë ftesë dy liderëve të partive opozitare që të takohem formalisht me ta dhe t'i informoj në detaje për pritjet tona edhe qëndrimet që do të mbajmë në takimin në Uashington. Sapo të kthehem, unë do të kërkoj që prapë formalisht të raportoj para juve për diskutimet që i kemi bërë në Uashington. Faleminderit!

KRYETARJA: Fillojmë tani me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, deputetja Saranda Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUEVCI: Faleminderit, kryetare!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Është e pabesueshme që edhe sot gati 10 vjet pas po flasim me të njëjtën retorikë rreth dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Një herë na thanë se është dialog teknik, pastaj doli të jetë dialog politik, e tash po thuhet që është dialog ekonomik. Kur dhe si u vendos që të shkohet në takim me Vuçiqin për çështje të zhvillimit ekonomik, siç po deklarohej? Kur dhe ku u vendos që këto janë prioritetet e Kosovës në raport me Serbinë? Kush ua dha mandatin për këto tema? Asnjëherë në dialogun me Serbinë, qeveritë e vendit tonë nuk ishin në gjendje që në tavolinën e bisedimeve ta shtrojnë si prioritet dhe temë të kaluarën e pashmangshme të krimeve të luftës. Krimet që i bëri shteti serb ndaj popullatës shqiptare në luftën e fundit. Mund sa të doni të flitni se sa e rëndësishme qenka lufta e fundit në Kosovë, por as edhe një herë nuk patët guximin që t'ia përplasni fytyrës të vërtetën për të gjitha krimet e Serbisë në Kosovë. Ku mbeti premtimi i Thaçit për padi, për gjenocid ndaj Serbisë? Ku mbetën fjalët për dënim të të gjithë kriminelëve të Serbisë për krimet që bëri ndaj popullatës tonë? As edhe t'ua përmendni nuk keni guxuar deri më tani, e lëre më të kërkonit llogari nga Serbia. Rruga drejt normalizimit të raporteve me Serbinë nuk mund të kalojë duke e fshehur e mohuar të vërtetën e gjenocidit në Kosovë, e as nëpërmjet zhveshjes së shtetit të Kosovës nga elementet e shtetësisë e të barazisë. A ka mundësi së paku bile qetësi, edhe nëse nuk jeni duke dashur të dëgjoni? Jo, veç po flas për tema të rëndësishme, e gjithëherë po ndërhyini në fund.

Nuk është e mundur që me një shtet që ka qenë agresor gjatë luftës, destrukтив pasluftës, mohues i krimeve të luftës, bllokues i shtetit në të tashmen, të flitet për zhvillim ekonomik. Ekzistenca e Kosovës si shtet është pengesë e vërtetë për Serbinë. Jo rastësisht për t'u ulur në tavolinë, ju u detyruat t'i plotësoni dy kushte të Serbisë, që janë thelbësore për shtetësinë e Kosovës: e hoqët reciprocitetin dhe hoqët dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Të pabarabartë në pozicione silleni sikur historia ka nisur sot, kurse keni hequr dorë nga kërkesa për t'i kthyer të pagjeturit. Përgjatë këtyre viteve, Serbia, e besa edhe para disa ditëve Vuçiqi, me të

cilin po takoheni, ka amnistuar krimet e luftës. Nuk është distancuar nga krimet e luftës, madje i ka mohuar ato, siç ndodhi me mohimin e Masakrës së Reçakut. Kjo Serbi që nuk ka bërë asnjë hap për ta treguar të vërtetën për të pagjeturit, madje po do t'i fshehë shenjat e krimeve kundër njerëzimit, siç janë varrezat masive. Përveç tjerash, si qenkemi të barabartë në dialog kur në këtë rast Serbia thotë “unë po ndalem në sulm ndaj jush, vetëm atëherë kur ju hiqni dorë nga shtetësia”. Për t'u ulur me juve dhe për të dialoguar, ju nuk mund të aplikoni në organizata ndërkombëtare, ju nuk mund të silleni si të barabartë në tregti dhe në asgjë tjetër.

Serbia e do një Kosovë të nënshtruar, e për këtë i duhet një qeveri e dobët, dhe e kontrolluar nga Lista serbe, sepse vetëm kështu e mbajnë të dobët e të pafuqishme.

Gjithashtu, nëse nuk jemi anëtar i Interpolit, si do t'i arrestojmë e dënojmë kriminelët e luftës në Serbi? Se po, e keni lehtë këtu të flisni se si do të duhej të bëhet dënimi i krimeve të luftës. Nuk keni nevojë të flisni për këtë temë këtu, kjo temë e ka vendin para Serbisë. Përveç kësaj, zoti Hoti, askush nuk ta dha ty mandatin për të vendosur se si dhe kur shkohet në dialog. Së pari, nuk ke pasur besim përbrenda partisë, as për kryetar partie, e as për kandidat për kryeministër, edhe më pak e kishe mbështetjen e votuesve të LDK-së. Ti nuk përfaqëson asgjë dhe askënd në këtë dialog, përveç interesave të presidentit, i cili ta siguroi këtë karrige ku je ulur. Dialogu me Serbinë duhet të bëhet me kërkesa specifike tona si shtet, me program të qartë, por këtë nuk mund ta bëjë një qeveri ilegale, pa mbështetje të qytetarëve. Mos harroni edhe një gjë, ju vërtet nuk i përfaqësoni qytetarët, e sidomos rininë, por ju nuk mund t'ua shkatërroni të ardhmen e tyre.

Ky popull me të gjitha përjetimet gjatë luftës nuk ka për ta bartur barrën që i sillni ju, e as nuk do ta pagujë çmimin që i keni vendosur. Nuk mund të ecim përpara pa marrë Serbia përgjegjësi për dëmet që ka bërë, nuk mund të ketë raporte të dyanshme prej pozicionit të nënshtruar dhe nuk ecim përpara pa e fuqizuar vendin tonë. Të fillojmë së pari të mendojmë që duhet të trajtohem të barabartë karshi Serbisë.

Nuk mund që të prisni respekt nga komuniteti ndërkombëtar, që të të respektojë apo të trajtojë si të barabartë me Serbinë, ku ti vetë heq dorë nga shtetësia dhe nuk e trajton veten si të tillë. Kështu që, zoti Hoti, së bashku me presidentin nuk jeni legjitim të flisni në emër të popullit karshi Serbisë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Bogujevci! Nga LDK është lajmëruar për fjalë zoti Faton Bislimi

FATON BISLIMI: E nderuar kryesuese!
I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dialogu e ka bërë gati një dekadë jetëgjatësi dhe ka zërë vend të rëndësishëm në të gjitha debatet, jo vetëm parlamentare, por edhe ato mes qytetarëve tanë kudo që ata janë, sepse është kthyer në një sagë të vërtetë dhe në një barrë të rëndë për secilin prej neve. Është kthyer në një krye çështje, e cila me dashje ose pa dashje për shkak të rolit dhe rëndësisë që ka, na ka detyruar neve edhe shtetin e Kosovës që sadopak t'i spostoje anash çështjet tjera me karakter zhvillimor, socio-ekonomik, që direkt ndikojnë në jetën dhe standardin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Andaj, përmbyllja e këtij procesi të dialogut na jep neve mundësinë Parlamentit, Qeverisë dhe të gjitha institucioneve tjera shtetërore të Republikës së Kosovës që të fokusohen në realizimin e programit për krijim të mirëqenies socio-ekonomike, dhe në të gjitha sferat, këtë përfundimisht ia kemi borxh qytetarit të Kosovës.

Qeveria, kryeministri Hoti ka vetëm një mandat në këtë proces dhe ai është finalizimi i suksesshëm i këtij projekti madhor në fazë të fundit të shtet ndërtimit të Kosovës mision ky i cili është ndërtuar tash e fuqishëm për kohë të gjatë, së paku në dy simbolikat e rëndësishme të idealizmit tonë kombëtar. E para, lëvizjes sonë mbarëkombëtare nën udhëheqjen dhe vizionin e urtësisë politike të Presidentit Rugova dhe e dyta, heroizmit sublim të luftës sonë çlirimtare të pasqyruar më së qarti apo i qartë si kristali me familjen Jashari. Kushtet për dialog për të cilat u diskutua shumë, veçanërisht siç është ajo e reciprocitetit, e pezullimit apo heqjes së përkohshme të reciprocitetit për t'i hapur rrugë përmbylljes së suksesshme të dialogut me Serbinë është sfidë që na ka sfiduar në të kaluarën, na sfidon edhe sot, por mbi të gjitha është sfidë që i jep kuptim suksesit që pritët të bëhet së shpejti.

Andaj, nuk ka asnjë arsye për hezitim, as nuk ka arsye për frikësim se rëndësia e shtetësisë tonë po zhbëhet, po zbehet apo po tkurret nga ky proces i dialogut. Përkundrazi, ajo po sforcohet dhe po shkon drejtë përfundimit një herë e përgjithmonë. Kjo qeveri ka ndërmarrë hapat e domosdoshëm në koordinim të plotë me miqtë tanë ndërkombëtarë, e veçanërisht me aleatin tonë të pazëvendësueshëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për t'i dhënë fund këtij procesi në mënyrën më të mirë të mundshme. Ajo që neve dhe besoj shumicën e popullit të Republikës së Kosovës na bën krenarë dhe besim plotë që kjo fazë finale e dialogut do të përmbillet me sukses për Kosovën, është involvimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleati që kurrë nuk na la vetë, as në ditët më të vështira.

Por, kjo është mundësi e artë për neve që në koordinim me këtë partner të rëndësishëm pa e përjashtuar rolin e BE-së në asnjë moment, t'i vemi pikën mbi "i" procesit të dialogut dhe shtetësisë së Kosovës. Takimi që pritët të mbahet në Uashington D. C., më 27 qershor, besoj fuqishëm se do të jep frytet e para në aspektin e zhvillimit ekonomik kjo ... edhe nga kryeministri dhe është argumentuar dhe vërtetuar nga i dërguari special i presidentit të Shteteve të Bashkuara,

zoti Grenell. Nuk ka shtet e as mendësi shtet formuese më të qartë se sa vizioni amerikan i rëndësisë së shtetit dhe qytetarit si zotërues i atij shteti. Ky vizion dhe ky identitet bazohet në vetëm një gjë, kur e keni parasysh miksin e madh të njerëzve që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i vetmi gjë i përbashkët për të gjithë ata është identiteti shtetëror, është të qenët amerikan. Prandaj, si ka mundësi që kjo logjikë e shtetësisë, e shtet formimit, e nderimit dhe respektimit të vlerave shtetërore të jetë në disfavor ose të jetë e dëmshme për Republikën e Kosovës dhe për kosovarin si qytetar i saj. Ne nuk kemi asnjë dyshim dhe besoj që shumica prej juve pajtoheni se pavarësia e Republikës së Kosovës dhe shtetësia e saj janë arritjet më historike të shqiptarëve në historinë tonë më moderne, e kjo shtetësi dhe kjo pavarësi për kumbarë fatmirësisht ka pasur Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të gjithë ata që po vënë në mëdyshje interesimin dhe involvimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që po hedhin hi syve qytetarit të Kosovës duke ndërtuar teori konspirative prej më të ndryshme se në Uashington paska me na gjet belaja, ose paskemi me humb diçka, më duhet të ua rikujtoj disa fakte me relevancë të madhe historike. Mos harroni se ka qenë fillimi i shekullit të XX-të, ku shtetësia e sapo shpallur e Shqipërisë, ishte vënë në pikëpyetje dhe kishte qenë pikërisht involvimi amerikan nën udhëheqjen e presidentit Vilson në atë kohë, që i kishte bërë shpëtimin madhor të Republikës së Shqipërisë si qenie shtetërore e shqiptarëve për herë të parë në Ballkan. Vijmë tek viti 1992, tek Xhorxh Bush presidenti Xhorxh Busi i vjetri dhe kërcënimi i Kërshëndellave, vija e kuqe që iu vë Serbisë dhe Jugosllavisë së asaj kohe se çfarëdo intervenimi ushtarak në Kosovë do të ballafaqohej me forcën e Shteteve të Bashkuara dhe kjo ndodhi, premtim i mbajtur.

Vijmë tek viti 1999 intervenimi i NATO-së në lidhshpin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për çlirimin e popullatës shqiptare në Kosovë, kjo nuk kishte me ndodh sikur Shtetet e Bashkuara mos ta kishin në një vijë interesin e tyre gjeostrategjik miqësinë permanente me Kosovën dhe shqiptarët. Vijmë tek viti 2007, paralajmërimi i Presidentit Gjorgj Bush i riu në Shqipëri kur i dha fund procesit me një fjalë të dialogimit në Vjenë duke thënë “mjaftë është mjaftë Kosova duhet të jetë e pavarur” nuk ka pasur fuqi tjetër që ka fol më qartë, më drejtpërdrejtë sesa Shtetet e Bashkuara viza-vijë shtetndërtimit, çlirimit dhe pavarësisë të Kosovës. 2008 njohja e pavarësisë së Kosovës pikërisht nga Presidenti Bush dhe kjo na sjellë deri tash vitin 2020 finalja me presidentin Tramp dhe të dërguarin e posaçëm për t’i dhënë fundin dhe epilogun e suksesshëm fazës së dialogut me Serbinë në mënyrë që Kosova të lirohet nga kjo brengë dhe të vazhdojë udhëtimin e vetë si anëtare e barabartë me të gjitha shtetet dhe vendet e botës.

Ftesa për bashkim që është bërë ose për konsultë dhe për ofrim të mundësive që të gjithë deputetët, pozitë e opozitë, e veçanërisht të opozitës edhe nga Kryeministri Hoti, edhe nga deputetët e LDK-së është ftesë e cila ka për bazë seriozitetin e veprimit tonë si shtet dhe funksionimit tonë si komb, nuk është ftesë politike, nuk duhet marrë si iniciativë i një partie politike, por mbi të gjitha duhet kuptuar si thirrje për veprim të përbashkët. Më duhet ta

përfundoj me një thënie të rëndësishme, të cilën e gjeni në të gjitha muret e secilës zyre në Kongresin e Shteteve të Bashkuara, e keni edhe në të gjitha monedhat e Shteteve të Bashkuara, atë të “many one”, nga “shumë një”. Unë e di që ne këtu jemi shumë me mendime të ndryshme, e di që jemi shumë parti me programe dhe vizione të ndryshme, e kuptoj se jemi edhe disa etni një shumicë edhe tjerat pakica që jetojnë në këtë vend, por ne e kemi veç një shtet, e kemi veç një Kosovë, edhe e kemi veç një të ardhme që mund ta ndërtojmë dhe ta lëmë pas për ata që vijnë pas neve. Kjo barrë nuk është veç e Kryeministrit Hoti, e këtij Kabineti qeveritar, veç e jona si deputetë, kjo barrë është e popullit të Kosovës, por neve na ka rastësisë për mos me përdorë fjalë tjetër me qenë përfaqësues dhe delegues të këtij mesazhi popullor dhe bartës të kësaj barre për të ardhmen e vendit.

Andaj, edhe një herë ju kisha lut që të jeni konstruktiv dhe të keni parasysh se Kosova siç e thashë është një, është e jona, e juaja, e secilit që e ndjen veten kosovar dhe qytetarë të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, deputeti Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Kryeministri sot është këtu për të raportuar sipas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, për çështjen e dialogut me Serbinë, edhe pse realisht edhe interpelanca e trajtoi këtë temë pa çka se kërkesa zyrtare ndërlidhej vetëm me temën e reciprocitetit.

Shumë mirë që po e zhvillojmë këtë debat, sepse vetëm Kuvendi i Kosovës është institucioni që ka legjitimitetin e plotë për të thënë fjalën e fundit për përfundimin e procesit të dialogut dhe për ndonjë marrëveshje eventuale që mund të burojë nga ky proces. Por, Kuvendi nuk mund të përjashtohet nga rrjedhja e procesit dhe raportime të tilla në lidhje me dialogun duhet të bëhen në vazhdimësi, para dhe pas çdo takimi, apo raundi të bisedimeve, qofshin ato bisedime në Uashington apo në Bruksel. Dhe, ky qëndrim yni si Parti Demokratike e Kosovës ka qenë e shprehur qartë edhe në të kaluarën, e veçanërisht në mandatin e kaluar. Por, këtë e kemi bërë edhe kur e kemi udhëhequr qeverinë, raportimin para Kuvendit, para dhe pas çdo raundi të takimeve në procesin e dialogut. Me javë dhe me muaj të tërë ne jo vetëm që e kemi ftuar opozitën e kaluar siç thashë, por pastaj që përfundiam bashkë në pushtet dhe tash një pjesë vazhdon të jetë në qeveri që të bashkohemi për procesin e dialogut, siç po na fton sot zoti Hoti.

Por, ju keni refuzuar edhe pse ne ju kemi ofruar jo vetëm bashkëpjesëmarrje, por edhe që ta udhëhiqni dialogun e ne të jemi pjesë e ekipit të përbashkët. Pra, kur ju zoti kryeministër ishit në opozitë, unë personalisht në emër të Partisë Demokratike të Kosovës si udhëheqëse e koalicionit të kaluar qeveritar ju kam afruar që Lidhja Demokratike e Kosovës, si partia më e madhe

opozitare ta udhëheqë procesin e dialogut në emër të Kosovës. Besoj ju kujtohet ajo tryezë e partive politike që është mbajtur këtu në Kuvend, ku partinë tuaj e përfaqësonte zoti Agim Veli dhe ju zoti Hoti. Ju jo që s'keni pranuar këtë, por në të gjitha format e keni injoruar dhe e keni refuzuar çdo iniciativë të ish Qeverisë në lidhje me dialogun, njëjtë si ju si LDK ashtu kanë bërë edhe Lëvizja Vetëvendosje.

As s'keni dashur që të hartojmë platformë të përbashkët, as s'keni dashur të hartojmë ligj të përbashkët, as s'keni dashur që të krijojmë ekip të përbashkët. Krejt çka keni dashur në fakt ka qenë pushteti dhe tash kur jeni në pushtet, njëjtë si Albin Kurti para do kohe kërkonim mbështetjen e pjesëmarrjen e opozitës në dialog, bile me një lloj fontanë dëshirash edhe ju sikur paraardhësi juaj e keni projektuar edhe në çfarë role duhet me qenë ne si opozitë. Por, të ju them të drejtën kjo për mua është njëfarë hipokrizie, nuk besoj se keni as të drejtë morale për t'i kërkuar tash ato që i keni refuzuar mbi një vit kur ju vetë keni qenë në opozitë.

Bile për të rikonfirmuar atë që e tha edhe kryetari i PDK-së, zoti Veseli, ju kryeministër na patët fyer në mënyrën më të rëndë të mundshme në atë kohë, s'mund t'i harroj togfjalëshat që keni përdorur disa herë, sepse prej juve realisht nuk e kam prit, atëherë. Sa për përkujtim ne që ishim në koalicionin e atëhershëm na patët quajtur “kastë vrastare e perspektivës” dhe “rrezik për tradhti kombëtare”. Fjalët e rënda lënë shenjë dhe vështirë harrohen. Tani për t'iu kthyer asaj që thashë se për ne roli i Kuvendit është jo vetëm i patejkalueshëm, por edhe rol vendimtar rreth procesit të dialogut, ju them sot kryeministër se ju me qasjen tuaj deri tashme e keni fyer Kuvendin.

Ju as që keni kërkuar që të vini këtu sonte dhe të paraqitni platformën tuaj për dialogun, prezantimi i platformës tuaj kudo tjetër para Kuvendit të Kosovës është fyerja për të cilën po flas. Lirisht keni mundur që të shkoni edhe në ndonjë klub të pleqve, njëjtë siç keni shkuar në Akademinë e Shkencave edhe të Arteve, apo ndoshta do të kërkonit tash mbështetje dhe votat e tyre për dialog, ose për ndonjë komision për dialogun. Urdhëro, vazhdo, besoj që shumë kanë për të ndihmuar. Nuk është Kuvendi “bira e fundit e kavallit” siç thotë populli, dhe ju lutem mos e trajtoni Kuvendin si të tillë, ju edhe tash sa thatë që kur keni qenë në opozitë, keni thënë pak a shumë këtë që po e them unë sot. Por, miq kjo pikë e rendit të ditës quhet raportim, unë kryeministër ju ftoj që të na raportoni se cila është agjenda e takimit të datës 27 qershor. Për çfarë tema konkrete do të diskutohet aty? Dhe, cilat janë qëndrimet e Qeverisë që ju udhëhiqni për ato tema? Së pari a e dini cilat janë temat, edhe cila është agjenda? Normalisht, shpresoj që ju e dini, por ne nuk e dimë dhe meqenëse jeni edhe të obliguar sipas Kushtetutës të na raportoni si Kuvend, nëse dini na njoftoni edhe neve.

Pastaj, a do të jenë vetëm tema nga fusha e ekonomisë, apo do të diskutoni edhe për çështje politike meqenëse ju thatë që do ta mbronit edhe sovranitetin edhe çështje të tjera. Për një temë që u fol edhe në pikën e kaluar të rendit të ditës unë ju pyes çfarë zotime keni dhënë në lidhje me

suspendimin e aplikimeve për anëtarësim në organizata dhe institucione ndërkombëtare dhe për çfarë periudhe kohore, më saktësisht a për deri të dielën apo për më gjatë. Nëse është kjo e vërtetë, ju lutem na tregoni se cila është logjika ose arsyeja e një zotimi të tillë.

Qeveria e Kurtit si shumicën dërrmuese të vendimeve të saj, vendimin për reciprocitetin e ka marrë diku kah gjysma e natës edhe atë si qeveri e shkarkuar. Ne të gjithë e dimë që ata s’e kanë pasur përnjëmend këtë vendim, andaj unë mund ta kuptoj heqjen e reciprocitetit si shenjë e vullnetit të mirë edhe si një kundër peshë për ndalesën apo ndaljen e fushatës së egër së Serbisë kundër njohjes së Kosovës si shtet, por sinqerisht s’mund ta kuptoj aspak zotimin për të mos aplikuar për subjektivitet ndërkombëtar të Kosovës përmes anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Në fakt, për përkujtim këtë ju e keni bërë edhe në Qeverinë Vetëvendosje - LDK, sepse aty patët vendosur që të mos aplikoni për anëtarësim në Interpol.

Por, tash po del se ju jeni zotuar për të mos aplikuar në asnjë organizatë tjetër dhe opinionin publik, por edhe Kuvendi, para së gjithash, e meriton një sqarim për modalitetet, arsyet dhe racionalitetin e një rezoni të tillë. Tani ne këtu mund të flasim gjerë e gjatë për tema, e detaje të shumta rreth procesit të dialogut, por esenca e kësaj çështje çfarë dëshirojmë si vend, si shtet të arrijmë në fund të këtij procesi. Sa i përket Partisë Demokratike të Kosovës të gjithë ju e dini që së paku qysh në korrik të vitit 2018, pas diskutimeve në tryeza e takime të ndryshme të përbashkëta të partive politike, ne ju kemi dorëzuar zyrtarisht të shkruar platformën tonë gjithë liderëve politike dh e partive politike në Kosovë.

Të njëjtin qëndrim e kemi edhe sot dhe do ta kemi edhe në të ardhmen, sidomos ju që po pretendoni me hedh ndonjë dyshim ose me bë nga pak politikë. Shkurt, e keni atë dokument lexojeni, por unë po ua përkujtoj kështu të përmbledhur shkurt “çfarëdo marrëveshje potenciale duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të mos cenojë sovranitetin shtetëror, integritetin territorial dhe karakterin unitar të shtetit tonë, si dhe të kalojë përmes referendumit qytetarë dhe me 2/3 e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës”. Aty e keni nja 7-8 faqe përmbledhje, i keni prej parimeve themeltare deri te vijat e kuqe por ua përmbledha këtë pjesën që është pak a shumë më e rëndësishme.

Andaj, brenda kësaj kornize ju ftojme kryeministër që të ushtroni të drejtat dhe përgjegjësitë kushtetuese që keni si kryeministër dhe si qeveri dhe të keni parasysh që ky Kuvend do ta thotë fjalën e fundit dhe finale për çfarëdo marrëveshje potenciale në përfundim të procesit të dialogut. Duke u nisur nga ato që i thatë shkurtimisht nuk e konsiderojmë të nevojshme që të krijohen komisione as në Kuvend dhe askund tjetër. Kuvendi i plotë përmes seancave plenare mund ta luajë këtë rol edhe për shkak të transparencës, edhe për shkak të legjitimitetit. E juve, kryeministër rruga e mbarë për në Uashington, ku është Amerika pa dyshim duhet të jetë edhe Kosova, por kur të kthehesh mos harro eja edhe na raporto, mos prit prapë me të thirr ne, por merre iniciativën, sepse unë besoj që e din që e ke obligim kushtetues dhe për së treti herë po

them para se të shkosh nëpër bisedime, por gjithsesi menjëherë edhe sapo të kthehesh të na njoftosh për ato që ndoshta sot nuk i ke informatat apo që nuk je në gjendje që të na raportosh. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, është lajmëruar zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Sot, prej mëngjesit ndoshta edhe atëherë kur kemi debatuar për marrëveshjet ndërkombëtare ne kemi bërë një debat politik, folëm për reciprocitetin, por njëkohësisht folëm edhe për dialogun, gjë që po i bie të përsëriten gjërat, por kështu e ka diplomacia dhe kështu e ka parlamentarizmi dhe ne do të vazhdojmë ta kryejmë punën tonë si deputetë.

Dialogu, 10 vjet dialog, shumë marrëveshje të arritura e plot të pa implementuara. Dialog pa transparencë dhe pa llogaridhënie, degradim i dialogut deri tek idetë e ndarjes dhe shkëmbimit të territoreve, për të ndalë këtë trend u vendos taksa dhe u ndërpre dialogu. Vendosija e taksës dhe heqja u kushtëzua që të bëhet me njohjen e shtetësisë së Kosovës dhe përfshirjen e SHBA-ve në procesin e dialogut, mirëpo taksa u hoq, u hoq pa kushte dhe pa konsultim me aleatët tanë, siç janë SHBA-ja dhe Brukseli. Ne si deputetë, kërkojmë transparencë në procesin e dialogut dhe njëkohësisht do e mbajmë qeverinë në mbikëqyrje sa i përket këtij procesit.

Ajo çka na intereson të dimë është agjenda, platforma, a do të ketë ndonjë marrëveshje dhe qartësia për marrëveshje. Është e çuditshme për disa parti politike, të cilat sa herë që janë në qeveri pranojnë të dialogojnë, pranojnë të jenë pjesë e ekipeve negociatore, ndërsa në momentin që dalin në opozitë refuzojnë dhe e refuzojnë edhe dialogun, e refuzojnë edhe dialogun që udhëhiqet nga aleati kryesor i Kosovës, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Është momentum që partitë politike të jenë bashkë dhe të unifikuara për dialog, ta kornizojnë dialogun dhe saktë të dihet çka do të diskutohet. Me përkrahjen e aleatëve tanë të ofruar nga SHBA, Brukseli, të cilët po garantojnë një proces të drejtë, një dialog të drejtë, një dialog i cili nuk prek shtetësinë e Kosovës. Ne duhet t'i besojmë, duhet të jemi bashkë dhe të fillojmë negociatat.

Nga BE-ja duhet të kërkohet që sa më shpejtë të ketë liberalizim të vizave, duhet të kërkohet që të kemi njohje nga pesëshja jo njohëse, sepse Kosova i ka përmbush të gjitha obligimet sa i përket liberalizimit të vizave, ndërsa është vendi i vetëm i cili nuk ka liberalizim të vizave. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës beson se ka definim të procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Ky dialog duhet të bazohet në disa parime, parimi i integritetit territorial. Në asnjë mënyrë në këtë dialog nuk do të diskutohet për territorin dhe kufijtë, territori dhe kufijtë e Kosovës janë dhe

do të mbesin ata të 17 shkurtit 2008. Parimi i karakterit të pushtetit unitar, pra nuk guxon të flitet për një pushtet të dytë brendapërbrenda Kosovës, terma si “Republika Srpska” e tjerë, janë terma të vdekur dhe nuk do t’i pranojmë. Parimi i ruajtjes së kushtetutshmërisë që nënkupton që Kushtetuta e Kosovës është e shenjtë për ne si dokument themeltar i shtetit dhe në asnjë mënyrë për asnjë çmim nuk do të lejohet shkelja e saj. Garancia më e madhe për ne si Kosovë është padyshim fakti që këtij dialogu do t’i prijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sa herë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë në krye të proceseve, ku Kosova ka marrë pjesë çdoherë rezultatet kanë qenë pozitive për ne. Po ashtu, ne besojmë që ekipi që do të udhëtojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është ekipi i dalë nga bartësit e institucioneve të Kosovës dhe këtë ekip Aleanca e përkrah plotësisht.

Pra, bisedimet me Serbinë nuk duhen të dalin prej parimeve, nuk ka korrigjim të kufijve, nuk ka Republikë të Dodikut, nuk duhet të ketë ndryshime kushtetuese që prekin 17 shkurtin 2008, ne jemi të përkushtuar që bisedimet të udhëhiqen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shkak se deklarata e BE-së ka qenë të ndryshme dhe nuk kanë treguar unitet, veçanërisht nga shtetet mosnjohëse e dy prej këtyre shteteve Spanja dhe Sllovakia kanë pozita kyçe në këtë dialog, Borrelli dhe Lajçak. Kemi shumë për të diskutuar me Serbinë, janë dëmet e luftës, viktimat e dhunuara gjatë luftës, njohja reciproke, suksesioni, kemi edhe të flasim edhe për pensione, për dëmet e luftës dhe për shumë tema të tjera, andaj ekipi duhet t’i ketë parasysh të gjitha. Andaj, ekipit i dëshirojmë suksese dhe të qëndrojnë dhe t’i mbrojnë parimet, të cilat po kërkojmë të gjithë.

Pra, duhet të jetë një platformë e qartë, një platformë e furnizuar, të kemi zotime dhe të mos pranojmë diçka që e prej sovranitetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Kadrijaj! Nga Grupi Parlamentar Lista serbe dhe Nisma Socialdemokrate nuk është lajmëruar askush për fjalë. Nga Grupi 6+ zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Sayın Meclis Başkanı, Sayın Başbakan, Saygıdeğer Vekiller, kıymetli basın mensupları ve siz değerli Kosova halkı,

Kosova ve Sırbistan müzakereleri yıllardır Kosova siyasetinin ana gündeminde yer teşkil etmiş ve bugünden sonra da devam etmesi muhtemeldir.

Kosova’nın bağımsızlığından bugüne kadar komşu ülke Sırbistan ile ilişkilerimiz her iki ülke tarafından istenilen seviyeye gelemediği için, tam 9 yıldır iki ülke arasında ilişkilerin normaleşmesi için çaba sarf edildiğini, bu konuda dost ülkelerin de arabulucu rolünde ayrı bir çaba sarf etmesine ragmen, halen bir sonuca ulaşmamış olmamızın herkesin umudunu da tüketme durumuna getirdiğini görmekteyiz.

Balkanlar'daki istikrarsızlık elbette ki tüm Avrupa'yı da etkilemektedir; bu yüzden de Avrupa Birliği, Kosova ve Sırbistan arasında kalıcı bir barışın sağlanması konusunda ciddi yaklaşımlar sergilemektedir.

Diğer yandan, Amerika Birleşik Devletleri Kosova'nın bağımsızlığından bugüne dek Kosova'ya ciddi destek sunmuş, bunun en güçlü kanıtı da yakın tarihte atamış olduğu özel temsilci ile Kosova ve Sırbistan arasında kalıcı bir çözüme ulaşılması için ard arda toplantılar düzenlemekte ve 27 Haziran'da Washington'da iki ülke devlet başkanları ve başbakanlarını bir araya getirerek çözüme ulaştırmayı hedeflediğini görmekteyiz.

Bu bilgiler ışığında, bizleri en fazla ilgilendiren asıl konu, bu görüşmelerin içeriği ve ulaşılmak istenen çözümün ne olacağıdır.

Halihazırda en önemli konu, şu anda ne yazık ki göremediğimiz ve bizleri de en fazla endişelendiren durum, tarafımızı temsil edecek büyük Arnavut partilerin arasında ortak bir platformun ve uyumun olmamasıdır.

Tarihi ve kalıcı bir çözüm olması açısından meclisin ortak bir düşünce ve ortak bir tutumda buluşamaması, siyasi cekişmeler, daha fazla siyasi puan kazanma düşüncesinde olan, siyasetin dışına çıkan anlayış ve tutumlar, açıkçası bizleri de endişelendirmektedir.

Başbakanın davetlerine yanıt vermeyen 2 büyük siyasi parti, yine zamanında heyetler oluştururken, şimdi iktidarda olan partinin de destek vermediğini biliyoruz.

Değerli vekiller, siyasi parti liderleri; bu nereye kadar böyle devam edecek?

“Yürütmede ben olmazsam, oyunda ben yokum” siyasi yaklaşımı özellikle bizler için tarihi nitelik taşıyan bir olay olan Kosova ve Sırbistan müzakerelerinde olmaması gereken tutumlardır.

Sürecin iyi işletilememesi durumunda elbette ki muhalefet bu sürecin gidişatını eleştirecektir. Lakin, muhalefetin pusuda bekleyerek, “bu işi yürütecek olan hata yapsın da biz eleştirelim” mantığı, muhalefet açısından kabul edilebilir bir davranış olsa da, zor ve bu denli önem arz eden süreçte bu şekilde bir davranışın doğru olmadığı kanısındayım.

Burada atılacak imzaları ve anlaşmaları sonradan eleştirmek, halkımızı birbirine daha fazla düşürmekten öteye götürmeyecektir. O yüzden, çok geç olmadan herkesin masa etrafında olmasının ve herkesin Kosova tarafının kırmızı çizgilerinin belirlenmesinde katkısını sunmasının son derece gerekli olduğu düşüncesindeyim.

Türk toplumu milletvekilleri olarak, Sırbistan ile yapılacak görüşmelerin, bölgede kalıcı barışın sağlanması için vesile olacağı düşüncesine dayanarak, katkımızı sunmaya hazır olduğumuzu ve bunu tüm iktidarlara açıkça belirttiğimizi ve bundan sonra da gerekli desteği sunmaya devam edeceğimizi bildirmek isterim.

Elbette ki, olası bir anlaşmada bizlerin de düşüncelerin alınması gerektiğini ve her ne olursa olsun oyumuzun evet olacağı anlamına gelmeyeceğini de vurgulamak isterim.

Türk toplumu vekilleri olarak Kosova'nın sınırlarının değişimi konusundaki bir anlaşmaya evet demeyeceğimizi ve bizlerin de kırmızı çizgimizin olduğunu şimdiden açıkça belirtirim.

Olası bir anayasa değişikliğinde topluluk haklarımızın ihlal edileceği ve sadece bir topluluğa pozitif ayrımcılık sağlayacak anlaşmaya da evet demeyeceğimiz açıkça ortadadır.

Anlaşma her iki ülkenin birbirini tanıması ile sonuçlanır ise bölgede kalıcı bir barış sağlanmış olacaktır. Aksi takdirde bu iki ülke arasında sorun devam edecektir ve zaman geçtikçe de daha fazla derinleşecektir.

Avrupa'nın ve Amerika'nın anlaşma sağlamak için göstermiş olduğu çabaya hep birlikte Kosova tarafı olarak da destek olunarak, Avrupa ve Amerika'nın bölgemizin kalkınması için ciddi ekonomi desteği sunmasının, Avrupa'nın bir an evvel Kosova'ya vize serbestisi sağlamasının ve bölgede Kosova'ya uygulanan çifte standartan vazgeçilmesinin önü açılmalıdır.

Sonuç olarak Kosova halkının geleceği için, muhalefetin ve iktidarın birlik olma zamanı olduğunu ve daha geniş çerçeveden bakarak, bu tarihi fırsatı kaçırmamak için birlikte hareket ederek, geleceğimize yön vermek zorunda olduğumuzu belirtir, herkesten de bu konuda daha duyarlı olmasını temenni ederim.

Teşekkür ederim!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Damka! Nga Lëvizja Vetëvendosje, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetare!

Është e kuptueshme që në rastet e tilla nuk shpëtojmë pa disa pyetje fundamentale kështu kur është duke u nis zoti Hoti në bisedime, ne e pyesim ku po shkon, pra e pyesim ku je nis dhe presim përgjigje, por kjo nuk është përgjigjja e vetme që e presim, sepse kemi edhe pyetje tjera, por pyetjen se ku je nis, duke e ditur që është nisur pa ekip, pa agjendë të publikuar nëse ka agjendë, pa platformë, apo i mjafton që edhe agjendë, edhe ekip, edhe platformë është Thaçi, i cili po i prin në këtë udhëtim edhe mund t'i prijë edhe në udhëtimet tjera të ngjashme nëse do të shkojë.

Që 12 vite na është thënë që Kosova dhe Serbia bisedojnë si dy shtete të barabarta, ku është barazia mes Kosovës dhe Serbisë, ku paraprakisht u hoq dorë nga kjo barazi, pra nga fundamenti i barazisë, siç është reciprociteti. Na është thënë po ashtu, që Kosova ka përfituar nga bisedimet dhe marrëveshjet e arritura. Neve na kujtohet edhe kur përsëritej ajo fraza bajate dikur që Serbia ka njohur de facto Kosovën me nënshkrimin e marrëveshjeve në të kaluarën, e tash ku mbetën gjithë këto arritje. Meqë Kosova dhe Serbia bisedojnë si dy shtete të barabarta, pra ku mbeti barazia pasi që hoqët dorë nga reciprociteti.

Pasi Kosova paska dal fitimtare nga marrëveshjet e arritura, a është fitore Zajednica dhe cila do të jetë fitorja e ardhshme në takimin me Serbinë. Pasi që Serbia paska pas njohur de facto Kosovën, si u bë që nuk po ndalet së kërkuar dhe së lobuari jo për njohje de facto, por për çnjohje de jure. Nuk na demantoi koha, përkundrazi doli e vërtetë ajo që paralajmëruam dhe kësaj nuk i gëzohemi, por sërish të njëjtën gjë po ua themi, po gaboni jeni duke shkuar përballë Vuçiqit dhe Serbisë të zhveshur nga shtetësia dhe nga dinjiteti, dhe po ashtu edhe nga legjitimiteti. Po shkoni pa e ditur se ku, e nëse e dini aq më keq, e nëse e dini atëherë edhe aq më e rëndë do të jetë përgjegjësia për atë çfarë po ndërmerrni. Po nuk është hera e parë që neve na është kërkuar t'i bashkohemi, edhe të tjerët para jush na kanë kërkuar që t'i bashkohemi në ndërmarrje të tilla. Dhe ne nuk jemi bashkuar dhe kemi bërë mirë që s'jemi bashkuar dhe është mirë të mos jemi bashkë për të keqen, sepse kurrë deri sot s'na keni ftuar që të bëhemi bashkë për një të mirë të këtij vendi, as kësaj radhe nuk po na ftoni që të bëhemi bashkë për të ndarë diçka të mirë për Kosovën. Përkundrazi, po na ftoni për të ndarë përgjegjësitë me ne, e ne bëjmë shumë mirë që nuk bëhemi bashkë as në këtë ndërmarrje.

Po ashtu, po t'i mbani fjalët edhe në të kaluarën, por edhe tash ju do duhej të mos shkoni fare në bisedime, sepse ju vetë keni thënë që atje nuk duhet të shkohet pa dakordim dhe pa koordinim me opozitën, dakordim dhe koordinim, të cilën nuk e kemi. Zoti Hoti këtu që në debatin e mëhershëm që keni hequr masat e reciprocitetit për të kërkuar njohje reciproke, po mundohem të ju parafrzoj saktë, keni hequr masat e reciprocitetit për t'i hapur rrugë bisedimit deri në njohjen reciproke, e nëse doni njohje reciproke pse po hiqni dorë nga reciprocitet qysh në nisje. Pra, më duket pak paradoksale një konstatim i tillë.

Prandaj, për fat të keq zoti Avdullah Hoti i Qeverisë Koti ju nuk keni platformë, nuk keni ekip, nuk keni as kredibilitet e mbi të gjitha nuk keni legjitimitet për të shkuar dhe për ta përfaqësuar as këtë Parlament, dhe as qytetarët e Republikës së Kosovës. Pa legjitimitet shkuat në qeveri, pa legjitimitet po shkoni edhe në bisedime.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Kryeministri e ka kërkuar fjalën!

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë, disa adresime të shkurtra në ato që deputetët thanë deri më tani, kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët.

E para, më 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë e nisim dialogun për njohje reciproke me një agjendë të fuqishme ekonomike. Domethënë, ky është qëllimi i takimit në Uashington. E dyta, unë nuk kam dhe asnjëherë nuk kam me pas agjenda të fshehura për dialog, krejt keni për t'i ditur, të gjithë së bashku e thashë në pikën më herët, ose e bëjmë marrëveshjen bashkë që kalon këtë Kuvend ose nuk bëhet marrëveshja. Nuk ka me ardh marrëveshje që rrëzohet në këtë Kuvend. Nuk keni me pas një herë prej meje platformë, as dokument që kam me iu kërkua me dhënë komente, sugjerime, e tjera e tjera, platforma për dialogun është Kushtetuta e Kosovës, pikë, nuk ka përtej saj. Edhe një gjë të fundit po e them, unë do të shkoj në Uashington, në Berlin, në Paris, e në Bruksel sa herë që më kërkohet, pa e vënë asnjë kusht, sepse këta janë partnerët tanë që na kanë mbështetë në të gjitha proceset deri më tani dhe unë atyre ju besoj plotësisht.

KRYETARJA: Replikë, deputeti Selimi!

REXHEP SELIMI: Zoti Hoti, për racionalitet të kohës do të jem i shkurtër, por po ashtu edhe do të jem i qartë, ju sapo thatë që po shkojmë të nisim dialogun, a mund të konstatojmë që ju sot po nisni dialogun, kjo është goxha e rëndësishme ta dimë. Sepse, nga partnerët tuaj e nga ai që ju ka emëruar ose ju ka nominuar po thotë që ne po shkojmë ta përmbyllim dialogun, madje unë besoj që as e para, as e dyta nuk qëndrojnë, ju atje nuk po shkoni për dialog, ju atje po shkoni për marrëveshje. Sido që të jetë, ju sapo deklaruat që ju po shkoni ta nisni dialogun, na thoni edhe një herë sepse ky është lajm. Dhe e dyta, ju thatë që sa herë të më kërkohet do të shkoj atje pa vënë kushte, po ju vetë a keni kushte për të tjerët, apo ju shkoni pa kushte dhe nuk vëni kushte. Pra, a keni jo vetëm që nuk keni platformë ekip, po a keni njëfarë orientimi se pse po shkoni, është shumë me rëndësi për këtë Kuvend ta di se pse po shkoni edhe atëherë kur shkoni pa kushte. Faleminderit!

KRYETARJA: Kryeministri, kundër replikë!

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Unë besoj që isha mjaft i qartë, veç rima nuk di të bëj sikur ti, nuk di me rimua shumë kur flas i them gjërat kështu drejtë edhe qartë. Unë besoj që në paraqitjen time në fillim të kësaj pike të rendit të ditës, e thashë qartë që unë kam mandat me përfaqësua shtetin e Kosovës në procesin e dialogut vetëm në bazë të Kushtetutës dhe kur them kështu e ke të qartë për çka po flas. Unë nuk kam mandat as me bisedua për integritetin territorial, as për karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Unë shkoj në këtë proces për të siguruar njohjen reciproke, për asgjë tjetër. Mandej, si derivat i saj duhet të normalizohen marrëdhëniet. A ka më qartë se kjo?

KRYETARJA: Deputeti Frashër Demaj e ka fjalën.

FRASHËR DEMAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, zonja Osmani,

I nderuar kryeministër Hoti,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në kohën kur vëmendja e partnerëve tanë strategjikë është rikthyer nga Kosova tendencat irracionale janë tërësisht jashtë logjikës dhe sjelljes së përgjegjshme institucionale. Nuk mund individi, as subjekti, qoftë qeveritar apo opozitar, të shfaqet si shpëtimtar i qytetarëve të vendit dhe shtetit të Kosovës, duke linçuar e akuzuar të tjerët dhe për përgjegjësi institucionale, shtetërore e qytetare, madje duke përdorur edhe terma të papranueshëm në logjikën normale të demokracisë liberale.

Shfaqja e padinjitetshme politike rrezikon të acarojë situatën në shoqërinë tonë. Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë të vërtetën e funksionimit dhe mosfunksionimit, mundësisë dhe pamundësisë, qasjes racionale dhe asaj të munguar, si dhe përgjegjësisë kolektive në momentet kur vendoset për të ardhmen e Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Me fjalorin dhe sjelljen tonë të përgjegjshme në Kuvend dhe në institucionet tjera, pavarësisht ashpërsisë së diskursit politik, ne kemi obligim të bartim mesazhin e paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit, si vlera të patjetërsueshme qytetare, pa mburrje dhe pa akuza për heronj dhe tradhtarë. Armiqësia politike dhe mosdurimi partiak si shkak-pasojë e papërgjegjësisë bartet jashtë dhe krejt natyrshëm reflekton në mosdurim, mungesë të tolerancës, diskurs të papranueshëm të komunikimit qytetar dhe qasje iluzore të bazuar në hipokrizi politike dhe në manipulimin e masave.

Të nderuar deputetë,

Mungesa e eksperiencës dhe pamundësia nuk duhet të shndërrohen në arsye e arsyeja në argument të plotfuqizuar njëanshëm, që anashkalon respektimin e interesave qytetare në këmbim të interesave të ngushta partiake. Kjo situatë në të cilën gjendemi kërkon maturi dhe veprime që ngrenë nivelin e vetëpërgjegjësisë institucionale të secilit deputet dhe drejtues institucional, që do të reflektonte edhe në marrjen e përgjegjësi qytetare nga secili shtetas i Kosovës.

Qytetarët tanë sot presin nga ne që me përgjegjshmëri të lartë të diskutojmë e marrim vendime të duhura për masat ekonomike dhe fiskale, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e ekonomisë dhe shtetit, për përballimin e situatës, për punëtorët në sektorin publik dhe privat, për fermerët dhe ndërmarrësit, për të papunët që nuk ia dalin dot, për familjet e varfra pa kushte ekzistenciale, për fëmijët, nxënësit dhe studentët, për pleqtë dhe të sëmurit kronikë, si dhe për kategoritë e ndryshme sociale që duhet ta ndjejnë ndihmën dhe dorën e shtetit.

Në këto rrethana politike heqja e reciprocitetit ishte si rezultat i kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si një prej përkrahësve dhe partnerëve strategjikë të Republikës së Kosovës. Andaj, çdo refuzim në kuadrin e partneritetit nënkupton rrezikimin e interesave të Kosovës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin dhe mbeten sponsori kryesor i lirisë, pavarësisë, zhvillimit dhe perspektivës ndërkombëtare të vendit tonë.

Qytetarët e Kosovës na kanë votuar që t'i përfaqësojmë me dinjitet dhe të marrim vendime për të ardhmen e vendit. Partnerët tanë, si SHBA-ja, Britania e Madhe dhe vendet kryesore të Bashkimit Evropian, presin prej nesh që të sillemi me përgjegjësi përballë interesave tona shtetërore dhe obligimeve ndërkombëtare. Andaj, zotimet e kryeministrit Hoti dhe të Qeverisë së Kosovës, se procesi i dialogut me Serbinë duhet të zhvillohet duke pasur një konsensus të brendshëm në mes të subjekteve politike të koalicionit qeveritar dhe opozitës, është pjekuri politike të cilën duhet përkrahur.

Në procesin e dialogut Qeveria e Kosovës do të garantojë që do të respektohet Kushtetuta, tërësia territoriale e Republikës së Kosovës dhe karakteri unitar i shtetit, si dhe të krijojë kushte optimale për akomodimin e opozitës në nivelet më të larta të vendimmarrjes në procesin e dialogut. Qeveria gjithashtu na garanton se procesi i dialogut do të rezultojë me njohje reciproke.

Sot më shumë se kurrë, pavarësisht dallimeve politike është shumë e rëndësishme, që çështjet t'i trajtojmë racionalisht mbi parimet demokratike dhe të mobilizojmë institucionet e Republikës së Kosovës për të mirën e qytetarëve dhe tejkalimin e situatave sfiduese. Sot duhet të gjejmë kurajë qytetare dhe të shohim përtej interesave politike e partiake, sepse qytetarët e vendit presin që ne të hapim dyert e perspektivës për secilin nga shtetasit e këtij vendi, në mënyrë që secili qytetar të ndjehet krenar me shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Mërgim Lushtaku nga PDK. Nuk është këtu. Deputetja Besa Ismajli-Ahmeti e ka fjalën.

BESA ISMAJLI-AHMETI: Faleminderit!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar dhe të respektuar të gjithë,

Meqenëse u përmend dhe jemi bashkë këtu do të doja të shfrytëzoj fillimisht këtë mundësi që të uroj komunitetin egjiptian në ditën e tyre, meqë ka pak orë që na ndajnë nga ajo ditë. Ju dëshiroj gjithë të mirat dhe ditë më të mira për ju, familjet e juaja dhe të gjithë bashkëqytetarët tjerë në Kosovë.

Dialogu ka qenë tema që është konsumuar, bastarduar dhe është përdorur për fushata elektorale nga kolegë dhe parti të shumta, por nuk ka definuar politika, plane dhe platforma. Me një fjalë, diskursi ka qenë parësor karshi veprimi, natyrisht që është neglizhuar sepse ka kërkuar

përgjegjësi dhe ka kërkuar mençuri. Këto dy të fundit i ka zotëruar Partia Demokratike e Kosovës ndër vite e sidomos, këto dy vitet e fundit që kur kemi një dritë të gjelbër nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se gjërat duhet të lëvizin në këtë drejtim. Kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi pro dialogut. Por, dialogu si politikë pajtuese dhe integruese në instancat dhe organet ndërkombëtare, përfshi Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Sa për të sqaruar përfundimisht qytetarëve dhe disa kolegëve që mund të kenë mëdyshje, jemi të pakompromis ndaj ideve që e cenojnë shtetësinë dhe territorin e vendit. A është i nevojshëm dialogu? Nuk ka asnjë diskutim, është më se i nevojshëm, i domosdoshëm.

Me Serbinë duhet të përballemi në çdo instancë, ashtu siç dikur u përballëm vërtetë në ato kohëra me një rezistencë të armatosur për të larguar represionin dhe agresionin e saj dhe tash me vendosmëri, me integritet e përballje të guximshme për të larguar atë nga pengesat që ne domosdo dhe bashkërisht do t'i kalojmë integritet në strukturat ndërkombëtare. Por, më e rëndësishmja në qëndrimin tonë mbështetës gjatë viteve është roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës si rol thelbësor në dialog. Është evident një polarizim, një asimetri e çdo përpjekje për ta larguar këtë ndikim. Thënë në një mënyrë direkt, mosbashkëpunimi me SHBA-të, që çon kah interesi politik i cili është i pranishëm në Serbi dhe nuk do të duhej të ishte i pranishëm në Kosovë. Prezenca e këtij interesi natyrisht që rrezikon edhe Kosovën dhe subjektivitetin e saj ndërkombëtar, përfshirë edhe atë të brendshëm. Andaj, Partia Demokratike e Kosovës ka dëshmuar qëndrimin e palëkundur në këto zhvillime.

Qëndrim krah pozicionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në përballjet politike dhe ato diplomatike në arenën ndërkombëtare.

Një qëndrim i njëjtë i prerë, vetëm se jo në një interes të dyanshëm ka qenë edhe për Bashkimin Evropian, edhe pse janë bërë disa vite kur Bashkimi Evropian ka shfaqur disa qasje përjashtuese ndaj qytetarëve të Kosovës, duke u nisur nga lëvizja e lirë. Por, po, Kosova ka domosdoshmëri për krijimin e raporteve me Bashkimin Evropian, pavarësisht disa sjelljeve, por ka një amanet të brezave për shtrëngim dhe përforcim të raporteve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në çdo kohë, edhe pse partnerët e koalicioneve të Qeverisë së kaluar i kanë lëkundur seriozisht ato. Përkundër kësaj, ata prapë janë shtytësit e progresit dhe integritit. Progresi si synim i dy qeverive të partnerëve të ndërruar, kam frikën se mungon. E potencova më lartë, që njëra ndër pikat kryesore të bisedimeve është platforma e kjo duket se i mungon kryeministrit Hoti, i cili me transparencë më shumë facebook-iane po nis bisedime me nja dy-tri citime, pa definuar qartë situatën.

Si mund të thuhet që Kushtetuta është platforma, kur ndaj dy shkeljeve të Kushtetutës keni qëndruar në një qeveri pa ju bërë fare përshtypje. Problemet kryesore për një subjekt që përfaqëson, përfshi edhe vartësit e saj, shkojnë më shumë kah politikën e brendshme partiake, se

sa ato nacionale në rastin e tanishëm me dialogun. Ditën thërrasin për unifikim rreth dialogut, ndërsa natën edhe mund të përjashtojnë kolegët nga pozita të larta.

Kisha mospajtime me zonjën Osmani, por jam pro trasimit të idealeve politike për një grua, e cila nënkupton një praktikë të vështirë në vendime politike. Praktikë të cilën duket se paria e burrave të LDK-së nuk ngurruan dhe e përjatshtuan. E tash, performancat e juaja të dialogimit i kemi parë gjatë dialogut dhe negociatave që keni pasur për koalicionin dhe për këtë qeveri. Gjithsesi, pika e fundit ka të bëjë pikërisht me qasjen më lartë, është përdorur njëjtë edhe në përfaqësimin e grave në dialog gjatë gjithë këtyre viteve dhe nuk duket të jetë dallues edhe në të ardhmen. Kjo rrugë e Qeverisë Hoti thellon ndarjet, përjashtimin dhe pozitën e pafavorshme të gruas kosovare, e cila me kapacitet e integritet vetjak dhe përgatitje profesionale është e tejkaluar në rastin konkret është pozicionuar larg të qenët vetëm e dëshirueshme, sa i përket pozicionimit.

Dhe kur jemi këtu kam dy pyetje, meqenëse dialogu është lajmëruar të jetë dialog ekonomik. I nderuar zoti kryeministër, ne kemi pasur tri letra të qëllimeve dhe do të doja të di qëndrimin tuaj për sa u përket këtyre. Nëse ato do të shndërrohen në marrëveshje gjatë takimit që ju do të keni në Uashington. Dhe një pyetje tjetër, dua të di se çfarë ka ndodhur me marrëveshjet e arritura deri më tani në procesin e dialogut, i cili është i lehtësuar nga BE-ja. A do t'i diskutoni sërish këto marrëveshje dhe të zbuloni, të dini dhe të përmirësoni moszbatimin e tyre?

Përveç agjendës që nuk e dimë se çfarë do të ndodh në Uashington, ne nuk po kuptojmë nga ju, as cila është agjenda e Brukselit. Ju lus për përgjigje në këto dy pyetje të mija. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

S'e di ku shkoi kryeministri, sepse meqë po thotë se është bartës i dialogut besoj se duhet të jetë këtu dhe të na dëgjojë e të na japë përgjigje, sepse të gjitha diskutimet në fakt janë pyetje për të.

Po e nis me fjalën që derisa ne këtu po flasim për dialog Nezir Mehmetaj vazhdon të jetë i burgosur në burgjet e Serbisë. Ai vazhdon të mbahet peng nga një mendësi raciste, e cila nuk ka ndërruar as nga kjo klasë politike sot, për shkak se është shqiptar, për shkak se ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak se ka qenë luftëtar. Pra, edhe derisa ne po flasim këtu, po flasim për dialog dhe po presim që të kemi njohje dhe kemi ndërmarrë veprime, fillimisht heqjen e taksës, pastaj heqjen e reciprocitetit, pastaj një zotim që nuk do të angazhohemi që të aplikojmë në organizata ndërkombëtare deri s'e di kur, sepse nuk na e tha kryeministri, Nezir Mehmetaj vazhdon të mbahet në burg dhe besoj se të paktën ia kemi pasur borxh atij dhe të gjithë atyre që luftuan që ne sot të jemi këtu, që ta bëjmë një, mos të them kusht, por të paktën

një kërkesë që para çfarëdo iniciative të re për dialog njeriu ynë, qytetar i këtij vendi, të lirohet, sepse po mbahet peng!

Meqë kryeministri nuk është këtu unë besoj se do të na japë përgjigje, sepse pakë a shumë edhe deputetët tjerë ia bënë të njëjtat pyetje. Pra, pse sot nuk e kemi një platformë mbi të cilën ne do të diskutonim si deputetë, ndoshta do të jepnim edhe ide dhe do të ishim bashkë, ashtu siç kërkoi kryeministri gjatë tërë kohës. Pra, që të jemi bashkë fillimisht duhet që në Kuvend të kemi një platformë.

E dyta, cila është agenda në Uashington? Cilat tema do të trajtohen dhe kush i ka përcaktuar temat? Pyetja e tretë, a ka tema Qeveria jonë dhe cilat janë ato tema?

Mendoj se para se të shkojnë në Uashington, edhe pse po duket se tashmë është vonë, do të duhej që këto përgjigje të jepen në këtë Kuvend.

Dhe, pyetja e katërt që është pothuajse më e rëndësishmja, besoj për të gjithë ne, është: te cila pikë do të zënë vend çështjet siç janë: të pagjeturit, krimet e luftës, pensionet, gratë e dhunuara dhe temat tjera të cilat ne nuk hezitojmë t'i përmendim në këtë Parlament sa herë që kemi përvjetorë.

Pra, mendoj dhe pajtohem kur kryeministri thotë se ne duhet të jemi bashkë në këtë proces dhe besoj që përballë Serbisë nuk ka tjetër mënyrë që të dalim fitues, përveç se të jemi bashkë, bashkë edhe me aleatët tanë. Mirëpo, pyetja kryesore është, bashkë për çka? Pra, që ta dimë për çka të jemi bashkë duhet të kemi një platformë dhe duhet që kryeministri besoj të kthehet dhe të na japë përgjigje në pyetjet e bëra. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Nisma nuk e ka kërkuar askush fjalën, as nga përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë. Deputeti Elbert Krasniqi e ka fjalën.

ELBERT KRASNIQI: E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Shumica e gjërave u thanë edhe në pjesën kur diskutuam për reciprocitetin, por kur flasim për dialogun është shumë e rëndësishme që të përmendet fakti se nga Qeveria aktuale komunitetet joshumicë janë përjashtuar në mënyrë totale nga dialogu. Ne nuk dimë asgjë për dialogun, ne nuk jemi të përfshirë në dialogun. Së fundmi rifillimi i dialogut thuhet se bazohet mbi qëllimet e normalizimit të raporteve ekonomike.

Ajo çfarë është raport është e ashtuquajtura fazë e parë e dialogut synon zhvillimin ekonomik, i cili ndër të tjera vjen edhe në krijimin e vendeve të punës, një e mirë e domosdoshme për shtetin tonë. Duke marrë parasysh që komuniteti egjiptian gëzon një zhvillim socio-ekonomik jo të

kënaqshëm dhe jo të barabartë me grupet tjera, jam shumë i interesuar të dëgjoj nga kryeministri si udhëheqës potencial i dialogut, jo domosdo, se si e ka parashikuar impaktin pozitiv të zhvillimit ekonomik të dialogut në zhvillimin e komuniteteve joshumicë? Në çfarë forme zoti Hoti ka integruar nevojat e komunitetit në strategjinë zhvillimore të paraparë nga ana juaj?

Komuniteti egjiptian i Kosovës vazhdon të jetë njëri ndër grupet me zhvillim më të ngadalshëm, pjesëmarrje më të ulët në punësim, qoftë në sektorin publik apo atë privat dhe me mungesë të infrastrukturës bazë për një zhvillim socio-ekonomik. Duke marrë parasysh rëndësinë e përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike të komuniteteve, rëndësi kjo e theksuar në mënyrë eksplicite edhe nga Komisioni Evropian në raportin vjetor të progresit, besoj se kryeministri duhet të ketë një strategji të qartë se si të arrijë këtë qëllim.

Si parashihni zhvillimin ekonomik të një pjese të madhe të popullit, i cili bën luftë ekzistenciale në bazë ditore? A ishte nënshtrimi ndaj Serbisë dhe ulja në tavolinën e dialogut si indiferentë ndaj palës tjetër e vetmja formulë që garanton zhvillim ekonomik për vendin tonë?

Dështimet 20-vjeçare të Qeverisë kosovare në politikat gjithëpërfshirëse dhe ofrimin e kushteve për jetë të dinjitetshme të qytetarëve të saj nuk arsyetohet me vetëm një proces, aq më pak kur këto grupe përjashtohen nga ky proces.

Për fund, zoti Hoti, do të ishte mirë të tregoni se cila është agjenda e dialogut dhe a është i informuar vet për këtë agjendë apo është dërguar te dikush tjetër? Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Xhavit Uka e ka fjalën. Deputeti Visar Hoti me kartelë të deputetit Uka.

VISAR HOTI: E nderuara kryetare e Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Meqenëse sonte është fjala ime e parë si deputet në Kuvend të Kosovës më lejoni që të përshëndes të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, si dhe të gjithë bashkëatdhetarët tanë që jetojnë në diasporë dhe njëkohësisht t'i falënderoj për mbështetjen gjatë procesit zgjedhor, ku si rezultat i kësaj mbështetjeje unë sot kam siguruar ulëse në Kuvend.

Qytetarë të nderuar, Republika e Kosovës është treguar vazhdimisht e gatshme që të rrisë bashkëpunimin rajonal. Po ashtu, është treguar e gatshme që të jetë tejet e përgjegjshme në zbatimin e obligimeve që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Republika e Kosovës është treguar po ashtu, e gatshme vazhdimisht që të jetë në tryezën e bisedimeve, si në nivel rajonal ashtu edhe në raport me problemet që ekzistojnë me Serbinë.

Tani, shtrohet pyetja se a ka gabuar Kosova ndonjëherë që ka marrë pjesë në takimet rajonale, ani pse ka pasur kritika edhe për këto takime rajonale dhe zhurmë të brendshme politike. Natyrisht se nuk ka gabuar, sepse duke qenë prezent në takimet rajonale ka siguruar që Kosova të jetë pjesë e planeve evropiane, si në infrastrukturë, ashtu edhe në tërheqjen e fondeve nga instrumente të ndryshme financiare ndërkombëtare. Por, mbi të gjitha, Kosova ka arritur të refuzojë tregun unik rajonal si paradhomë të BE-së vetëm duke qenë në këto tryeza. Po të mos merrnim pjesë në dialogun rajonal, natyrisht se kjo do të përfundonte keq për Kosovën.

Kthehemi tek gatishmëria dhe përgjegjshmëria e Kosovës në raport me obligimet nga marrëveshjet ndërkombëtare. Kosova vetëm duke respektuar marrëveshjet dhe raportet ndërkombëtare arrin të tregojë se është partner serioz dhe i gatshëm për të qenë pjesë e familjes evropiane, tregon se është e gatshme të hyjë në marrëveshje kontraktuale edhe me Bashkimin Evropian, sikurse ishte rasti me Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim.

Dhe e fundit, a ka gabuar Kosova që është e gatshme të marrë pjesë në dialog me Serbinë?

Besoj se nuk kemi nevojë të kthehemi në histori, të përmendim se në çdo tryezë bisedimesh ku ka qenë Kosova ka pasur vetëm fitore për Kosovën. Kurrë, asnjëherë Kosova nuk ka humbur nga pjesëmarrja në tryeza dialogu. Ne të gjithë mund të nxjerrim disa trika popullistë, të kritikojmë në momente sa për të fituar disa poenë politike, por nuk ka vend më të mirë për Kosovën që të zhvillojë dialogun, se sa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se në Bashkimin Evropian. Para disa javësh ish-Qeveria lavdërohej me pavarësimin energjetik të vendit dhe krijimin e mundësisë për shfrytëzimin e autostradës energjetike Kosovë - Shqipëri. Pavarësia energjetike është arritur vetëm si rezultat i dialogut të zhvilluar vite e vite më parë. Rezultatin tentuan ta korrin ish-Qeveria, ndërsa kur zhvilloheshin bisedimet po të njëjtat kanë kritikuar atë marrëveshje.

Shumë qeveri para jush kanë punuar në këto projekte, përfshi dialogun dhe marrëveshjet për energjinë, gjë që tashmë i mundëson Kosovës përfitime ekonomike milionëshe. Njësoj, si rezultat i dialogut sot kemi edhe kodin telefonik që është element i shtetit sovran. Edhe atëherë, po ashtu e keni kritikuar këtë marrëveshje. Rezultat i kujt është kjo? Natyrisht, rezultat i dialogut. Edhe kjo marrëveshje i mundëson Kosovës që gradualisht të hyjë në skemën ndërkombëtare në çdo aspekt dhe mundëson përfitime milionëshe, po ashtu për vendin.

Ka shumë argumente që fillimisht i keni kritikuar e kur kanë dalë ndryshe nga kritika juaj nuk keni bërë zë, por megjithatë Kosova ecën përpara me dialog dhe në bashkëpunim të pandërprerë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kushdo prej jush këtu gjejeni një rast kur Kosova ka humbur e kur është pajtuar me Amerikën. Keni kundërshtuar dhe keni rrezikuar deri në pikën e fundit partneritetin më të rëndësishëm që Kosova ka pasur ndonjëherë për vetëm pak ditë. Prandaj, konsideroj se kryeministri i vendit është i qetë dhe i gatshëm më shumë se kurrë, që ta

përfaqësojë Kosovën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse shteti ynë aleatin kryesor ka SHBA-të.

Konsideroj se Kosova do të jetë serioze në këtë takim dhe sikur çdo herë në histori, në tryezë ku Kosova është prezent, ne do të shënojmë fitoren e radhës, ndoshta më të rëndësishmen pas Pavarësisë.

Meqenëse i kam edhe disa minuta do ta adresoja vetëm edhe një çështje. Në diskutimet e mëhershme u tha, se po shtyhen zgjedhjet në Podujevë me tendenca ta caktuara nga Lidhja Demokratike. I nderuari deputet, zoti Bulliqi, vlerësoi se shtyrja e zgjedhjeve është bërë për shkak që t'i ruajmë qytetarët nga COVID-19, po nëse ju teket t'i mbani shpejt zgjedhjet Lidhja Demokratike që nga 15 marsi dhe jo vetëm t'i mbani, por edhe të ju mundë rrastë, qe besa. Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë, Shpejtim Bulliqi!

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetare!

Unë do t'i preferoja këtij djali të ri, që ka ardhur dje këtu, le të merret me tema pak më të vogla për fillim, sepse këto janë të mëdha, për faktin se ky e di shumë mirë që në rast se u janë lejuar zgjedhjet serbëve të mbahen në Kosovë, tashmë nuk ka asnjë arsye që të shtyhen këto zgjedhje në Podujevë.

Se kush fiton, atë do ta thotë sovrani në ditën e zgjedhjeve dhe tashmë këto gjëra janë të ditura, që qytetarët llapjanë janë ngopur me një keqqeverisje çfarë e kanë bërë këta që kanë qeverisur deri dje dhe me padurim janë duke pritur që të vijë ai moment, që t'ua tregojnë vendin këtyre. Besoj, se këtë punë e di edhe ky djali i ri. Faleminderit!

KRYETARJA: Fjalën e ka deputeti Rasim Demiri nga 6+. A është këtu deputeti? Nuk është. Atëherë, fjalën e ka deputeti Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar deputetë,

Kabinet Qeveritar, ose ata pak që kanë qëndruar në këtë pikë të rendit të ditës, e cila besoj që është shumë e rëndësishme për të lënë anash diskutimin dhe për të mos dëgjuar deputetët e Kuvendit të Kosovës, kur e dimë shumë mirë se në këtë dialog rol kryesor dhe përfundimtar do të ketë Kuvendi i Republikës së Kosovës. Andaj, apeloj edhe te kryeministri për vëmendje dhe për prezencë në këtë pjesë të kësaj pike të rëndësishme.

Dialogu me Serbinë është karakterizuar nga ndërprerjet dhe vonesat e kohëpaskohshme, si pasojë e tensioneve, qoftë të brendshme apo ndërmjet dy shteteve, me kundërthënie të mëdha dhe polarizim të skenës politike. As Qeveria "Shkurti" e as kjo qeveri e stagnimit nuk i kanë dhënë

rëndësi çështjes së dialogut, por janë marrë vetëm me taksën dhe reciprocitetin e mos të flasim për problemet reale të qytetarëve, të cilat i kanë vendosur në sirtarin e harresës.

Tani, kur jemi në javën vendimtare se çfarë do të ndodh me këtë dialog, kryeministri Hoti në vend se të krijojë konsensus politik të kërkuar prej kohësh, ai bën ftesa nga studio televizive dhe nga konferenca të ndryshme, sa për të larë gojën, edhe një herë tregon qasjen jo serioze me nismën e tij të gabuar.

Dëshiroj të pyes kryeministrin, se a e di saktësisht se për çfarë do të flitet në Uashington? A do të flitet për çështje teknike, ekonomike apo politike? Pra, rifillim të dialogut apo marrëveshje përfundimtare? Kryeministri dhe kjo qeveri po ashtu duhet të na tregojë neve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës se cilat janë parimet bazë, të cilat nuk do të shkelen, sepse e vetmja gjë të kemi dëgjuar nga kryeministri është se unë do ta udhëheq dialogun në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Deri në çfarë stadi do të shkojë lëmshi i kësaj qeverie, nëse i kërkohet, duke pasur parasysh se kjo Qeveri me plotë gojë thirret në shpëtimin dhe ruajtjen e miqësisë së shenjtë të Amerikës.

Ne si Parti Demokratike e Kosovës kemi theksuar, se aty ku janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës jemi edhe ne dhe kjo nuk vihet as në diskutim, mirëpo jemi të zhgënjyer nga mënyra se si kryeministri po e neglizhon rolin tonë në këtë proces dhe po mendon që dialogu me Serbinë mund të zhvillohet vetëm nga pushteti apo pa përfshirjen e opozitës. Po ashtu, një gjë e bëjmë të qartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, se ne nuk do të lejojmë që të cenohet integriteti territorial i vendit tonë, në të cilin u derdh gjaku i shumë e shumë gjeneratave dhe jemi në nivel më të lartë të detyrës për të mbrojtur interesin e vendit. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Fatmire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj për fjalën!

Për një moment, pak më herët, u duk këtu ministri i shëndetësisë, por iku aq shpejt sa nuk arriti së paku të japë një vërejtje këtij Kuvendi, duke qenë se përditë në media po i fton qytetarët të respektojnë distancën fizike, të mbajnë maska dhe s’di a u frikësua nga ky ambient tmerrues këtu, ku jo që s’ka distancë, po që pjesa dërrmuese në mëngjes i kanë pasur masat, por COVIDI zbutet kah mbrëmja dhe...

Kështu që, ministri së paku të ishte në nivel të detyrës dhe së paku ta kish marrë fjalën e një vërejtje t’ia japë këtij Kuvendi. Kaq sa për Pandeminë, sepse vërtet për një kohë jemi relaksuar, sepse Qeveria Kurti dhe Ministria e Shëndetësisë atëherë e ka menaxhuar me shumë sukses Pandeminë, tash jemi në një situatë tjetër. Por, shqyrr jemi relaksuar. Nëse jeni të gatshëm nga 14 ditë të vetizoloheni, vazhdoni. Po të dal vetëm një rast këtu, të gjithë duhet të shkojmë në shtëpi, nuk mjafton vetëm një test.

Çështja tjetër, e tha një deputet këto sot, ne flasim me gjuhë të butë, por japim goditje të forta. Po, ju jeni ata që keni dhënë goditje pabesisht, pikërisht në mesin e Pandemisë partnerit në bashkëqeverisje. E keni krijuar një Qeveri, po, me 2/3-at e keni rrëzua Qeverinë Kurti, por sot këtu në Kuvend dëshmuat që asnjë çështje më nuk keni mundësi ta shtyni në këtë Kuvend, as çështjen më të vogël.

Pra, cila është pozita juaj negociuese tani karshi Vuçiqit, i cili po del i fuqishëm pas zgjedhjeve në Serbi, ndërsa ju shkoni pa legjitimitet, sepse siç u pa sot, nuk e keni mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje si partia më e madhe në vend, Grupi Parlamentar më i madh. Nuk e keni mbështetjen e PDK-së që sot, bazuar në atë çfarë kanë folur deputetët e PDK-së, ishte dashur këtu të vendoset një mocion dhe të nënshkruhet edhe ju të shkoni në shtëpi. Mirëpo, keni fatin që këta e kanë presidentin, i cili çdo ditë nga mediat thotë kush është kryenegociatori, ua tregon juve këtë Kushtetutë që e paskëshit ju platformë, bazuar në atë Kushtetutë ai do të ju prijë atje. Kjo PDK këtu ju tha sot qartë, zyrtarët e tyre, thanë që ne do të ju mbështesim deri në një moment të caktuar, sepse juve nuk ju besojmë, i besojmë presidentit, zyrtarit të tyre, eskponentit të lartë të PDK-së, që aktualisht nuk e ka vetëm petkun zyrtar të PDK-së, mirëpo është e qartë se këta e mbështesin deri në fund. Juve nuk u besojnë, por derisa të jetë ai kryenegociator edhe disi mund të figuron aty, por për më tepër asgjë.

Ky president në medie ka thënë “ofertën e mirë edhe do ta pranojmë”. Pra, kryeministri sot tha “Ne po e fillojmë një dialog”, ndërsa ne çdo ditë kemi kuptuar se një ofertë është dhe nëse është e mirë do ta pranojmë. A bëhet fjalë për dialog apo për marrëveshje të gatshme, e cila duhet të nënshkruhet? Kjo është pyetja në të cilën duhet të na përgjigjet kryeministri, që pretendon. Ju po shihni se bazuar në këtë Kushtetutë këta kanë marrë “më thua” menjëherë, se as Kushtetuta... nuk po dimë kush është kryenegociator. Nuk e kuptuam! Ndoshta, do të jetë bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese apo në Kushtetutë... e shohim, sepse nuk e kemi të qartë dhe nuk kemi marrë përgjigje të qartë.

Ju po shkoni të bisedoni për çështje të sovranitetit, ndërsa hoqët dorë nga sovraniteti ende pa shkua. Si është e mundur të hiqet dorë nga reciprociteti dhe të shkohet e si përfundim të arrihet ai reciprocitet? Si është e mundur që në start të hiqet dorë nga anëtarësimi në institucionet, në organizatat më të rëndësishme, ende pa filluar dialogun? Domethënë, shkoni në një pozitë skajshmërisht inferiore, që neve si qytetarë të Republikës së Kosovës na vendos në një pozitë aq të pavolitshme.

Çështja tjetër, po, ku është Amerika duhet të jetë Kosova, u tha këtu sot. Pra, edhe një herë po ju them, zyrtarët e PDK-së juve nuk u besojnë, i besojnë presidentit dhe Amerikës, por unë po them se verbërisht nuk shkoj, as pas prindit tim që më ka rritur e edukuar, më ka financuar e më ka prurë deri në këtë ditë, sepse edhe prindit tim kur ulet dhe negocion me duhet të bindem që është diçka mirë për mua. Do të thotë, pala ndërkombëtare gjithmonë kudo që është biseduar në dialog kanë

thënë se ne do të pajtohemi me një marrëveshje, të cilën do ta arrijnë palët që negociojnë, që nënkupton Kosova dhe Serbia.

Ju gjithnjë këtu keni ardhur dhe keni thënë, që po ne po na imponohet, kjo edhe sot u kuptua këtu që ne duhet t'u besojmë partnerëve tanë ndërkombëtarë. Po, ne duhet t'u besojmë, por ne duhet të shkojmë të fuqishëm, të argumentuar me një platformë të munguar, siç po e shohim. Sot të thash këtu në Kuvend "platforma jonë është Kushtetuta", domethënë ne Kushtetutën e kemi që moti, por shumë herë është shkelë kjo Kushtetutë. Dhe, ju do të thoni se e keni platformë Kushtetutën, të cilën nuk keni hezitur ta shkelni sa herë që keni pasur nevojë. Cili është besimi që nesër, meqenëse shumë herë u përmend shkëmbimi e falja e territoreve që nuk do të futet përsëri në agjendë, meqenëse tashmë po shihet që paska pasur një marrëveshje, edhe pse dikush nuk e paska parë.

Këto ditë po riaktualizohet shumë kjo temë. Pse mos të jemi ne të brengosur, që atje dikush do të vendos për fatin donë dhe kur të kthehet këtu do të thotë "po, për të mirën e përgjithshme ne kemi qenë të detyruar të pranojmë një marrëveshje optimale". Jo, ne nuk duam marrëveshje optimale. Ne e duam më të mirë për vendin tonë, mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit, për të cilën ju ende pa shkuar po hiqni dorë. Ende pa shkuar ju keni hequr dorë dhe jeni vënë në një pozitë inferiore karshi Serbisë. Si mendoni pastaj të rinegocioni për diçka që veç ka qenë duke u zbatuar?

Reciprociteti ka qenë duke u zbatuar. Nëse për juve është hipokrizi reciprociteti, pikërisht vonesa nga ju, nga LDK-ja, partnerin në bashkëqeverisje e keni pasur të pamundur ta zbatoni programin e përbashkët, sepse ju e tradhtuat në mes të rrugës, programin për të cilin jeni zotuar. Isha në të gjitha negociatat përfundimtare dhe më kujtohet se si zotoheshit pranë kryeministrit Kurti, se si po dyshon që ministrat që vijnë nga LDK-ja nuk do të jenë bashkëpunues, se nuk do të jenë ata që do të ndjekin politikën e Qeverisë. Dhe pabesisht, në natën e mbajtjes së Këshillit të Sigurisë menduat ta transferoni pushtetin nga kryeministri te presidenti, ndërsa sot kaq të relaksuar po qëndrojmë këtu, ndërkohë që numri i rasteve me COVID është ekstremisht i lartë.

Më vjen mirë që u kthye ministri i Shëndetësisë dhe shpresoj që më ka dëgjuar, që një vërejtje këtij Kuvendi, meqenëse po di t'u japësh vërejtje qytetarëve të Republikës së Kosovës për mosmbajtje të maskave, mosmbajtje të distancës, ndërsa këtu nuk po i sheh ato dhe habitem se si mund të presim që qytetarët t'i respektojnë masat e një Qeverie, kryeministri i së cilës Qeveri shkon në Rugovë, përqafohen, zgjasin duart, ulen në një tavolinë pa distancë, hanë e pinë edhe japin modelet "më të mira" të prerjes së shiritave në grumbull. Qytetarët mund edhe të gabojnë, por kryeministri tani që propagon këto masa... Unë pres, sepse situata më nuk është e relaksuar, përkundrazi.

Prandaj, nisja në pozitë inferiore në këtë dialog, nuk mund të presim asgjë, për më tepër që edhe u tha, se s'ka as platformë.

KRYETARJA: Ministri i Shëndetësisë e ka fjalën.

MINISTRI ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetare!

Kryeministër,

Edhe më parë kemi bërë thirrje që të zbatohen rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. E dyta, edhe obligimet që dalin nga manuali për parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe ju lus edhe juve të gjithëve që t'i respektoni. Janë obligative.

Sa i përket rritjes së numrit të rasteve, dokoreshë, duhet t'i keni dy fakte parasysh. Edhe masat pas hapjes, e nderuar deputete, me datë 18 maj edhe pas lirimit të masave të fazës së tretë, që kanë nisur më 1 qershor, trendi i rasteve me COVID 19 pas lirimit të këtyre masave është rritur, është e njohur.

Por, njëherësh, unë kam insistuar që të rriten edhe testet. Tash, po ta jap edhe ty një statistikë edhe për opinionin. Prej 8 shkurtit 2020, kur kanë filluar testimet, që i bie deri më ditën kur unë kam marrë mandatin e ministrit, janë 140 ditë. Janë bërë 15 833 teste. Ndërsa, për 15 ditë që unë jam ministër janë bërë 5 933 teste, që i bie përafërsisht 30%. Jo pse kemi dashur dhe jo pse kemi qenë... Urdhëro! Merre fjalën të lutem dhe ulu, je deputete, mos u ul, se ai pozicion është pak i pafavorshëm për kulturën e një deputeti. Ulu! Po, kështu. S'po ta përmend emrin, se fare s'po më intereson emri yt.

Dhe, kjo është puna e testimeve gjithnjë duke përkrahur dhe respektuar edhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësor për ta ruajtur shëndetin publik. Andaj, ju kisha lutur t'i keni parasysh këto fakte dhe mos të kemi keqkuptime e keqinterpretime edhe në publik, sepse nuk është interes vetëm i një ministri, as i një deputeti, po i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo është fakt dhe nuk ka fakte tjera.

Për një informacion për ju dhe për publikun, në Klinikën Infektive sot janë 102 persona, 2 janë në Spitalin e Mushkërive, 50 prej tyre janë me oksigjeno-terapi, 6 janë në intensivë. Domethënë, kjo është e vërteta dhe lajmi i fundit që isha prezent edhe në infektivë. Kapacitetet tjera, është një mobilizim që të shtohen edhe në mjekësinë sportive edhe në dermo, kështu që e kemi situatën nën kontroll gjithnjë duke i ndihmuar profesionistët shëndetësor, të cilët me angazhimin maksimal të tyre edhe shtimin e kapaciteteve humane, që t'u dalim në ndihmë që të mos kemi problem në menaxhimin e situatës. Edhe ju kisha lutur edhe juve që ta përkrahni këtë situatë. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Fidan Rekaliu e ka fjalën.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Dialogu me Serbinë është aktualisht një nga proceset më të rëndësishme në kuadrin e eliminimit të pengesave për fuqizimin e integritetit të plotë të Kosovës në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare si shtet i pavarur dhe sovran.

Në këtë përpjekje të rrumbullakimit të subjektivitetit tonë ndërkombëtar Kosova është mbështetur nga miqtë e saj, duke dhënë kështu prova të qarta se ne jemi për dialog, për fqinjësi të mirë e perspektivë euro-atlantike. Duke qenë kështu, konsiderojmë se është tejet me rëndësi që pjesëmarrja jonë të jetë e plotë, kualitative dhe më e rëndësishmja të përfaqësohemi mirë edhe nga institucionet kushtetuese për të dëshmuar seriozitet, respektim të parimeve të shtetit të së drejtës. Sigurisht se ky proces ka vështirësitë e veta, sidomos kur pala tjetër ende nuk ka kaluar faza të rëndësishme të pajtimit a të kërimit të faljes për krimet e kryera, bashkëpunimit të sinqert për të gjetur të zhdukurit nga lufta e fundit dhe vendosjen para drejtësisë të urdhërdhënësve dhe kryerësve të veprave që shkojnë në nivel të krimeve të luftës, krimeve në masë dhe atyre të gjenocidit.

Megjithatë, është një proces para nesh që duhet përfunduar për të ardhmen tonë dhe të gjeneratave pas nesh. Pra, për të ndërtuar sa më të qartë pozicionin tonë negociues janë të rëndësishme që Qeveria e Kosovës t'u përmbahet disa parimeve, që fillojnë nga fakti se Kosova nuk negocion me Serbinë shtetësinë tonë, se ne jemi shtet i pavarur dhe i tillë do të jemi me apo pa njohjen nga Serbia. Kosova ka qenë gjithmonë brenda të drejtës së saj legjitime në kërkesën për shtet të pavarur e sovran, një fakt i vulosur edhe nga opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si i tillë dhe që Kosova duhet ta shfrytëzojë këtë fakt me konsistencë. Dialogu bëhet për të arritur njohjen reciproke dhe për t'u përmbyllur çështjet e hapura në mes të dy vendeve, duke përfshirë çështjen e të pagjeturve, dëmet shkatërrimtare të luftës, që Serbia i ka shkaktuar në Kosovë, adresimin e Fondit Pensional, që është marrë nga Kosova, Fondin e artefakteve muzeore, pjesë e koleksioneve të muzeut tonë, zgjidhjen e problemeve të qarkullimit të mallrave me origjinë të Kosovës e me theks të veçantë eliminimin e maltretimeve të bashkatdhetarëve tanë, që për çdo vit përballen me vështirësi gjatë ardhjes dhe largimit nga vendlindja e tyre.

Qeveria ka mandat që në përputhje të plotë me Kushtetutën tonë nga ky proces të sigurojë se Kosova do ta ruajë sovranitetin shtetëror në kufijtë ekzistues dhe të garantojë moscenimin e karakterit unitar të shtetit. Dialogu ndërmjetësohet nga miqtë dhe partnerët tanë të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj nuk duhet të frikësohemi nga ky proces. Kosova as nuk është udhëzuar gabimisht e as nuk është vënë ndonjëherë në presion për vendime të gabuara nga miqtë e saj, me theks të veçantë Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

I nderuari kryeministër,

Dua të shpreh besimin tim në përkushtimin, dijen e vullnetin tuaj për ta udhëhequr këtë proces, ashtu siç ju obligon Kushtetuta e vendit. Besoj në pjekurinë tuaj dhe të ekipit tuaj, se do t'ia dilni në mënyrë të shkëlqyeshme të përfaqësoni vendin e të koordinoni të gjithë procesin me aleatët tanë euro-atlantikë, për një marrëveshje që hapë perspektivë të re e dinamike për Kosovën, qoftë në planin ekonomik, politik, diplomatik e atë të integritimeve evropiane. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputetja Yllëza Hoti e ka fjalën.

YLLËZA HOTI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë,

Tashmë është bërë e ditur që çështja e zhvillimit ekonomik të vendit po përdoret si arsyetim, ose thënë më mirë si fasadë e rinisjes së dialogut Kosovë - Serbi. Megjithatë, përveç faktit që i tërë ky proces po ndodh në një mënyrë jotransparente, ky arsyetim nuk përputhet aspak as me vendimet e lëshimet që i bëni gjatë rrugës, siç ka qenë heqja e reciprocitetit. Në bazë të të dhënave mbi tregtinë e jashtme të vitit 2019, Kosova ka pasur një deficit tregtar prej 3113,4 miliardë euro. Në tregtinë me shtetet e CEFTA-s, importet kanë arritur në 502,7 milionë euro, ndërsa eksportet vetëm 164,8 milionë euro.

Pra, edhe si pjesë e marrëveshjes tregtare CEFTA, Kosova ka pasur një rritje të vazhdueshme të deficitit tregtar ndër vite. Një arsye e madhe që ka ndikuar në këtë aspekt është aplikimi i barrierave jotarifore nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina. Serbia vazhdimisht ka aplikuar dhe vazhdon të aplikojë masa që e bëjnë të vështirë ose të pamundshme eksportin e mallra kosovare, duke e rritur kështu çmimin e tyre dhe duke u pamundësuar konkurrencën me tregun e shteteve të tjera.

Me heqjen e reciprocitetit ju keni treguar se pajtoheni me këtë standard të dyfishtë. Me heqjen e reciprocitetit, ju keni treguar se pajtoheni që prodhuesit e Kosovës duhet t'i nënshtrohen këtyre masave jo të drejta nga autoritetet serbe, ndër të cilat janë mospranimi i produkteve me tiketa ku ceket se ai produkt është prodhuar në Kosovë. Kërkesat e palës serbe që eksportet e Kosovës t'i respektojnë standardet kombëtare të Serbisë e jo të Kosovës, mospranimi i licencave kosovare të produkteve për eksport, si dhe praktika të tjera penguese që rezultojnë në kosto shtesë kohore, por edhe monetare për kompanitë e Kosovës. Përmes këtyre masave, Serbia po arrin qëllimin e uljes së eksporteve kosovare në shtetet fqinje, përderisa produktet e tyre kalojnë pa asnjë problem si import në Kosovë.

Fakti që Kosova nuk vendos asnjë barrierë specifike tregtare ndaj produkteve serbe, rezulton në akumulimin e disbalanceve afatgjate në kurriz të ekonomisë së Kosovës.

Si mund të arsyetohet heqja e reciprocitetit në aspektin ekonomik, kur trajtimi jo i barabartë i të dy palëve ndikon negativisht në ekonominë e Kosovës, por jo në atë të Serbisë? Si mund të përdoret zhvillimi ekonomik si arsyetim i rëndësisë së vazhdimit të dialogut me Serbinë, kur ky trajtim i njëanshëm i bën keq vetëm ekonomisë së Kosovës?

Një term shumë i përdorur në fushën e tregtisë ndërkombëtare është parimi ‘level of the playing field’, një parim që definohet si baraspeshim i pozitave negociatore mes dy palëve dhe balancim i të drejtave dhe obligimeve të tyre. Vetëm në v. 2020 ky parim është përdorur nga vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në diskutimet e tyre për tregti me Kinën si dhe në negociatat mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian. Në vitin 2019, SHBA ka kërkuar që të aplikohet ky parim në tregtinë e tyre me Kinën, me arsyetimin se Kina po i favorizon me subvencione prodhuesit e tyre, kështu duke i vënë ata në avantazh në krahasim me prodhuesit amerikanë. Gjithashtu, në fillim të v. 2020 janë publikuar artikuj të shumtë rreth iniciativave të Bashkimit Evropian për aplikimin e këtij parimi në raport me Mbretërinë e Bashkuar, për t’u siguruar që tregtia mes këtyre të dyjave të jetë sa më e drejtë për të dyja palët.

Në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare, sipas Deklaratës mbi parimet e ligjit ndërkombëtar të vitit 1970, të gjitha shtetet kanë të drejta dhe detyrime të njëjta, pra janë juridikisht të barabarta. Në atë rast, madhësia e një shteti ose rinia e atij shteti nuk duhet të konsiderohet si arsyetim që ai shtet të trajtohet si më pak dhe t’i cenohet e drejta e barazisë sovrane. Si shtet i pavarur që duhet të punojë për zhvillim ekonomik dhe trajtim të drejtë në tregtinë ndërkombëtare, edhe Kosova do të duhej të kërkonte aplikimin e një parimi të tillë. E në marrëdhënien tonë me Serbinë, ky parim aplikohet përmes vendosjes së reciprocitetit.

Si shpjegohet që për vazhdimin e dialogut, kusht për Kosovën të jetë heqja e reciprocitetit, ndërsa për Serbinë mjafton një sugjerim që në të ardhmen ndoshta konsiderojnë të na njohin si shtet? Si mund të shpjegohet që kusht për dialog për Kosovën të jenë ndërprerja e proceseve të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, që ndikon negativisht te ne, ndërsa për Serbinë të jetë ndërprerja e fushatës për çnjohjen e Kosovës, që s’i dëmton ata aspak.

Si e shpjegoni ju z. Hoti vendimin tuaj për të rinisur këtë proces dialogu ku shteti ynë vazhdon të trajtohet si sekondar me palën tjetër? Përderisa nga Qeveria Kurti është bërë analizë e detajuar mbi arsyet dhe argumentet e nevojshmërisë së vendosjes së reciprocitetit, ju e morët këtë vendim për ta hequr reciprocitetin në ditët e para të punën suaj, që e dëshmon edhe më shumë sa pak rëndësi i keni dhënë analizës për efektet që kjo do të ketë për shtetin tonë.

Përveç kësaj, mungesa e transparencës në vendimmarrje po ju karakterizon çdo ditë e më shumë. Në seancën e fundit, znj. Bajrami nuk mori mundin t’i përgjigjet asnjë prej pyetjeve të shumë deputetëve rreth kërkesës suaj për rritjen e kufirit të deficitit. U arsyetuat se duhen mjete shtesë

për financimin e Pakos të Rimëkëmbjes ekonomike, por ende nuk na keni dhënë asnjë detaj për shumën që do të shpenzohet për këtë pako, e as se si do të alokohen këto mjete.

Tash po vazhdoni me të njëjtën mungesë transparence teksa po filloni dialogun me Serbinë, duke publikuar asnjë plan apo detaj rreth temave që do të diskutohen. Ju nuk e përfaqësoni vullnetin e as interesat e popullit të Kosovës, e këtë e keni dëshmuar në mënyrën se si e keni formuar këtë Qeveri dhe po vazhdoni ta dëshmoni me këtë keqqeverisje.

KRYETARJA: Deputeti Jahja Koka e ka fjalën.

JAHJA KOKA: Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësi dhe privilegj të veçantë që t'ju përshëndes juve të pranishëm dhe në mënyrë të veçantë po ashtu po i përshëndes qytetarët e nderuar!

Në prag, të takimin në Uashington apo fillimit të negociatave në Uashington dhe pastaj edhe në qendrat e Evropës, pra është jo vetëm legjitime, po e domosdoshme të pyesim se cilat janë pritjet e këtyre negociatave, cili është kredibiliteti i ekipit tonë në këto bisedime, sa jemi të përgatitur apo shkojmë vetëm si “muça mas daive” atje? Për ta dhënë përgjigjen në këtë, filloj me një algoritëm apo me një kod të Benjamin Franklin. Benjamin Franklin ishte siç thuhet ‘founding father’ apo njëri nga baballarët e themelimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili jorastësisht ishte fizikan, por që e kishte një kredibilitet të madh, pra quhej edhe gjeni në aspektin e diplomacisë. Duke zbatuar kodin e tij dhe ato që derivohen në situatën tonë konkrete, dalin disa porosi shumë interesante.

Por, tani të konstatoj që ekipi ynë negociues ‘videndum super est’ për nga kompetenca profesionale, psikologjike, diplomatike, hyn në negociata të paktën me dy hendikepe relevante. Tani me radhë po i përmend të parën, e pastaj të dytin. I pari hendikep lidhet me fjalën çelës: reciprocitet. Mos keni frikë zonja e zotërinj, se nuk do të përsëris atë që u përsërit vazhdimi, madje edhe kështu në emisione televizive të tjera prej opinionistëve lidhur me reciprocitetin, por do të them diçka që konsideroj që është tërësisht e re, që derivohet nga kodet apo mendimet e Franklin, Churchill dhe Kissinger. Në bazë të kësaj, del fakti që reciprociteti por edhe taksa nuk e kanë penguar Vuçiqin as Serbinë për të vazhduar dialogun. Del diçka shumë tjetër, shumë relevante, të cilën do ta konstatojmë ne tani. Hajde së bashku zonja dhe zotërinj të mendojmë në të njëjtin kanal të të menduarit. Po të donte Vuçiqi dhe Serbia të përfundonte marrëveshjen, ata menjëherë do të arrin atë që e quajmë ne gjithëpërfshirëse, d.m.th. të përfundojë me sukses sipas planifikimit të tyre.

Pra, do të ishte rezultat i arritshëm shumë shpejt. Pra, në një interval shumë të shkurtër kohore, pothuajse delta T barazi me zero. Ata reciprocitetin do ta konsideronin si irrelevant, pra do të ishte çështje e historisë, nuk do të kishte kurrfarë peshe. Por, relevanca e reciprocitetit është diku

tjetër. Është diku tjetër për arsye se atë e përdorte si kredibilitet diplomatik apo për një arsye shumë më madhore që na duket në fillim bukur e çuditshme. Pse të mos vazhdohet dialogu pa e hequr reciprocitetin ose taksën? D.m.th. çfarë pengese është ajo?

Pra, nuk është aq naive, por kërkon një kredibilitet, një siç e quan Franklin, një shpejtësi e caktuar fillestare diplomatike. Kur flasim për shpejtësinë fillestare merreni me mend që është një front njerëzish që vrapojnë. Duhet të nisen për të arritur në cak. Natyrisht nisja bëhet me një plasje, me një revole atje, ku asnjëri s'guxon të ketë shpejtësi fillestare me përparësi ndaj tjetrit. Dhe në qoftë se dikush e falsifikon atë shpejtësi fillestare, loja ripërsëritet. Unë dua të them shpejtësia fillestare në diplomaci, siç thotë Franklin, ka rol pothuajse dominant.

Prandaj, pikërisht ky është ai kredibiliteti, kjo është arsyeja pse me shumë fanatizëm ata donin të flasin për reciprocitetin e të tjera, por pastaj na e thyejnë dorën, në mënyrë simbolike, dhe neve na e tregojnë vendin, që sipas tyre faktikisht jemi pjesë integrale e Serbisë.

Që të jem më i qartë, meqë Kosova e pat shpallur pavarësinë, na njohën 115 apo 116 shtete e të tjera, ata me këmbëngulësi na quanin Kosovë e Metohi dhe në preambulën e tyre kushtetuese mbanin, në dukje të them të drejtën shumë infantile, por pikërisht relevanca qëndron pikërisht në atë shpejtësinë fillestare të Franklinit, në domosdoshmërinë që ata të na tregojnë atë që ishte de-fakt e de-jure sipas Kushtetutës së tyre, ta bëjnë të dukshme, ta bëjnë publike, ta demonstrojnë muskujt e tyre, jo vetëm intelektualë, por edhe diplomatikë.

Duke kaluar, pra shpejtësia fillestare ka një rëndësi shumë të madhe në diplomaci, apo përparësia në momentet e fillimit të bisedave. T'ju kujtojmë faktin që po të mos kishim ne elemente të Federatës, ne nuk do të kishim pas luftës me lehtësi të arrijmë aty ku jemi sot. D.m.th. t'ju them të vërtetën edhe ata burra të kohës së Krahinës Socialiste Autonome kishin shumë më këmbëngulësi sesa ne sot për t'i mbajtur disa parime relevante të cilat janë më vonë shumë të rëndësishme dhe kredibile. Dhe ne hoqëm dorë pikërisht për një arsye që është bukur, kam nevojë po të kisha kohë ta elaboroj.

Tani po kaloj në hendikepin e dytë për të cilin desha të flas, duke e zbatuar gjithësi gjenialitetin e diplomacisë së Franklin. Franklin ju tregova ka qenë fizikan dhe ka zbuluar rrufepritësin dhe parimin fizik të rrufepritësit. Duke zbatuar ligjet natyrore, fundamentale, gjithëpërfshirëse në problemet diplomatike dhe sociologjike-politike, ai e përshkruan kështu: në qoftë se dikush ju sulmon juve, pra ju invadon juve në aspektin diplomatik apo politik, atëherë duhet ta përdorësh teknikën apo strategjinë e rrufepritësit. D.m.th. të bësh mënjanimin apo përtokësimin, duke e ruajtur shtëpinë tënde. Që përkthyer në gjuhën tonë popullore, në mënyrë analoge i bie që qeni i keq ta bie ujkun në torishtë.

Në këtë kontekst, desha të them faktin që Kosova në fakt e pat arritur pavarësinë, njohjen e shteteve më kredibile në botë qoftë për nga GDP-ja, qoftë për nga fuqia ushtarake dhe pasat u vulos në mënyrë kështu juridike, me GJND-në u vulos dhe pastaj në diplomat nga Harvardi, një mik i imi thotë: ju pastaj miku im mos u befasoni, për arsye se Kosovën e vutë në treg, pra i hapët kufirin. Integriteti territorial përcaktohet sidomos me kufijtë e caktuar strikt, rigjid, diplomatikë dhe legjitimë dhe ju me vullnetin e juaj, së pari filluat me negociata shumë normale teknike e të tjera, pastaj vazhduat me disa fluska, disa vija e pika që pastaj t'i hapni kufijtë dhe të labilizoni stabilitetin e juaj, pra efektivitetin e kredibilitetin e juaj edhe territorial, edhe të strukturës administrative, dhe ja ku keni ardhur në një situatë shumë të palakmueshme.

Dhe një koment të fundit para se të përfundoj është fakti që në qoftë se tani shkojmë në marrëveshje, dhe në qoftë se s'na pëlqejnë ato, me siguri siç po paralajmërohet do të jenë shumë të vështira e të tjera, atëherë tërheqja jonë siç po planifikohet, me siguri do ta hidhëronte Grenellin. Ai po thotë 'you have a great and if you miss it, you'll go back to status-quo'. Çka do të thotë kjo? How back? Mos po shkojmë ne te 1999 apo si është kjo punë?

Dhe në fund, duke përfunduar këtë, duke shfrytëzuar kohën time për diskutim, desha të bëjë një ekstrapulim hipotetik. Merreni me mend që neve tani po pajtohemi t'ia japim disa copa Serbisë atje, po pajtohemi edhe në këtë degradimin kështu kushtetutar të brendësisë, pra degradojmë strukturën tonë kushtetuese, pra me njëfarë minishteti brenda, por të jeni të bindur që nuk do të dalin aty. Ato toka apo pasuri ekstraterritoriale pas 20 vitesh do të jeni të bindur që do të vidhet, do të shëmtohet e do të savatohet Kosova edhe më keq sesa Millosheviqi. Kam dëshirë që këto të mos jenë të vërteta, por në qoftë se analizoni në mënyrë determinuese, të mençur me një ashtu analizë me dimension historike duke u bazuar.

KRYETARJA: Deputetja Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit kryetare!

Debati i dytë në fakt, me interpelancën dëgjuam, po nuk e kuptuam asgjë. Në fakt, nuk pati asnjë argument valid se pse është dashur të hiqet reciprociteti. Ndërsa, për dialog dëgjuam fjalë, të cilat një emërues të përbashkët e kanë miqtë tanë ndërkombëtarë, edhe asgjë më tepër.

Përderisa sot më 23.06.2020, i deleguari special i presidentit Trump, ambasadori Grenell, në një intervistë deklaroi: bashkë palët do të diskutojnë për çështjet ekonomike, për një mini-Shengen zonë, është një ide shumë e mirë, do të sjellë punësim në rajonal, do të sjell kapitalizmin në rajon, ndërsa do t'i shtyjë të dy palët që bashkërisht të kenë marrëveshje ekonomike dhe tregtare, pastaj çështjet politike vijnë në radhë të dytë. Përderisa, Kosova dhe Serbia po që janë armiq në politikë, asnjëherë s'kanë qenë armiq në tregti edhe në ekonomi, edhe po besoj që ambasadorit Grenell, nëse jo deri më tash, ishte dashur tash ju z. Hoti dhe të tjerët që jeni takuar me të t'ia përcillni. E para!

E dyta! Më lejoni t'ju rikujtoj nëse mini-Shengeni, ajo që sot e deklaroi z. Grenell është temë për të cilën ju asgjë specifike nuk e thatë se cila do të jetë diskutimi juaj në Uashington. Më 13 nëntor 2019 keni deklarura mini-Shengeni ballkanik është një modalitet tjetër i Unionit Doganor Ballkanik të cilin e kemi refuzuar në v. 2016. Ja disa arsye pse ky projekt nuk është në interesin e Kosovës dhe shumicës së vendeve në regjion. Ia pamundëson Kosovë të vendosë kontroll, tarifa apo reciprocitet të plotë për mallra që e çrregullojnë tregun e Kosovës, në radhë të parë ndaj Serbisë dhe Bosnjës, si dy vende që nuk e njohin Kosovën dhe e pengojnë në çdo formë. Këtë pengesë të parë e keni hequr, siç u pa edhe më herët, në fakt pas votimit të Qeverisë suaj, tri ditë më pas e keni hequr. D.m.th. argumentin tuaj të parë që keni qenë në kundërshti për mini-Shengenin, e keni larguar.

Nën dy, mundëson lëvizje të papenguar për zyrtarët serbë që vijnë në Kosovë për fushatë politike kundër shtetit të Kosovës, pa pasur mundësi të ndalen në kufi, për shkak të lëvizjes së lirë pa leje paraprake, që mundëson mini-Shengeni. Sapo e pamë të dielën, u mbajtën zgjedhjet pa asnjë problem, bile në disa harta promovuese politike, edhe Kosova ishte pjesë e Serbisë.

Nën tre, e defaktorizon Kosovën politikisht dhe ekonomikisht në kontekst të marrëdhënieve rajonale, pasi marrëveshja nënkupton delegimin e fuqisë shtetërore në mini-Shengen.

Nën katër, favorizon ekonomikisht shtetet e Ballkanit që kufizohen me shtetet anëtare të BE-së nëpërmejt politikës së taksave, ndërkaq Kosovën nuk e ka në asnjë kufi me BE-në.

Nën pesë, krijon mundësi për invazion të mallrave nga Rusia dhe vendet e zonës ekonomike ruse, për shkak se Serbia ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Rusinë.

Nën gjashtë, si vendi me popullsinë dhe me ekonominë më të madhe në rajon, Serbia përmes kësaj ideje tenton ta mbajë sa më gjatë regjionin e Ballkanit jashtë Bashkimit Evropian, në pritje të krijimit të balancave të tjera gjeopolitike me rol të shtuar të Rusisë.

Të njëjtën afërisht deklaratë e ka edhe z. Mustafa pak ditë më pas, në të cilat thotë se në cilat kuzhina po zihen projektet e Unionit Doganor të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të tregut të përbashkët të shteteve të Ballkanit Perëndimor, dhe së fundmi mini-Shengeni ndërmjet këtyre vendeve.

Do të thotë, krejt ajo çfarë ju keni deklaruar, me konfirmim të plotë, me bindje të plotë, po ju përgatitet për në Uashington, edhe ju asnjë fjalë të vetme nuk e thatë. Tash ne duhet t'i përcjellim lajmet se çfarë thotë ambasadori Grenell, se çfarë thotë ose deklaroi presidenti Vuçiq, apo ndoshta edhe çfarë deklaroi Presidenti Thaçi në mes rreshtave për të kuptuar për çka do të diskutohet. Ne mund të rrimë këtu, është ora gati 11 e natës, bëhet edhe 12, ju niseni për rrugë dhe pastaj ktheheni për të na thënë se miqtë tanë ndërkombëtarë na kanë propozuar diçka që

është kundër bindjeve tuaja, interesit kombëtar ose interesit të Kosovës dhe jo e thënë nga ne, por e thënë nga ju. Kjo ishte sa i përket deklaratës dhe agjendës së punës në Uashington sipas intervistës së fundit të ambasadorit Grenell. D.t.th. ju po shkoni atje për të diskutuar çështje ekonomike që përshin mini-Shengen zonën me të cilën do ta sillni kapitalizmin në Kosovë, me të cilin do të krijoni vende të punës dhe me të cilin do të afroheni ekonomikisht edhe në aspektin tregtar me Serbinë.

Por, anash kësaj, në debatin që edhe unë pajtohem, se këto dy debate janë të ndërlidhura, reciprociteti dhe dialogu, ju prapë nuk u përgjigjët. Cili është roli i procesit të Berlinit, i cili gjithashtu kishte të parapara projekte dhe fonde për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor? Cili është roli i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të nënshkruar në prill të v. 2016 në raport me marrëveshjet tregtare eventuale që propozohen si formacione ose si plane të reja nga administrata e Presidentit Trump? A do të diskutoni për 22 miliardë euro dëme të luftës, përfshirë, haje po i zbërthejmë vetëm dëmet ekonomike? A do të diskutoni për 2 miliard euro fonde të vjedhura të kursimit pensional të qytetarëve të Republikës së Kosovës?

Këto janë pyetje valide, për arsye se janë çështjet ekonomike, s'po i përmend më herët, i thanë më herët parafolësit çështjen e viktimave, çështjen e të pagjeturve, e shumë çështje të tjera të dhimbshme të luftës së fundit në Kosovë. Por, sa i përket çështjeve ekonomike, sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me funksionimin real të shtetit të Kosovës dhe zhvillimin ekonomik i cili po promovohet si shtyllë e takimit tuaj në Uashington, ne na intereson të dimë se çfarë qëndrimi do të mbani. Përderisa deklaratat tuaja kanë qenë në kundërshti, në fakt tepër shumë refuzuese ndaj një ideje që sot, hiç më larg se sot, ambasadori Grenell deklaroi. Apo duhet të presim prapë që dikush tjetër të vjen dhe të na thotë se çfarë do të diskutohet, kush do të diskutohet, pse është e rëndësishme, se përndryshe Kosova mund të izolohet ose mund ta humbë mbështetjen ndërkombëtare.

Kur do të kemi një plan i cili do të jetë i mirëmenduar, i planifikuar, i prezantuar? Unë nuk kam asnjë dyshim se një plan i tillë do ta merrte mbështetjen edhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfshi pozitë e opozitë, sikur të ketë kredibilitet dhe sikur të ketë qartësi. Ne sot, thash edhe një herë, mund të rrimë deri në ora 12 ose pas, ose deri ditën e nesërme, dhe nga ajo çfarë dëgjojmë në një retorikë të zbrazët, asnjë informacion shtesë nuk e morëm. Tash po presim ndoshta pak më vonë, ambasadori Grenell prapë na informon për detajet e mëtutjeshme të zbërthimit të marrëveshjes, të mënyrës se si do t'i shtyjë palët që të bashkëpunojnë ekonomikisht dhe në aspektin tregtar, përderisa e kemi një deficit gati 90 për qind me Serbinë, diku 400 milionë ata na shesin neve, ne atyre diku 35 milionë vjetore, po s'ka rëndësi, me rëndësi është të kesh mbështetjen e miqve ndërkombëtarë dhe të pajtohesh që ne bashkë mundemi edhe në mini-Shengen të pajtohemi, se na kanë thënë ashtu.

Po, z. Hoti kisha pasur dëshirë, ose është me rëndësi po mendoj edhe në funksionon tuaj po edhe të këtij Kuvendit, edhe në interesin e të gjithë qytetarëve që dëgjojnë, cili është mendimi juaj për mini-Shengenin? Ju do të shkoni për të diskutuar mini-Shengenin, këtë po e thotë negociatori, nuk e thash unë. Është deklaratë e cila sot është në rrjetet sociale, deklaratë bile jo e shkruar, por e folur. Kështu që mund ta dëgjoni ambasadorin Grenell duke i përsëritur këto fjalë shumë qartë dhe pastër mbi pritjet e tij nga takimi juaj në Uashington D.C.

KRYETARJA: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit ,kryetare e Kuvendit!

Unë mendoj që isha mjaft i qartë në deklarinimin që bëra. Asnjëherë s’kam ndërruar asgjë qëndrim, as për mini-Shengenin e as për një temë, ndonjë temë tjetër që po i përmendni. Unë ju lus të mos krijojmë asnjë situatë hipotetike edhe të ndërtojmë skenarë çka nëse.

Ju më keni ftuar të raportojë në Kuvend për qasjen tonë për dialogun. Unë ju tregova, platforma jonë për dialog është Kushtetuta e vendit. Kosovën në dialog e përfaqësoj unë. Besoj që një dakordim ka mes grupeve parlamentare që të nxirret një rezolutë këtu në Kuvend, ku Kryeministri i vendit raporton rregullisht para dhe pas çdo raundi të dialogut. Kaq! Kjo është.

Besoj ju e dini sikur unë se si është nënshkruar ai edhe si është mbrojtur shteti i Kosovës kur është nënshkruar ajo marrëveshje. Është djegur Prishtina për atë, për një marrëveshje që për herë të parë që është nënshkruar në Brusel ka referenca kushtetuese. Edhe për atë, edhe për demarkacionin e dini ju shumë mirë, se keni qenë anëtar i Komisionit shtetëror, për dy-tri vjet për marrëveshjen e demarkacionit. E dini ju për çka po flas.

KRYETARJA: Replikë, Mimoza Kusari. Regjia, fjalën Mimosës!

MIMOZA KUSARI-LILA: Zoti Hoti,

Nuk po dua të hyj në replikë në raport me sa i keni ndërruar qëndrimet ose si i keni ndërruar qëndrimet. Një të tillë e keni pasur për reciprocitetin, ku ka qenë tepër e qartë. Në fakt, një të tillë ju lexova, ku ju keni deklaruar se nuk mund ta pranoni mini-Shengenin se ju parandalon që të përdoret tarifa ose reciprociteti për mallra që e çrregullojnë tregun e Kosovës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, gjë të cilën e keni hequr pa asnjë kusht apo arsye shtesë. D.m.th. kjo është vetëm për nëntorin e v. 2019 e ne tash jemi në muajin qershor 2020. Mos të flasim edhe për fushatë e të tjera. Por, nuk po flas me spekulime. Nëse doni, ju lëshoj edhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dëgjojeni intervistën e ambasadorit Grenell. Ai deklaroi se në Uashington do të diskutoni për mini-Shengen.

Në rast se ju thoni se ju do të mbani të njëjtin qëndrim në kundërshti me mini-Shengjen Shengen, nëse. Dakord, zonë ekonomike me këto çështje. Jo vetëm pak, shkon pak më larg. Shih, shihe! Jo s'po e shoh, por po e dëgjoj. Po i përmend edhe disa attribute. Mua po më intereson ta di shumë e thjeshtë prej jush, cili do të jetë qëndrimi juaj? Ju keni ndërruar qëndrim z. Hoti. Nuk mund të na jepni. Keni ndërruar qëndrim për çështje politike, për marrëveshje të koalicionit? Cilën? A po doni prapë të ju deklarojmë? Keni thënë se asnjë qeveri nuk është stabile nëse varet nga votat e Listës Serbe. E keni thënë shumë herë, e keni përsëritur, e keni ripërsëritur. Keni dalë keni kërkuar vota për reciprocitet e të tjera e të tjera.

Tash deklaroheni që për marrëveshje ekonomike të natyrës çfarëdo që mund të ju prezantohet për të cilin asnjë informacion nuk e shpalosët, qoftë Shengen, qoftë Shezgen, në cilëndo natyrë, ose në cilindo format, ju shkoni atje e thoni unë e kam Kushtetutën. Kushtetutën e kemi të gjithë. Kushtetuta është dokumenti bazik i shtetësisë së Kosovës, por nëse zëbërthehet pjesëmarrja juaj në dialog.

KRYETARJA: Ministri i Drejtësisë e ka fjalën.

MINISTRI SELIM SELIMI: E nderuara kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Mendoj që është duke u bërë një gabim i shtrembërimit të fjalëve të z. Grenell. Nëse i referoheni intervistës së tij në News Max TV, ai përmend Shenzhen, zonën Shenzhen e cila i punënon 40 milionë punëtorë. Është një qendër e madhe financiare, inovative, edhe e cila është krijuar në vitin 1980. Përderisa zona Shengen është një komunë në Luksemburg që në vitin 1985 është arritur një marrëveshje për kalimin e lirë të kufirit etj. Mendoj që është një gabim logjik.

Kur i referohet zonës Shenzhen, unë gjatë asaj interviste e kam kuptuar që plani është që të bëhet një impuls i madh ekonomik, së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e tjerë, diçka e ngjashme sikur plani Marshall, përderisa mini-Shengeni apo Shengeni i cili është shtrembëruar si fjalë kohëve të fundit, nuk ka të bëjë me atë deklaratë. Por, edhe Kryeministri Hoti edhe delegacioni i tij jemi zotuar që nuk do të hyjmë në këso negociata të mini-Shengenit apo çfarëdo lloj mutanti të Shengenit që ekziston.

Pra, sa për korrektësi, Shenzhen është një zonë ekonomike në Kinë, e cila është bërë në v. 1980, i punëson 40 milionë, është qendër e madhe financiare. Shengen është një komunë në Luksemburg e cila ka të bëjë me një marrëveshje për lëvizjen e lirë.

KRYETARJA: Deputetja Mimoza Kusari, replikë! Regjia, mikrofonin deputetes!

MIMOZA KUSARI-LILA: Mirë! Sa i përket edhe z. Selimi, edhe z. Hoti...

Mua po më intereson të di prej anës suaj, një zonë, edhe ajo e cila i ka 40 milionë në Kinë, por që në Kosovë e ka vështirësi midis Kosovës dhe Serbisë. A parashih pjesën veriore të Kosovës? Në cilën pjesë veriore të Kosovës? Cili do të jetë? Nëse është në pjesën veriore, cili është statusi i minierës së Trepçës, cili është statusi i Ujmanit? Çfarë marrëveshje do të ketë Kosova dhe Serbia në një zonë ekonomike? Prapë asgjë nuk e liron me 22 miliardë euro dëme të Kosovës. Nëse është bërë shtatë miliardë ose sado që flitet për investime, çka do të ndodhë prapë, me gjithë dëmin që Kosova e ka pësuar prej Serbisë dhe a do të jetë kjo formë e harresës së atyre dëmeve, e nëse fillojmë me harresë të dëmeve ekonomike, atëherë fillojmë me harresë edhe të dëmeve të tjera në njerëz.

Por, ju nuk dhatë as edhe një informacion më të vogël në raport me përmbajtjen, në raport me formacionin, në raport me qëndrimin. Nëse flasim për komunat e veriut, ose zonën midis Kosovës dhe Serbisë, flasim për komunat të cilat kanë qenë subjekt i trajtimit edhe të një procesi tjetër. Edhe mënyra se pse mendoni që me Serbinë ne po diskutojmë për një zonë e cila ndodhet në territorin e Kosovës dhe i jep Serbisë kompetenca, si mund të jetë marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë nëse është në territor të Kosovës. d.m.th. është riorganizim i hapësirës industriale brenda Kosovës në marrëveshjen e Serbisë.

Nëse e kemi veriun e Kosovës, komunat e Kosovës, atëherë pse duhet ta kemi Serbinë në këtë pjesë? E kemi popullatën serbe, por jo shtetin e Serbisë. A nëse kjo zonë shtrihet edhe në territorin e Republikës së Serbisë, atëherë na tregoni! Por krejt këto çka ju po i thoni, është zbërthim, edhe në fakt është ofendim për të gjithë ne, të thuhet vetëm kushtetutën e kemi. Ok! S'qenka mini-Shengeni, qenka Shenzeni me 40 milionë të punësuar në Kinë. Sa do të ketë? Jo, Jo! Apsolutisht, po! Cilat janë specifikat e organizimit gjeografik edhe administrativ të një hapësire të tillë?

KRYETARJA: Kryeministri e ka kërkuar fjalën edhe një herë.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Unë prapë po them që kam përshtypjen po ngremë hipoteza znj. Kusari. Edhe po kërkojmë që ne t'i testojmë hipotezat që po i ngrehni këtu. Jo, jo. Ku po dalin këto teori? Ku po i sheh këto? Kur thash që në këtë takim në Uashington se do të fillojmë me një agjendë ekonomike që i jep shtysë dialogut, kjo nënkupton letrat e qëllimit të mirë që janë nënshkruar më herët në Minhen nga përfaqësuesit e Serbisë dhe nga përfaqësuesit e Kosovës për projekte të mëdha infrastrukturore, që i sigurojnë Kosovës qasje në rrjete infrastrukturore hekurudhore, edhe rrugore. Edhe projekte të tjera. Me këtë do ta nisim procesin e dialogut. Edhe mandej do të lëvizim më tutje. Edhe sapo të kthehemi prapë do të jemi këtu përpara juve t'ju tregojmë çka kemi biseduar, çfarë qëndrimi kemi mbrojtur. E dini qëndrimin tonë për mini-Shengenin ballkanik, edhe për zonën ekonomike, edhe për të gjitha këto tema. Edhe nuk kam për të ndërruar qëndrim për këto tema.

KRYETARJA: Kundër-replikë, deputetja Kusari-Lila!

MIMOZA KUSARI-LILA: Atëherë z. Hoti, m'u përgjigj në pyetjen që s'më jeni përgjigjur herën e parë. Me çfarë dokumenti keni për të nënshkruar. Këto janë dokumente që në fakt janë nënshkruar në Berlin. Pala kosovare është drejtori i rrugëve, i infrastrukturës dhe zhvillimit, ndërsa Serbia e ka Qeveria e Republikës së Serbisë. D.t.th. ne jemi në nivel të drejtorisë, Serbia është në nivel të qeverisë. Këto janë dokumente me nënshkrime të Republikës së Serbisë dhe të përfaqësuesit të stafit civil të Ministrisë. Këto janë letrat e qëllimit që janë nënshkruar në Berlin, a do të vazhdoni me nënshkrime të njëjta?

KRYETARJA: A dëshironi të përgjigjeni? Kryeministri.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Ato letra janë nënshkruar si letra të qëllimit, ku Qeveria e Kosovës, shteti i Kosovës ka marrë zotime për ndërtimin e autostradës edhe hekurudhës deri në pikën kufitare, siç ka marrë zotim pala serbe për ndërtimin e hekurudhës edhe autostradës deri në pikën kufitare. Personi që i ka nënshkruar ka marrë autorizim nga qeveria paraprake, edhe lexojeni mirë me çfarë autorizimi i ka nënshkruar ato letra të zotimit.

KRYETARJA: Deputeti Eman Rrahmani e ka fjalën.

EMAN RRAHMANI: Të dashur qytetarë!

E nderuar kryetare,

E nderuar nënkryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria ilegale e Hashim Thaçit e varur nga secili deputet i Listës Serbe dhe me mbështetjen më të vogël popullore që ka pasur ndonjëherë ndonjë Qeveri së bashku me Presidentin, publikisht ka deklaruar se e ka për obligim formimin e Zajdenicës në Kosovë. Këtë Qeveri ilegale të Thaçit të cilës po i shërben z. Hoti, kanë paralajmëruar takim me palën serbe për 27 qershor.

Çka keni obligim përveç Zajendicës? Ndarjen e Kosovës, faljen e krimeve të luftës që ka bërë Serbia, faljen e dëmeve të luftës apo çfarë? Në çfarë borxhi keni hyrë ju z. Hoti që po i shërbeni Presidentit dhe Lisëts Serbe? Për Presidentin të gjithë e dimë që e ka nga frika për të shpëtuar veten nga Gjykata Speciale, po ju çfarë keni? Çfarë keni bërë, nga kush po frikësoheni? Kujt po i shërbeni?

Sot, oferta për Serbinë duhet të jetë kërkesa e borxhit që i ka Kosovës dhe popullit të saj. Duhet t'ia renditim të gjitha, duke filluar nga 12 mijë civilë të vrarë, 20 mijë gra e vajza të dhunuara, 1 647 të pagjetur, 130 mijë shtëpi të rrënuara, 1 200 artefakte të plaçkitura, depozitat bankare, fondin pensional, degët e ndërmarrjeve tona shoqërore që i kemi në Serbi. Madje edhe të

dëbuarit nga trevat e tyre, e që janë mbi 800 mijë persona të moshave dhe gjinive të ndryshme. Kjo është fatura e Serbisë, madje minimale. Këtë faturë duhet t'ia paraqesim kudo e kurdo.

Unë sot këtu me vete kam raportin e vlerësimit të dëmeve që i ka bërë Serbia dy ndërmarrjeve shoqërore, asaj të Trepçës dhe ish-PTT-së së Kosovës. Tani do t'jua sjell që t'i keni me vete si dëshmi për t'i kërkuar Serbisë dëmshpërblimin për këto dëme. Raportet janë të faktuara nga ekspertë të fushave dhe të detajizuara për të dy ndërmarrjet.

Rekapitulimi i dëmeve dhe kompensimeve që duhet t'i paguhen ish-PTT-së së Kosovës nga ana e Serbisë për periudhën prej 12. 9. 1990 deri më 12. 6. 1999 janë këto: kompensimet për pagat e punëtorëve të përjashtuar 164 milionë e 591 mijë e 500 marka gjermane. Kompensim për shfrytëzimin e amortizimit 64 milionë e 116 mijë e 800 marka gjermane. Kompensim për një pjesë të fitimit 88 milionë e 940 mijë e 200 marka gjermane. Për shkatërrimin e objekteve dhe kapaciteteve 101 milionë e 511 mijë marka gjermane. Për pengesën në mosrealizimin e programit të zhvillimit të PTT-së së Kosovës 783 milionë e 770 mijë marka gjermane. Pra gjithsej, vetëm për PTT-në e Kosovës, pra ish-PTT-në, janë 1 miliard e 202 milionë e 929 mijë e 500 marka gjermane.

Në vazhdim do të paraqesim dëmet e organizatave në kuadër të Trepçës, të cilat kanë pasur si aktivitet prodhimin apo përpunimin e metaleve. Për vlerësimin e dëmeve është përfshirë periudha prej v. 1989 gjer në vitin 1999, kurse vlerësimi i dëmeve është bërë në bazë të këtyre parametrave. Dëmet e shkaktuara si pasojë e përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna, mospagesa e pagave dhe kompensimit të tjera, janë 253 milionë e 579 mijë e 675 euro. Dëmet e shkaktuara në pajisje, pajisje të vjedhura dhe të shkaktuara për shkak të mirëmbajtjes joprofesionale, janë 137 milionë e 318 mijë e 504 euro. Dëmet në infrastrukturë 73 milionë e 69 mijë e 274 euro. Dëmet me fitim të humbur, pra dëmet e llojeve të ndryshme, 555 milionë e 500 mijë e 259 euro. Vlera totale e dëmeve të shkaktuara nga Serbia në Trepçë është 1 miliard e 19 milion e 467 mijë e 712 euro.

Mbi 22 miliard euro është llogaritur dëmet e luftës që ka shkaktuar Serbia nga viti 1989 deri në vitin 1999. Serbia na ka shumë borxhe dhe duhet të kërkojmë borxhin. Serbia na ka borxh miliarda. E kemi obligim ndaj dëshmorëve, martirëve ndaj mbi 1333 fëmijëve të vrarë që t'i kërkojmë këto borxhe. Andaj, z. Hoti, bëjeni këtë, kërkojeni llogarinë për dëmet e shkaktuara nga Serbia. Unë tash do t'jua dhuroj këto raporte e besoj do t'i keni me vete edhe atje ku do të shkoni.

KRYETARJA: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI: Gjatë këtyre dy javësh kemi punuar duke i sistematizuar krejt studimet, analizat, dokumentet e qeverive paraprake për procesin e dialogut. Evidenca që

kemi ne tregon që gjatë periudhës 1990 deri 1999, Produkti kombëtar i humb i Kosovës është 11,9 miliardë dollarë, humbje në investime 5.7 miliardë dollarë, në Trepëçë humbje 700 milionë dollarë. Në KEK 1,5 miliard humbje të investimeve. Dëmet në asetet fikse të bankave 226,7 milionë dollarë. Kursime të grabitura 320 milionë dhe grabitja tjetër e dokumentacionit të përcjellë me të. Dëmet në sistemin buxhetor 3.6 miliardë euro. Paga të humbura 5.4 miliardë. Shtesa të fëmijëve janë 257 milionë. Dëme në sistemin pensional 820 milionë. Të evidentuara të gjitha këto. Dëmet e luftës: 76 për qind e familjeve që kanë pësuar dëme. 78 për qind e familjeve kanë qenë të zhvendosura, 40 për qind e fondit të banimit ka qenë e papërdorshme, vetëm 20 për qind ka mbetur e padëmtuar. 75 deri 80 për qind të pajisjeve shtëpiake të plaçkitura. 50 për qind zvogëlim i fondit të bagëtisë. 42 për qind të familjeve të plaçkitura gjatë depërtimit. 92 për qind të ndërmarrjeve dhe bizneseve private që kanë pësuar dëme. Rënie e buxhetit të familjeve për rreth 50 për qind.

Pra, janë dëme gjatë viteve të '90-ta dhe janë dëme gjatë luftës, të sistemuara si 'position papers', studime për secilën temë, veç e veç. Në një dokumentacion kaq të papërgatitur. Tash, në këshillin e ekspertëve për dialog brenda zyrës së Kryeministrit do të sistematizohen të gjitha këto dokumente dhe këto do të diskutohen si pjesë e procesit të dialogut pas njohjes reciproke.

Pse po insistojmë kaq shumë që e para të jetë njohja reciproke, edhe mandej ne po i adresojmë të gjitha këto çështje në përputhje me konventat ndërkombëtare? Sepse vetëm atëherë kështu mund t'i zgjidhim.

Nuk kemi qëndruar kot gjatë këtyre ditëve. Kemi mbledhur gjithë punën që është bërë në qeveritë paraprake, edhe jemi të gatshëm të hyjmë në këtë proces. Po ju nëse ngrehni hipoteza të ndryshme edhe kërkonë që unë t'i vërtetoj prej kësaj foltoreje, nuk mund t'i bëj ato.

Unë po raportoj para juve për qasjen tonë, për përgatitjet që kemi bërë deri tash. Sapo të kthehem nga udhëtimi prapë do të jem para juve për t'ju informuar në detaje cilat janë propozimet që na kanë dalë përpara në tavolinë dhe cili është qëndrimi jonë që kemi mbajtur dhe që do të mbajmë për ato tema? Udhëzues për neve, platformë për neve është Kushtetuta e Kosovës. Nga aty derivon gjithçka.

KRYETARJA: Deputetja Floretë Zejnullahu e ka fjalën.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot për dialogun po flasim përballë një Qeverie të ndërtuar nga një marrëveshje e pashpjegueshme dhe politikisht e paarsyeshme. Dialogu Kosovë - Serbi është tema jonë ditore

tash e 21 vjet. Kosova përballë Serbisë ka fituar në secilin rast. Si deputete e Partisë Demokratike jam e lumtur që këto fitore kanë ndodhur fillimisht për vendin dhe së dyti janë udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës.

Qytetarët i kanë të freskëta qëndrimet tuaj kundër dialogut dhe kundërshtimet e dëmet që i keni sjellë Kosovës për këtë proces. LDK dhe Vetëvendosje së bashku! Dialogu është përdorur nga ju për të thelluar kundërshtimet mes njerëzve të thjeshtë dhe vetë skenës politike.

Për dialogun nuk mund të na flasë sot Vetëvendosje e cila kishte frikë të dialogonte, nuk mund të flasë Vetëvendosje e cila në vazhdimësi ka fyer luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila më mirë se kushdo ka ditur të dialogojë me Serbinë.

Për dialogun nuk mund të flasë as LDK, e cila këtë proces e ka përdorur siç i ka konvenuar për politika ditore për disa vota. Ju rikujtoj që Qeveria Kurti-Hoti nuk ka pasur fare politikë të jashtme dhe se Kurti-Hoti kanë qenë të fokusuar t'i godasin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ambasadorin, njëherësh përfaqësuesin special për dialogun Kosovë-Serbi, z. Grenell. Pasi fatet e Qeverinë Hoti ishin të planifikuara nga dëshira e madhe për pushtet, nga lakmia për protagonizëm, duket se kështu do të vazhdojë qasja e kësaj Qeverie edhe për dialogun. E vërteta është se ne kemi një Kryeministër formal, por kjo Qeveri në të vërtetë ka disa kryeministra që duket se po udhëheqin dhe qeverisin me të. Numëroni zëvendëskryeministrat e ministrit aktual dhe në fakt do të shihni nga një kryeministër real.

Si deputete e re, ndihem shumë keq kur qytetarët e vendit, të cilëve për fat të keq, ju LDK së bashku me Vetëvendosjen edhe në kohë pandemi ju sollët vetëm probleme dhe për asnjë moment nuk u gjendët pranë tyre. Në vend që të ndihmoni bizneset që po falimentojnë si pasojë e krizës ekonomik, në vend që t'i ndihmoni familjet që jetojnë në përkujdesje modeste sociale, ju në rend të parë kishit luftën për pushtet. Ju nuk ishit në gjendje të prezantoni një projekt konkret për zhvillim ekonomik e punësim e mos të flasim për investime në arsim, në shëndetësi e drejtësi. Madje këtë të fundit vetëm e sfiduat. Edhe sot ju nuk keni një plan për dialogun. Sot qytetarët e vendit, të rinjtë, studentët, punëtorët që kujdesen për pastrim, zyrtarët e administratës, infermierët, mjekët, farmacistët, policët, minatorët, mësuesit dhe profesorët, të gjithë pa dallim, mbi të gjitha të papunët, në këtë vend e shohin qartë luftën tuaj që kishit për pushtet. Kjo duket qartë më shumë se kurrë edhe sot kur po flasim për përballjen tonë me Serbinë.

Ju nuk u ofruat asgjë njerëzve të thjeshtë të këtij vendi dhe ju nuk jeni garancë që këtë do ta bëni as edhe në këtë rast. Dialogu me shtetet fqinje lidhet me njerëzit e vendit tonë, me fatin e shtetit dhe të ardhmen tonë si vend në arenën ndërkombëtare. Por kjo nuk dukeet kur dëgjojmë këtë Qeveri e as atë që iku para disa javësh.

Qytetarët e Kosovës e kanë parë qeverisjen e LDK-së edhe të Vetëvendosjes. Ju kemi parë të qeverisni edhe bashkë në nivel lokal dhe tani edhe në nivel nacional. Qytetarët e vendit ju kanë parë edhe sa të dobët keni qenë edhe kur keni dialoguar në emër të Kosovës. Këtë do ta shohim edhe tash, për fat të keq. Por mirë që kemi miq si Amerika që nuk na lënë të dështojmë.

Qeveria LDK dhe Vetëvendosje dezertori si pasojë e paaftësisë për të menaxhaur me pandeminë, me ekonominë e vendit dhe me dialogun. Ju Vetëvendosje dhe LDK nuk guxuat të merreni me tema të ndjeshme të vendit sikurse dialogu me Serbinë. Ju keni rrezikuar miqësinë e shenjtë me SHBA-të dhe këtë e keni bërë duke qenë bashkë në Qeveri.

Si njëra nga përfaqësueset e qytetarëve të vendit, shpresoj që njëherë e përfundimisht të kemi një epokë të re të stabilitetit dhe të mirëqenies për vendin tonë dhe tërë rajonin. Si deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, parti që do të fitojë zgjedhjet e ardhshme, kurdo që ato do të mbahen, i rikujtoj Kryeministrit aktual, që marrëveshja me Serbinë duhet të garantojë njohje dhe anëtarësim të Kosovës në OKB.

Kosova dhe ne qytetarët e saj jemi me fat që si vend në të gjitha fazat e shtetndërtimit kemi pasur mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe besoj që së bashku do t'i japim qytetarëve të Republikës së Kosovës të ardhmen që ata e meritojnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën! Deputet, mirëkuptimin tuaj i kërkojmë, sepse shumë e gjatë lista, edhe derisa ju erdhi radha. Me lartelë të Teutës. Krejt grupi parlamentar sot kartelën e Teutës e keni shfrytëzuar. Faktikisht me kartelë të Times qenka.

Daut Haradinaj, fjalën!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

E reduktova fjalën, meqenëse u bë vonë. Edhe ashtu po e shoh edhe deputetët janë lodhur sot gjatë gjithë ditës. Më vjen mirë që s'jeni lodhur. Mos u lodhni edhe pak!

Një fakt i pamohueshëm është se Kosova ka dialoguar të paktën dhjetë vjet dhe një pjesë e madhe e këtyre marrëveshjeve nuk janë se kanë prodhuar ndonjë produkt në të mirë të Kosovës. Aq më tepër, dialogun e udhëhequr nga Mogherini, të gjithë e dimë qëndrimin e saj, e cila ka qenë tepër e qartë që ka anuar rreth ndarjes së Kosovës. Pikërisht aty është bllokuar dialogu dhe është kërkuar që në tavolinën e dialogut të udhëhiqet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, kemi pasur pothuajse dy vjet e gjysmë dhe nuk kemi pasur asnjë marrëveshje me Serbinë, deri tash në këto rrethana të reja.

Të gjithë po pajtohem që ka ardhur koha, dikush tha para a po rifillon dialogu a po fillon, unë mendoj që ky dialog është drejt përmbylljes. Por, kjo përmbyllje a do të jetë me njohje

reciproke? Pra, kjo do të jetë pyetja. Në rast se dikush mendon t'i besojë Lajçakut më shumë sesa kryediplomatit amerikan në këtë temë, mendoj që e kanë gabim. Por, krejt çka kisha thënë është, edhe Partia Demokratike, edhe Vetëvendosja, është moment historik që të jenë në tavolinën e dialogut, sepse ajo marrëveshje cialdo që të jetë, qoftë e mirë, e që unë besoj që është, le të bëhemi të gjithë fitues, sepse kur ishte në pyetje krijimi i ushtrisë, ishim unik, edhe pse kishim zëra kundër prej faktorëve bukur relevantë. Ne sot e kemi ushtrinë akt të kryer. Ishim unik në Trepçë, e kemi akt të kryere. Shumë vendime kur kemi qenë unikë, janë kryer. Prandaj, thirrja ime publike është edhe për z. Kurti, edhe për z. Veseli, është moment historik që t'i japim përkrahje ekipit tonë shtetëror që ta kryejë detyrën e vet dhe ta përmbyllim këtë kapitull historik me Serbinë me njohjen reciproke.

Ky Kuvend ka nxjerrë rezoluta e rezoluta që e ka autorizuar Qeverinë e Kosovës për ta kryesuar dialogun. Sot Kryeministri Hoti e ka shumicën, e cila ia ka dhënë besimin pikërisht në këtë Kuvend. I njëjti rast ishte para dy muajsh për z. Kurti. Pavarësisht që z. Kurti deri diku nuk u gjet mirë në raport me taksën dhe e pati një bllokadë prej aletatëve tanë. Pra sot është një situatë e re, është një situatë reale dhe ne të gjithë bashkë duhet t'i japim mbështetje delegacionit tonë shtetëror dhe të përfundojë ky kapitull njëherë e përgjithmonë në favor të Kosovës.

Në rast se jemi ne unikë do të dalim fitues. Por, në të njëjtën kohë, nuk duhet harruar, secili delegacion shtetëror ka për të ardhur këtu për të raportuar dhe për t'i dhënë llogari Kuvendit të Kosovës. Çfarëdo marrëveshje që do të arrihet do të përfundojë po ashtu prapë në Kuvendin e Kosovës. Pra ne jemi dora finale e çfarëdo marrëveshje që do të arrihet në të ardhmen e afërt. Kaq kisha. Faleminderit shumë!

KRYETARJA: Zëvendëskryeministri Selmanaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër

Të dashur ish-kolegë deputetë,

Në fakt unë dua të them disa gjëra, sepse kam përshtypjen se po futemi në labirithin e instrumenteve që i kemi përdorë si politikë, por po largohemi prej substancën themelore. Ku është substanca themelore? Unë mendoj që substanca themelore është kriza e fuqizimit të subjektivitetit tonë ndërkombëtar si shtet.

Unë po jua kthej në rikujtesë që Kosova e ka shpallur njëherë pavarësinë në v. 1991. Ka pasur referendum për këtë punë. Por, normalisht që s'ka pasur njohje ndërkombëtare për këtë proces dhe më pas u detyruam ta rishpallim më 2008. Për fatin e mirë, me miqtë tanë ndërkombëtarë arritëm ta konsolidojmë deri në një shkallë shtetësinë e Kosovës. Morëm mbi 100 njohje afërisisht. Filloi anëtarësimi në shumë organizata ndërkombëtare dhe nga ky trend pozitiv i

fuqizimit tonë ndërkombëtar të subjektivitetit tonë ndërkombëtar u stopuam. Dhe të them nga ky hov i joni i fuqizimit filluan të ndërmarrin masa dhe veprime të cilat i ndalin dëmet eventuale që mund të na shkaktohen dhe u paraqit taksa. Taksa nuk na doli si instrument i cili do të ndikonte në fuqizimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtar, por jo, për t'i ndalë dëmet eventuale të cilat mund të na shkaktohen, sepse filluan të na bien njohjet. Filluam të mos anëtarësohemi në organizma ndërkombëtarë. D.m.th. Kosova filloi një fazë të stagnimit dhe më pas u shtrua edhe si opcion reciprociteti. Tashti, unë reciprocitetin e kuptoj si masë të cilat shtetet e marrin si masë ekonomike fillimisht, por për qëllime politike të caktuara, dhe unë nuk jam i sigurt që ne si shqiptarë të Kosovës, kemi realizuar ndonjë qëllim politik pa ndihmën e ndërkombëtarëve, pa ndihmën e miqve tanë.

Tashti, nga kjo fazë pak njihemi. Ne po provojmë që të futemi edhe me tutje në faza të tjera të stagnimit pa miqtë tanë ndërkombëtarë. A mund të ecim tutje, dhe mendimi im, dhe tash si pjesë që Qeverisë, mendoj që jo.

Ne jemi shumë koshient si Qeveri e Kosovës që kjo temë nuk është e lehtë, është ndër temat më të rënda që i ka pasur Kosova në 20 vitet e fundit. Por, kemi bindjen që kur ia kemi dalë bashkë më 1991, ia kemi dalë bashkë më 2008, mund t'ia dalim bashkë edhe tani.

Po diskutoni dhe po thoni që nuk ka platformë. Unë kam përshtypjen që ju jeni befasuar nga qartësia e qëndrimit tonë. Keni menduar që mund të jemi më konfuz dhe më pas mund të na sulmoni. E vetmja platformë për Qeverinë e Kosovës është Kushtetuta.

Parimet themelore të negociatave tona janë; nuk ka prekje të territorit, nuk prekte unitariteti i shtetit dhe zgjidhja do të jetë nuk kuadër të frymës kushtetuese. Këto janë parimet bazë tonat dhe s'ka parime të tjera.

Unë po e shoh që s'po na besoni, po unë po ju them me bindje që, aq sa e njohë këtë kryeministër tonë që e kemi, jemi të vërtetë, jemi të sinqertë para jush. Na besoni. Në rregull, mund të keni arsye shumë për shkak të kaluarës. Mund të keni arsye shumë se ka pasur dilema të mëdha, po ne jemi ata që kësaj radhe po e themi të vërtetën. Nuk po duam që problemet t'i lëmë nën tepih, po duam të ballafaqohemi me to, sado të rënda që janë, sado të vështira që janë.

Nëse ka diku thika e gërshërë, do të shkojmë që t'i shohim. Do të shkojmë që ta shohim se a ka gjak diku, a ka shampanjë diku, do të shkojmë që ta shohim. Dhe, në momentin kur e shohim, do të vijmë këtu dhe do t'u themi: Po është e vërtetë, paska thika, paska gërshërë dhe Kosovës po i përgatitet e keqja, por do tua themi juve këtu dhe s'kemi për ta fshehur.

Ne po mendojnë që duke u dalë në ballë proceseve, bëjmë zgjidhje për Kosovën.

Unë po e shoh, po them se edhe çështja e anëtarësimit. Kemi aplikuar për UNESCO, kemi dështuar një herë. Kemi aplikuar për së dyti, kemi dështuar dy herë. Kemi vendosur që të aplikojmë në Interpol, kemi dështuar, dhe pse kemi dështuar? Të mos mendoni se për shkak të pazotësisë sonë. Jo, unë mendoj që për shkak të mosangazhimit aq sa duhet të partnerëve që na kanë ndihmuar në çlirim, në konsolidim të shtetit të Kosovës dhe në fuqizim të mëtutjeshëm tonin. Pa ta, nuk mundemi.

Nëse ne themi sot, po e shtymë aplikimin deri më datë 27, dhe nëse dikush thotë këtui; jo aplikoni para datës 27. Jo hipokrizi, po është të tallesh me popullin tonë. Ne çfarë po kërkojmë, jepni shanse Kosovës.

Ne kemi vendosur që t'i dalim në ballë këtij procesi të rëndë, shumë të rëndë, por siç duket fati i LDK-së që nga krijimi i saj qenka që të ballafaqohet me tema të rënda, madje me temat më të rënda për Kosovën.

As nuk po themi po e delegojmë të dikush tjetër këtë përgjegjësi, as nuk po themi prej kësaj përgjegjësie. Po i dalim në ballë. Tashti juve po ju pengon pse dikush ka guxim t'i dalë në ballë, por ju e keni gabim. Respektojeni këtë.

Unë po them edhe një herë, po e përsërisë për të dytën herë; kemi dalë mirë '91-ën, se kemi qenë bashkë, kemi dalë mirë në 2008-ën, se kemi qenë bashkë. Bashkoheni të dalim mirë edhe tani, sepse nuk kemi problem me njëri-tjetrin, kemi problem me dikë tjetër.

Për neve nuk është problem Vetëvendosje e as PDK-ja e as askush tjetër këtui, problem e kemi Serbinë. Andaj, unë jam i sigurt që të vetëm as çlirimin, por as këtë përmbyllje s'mund ta bëjmë.

Mirë pas 10 viteve të angazhimit të dialogut, e kemi tash një angazhim shumë të madh nga një shtet më miku i yni, për të cilin historia jonë e re dhe jo vetëm historia jonë e re, po edhe nëse i kthehemi edhe 100 vjet përpara, flet se fati i shqiptarëve është lidhur goxha shumë me mbështetjen e SHBA-ve. Prandaj po themi, nuk kemi arsye që të mos besojmë.

Ne po themi, po shkojmë mbi parime shumë të shëndosha të negociatave, po shkojmë atje, dhe nëse eventualisht ka diçka që s'na pëlqen neve, vijmë bisedojmë, i kthejmë masat e reciprocitetit...Urdhëro? Nuk po dua që të bashkëbisedojmë kështu, por unë po flas se unë po e shoh që ka pasur për një kohë të gjatë këtui një mungesë, një mungesë të besimit reciprok dhe të një vërtetësie me njëri-tjetrin. Një Qeveri tjetër e keni përballë, të më besoni që e keni një Qeveri tjetër përballë.

E keni një kryeministër që po është në gjendje t'ju thotë gjithçka që është i gatshëm ta bëjë për këtë vend. Pra, ta përmbyllë një konflikt shekullor. Mund edhe të mos besoni, por çka po them

unë, besoni të vërtetës, besoni të drejtës sonë si shtet, të mos i besoni individëve, po besoni të drejtës sonë si shtet. Kemi të drejtë që ta bëjmë këtë.

As nuk po themi që po ikin, sepse çka është edhe tjetra e vërtetë, nuk po i shkruajmë letra as zv/presidentit amerikan, por po shkojmë që ta shohim atë. Nuk po japim intervista në “The Guardian”, ku themi se ky emisar i SHBA-ve është dorë e Serbisë, po shkojmë që të takohemi me të. Pra, duam që të ballafaqohemi me këtë. Të na besoni, jepnani kohë dhe do të bindeni edhe ju.

Krejtësisht në fund unë po them, sepse nuk po dua që ta zgjasë më shumë, ta shndërrojmë kakofoninë në bashkëpunim. T’i ofrohem njëri-tjetrit, sepse ky vend ka nevojë më shumë se kurrë.

Ne po themi, Kushtetuta e Kosovës për neve është akti themeltar i shtetit dhe më e rëndësishmja. Edhe tri ditë, po themi se nuk po aplikojmë në organizma ndërkombëtarë, sepse nuk po duam që të bëjmë shou për storie të dështimit, dhe me pas Serbia të thirret në sukseset e saj. Ne po themi, jo. Po e suspendojmë tri-katër ditë Kushtetutën, por po besojmë në angazhimin tonë.

Unë po ju lus edhe një herë të gjithëve, të ecim bashkë, kemi shumë tema për të cilat mund të kemi divergjenca për zhvillim ekonomik, për mirëqenie në këtë vend, për edukim e për gjithçka tjetër.

Shteti i Kosovës është mbi LDK-në, mbi Lëvizjen Vetëvendosje, mbi PDK-në dhe mbi secilin. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Hekuran Murati e ka fjalën.

HEKURAN MURATI: Zoti Selmanaj, unë e kuptoj që është pak vonë e jemi lodhur, por kjo s’do të thotë se e kemi humbur kthjelltësinë e mendimit dhe mund të na thuash çmos këtu dhe të vish e të thuash që ka qartësi rreth bisedimeve, kur as vet ju nuk keni agjendë.

Unë e pyeta më herët z. Hoti, i thashë se cila është agjenda në Uashington? Cila është agjenda në Bruksel? A është e vërtetë që do takoni Vuçiqin në Bruksel? Por, nuk mora përgjigje.

Po ashtu pyeta, me leje të kujt po shkoni në këto bisedime meqenëse lejen e këtij Kuvendi nuk e keni. Pra, me lejen e kujt po shkoni në këtë bisedime, sepse lejen e Kuvendit nuk e keni.

Sa i përket qartësisë dhe agjendës. Si mund të pretendosh qartësi në negociata, kur tri ditë para se të shkoni në ato negociata, del ai ndërmjetësi Riçard Grenelli me një ide si puna e Shenzhenit në Kinë, dhe thotë që në Kosovë do ta sjellim kapitalizmin. Ndërkaq këtu na u prezantua si ide e

mirë, që Shenzheni qenka një zonë ekonomikisht e zhvilluar e tjera e tjera. Por, kjo është vetëm me grithë sipërfaqen për ata që nuk e dinë sesi është puna e Shenzhenit.

Shenzheni si qytet, si zonë ekonomike është themeluar prej liderit të atëhershëm të Kinës, kur është ndryshuar, Deng Xiaoping, edhe ka vendosur që ta testojë sistemin kapitalist në vitin 1980, por nuk ka qenë kjo ideja kryesore.

Qëllimi kryesor ka qenë Hong-Kongu, sepse Shenzheni është qytet që e lidh Kinën me Hong-Kongun, e Hong-Kongu ka qenë i kolonizuar prej Britanisë së Madhe. Pra, Hong-Kongu ka qenë i kolonizuar nga Britania e Madhe për 100 vite dhe plani ka qenë që Hong-Kongu t'i kthehet Kinës në vitin 1997. Pra, 17 vjet më parë, Kina ka vendosur që ta themelojë një qytet afër Hong-Kongut, një zonë ekonomike, në mënyrë që ta bëjë sa më atraktive edhe ta rimarrë Hong-Kongun sa më lehtësisht që është e mundur. Pra, Hong-Kongu ka qenë koloni britanike, në vitin 1997 i është kthyer Kinës.

Tash, çka dua t'ju pyes unë juve: A pajtoheni me të vërtetë me këtë ide, që mes Kosovës dhe Serbisë të ketë një Shenzhen, zonë ekonomike edhe cila këtu nga qenka Hong-Kongu, e cila Kina? Pra, cila është zona e kolonizuar që do t'i kthehet Kinës, se po e shoh që nuk e keni të qartë ku po hyni.

Kjo nuk ka të bëjë asgjë me ekonomi, kjo është prelude për diçka shumë të rrezikshme me të cilën po e fusni vendi.

Andaj, ju lus edhe një herë që të më përgjigjeni se a keni agjendë? Çfarë do të diskutohet në ato bisedime? A keni agjendë për Bruksel? Çka do të diskutohet në Bruksel?

Jo po thoni, puna e Kushtetutës, e kemi platformën. E kemi parë qysh e keni pasur edhe kur e keni bërë Zajednicën. Kanë dalë 24 shkelje kushtetuese, 24, kur e keni bërë Zajednicën. Edhe atëherë keni thënë, po shkojmë të negociojmë duke u bazuar në Kushtetutën e vendit.

Pra, fjala e juaj nuk është se ka ndonjë peshë të madhe, kur hiq më larg se tre muaj, ju i gënjyet 2 milionë shqiptarë. E gënjyet komplet popullin e Kosovës. E tradhtuat votën e popullit për çka ju kishin votuar edhe për çka i kishit bindur. Ngase të gjithë menduan se më në fund ndodhi ndryshimi, së bashku e sollëm ndryshimin, por ju e tradhtuat atë votë. Tash, ju dilni këtu dhe thoni, na besoni ju lutem kësaj here se nuk do t'ju gënjejme.

Ky është problemi, nuk ka besim për juve më. S'ka, beso për juve më. Është harxhuar ai besim që sa herë.

Prandaj, edhe një herë; kujdes ku po hyni edhe çfarë preludi po shkaktoni se duhet t'i studioni pak më shumë, jo t'i merrni informatat tri ditë përpara edhe të mendoni se po bëni diçka të zgjuar. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Abelard Tahiri e ka fjalën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, e nderuara kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër,

E dëgjuam disa herë kryeministrin që tha platforma ime do të jetë Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Pra, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është akti më i lartë juridik i shtetit tonë dhe besoj që këtë e ke për obligim që ta respektosh.

Në anën tjetër, mendoj që duhet ta kesh një dokument, i cili do duhej që t'ju prezantohej sot deputetëve të Kosovës, para fillimit të këtij procesi.

Të nderuar deputetë,

Në një hark kohorë prej 6 muaj patëm një taksë kundër Serbisë, zëvendësimin e saj me reciprocitetin dhe tash tërheqje nga reciprociteti. Të gjitha këto të ndërlidhura me procesin e dialogut.

Ky realitet tregon sesi duhen këta pushtetarë të cilët nuk e kanë brengë shtetin, por realisht pushtetin. Kjo sjellje e tillë në këta 6 muaj, ka të përbashkët tre kryeministra, ku e veçanta e këtij bashkësie është protagonzmi i tyre dhe pemës tij, eksperimentimi me shtetin e Kosovës.

Kur debati për taksën ishte shteruar nga ish-kryeministri Haradinaj, erdhi kryeministri Kurti, që me një melodramë e hoqi atë pa dinjitet. Ashtu siç ishte vet pa dinjitet, pa dinjitet e vendosi reciprocitetin, në orën e fundit të tij si kryeministër.

Ndërkaq, kryeministri aktual, Avdullah Hoti, që në orën e parë të tij e tërhoqi këtë vendim.

Pra, kryeministri Haradinaj nuk i fitoi zgjedhjet me taksën, e Albin Kurti e humbi për 50 ditë atë që e fitoi, ndërsa Avdullah Hoti që sot s'ka fituar asgjë, po përpiqet që ta vendos një agjendë mbi humbësit tjerë para tij.

Para se të pyesim se kush çka humbi e çka fitoi, pyetja që sot duhet ta shtrojmë është, çka humbi e çka fitoi Kosova nga kjo politikë?

Pra, morën vëmendjen mediatike brenda dhe jashtë vendit, sesi Kosova nëpërmjet taksës, e pambështetjen e partnerëve të saj strategjikë, po i bën bisht dialogut. Morën vëmendjen mediatike, brenda dhe jashtë vendit, sesi Kosova po e heq taksën për reciprocitetin, duke e kushtëzuar dialogun jashtë parametrave të bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Dhe, tash së fundmi, po e marrim vëmendjen mediatike brenda dhe jashtë vendit, sesi Kosova pas kurtheve që i ngritën pushtetarët e saj, po i rikthehet dialogut pa taksë, pa reciprocitet e qe besa edhe pa dinjitet. Kjo, të nderuar deputetë, është ajo që e kemi sot. Nuk kemi fituar asgjë, veç kemi humbur kohë për shkak të mungesës së vizionit e strategjisë dhe nevojës së protagonizimit të të tre kryeministrave të Republikës së Kosovës, pra këtyre tre të fundit.

Sot, jemi ftuar këtu me shkas nga partia e Albin Kurtit për t'u marrë me kurthet që i la pas vetes, pikërisht Albin Kurti. Pra, si manipulues që është, në orën e fundit vendosi reciprocitetin në letra, i vetëdijshëm se një hap i tillë veçse e komplikon edhe më shumë agjendën e shtetit tonë, në rrethana në të cilat gjendemi.

Ai e ka ditur mirë, se një hap i tillë është pengesë për një agjendë për paqe e normalitet në të cilin jashtë përfshirë direkt partnerët tanë strategjik, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

Ai thjesht, ka zgjedhur t'ia bëjë një pengesë më shumë Kosovës dhe aleatëve të saj përballë Serbisë. Pikërisht, me këtë veprim, Albin Kurti arriti që partneritetin special mes Kosovës dhe SHBA-së e shndërroi në sanksione të SHBA-së ndaj Kosovës.

Amerika sipas tij, na u bë rreziku më i madh për popullin tonë. Shtëpia e Bardhë që për ne shqiptarët ishte dhe vazhdon të jetë shtëpi e shpresës, Albin Kurti, e portretizoi si shtëpi të thikave mbi Kosovën. Pra, ai e ka zgjedhur ta bëjë atë që di më së miri, mashtrimin dhe sabotimin. Kur ai mashtron e saboton, nuk merr përgjegjësi, sepse nuk e ka në mendje qytetarin në emër të të cilit ai thirret.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para 21 vjetësh me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me ndihmën e NATO-s, i kemi dhënë fund robërisë dhe jemi çliruar nga Serbia, por siç duket, ajo nuk është çliruar ende nga ne.

Ne e kemi fituar e ajo e ka humbur luftën, e bashkë me të, e ka humbur përgjithmonë Kosovës, por nuk i ka shuar shpresat. Andaj, padyshim që edhe ky konflikt duhet të marrë fund. Kjo është ajo që na intereson edhe neve dhe i intereson edhe aleatëve tanë si Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pa dyshim edhe Bashkimit Evropian.

Prandaj, dialogu është i paalternativë dhe masat që e pengojnë atë janë të pavend.

Sa i përket temës së kësaj seance se a jemi ne si PDK, për reciprocitet a po jo. Kjo është çështje shumë e thjeshtë dhe tashmë e thënë, nuk jemi për reciprocitetin e Albin Kurtit si kurrë kundër Kosovës në këtë kohë dhe nuk jemi për statusin e Avdullah Hotit si mungesë e zgjidhjes pa afat.

Nuk jemi për reciprocitet formal e të pakuptimtë që e fundos mbështetjen e SHBA-ve ndaj Kosovës, kur SHBA-ja na do në dialog, dhe as nuk jemi për hapje afatgjate përballë Serbisë nëse dialogu nuk ka efekt. Pra, jemi për qytetarët, për shtetin dhe interesat e tij të sinkronizuara me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kjo Qeveri e prirë nga LDK-ja, nuk mund t'i bëjë ballë as për së afërmi ndryshimeve që i duhen vendit. Nuk është e aftë për t'ju bërë ballë sfidave që e presin Republikën, prej atyre emergjente, si pandemia e rimëkëmbja ekonomike, tek ato si dialogu e integrimi, rendi dhe ligji si dhe zhvillimi. Pra, këtë po na e dëshmon edhe sot në këtë debat parlamentar, kryeministri Hoti.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Me ikjen e një mashtruesi e me ardhjen e një përfituesi, me zhbërjen e koalicionit të shpresave të rreme, e me ndërtimin e koalicionit të interesave të rreme, vërtetë ne si opozitë kemi shumë punë para vetës.

Do të jemi këtu për qytetarët dhe për institucionet, për demokracinë dhe për të ardhmen. Kosova meriton më shumë se kjo. Por, padyshim se një ditë shumë të afërt do ta ketë edhe atë me qeverisjen e Partisë Demokratike. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetare!

Unë e tërhoqa me kohë fjalën, po do të dëshiroja një replikë të vogël me atë i cili diskutoi paraprakisht.

Kur e dëgjon diskutimin e tij, vërtetë të krijohet përshtypja që Lëvizja Vetëvendosje që këto 20 vite ka qenë në pushtet, e jo ky i cili po flet për të gjitha këto në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

Ky që tani foli para meje, faktikisht është ai i cili e ka filluar dialogun me Serbinë me një flluskë bore, e cila flluskë bore e ka sjellë gjendjen e Kosovës, në këtë pikë në të cilën sot e kemi Kosovën.

Po ky është ai i cili ka gënjyer qytetarët e Kosovës për krejt këto vite, që duhet dhënë tokë Malit të Zi, sepse pason liberalizimi për qytetarët e Kosovës, dhe po i njëjti na shet demagogji sot në emër të PDK-së, sepse na qenka vetëm ajo e cila punon për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj që nuk kemi nevojë për demagogji të tilla, sepse ne e kemi parë yrnëkun e tyre, e kemi parë punën e tyre dhe kjo punë dhe ky yrnëk i tyre bashkë me këta që sot janë në Qeveri, i kanë sjellë qytetarët e Kosovës në këtë pikë dhe shtetin e Kosovës në këtë pikë. Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë, Abelard Tahiri!

ABELARD TAHIRI: Ndoshta e ngatërrove pak, unë s'foli në emër të Vetëvendosjes, po foli në emër të Partisë Demokratike, por po të kapin emocionet dhe s'ke faj. Faleminderit!

Shiko, kur e shoh se kush po flet, kush po flet në emër të Vetëvendosjes, vërtetë është interesant. Pra, personi që sapo foli, për dy mandate e ka udhëhequr arsimin në Komunën e Podujevës, dhe imagjinoi në Komunën e Podujevës a e dini sa është nota mesatare? 2.62. Pra, nuk ka ku të shkojë më keq.

Imagjinoi se çfarë i ka bërë arsimin në një vend, një njëri si ky që sot Vetëvendosja e ka qit që të garojë për komunën e llapit. Pra, shikoni se çfarë niveli kemi deputet në Kuvendin e Kosovës. Nota mesatare në Komunën e Podujevës është 2.62, dhe ai që foli në emër të Vetëvendosjes e ka drejtuar për dy mandate këtë komunë.

Juve, vërtetë që ju pengon zhvillimi që është bërë 20 vite, por ju nuk dini as ta definoni se në çfarë gjendje e ke sjell arsimin në komunë, sepse s'mund ta përmendi. Pra, vërtetët e ke problem që ta definosh të mirën prej të keqes. Faleminderit!

KRYETARJA: Kundër-replikë, z. Bulliqi!

SHPEJTIM BULLIQI: Shiko, është për të të ardhur keq se kush e vlerëson arsimin, për arsye se po flet për arsimin një njeri, i cili s'ka të bëjë fare me arsimin. Ky njeri e ka udhëhequr një ministri të cilën e ka udhëhequr e që dimë të gjithë, dhe ky njeri për punën e mirë që e ka bërë me rastin e noterëve, lënda e tij është në proces gjyqësor.

Andaj, ky duhet të merret me gjyqin dhe ta shohë se çfarë pune të mirë e ka bërë për interes të këtyre qytetarëve.

KRYETARJA: Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Duke e përcjellë të gjithë këtë debat dhe duke e parë këtë mosqartësi për negociatat që po na presin, po dua t'i bëj vetëm ndërlidhjet dhe paralelet me negociatat e Brukselit të cilat janë udhëhequr nga Hashim Thaçi. Cilat janë të përbashkëtat?

Të përbashkëtat janë, e para, heqja e reciprocitetit. E dyta është, premtimi që në fillim për njohje reciproke dhe të tjerat pastaj janë ad-hoc tema të cilat dalin aty për aty.

Dua tua përkujtoj që ai proces negociator i Brukselit ka përfunduar me marrëveshjen e prillit 2012 dhe pastaj me Zajednicën. Zajednica ju ka mbetur juve në duar. Ju e patët nënshkruar atëherë, Isa Mustafa. Ndërkaq, themelin e saj e pati bërë Hashim Thaçi, në atë marrëveshjen që qe nënshkruar këtu.

Situatë të ngjashme kemi edhe sot. Në themelin e ndërtuar të një marrëveshjeje të cilën ne nuk po e dimë, ju do ta vendosni vetëm një nënshkrim mbase, dhe do ta kryeni një punë të njëjtë për Hashim Thaçin siç e patët bërë edhe atëherë.

Çka po ndodh në këtë situatë? Ju se di a po e vëreni, qysh sot jeni të braktisur dhe të manipuluar dhe në çfarë pozite keni mbërri. Pra, jeni të instrumentalizuar komplet nga Thaçi, e nga ana tjetër, PDK po rrinë në terur, atje po ju godet sa po mundet, në ndërkohë që e gjithë punën jeni duke ia kryer asaj.

Agjenda është e tyre. Kjo agjendë është agjendë e tyre. Këtë agjendë të kësaj marrëveshjeje, është agjendë e PDK-së. Ju s'jeni duke bërë asgjë tjetër, veç jeni duke e kryer punën për ta, e dajakun po e hani dhe mirë e keni.

Po kthehemi vetëm të një manipulim që ndodhi pak më herët, po flas për Memli Krasniqin. E përmendi, tha, mos aplikimin për INTERPOL dhe ky është kulmi i manipulimit, dhe cili ishte manipulimi i Memlit sot aty, është komplet kësaj. Pra, ajo retorikë, është e njëjta.

Ju kujtohet që herën e kaluar kur është aplikuar për INTERPOL në Dubai, është dështuar në atë aplikim. A e dini pse ka dështuar? Shanset kanë qenë, por ju e keni dështuar vet. Ju e keni dështuar vet, sepse keni shkuar ndaras, në njërën anë presidenti, në një anë ministri i Punëve të Brendshme, dhe miqtë të cilët na kanë njohur si shtet, nuk kanë votuar atëherë.

Ku ndodhi kjo? Në vendin ku ne i patëm miqtë. Pse ka ndodhur? Sepse, a e dini bre se çfarë i keni bërë Ministrisë së Jashtme? A dini bre me ata dajë e mixhallarë e hala e teze, ia keni shkatërruar komplet cilësinë, s'di kush ka ditur të bëjë me keq në të.

Qysh po mendoni tash ju, se si kur të aplikoni ne atëherë kur mbledhja e INTERPOL-it në Argentinë, si do të dilnim ne. Të dështojë për së dyti? Njëherë ju dështuar, na bëtë horë, e tash të

aplikojmë për së dyti në Argjentinë, në vendin ku gjasat që do të mund të realizohej ai aplikim ose ai anëtarësim, ishte i pamundur.

Shumë më mirë do të ishte që në aplikimin e radhës që do të vinte, të përgatiteni pra tash për këtë radhës, ja ku e keni. Në vitin që vjen do ta kemi aplikimin për INTERPOL në Turqi, kemi vende mike shumë, kemi mundësi lobimi shumë më të madhe, kemi kohë shumë më tepër që të përgatitemi dhe ta kryejmë anëtarësimin në Interpol.

Anëtarësimi në Interpol gjatë këtij viti me një mandat sapo të marrë, në Argjentinë, në një ambient jo shumë të këndshëm dhe miqësor për Republikën e Kosovës, realisht do të ishte një mision, i cili do të përfundonte prapë me një dështim, i cili do t'i kushtonte Kosovës shumë më tepër.

Pra, jemi të gatshëm që edhe ne edhe të gjithë të tjerët, të ndihmojmë në aplikimin e radhës që do të mbahej në Turqi. Po eja të punojmë prej tash. Të punojmë prej tash, me miq e me krejt u i kemi.

Ndërkaq, me gjendjen çfarë e kemi pasur, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bën vakia do ta humbim, me atë diplomaci të shkatërruar që e ka Republika e Kosovës sot.

Prandaj, e njëjta logjike e manipulimit të tillë, sepse këtë punë ju e dini, e dini shumë qartë. Ju e dini sesi është gjendja në diplomacinë tonë. E dini, sepse vet e keni ndërtuar.

I njëjti mekanizëm është sot kur bëhet fjalë për negociatat. Këtu na e keni sjellë një rezolutë. E keni sjellë një rezolutë në të cilën nuk ka kurrfarë lloj këtu. Asnjë lloj kufizimi, i cili do të mund të ishte si binar përcaktues për rrjedhën dhe agjendën e negociatave të negociatorëve që shkojnë në Uashington.

Po, çfarë ka këtu? Këtu ka raportime. Bëhet fjalë për raportim. Të vijë z. Hoti këtu para se të shkojë në SHBA, dhe sa herë të kthehet të vijë po ashtu dhe të raportojë. Situatë të ngjashme ne kemi pasur edhe kur ka ndodhur Brukseli. Edhe kur kanë qenë negociatat në Bruksel asokohe, kemi pasur raportime të Hashim Thaçit.

E mbaj në mend se çfarë kanë qenë ato raportime. Ato raportime kanë qenë totalisht formale, ku ne të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës as që e kishim idenë se për çfarë po flitet atje. Ajo u mor vesh, tek kur kërciti marrëveshja në fund, e cila kur kërciti, më ishte e pamundur që të ndalej. Atëherë, u votuar me 2/3.

Ju po thoni që ne shkojmë në Uashington dhe kur shkojmë atje e shohim sesi është puna, dhe atëherë mbase as nuk e nënshkruajmë. Mirëpo, kur të shkonit atje brenda, edhe të mos e

nënshkruani, kostoja për Republikën e Kosovës do të jetë shumë më e madhe se sikur të mos shkonit tash.

Kur të nënshkruani e kur ta sillni këtu në Kuvend atë marrëveshje të cilën e keni nënshkruar në Uashington, 2/3 bëhen shumë shpejt, dhe pastaj e kemi në tavolinë një situatë të pakëndshme. Ishalla s'janë disa harta që i kam parë unë. Ishalla s'janë disa fshatra të Preshevës këndeje, e një pjesë e territorit të Veriut andej, e një copë Presheve në këtë anë, e as Bujanoci këndeje. Ishalla nuk është kjo, po ishalla nuk është as ajo zona për të cilën na foli Hekuran Murati, se kjo e dyta po del të jetë edhe më e keqe se e para.

Prandaj, ajo që është mesë e domosdoshme, është që këtu të përcaktohen kufijtë, të përcaktohen binarët e qartë se ka do të shkojmë, deri ku shkojmë dhe qysh e marrim vendimin.

Ne kemi dakord, ka pasur edhe tryeza, edhe në tryeza patëm ardhur. Na patët ftuar atëherë. Patëm ardhur edhe në ato tryeza, ku kemi thënë shumë qartë se për sa i përket marrëveshjeve me Serbinë, kemi qenë të gashtën që të bashkëpunojmë gjithmonë dhe mbase që të mirat e secilit në historinë e vet, t'ia kujtojmë, t'ia mbajmë në mendje sesi kanë qenë, mirëpo ju nuk jeni të interesuar për atë, sepse kjo do ta pengonte atë. Juve nuk intereson pengesa. Juve nuk ju intereson që të keni marrëveshje cilësor, juve po ju intereson vetëm të mos ndalet dialogu. Ju i hoqët pengesat. Ju hoqët edhe reciprocitetin, njëjtë sikurse atëherë që qe hequr në 2011-ën dhe hoqët dorë nga aplikimi në organizatat ndërkombëtare.

Këto dy vendime, janë simptoma e qartë e marrëveshjes të cilën ju do të na sillni, e që definitivisht do të jetë një marrëveshje e keqe, dhe nëse arrin të ndodhë ajo, atëherë frikësohem që do të jetë tepër vonë dhe duke e ditur se kur të nënshkruhen marrëveshjet atje, e dimë sesi ndodh në këtë Kuvend kur vijë puna te votimi.

Ju kujtohet juve LDK-së, se kemi qenë atëherë bashkë në opozitë, kur ishte bërë marrëveshja në Bruksel e që ishte votuar këtu, kemi qenë bashkë në opozitë, e kemi kundërshtuar deri në ditën e fundit, bashkë e patëm kundërshtuar siç i patëm kundërshtuar edhe plotë ligje, dilnim bashkë, ju ktheheshit, ne mbetnim në sallë. A ju kujtohet? Përvojën e asaj kohe, unë e di shumë mirë.

Në fund kur erdhi puna te votimi i marrëveshjes, nuk pati forcë që mund t'ju bindte juve që të ndaleshit e të mos e votonit atë marrëveshje, edhe pse kritikën ia patët bërë shumë të mirë gjatë të kohës. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Memli Krasniqi, replikë!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Liburni tha, Memli Krasniqi ka manipuluar e unë prita dhe njëmend thash, çka gabova.

Unë ju thashë që këta kanë vendosur, Qeveria e Albin Kurtit ka vendosur që të mos aplikojë për INTERPOL, dhe ky veç e konfirmoi që kanë aplikuar. Mirëpo arsyetimi ishte sipas tij, se në Argjentinë është vështirë.

Shiko, ka qenë vështirë të anëtarësohesh në secilën organizatë. Ka qenë e vështirë të anëtarësohesh në Bankë Botëror, në Fondin Monetar Ndërkombëtare, në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, besa goxha vështirë në Organizatën Botërore të Doganave edhe në shumë organizata të tjera, po ne u patëm anëtarësuar dhe i kemi kryer ato punë ne.

Absolutisht që është vështirë për Kosovën që të anëtarësohet në çdo organizatë. Ju a keni menduar se është e lehtë? Ju na keni shikuar në televizion duke i kryer punët ne, dhe keni menduar që po kryhen lehtë. Përreth tre muaj sa keni qenë në Qeveri, e keni parë sa zor është. Ne e dimë që është vështirë.

Thatë që Argjentina është problem. Nuk është Argjentina problem, ashtu siç nuk ka qenë problem as Dubai. Në Duabi, apo në Emirate të Bashkuara në fakt, ku është mbajtur në Abu Dabi, nuk kanë shkuar shumë ndaras, dhe besoj që ju e keni me të dëgjuar. Sikur të fliste Rexhep Selimi, ma merr mendja që e di më saktë, sepse ka qenë atje si kryetar i Komisionit për Siguri dhe aty kanë qenë të gjithë, ministri i Jashtëm, presidenti, ministri i Brendshëm, Komisioni për Siguri dhe kanë pasur goxha optimizëm që do të kryhet ajo punë.

Po ta tregoj arsyen që unë besoj që s'është kryer. Ka qenë një arsye shumë e thjeshtë. S'është kryer se s'e kemi pasur mbështetjen e partnerit tonë kryesor, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pse? Sepse kanë qenë hidhërueshëm. Siç kanë qenë hidhërueshëm me Qeverinë e Albin Kurtit, kanë qenë hidhërueshëm në atë kohë me Qeverinë e Ramush Haradinajt, për shkak të taksës. Nuk e kemi pasur mbështetjen siç e kemi pasur herëve të tjera, e ky është problemi kryesor.

Pse a përnjëmend mendove se kjo punë do të kryhej vetëm me kapacitetin e diplomacisë? As të asaj ministrie e asaj të kësaj ministrie, nuk kryhen punët aq lehtë. Pa mbështetjen e partnerëve kryesor ndërkombëtare, kjo punë nuk ndodhë.

Përndryshe, për bashkim që fole. Po ju veç në një konferencë keni shkuar në Mynhen, Qeveria i ka pasur dy delegacione dhe kryeministri Kurti dhe zv/kryeministri Hoti s'kanë qenë në gjendje që të shkojnë së bashku, kanë shkuar me dy delegacione.

KRYETARJA: Kundër-replikë, Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: Ju sapo e thatë të njëjtën, të cilën e tha edhe z. Selmanaj pak më herët. Pra ju e besoni të njëjtën gjë. Ju e besoni që këtu në këtë vend gjithçka bëhet vetëm prej ndërkombëtarëve.

Unë jam dakord që pa ndihmën e ndërkombëtareve nuk mund të zgjidhen shumë probleme, por jo pasur edhe iniciativë të brendshme.

Prandaj, në të gjitha këto iniciativa e sidomos të asaj në Dubai për të cilën fola, pa pasur punë diplomacia e vendit, të mos mendoni që të gjithë vinë dhe na i kryejnë punët të tjerët dhe na anëtarësojnë e ne vetëm do të shkojmë të shikojmë aty dhe të jemi formalisht.

Po kur shkon diplomacia e vendit tonë në nivelin çfarë është, e që është nivel për t'u vajtuar, natyrisht që rezultate do t'i kesh të tilla dhe me këto kapacitete, pa i ndryshuar dhe pa i përmirësuar ato, nuk do të ketë sukses.

Ato sukseset për të cilat fole që kanë ndodhur në shkuarën, përmendi...

KRYETARJA: Të nderuar deputetë, në veçanti kryetarë të grupeve, ju dëshiroj t'ju pyes, a jeni të interesuar të vazhdojmë sonte? Janë edhe për afërsisht 20 folës. Po edhe ashtu nuk jeni duke debatuar, vetëm deputetët janë duke folur, kështu që le të jetë zgjedhje e juaja.

I lus kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen, a janë të interesuar që ta shtyjmë debatin për një ditë tjetër apo të vazhdohet sonte deri në fund?

Zoti Selimi, e keni fjalën.

REXHEP SELIMI: Kësaj radhe e mora fjalën me të drejtën e replikës, për një saktësim, që Memli iu referuar asaj që pati ndodhur në Dubai. Pra, në Emiratet e Bashkuara, në Dubai është mbajtur Asambleja e Përgjithshme e INTERPOL-it, ku kam qenë pjesë e grupit punues.

Po ua rikujtoj edhe një herë që atje nuk kemi qenë të gjithë së bashku, sepse në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it, nuk ka qenë as ministri i Jashtëm e as presidenti, kanë qenë në njërin nga hotelet, po jo në Asamble. Në Asamble ka qenë grupi ynë punues.

Por, ajo çfarë mu kujtua mua tash, për saktësi po ju rikthej edhe njëherë, sepse nga Dubai, nga konferenca patëm ardhur direkt këtu dhe u pata përpjekur që tua shpjegoja edhe atëherë kolegëve deputetë, që është pak indikativë, mirëpo po ma kthen edhe njëherë aktualitetin e kësaj çështjeje.

Pra, sapo dështuam, çuditërisht meqë ishim në avantazh me vota, presidenti Thaçi në atë kohë u kujdes që në minutat e parë pas dështimit, ta bëjë një status në facebook dhe tha, po mundohem

ta parafrazoj: Ja pse ne nuk mund të integrohemi dhe të vazhdojmë me integrimet, prandaj, duhet t'i kthehemi menjëherë dialogut.

Do të thotë se la të kuptohet që pa dialog me Serbinë, ne nuk mund të integrohemi.

Pra, nëse nuk është kështu, mund të më korrigjoni. Ndoshta se kam cituar saktësisht, por e parafrazova. Edhe sot, i njëjti mesazh po na jepet. Ne që të integrohemi duhet të diskutojmë me Serbinë, e njëkohësisht kemi hequr dorë nga kërkesa për aplikim në organizatat ndërkombëtare.

Prandaj, është situatë e njëjtë. Kjo është situata sa për tua sqaruar juve, z. Krasniqi.

KRYETARJA: Kundër-replikë, e pastaj kthehemi edhe njëherë që t'ju pyes se a dëshironi që të vazhdojë debati apo jo.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Zoti Selimi, unë ju përgëzoj qysh po i mbani në mendje statusat, unë s'i mbaj në mendje as statusat e mi që i kam shkruar para dy viteve, që të mos rrej, më duhet të hy t'i shikoj.

Nuk e di çfarë ka shkruar, nuk i kam përcjellë këto detaje nga afër se s'kam qenë në atë komision, po e di që keni qenë goxha një numër i madh, të gjithë jeni përpjekur dhe të gjithë keni punuar, po në fund e vërteta është se s'kemi pasur sukses.

Unë e dhashë mendimin tim, nga ato që unë i di, se pse s'kemi pasur sukses. Nuk thash që kjo varet vetëm prej tyre, por desha tua them dhe po ua përsërisë, veç vet, pa mbështetja ndërkombëtare ne nuk mund t'i arrijmë sukseset që na nevojiten.

Përndryshe, ja qenë shumë e thjeshtë, ju keni qenë në Qeveri, e keni pasur Ministrinë e Jashtme, keni pasur plane të mëdha, keni shkarkuar ambasadorë, keni mundur të emëroni ambasadorë, ta bëni një plan dhe të bëheni gati deri në Buenos Aires, për të aplikuar. Por, keni vendosur të mos aplikoni me vetëdije të plotë dhe kjo është e vërteta.

KRYETARJA: Daut Haradinaj, replikë!

DAUT HARADINAJ: Kryetare, më shumë sa për ta shpjeguar, se e dëgjova Memlin kur tha që ishim të hidhëruar në atë kohë nga aleatët tanë, rreth ish-kryeministrin, kur ishte fjala për anëtarësim në INTERPOL.

Desha t'ia rikujtoj se pasi dështuam në anëtarësim në INTERPOL në Abu Dabi u vendos taksa 100%. Pra, ajo ishte pasi dështuam. Si derivat i dështimit të INTERPOL-it, ne vendosëm taksën 100%.

Ndërsa sa na u kanë hidhëruar, pikërisht ishte Sekretari i Mbrojtjes Matiss që na uroj ushtrinë edhe sot e kemi, sepse nuk u hidhëruan hiq.

KRYETARJA: Kundër-replikë, z. Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Daut, unë isha i saktë. Nuk thash që kanë qenë të hidhëruar me Ramushin, thashë që kanë qenë të hidhëruar me Qeverinë Haradinaj, e ne kemi qenë pjesë e asaj qeverie. Andaj, nuk mundemi e as s'e kemi ndërmend që t'i ikim përgjegjësisë që e kemi pasur edhe për sukseset e asaj qeverie, po edhe për gabimet që i kemi bërë bashkërisht në atë qeveri.

Për pjesën tjetër kemi diskutuar shumë herë, edhe për punën e ushtrisë edhe kush na e ka bërë për hair edhe si na e kanë bërë për hair edhe qysh na e kanë bërë për hair edhe kush na ka ndihmuar. Edhe ushtrinë, siç edhe u konfirmuar ajo që e thash pak më herët, ne dimë që s'do të mund ta bënim pa partnerët amerikanë. Unë prapë qëndroj pas mendimit që ne s'mund ta arrimë asnjë sukses ndërkombëtarë pa amerikanët, ky ishte fundi i fjalës time.

Pra, unë thash se ku është Amerika, mirë është të jetë Kosova, sepse ne duhet që më së shumti dhe më së pari t'ju besojmë atyre.

Ky është absolutisht edhe qëndrimi që e kemi pasur atëherë e që e kemi edhe sot.

KRYETARJA: Zoti Selimi, a jeni të interesuar që ta vazhdojmë debatin? Pastaj, z. Gashi e merr fjalën pas jush.

REXHEP SELIMI: Unë mendoj që këtë debat do të mund ta shkurtonte vet z. Hoti, nëse do të na përgjigjej në të gjitha pyetjet që ia kemi bërë. Përgjigjuni më shpejt, pastaj shko fli dhe je më i pushueshëm për nesër.

Përderisa ne s'kemi marrë përgjigje akoma nga ju, në disa pyetje, të mos them në dhjetëra pyetje, ne jemi të detyruar prapë të insistojmë që t'ju pyesim, meqë deputetët vërtetë kanë shumë pyetje.

KRYETARJA: Z. Gashi e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, znj. kryetare!

Ne si koalicion qeverisës, jemi deklaruar që i respektojmë dëshirat e opozitës dhe opozita e ka një dëshirë të theksuar që të flasim. Ne do t'i dëgjojmë dhe do t'ju përgjigjemi për ato që ne vlerësojmë se është e duhur që të përgjigjemi.

Pra, do t'i keni përgjigjet e duhura në kohën e duhur dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

Gjithsesi, Kuvendi është për diskutime dhe debate dhe z. Selimi, Rexhep Selimi, po më fal, se nata vonë po jep pasoja. Do t'ju dëgjojmë edhe pse është natë e vonë do ju dëgjojmë, edhe pse kryeministri ka për të udhëtuar nesër, edhe ai do ju dëgjoj. Andaj, shpresoj që keni gjëra të rëndësishme për të thënë. Faleminderit!

KRYETARJA: Jemi duke folur për procedurë, po në rregull, replikë. Z. Selimi, replikë.

REXHEP SELIMI: Mos u ankoni që është vonë, sepse ju Qeverinë e keni formuar në orën 01:00 të natës.

KRYETARJA: Kundër-replikë, z. Gashi!

ARBEN GASHI: Zoti Selimi, për cilën qeveri e ke fjalën, atë që kemi qenë bashkë apo këtë tash? Në rregull, se më duket edhe në atë që kemi qenë bashkë si njësoj e patëm bërë. Faleminderit!

KRYETARJA: Zoti Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, znj. kryetare!

Sipas kësaj që po e shohim, janë edhe 16 deputetë të lajmëruar për diskutim. Nëse shkojmë edhe kah 10 minuta, bëjnë edhe 3 orë.

Në këtë kohë, debati bëhet jo veç për neve në sallë, por debati bëhet që edhe qytetarët e Kosovës t'i shohim qëndrimet e secilit deputet edhe secilit grup parlamentar.

Prandaj, ne mendojmë që ky debat mund të vazhdojë edhe pa kryeministrin. Kryeministri i ka punët e veta, i vazhdon punët e veta, ne mund të vazhdojmë diskutimet.

Prandaj, ne mendojmë që duhet të ndërpritet seanca sonte, me kusht që të vazhdojë në një ditë tjetër kur është e përshtatshme dhe kur ne merremi vesh si grupe parlamentare, këtë javë.

KRYETARJA: Grupet tjera parlamentare, Daut Haradinaj, urdhëro.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Para se të deklaroj qëndrimin, desha edhe një herë t'ia shpjegoj z. Krasniqi se unë nuk i replikova, unë më shumë e shpjegova një rast.

Sigurisht, njëra prej arsyeve pse nuk jemi anëtarësuar në INTERPOL, dihet që janë shumë anëtare, shtete të treta, ku Serbia e ka fuqinë po edhe rusët edhe kinezët, dhe nuk është hera e

parë që kemi dështuar, por të paktën tri herë kam qenë edhe vet i involvuar që kemi dështuar në anëtarësim.

E di që vështirë është ta kesh një rol ose një angazhim aq të fuqishëm pa përkrahjen e SHBA-ve, rreth anëtarësimit në organizata të ndryshme.

Ndërkaq, po duket që një subjekt politik këtu rreth teje, kah fundi, më shumë është duke drejtuar pyetje parlamentare, dhe nuk e di pse s'kanë drejtuar pyetje parlamentare me shkrim dhe ndoshta kryeministri edhe nga Uashingtoni do t'ju kthejë përgjigje.

Po si do që ta vlerësoni, ne jemi të hapur.

KRYETARJA: Grupet tjera nuk janë prezent, edhe ashtu për të votuar diçka nuk kemi kuorum, po meqenëse dy grupet tjera sa po e shoh kanë interesim që të vazhdojë debati...Edhe një herë z, Selimi.

REXHEP SELIMI: Ne konsultim me grupin parlamentar, ne i tërheqim fjalimet tona.

KRYETARJA: Zoti Gashi, urdhëroni!

ARBEN GASHI: Ne si shumicë qeverisës, respektojmë vullnetin e opozitës. Besoj se u sqaruan për të gjitha ato që ishin të paqarta dhe e përfundojmë seancën, ndoshta me një rezolutë në se kemi kuorum për të votuar. Faleminderit!

KRYETARJA: Tani nuk kemi kuorum për të votuar në fund të kësaj seance. Diskutimet janë tërhequr nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje. E kemi një deputete të Grupit Parlamentar të PDK-së. A po e tërhiqni fjalën edhe ju?

Edhe deputetët e LDK-së e tërhoqën fjalën. Atëherë, vetëm z. Krasniqi meqenëse na e keni dhënë një propozim, një dokument. Ju lutem deklarohuni lidhur me propozimin tuaj, edhe pse kuorum për të votuar s'kemi, por ju lutem sqarojeni propozimin.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Atëherë, unë besoj si procedurë në përfundim të debatit, ne e kemi propozuar një rezolutë në lidhje me këtë pikë të raportimit të kryeministrit.

Meqenëse sot, siç thatë kryetare, nuk ka kuorum, unë kërkoj që rezolutën me tekst final, të cilën do tua dorëzojmë edhe juve zyrtarisht, ta vendosim për votim në seancën e radhës. Kryetare, a jeni këtu?

Po them, në seancën e radhës kisha kërkuar që këtë rezolutë ta vendosim për votim. Unë jua kam shpërndarë të gjitha grupeve parlamentare, këto që ishin prezent, tri grupe s'ishin, katër grupe ishim.

Kështu që, jemi të gatshëm që në ndërkohë ta diskutojmë, ta plotësojmë dhe nëse seancën e radhës, ndoshta si pikë të parë, para pikave që mund të vendosen të vendoset për votim. Faleminderit!

KRYETARJA: Atëherë, ju lus që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të konsultoheni në ndërkohë lidhur me këtë propozim-rezolutë.

Unë po propozoj që këtë seancë ta vazhdojmë të enjten në orën 10:00. Në qoftë se grupet parlamentare nuk pajtohen, ju lutem të më njoftoni dhe e ndryshojmë kohën në konsultim me juve.

Urdhëro, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, znj. kryetare!

Ta kemi parasysh se debati është përfunduar, mbetet që në seancën e radhës vetëm të votojmë për rezolutën. Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, zoti Selimi!

REXHEP SELIMI: Unë pajtohem me juve që seanca të vazhdojë të enjten. Aty kemi se çka të diskutojmë, sepse e kemi një projekt-rezolutë dhe së paku ne kemi nevojë që të diskutojmë për projekt-rezolutën.

Prandaj, pajtohem që kjo seancë të vazhdojë të enjten në orën 10:00. Faleminderit!

KRYETARJA: Po, po të enjten do të diskutojmë lidhur me propozimin, lidhur me tekstin, por ju lus juve grupeve parlamentare që ta shfrytëzoni ditën e mërkurë për të diskutuar lidhur me tekstin e rezolutës.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*